

Prof. Dr. Bekir Topaloglu

GRUAJA NË ISLAM

www.edukataislame.com

kuranotekaislame@edukataislame.com
edukataislame@edukataislame.com

“Xhenneti gjendet nën këmbët e nënës...”

Muhammedi a.s

*Shpirtit të gjyshit dhe mësuesit tim,
Muhammed Hanefi Kutluo ⇨lu
Zoti e mëshiroftë*

HUTBEJA LAMTUMIRËSE

Këtë hutbe në vitin 632 pas Isait a.s., i Dërguari i fundit, Muhammedi a.s. pas falënderimit dhe lëvdatës që ia bëri Zotit, pranë rreth njëqind mijë muslimanëve tha:

Njerëz!

Dëgjoni mirë fjalën time! Nuk e di, ndoshta me ju nuk do të takohem më deri në amshim. Njerëz sa e shenjt është kjo ditë, sa i shenjt është ky muaj, sa fatlum është ky qytet (Mekka), aq janë të shenjtë edhe shpirtërat tuaj, pasuria dhe nderi juaj që, gjithsesi janë të ruajtur nga të gjitha agresionet.

As'habë!

Nesër do të takoheni me Zotin tuaj dhe do të përgjigjeni për të gjitha sjelljet dhe qëndrimet tuaja. Pas meje mos u ktheni në rrugët e gabueshme që të mos therreni me njëri tjetrin. Këtë emanet (porosi të fundit) ju të pranishmit ua përcillni atyre që nuk janë të pranishëm këtu. Është e mundur që fjalët e mia t'i kuptojë më mirë ai të cilit i janë përcjellur se sa ai që gjendet këtu.

As'habë!

Kush është duke ruajtur ndonjë emanet, le t'ia kthejë pronarit të tij. Të gjitha fajdet janë asgjësuar dhe janë hedhur. Por bazën e borxhit duhet larë. S'duhet as të bëni zullum e as t'u kthehet ai. Me urdhër të Zotit, fajdeja tani në është e ndaluar. Këtë zakon të keq i ngelur nga koha e xhahilijetit (koha paraislamike, koha e injorancës) e hedh si zakon të keq. Fajden e parë që po e hedh është ajo e Abbasit, të birit të Abdulmutalibit (xhaxhait tim).

As'habë!

Gjakmarrja e kohës së xhahilijetit është zhdukur totalisht. Gjakmarrja e parë që po e zhduki është gjakmarrja e Rebijes, nipit të Abdulmutalibit.

Njerëz!

Sot djalli në tokat tuaja përgjithmonë e ka humbur fuqinë e ndikimit dhe të mbizotërimit ndaj jush. Por, përpos këtyre gjërave që ndalova, ju, po u pajtuat me djallin për disa punë që ju duken se janë imtësira, edhe më do ta kënaqni atë. Edhe nga këto duhet ta ruani besimin dhe duhet të frikësoheni.

Njerëz!

Do t'u porositja të keni parasysh të drejtat e gruas dhe frikën ndaj Zotit. Ju i morët gratë si emanet nga Zoti. Nderin dhe pastërtinë shpirtërore i pranuat në emër të All-llahut xh.sh.

Ju keni të drejta ndaj grave e edhe ato kanë të drejta ndaj juve. Të drejtat që keni ju ndaj grave janë që, ato të mos lejojnë që askush që nuk u pëlqen t'ua prishë çerdhen. E, nëse ajo pranon dikë në shtëpinë tuaj që nuk u pëlqen, ato mund t'i detyroni të heqin dorë nga kjo gjë, madje edhe me një të rrahur të vogël. E drejta e gruas ndaj jush është që t'i siguron legalisht me ushqim dhe veshmbathje.

Besimtarë!

Po u lë një emanet të atillë që kur ta përqaftoni nuk do të ngatërroheni fare. Është ky Kur'ani, Libri i All-llahut.

Besimtarë! Dëgjoni dhe mbani mirë në mend fjalën time! Muslimani është vëlla me muslimanin. Kështu, të gjithë muslimanët janë vëllezër. Askujt nuk i lejohet ta sulmojë të drejtën e bashkbesimtarit tuaj. Vetëm nëse ai vetë lejon një gjë të tillë, me dëshirë të veten.

As'habë!

Mos e mundoni as veten. Keni obligime edhe ndaj vetes.

Njerëz!

All-llahu i Lartësuar, secilit bartës të të drejtave, i ka dhënë të drejta në Ku'ran. Trashëgimtarit, nuk është e nevojshme t'i leni testament. Në shtratin e kujt ka lindur fëmija, atij i takon. Ai që fiton fëmijë nga marrëdhëniet jasht kurore, i mirret e drejta e përvetësimit të fëmijës. Ata bastardhues që thonë se nuk janë të babait të vet ose ai bukëpërmbysës që veç zotërisë së vet i përulet edhe dikujt tjetër, le ta gjejë mallkimi i Zotit, zemrimi i melekëve dhe përbuzja e të gjithë muslimanëve. Zoti s'pranon nga njerëzit e tillë as falje, as të jenë gjykues dhe as të jenë dëshmitarë.

Njerëz!

Zoti është një. Edhe babai juaj është një. Të gjithë jeni bij të Ademit. E Ademi është krijuar nga dheu. Para Zotit është më i çmueshëm ai që çmon më shumë. Arabi nuk ka asnjë prioritet nga joarabi, përveç masës së respektit ndaj Zotit. Njerëz! Nesër do t'u pyesin për mua. Çka do të thoni?

-Se nubuvetin (pejgamberinë) e Zotit e çove në vend, se e kreve detyrën tënde, se na këshillove dhe na le emanet." Kështu do të dëshmojmë (para Zotit).

Pastaj Muhammedi a.s. ngriti kah qielli gishtin tregues të bekuar, më pastaj duke e lëshuar nga të tubuarit tha:

-Jij dëshmitar o Zot! Jij dëshmitar o Zot! Jij dëshmitar o Zot!

PARATHËNIE

Shekujve të fundit në botë ka ndryshuar shumëçka. Shumë çështje nuk janë përmendur fare në të kaluarën ose, së paku, nuk u është dhënë hapësirë e duhur, ndërsa sot janë me rëndësi, relevante dhe janë çështje komplekse. Për zgjidhjen e çështjeve të këtilla, religjionet dhe sistemet shoqërore kanë zhvilluar dhe kanë shtruar ide të ndryshme dhe kanë bërë analiza sipas botëkuptimeve të tyre. Njëra ndër to është edhe çështja e gruas.

Në temën gruaja dhe e drejta e saj, në fillim në Perëndim, u hap një betejë e vërtetë. Në Evropë, sipas masave të zhvillimit ideor, në lëmin e të drejtave njerëzore dhe parimeve tjera, është thënë dhe shkruar shumë. Në anën tjetër, në Lindje dhe në vendet islamike, pa marrë parasysh të drejtat që Islami u jep femrave, ky “fajësohet” për shkak të disa, “mungesave dhe vlerësimeve të gabueshme”. Ndaj, filloi një luftë e njëjtë si në Evropë. Në realitet gjendja në vendet islamike ndryshonte nga ajo në Evropë. Por, sëmundja e imitimit të çfarëdo lëvizjeje në Evropë imituesve u pengoi të vërejnë ndryshimet midis tyre.

As sot nuk është zgjidhur çështja e gruas. Ndaj, për këtë thuhet e shkruhet shumë edhe në Perëndim edhe në Lindje. Nuk është shkruar asnjë vepër në gjuhën turqishte që na e ndriçon kuptimin objektiv të Islamit, lidhur me këtë çështje. Rinia e sotme intelektuale që shumë pak është e informuar me çështjen e Islamit, të vetmin informim mund ta marrin nga veprat jo objektive të Perëndimit, ku kanë vështirësi të mëdha të gjejnë realitetin në temën: “E drejta e gruas në Islam”.

Ja lexues të respektuar, veprën që keni në dorë, e shkrova sa për të plotësuar një nevojë të tillë. Tema kryesore e veprës është “mënyra e kuptimit të çështjes së gruas në Islam dhe të drejtat që Islami ia jep asaj”. Përveç kësaj, veçanërisht në kohën e të Dërguarit a.s. dhe të të katër halifëve, përfshin edhe temën lidhur me çështjen e gruas në vendet e sotshme të Lindjes dhe të Perëndimit, si dhe gjendjen paraislamike në siudhësën e Arabisë dhe në vendet tjera të botës.

Në përpilimin e kësaj vepre janë marrë edhe citate nga “librat e shenjtë” të kohës paraislamike. Kështu na u dha mundësia të bëjmë krahasime dhe t’i shqyrtojmë gjykimet e pranishme në librat religjioze të Perëndimit, që kanë ndikuar thellë dhe kanë bërë kritika të ashpra në lidhje me çështjen e gruas në vendet islamike. Kur iu rrekëm kësaj teme, gjithnjë kishim parasysh parimin që, “realitetin të mos e vlerësojmë me masat njerëzore, por njerëzit t’i vlerësojmë me masën e së vërtetës”. Dhe, duke u nisur nga ky parim, u mbështetëm në burimet themelore të Islamit, që janë Kur’ani Famëlartë dhe Sunneti. Kështu të gjitha ajetet që kanë të bëjnë me gruan, i nxorrëm nga Kur’ani. E, duke i krahasuar të gjithë hadithet lidhur me gruan, dëshiroam të japim një kuptim më të plotë për Islamin. U konsultuam me juristët islamikë për argumentet e Kur’anit dhe sunnetit, dhe kur morrën mendimet e tyre të mbështetura në argumente, duke i pasë parasysh të gjitha sektet e njohura, zgjodhëm

faktet të cilët na u dukën më bindëse. U ikëm disa ideve personale që s'kishin mbështetje në shpjegimin e komenteve dhe zgjidhjen e ideve, në mënyrë që deri në maksimum të ruajmë objektivitetin shkencor.

Burimet që shfrytëzuar në këtë vepër janë shpjeguar në fusnota ndërsa titujt e plotë janë dhënë në fund të librit. Nuk kishim qëllim t'i vërtetojmë realitetet shkencore e religjioze, dhe nuk iu dha vend asnjë qëndrimi përveç atij të ehli-sunnetit (atyre që pasojnë sunnetin). Për të gjitha vërejtjet dhe kritikrat që mund t'i bëhen kësaj vepre lidhur me çështjet e komplikuar që ngërthen libri, që më parë u falënderohemi.

“Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit.”

*Prof. Dr. Bekir Topalo ⇒lu
Universiteti Marmara
Fakulteti Teologjik
Stamboll*

Gruaja nga aspekti i krijimit

“Se askush nuk bart peshën e (mëkatit) tjetrit. Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar”.^{1*}

Krijimi i gruas sipas Biblës

Sipas Biblës² krijimi i nënës Havë ndodhi kështu:

“Atëherë Zoti, Perëndi e vuri njeriun në një gjumë të rëndë. Gjatë gjumit i nxorri një brinjë dhe vendin e saj e mbushi me mish.³ Nga brinja që i mori njeriut, Zoti Perëndi bëri gruan dhe ia solli njeriut. Kur e pa njeriu, tha: “Më në fund ja një tjetër nga gjinia ime - eshtra e nxjerrur nga eshtra ime dhe mishi i nxjerrë nga mishi im. Grua e ka emrin sepse nga njeriu doli.”⁴

Në Dhiatën e Vjetër, (Zanafilla: 3), nga druri i ndaluar i Xhenetit, gjarpëri e detyroi Havën ta lëshojë rrugën (e drejtë). Së pari Hava, pastaj me insistimin e saj, Ademi hëngrën nga pema e ndaluar. Dhe në freskun e ditës, duke shëtitur nëpër kopsht, kur dëgjuan zërin e All-llahut, Ademi dhe gruaja e tij, u fshehën ndërmjet drunjëve të kopshtit, duke i ikur ballafaqimit me Zotin. Kur e pyeti Zoti Ademin përse hëngri fruta nga druri i ndaluar, ai tha: *“Gruaja që ma fale si shoqe, më dha (frute) nga ky dru dhe unë i hëngra”*. Atëherë All-llahu iu drejtua Havës: *“Do t’i shtoj mundimet e shtatzanisë, me mund do të lindësh fëmijë dhe do të jesh e lidhur me burrin tënd, e ai do të ketë pushtet ndaj teje”*-E Ademit i tha: *“Pasi e dëgjove gruan edhe pse të urdhërova të mos hash nga druri i ndaluar, ti hëngre, prej sot është e mallkuar toka për shkakun tënd...”*

Fajin që Bibla ia ngarkoi së pari Havës e përmes saj Ademit, si mëkate të prindërve të parë, sipas besimit të tyre nga të gjitha anët bartet prej gjenerate në gjeneratë. Për këtë arsye të gjitha gratë e botës janë të njollosura dhe të gabueshme.

Krijimi i gruas sipas Islamit

Ajeti nga Kur'ani Famëlartë që flet për krijimin e gruas është si vijon:

“O ju njerëz, ! Keni frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e tij, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe keni frikë All-llahun në emër të Cilit përbetoheni... !”⁵

Në hadithin e Pejgamberit a.s. është thënë:

“Dëgjoni porosinë time, ndaj grave bëjuni të kujdesshëm, sepse ato janë të krijuara nga brinjë. Briri anën më të lakuar e ka pjesën e epërme. Po deshe ta drejtosh, ai do të thyhet, e po e le ashtu siç është, do të ngelë i lakuar. Dëgjojeni pra porosinë time për gratë!”⁶

Hadithi i lartpërmendur flet për atë se gruaja sipas natyrës është nervoze dhe si e tillë ajo nuk mund t'u përgjigjet të gjitha kërkesave të burrit. Për këtë arsye me të duhet sjellur në mënyrë gjentile, të mos nënçmohet dhe të pranohet ashtu siç është. Kjo mund të hetohet edhe në një hadith tjetër:

“Gruaja është si briu, nëse dëshiron ta drejtosh, ai thyhet, e nëse dëshiron të jetosh në lumturi, duhet të pajtohesh me shërbimet e saj.”⁷

Kur flitet për “drurin e ndaluar” në Xhennet, në Kur'anin Famëlartë rrëfimi u takon dy personave. Djalli, edhe Ademit edhe Havës u fali luhatje (dyshim), i bëri të jenë të ndryshueshëm dhe i detyroi të shërbehen nga “Druri i ndaluar”. Madje edhe në suren “Ta-ha” (ajetet 116-122) është treguar se Ademi ishte bashkëbisedues i vërtetë i Zotit dhe person me përgjegjësi, meqë pranoi urdhërin e All-llahut madje edhe ndalesat. Ai ka mundur ta detyrojë Havën për një sjellje tjetër.

S'është gjarpëri ai që i bëri të dyshojnë Ademi dhe Hava. Ai që i shtyu ishte shejtani. Fahreddin Raziu, në tefsirin e vet e mohon rrëfimin për gjarpërin⁸.

Feja Islame gabimin e prindërve të parë e shikon me një tolerancë të madhe. S'është ky ndonjë gjunah (mëkat) që nuk falet, s'është kjo ndonjë njollë për njerëzinë. S'është ajo siç është filozofuar në krishterizëm dhe siç është shpjeguar në Bibël. Është e vërtetë se Ademi ka gabuar, por kërkoi falje.

“Ai ia fali (gabimin). Ai është Mëshirues dhe Pranues i pendimit.”⁹

Pejgamberi a.s. thotë:

“Ademi dhe Musai a.s. (sipas të gjitha gjasave në botën e amshimit) biseduan. Musai tha: O Adem, ti je babai ynë. Ti na privove dhe na bëre pikë e pesë. Dhe na nxorre nga Xhenneti. E Ademi i tha: Edhe ty Musa, kur të pranoi All-llahu si bashkëbisedues, të dha vend të lartë. Me dorë të Vet ta shkroi librin. Si mund të më fajësosh për një cilësi të cilën All-llahu e ka shkruar dyzet vjet para se të më krijojë? Ja kështu Ademi e heshti Musain.”¹⁰

Lidhur me gabimin e njeriut të parë, muslimanët kanë mendim krejt tjetër nga mendimi pesimist i të krishterëve. Largimi i Ademit a.s. nga Xhenneti dhe zbritja e tij në botë me urdhër të All-llahut xh.sh. është një bëmiresi. Me këtë bota nuk u mallkua, por iu mundësua që të banohet. U bë skenë e civilizimeve të shumta. Sa të dërguar i ka bartë në kurriz dhe i ka ruajtur. I Dërguari a.s. thotë kështu:

“Dita më fatlume në të cilën lind dielli është dita e xhumasë, është kjo dita kur u krijua Ademi. Atë ditë u vendos në Xhennet dhe pikërisht atë ditë u përjashtua nga ai. Edhe Dita e Gjykimit do të ndodhë ditën e xhuma.”¹¹

Shejhu Ebul-Hasan Shazeli thotë për Ademin a.s.:

“Sa nder i sjell dëgjueshmëria për të cilën arriti të bëhet halif (gradë për realizimin dhe përcjelljen e urdhërave të All-llahut në botë) dhe deri në Ditën e Gjykimit i mësoi pasardhësit si të pendohen.”

Qëllimi i këtyre të thënave nuk ishte ta arsyetojë mëkatin, por ta lavdërojë pendimin, e me të edhe kthimin kah Krijuesi.¹²

Feja Islame me asgjë nuk e fajëson gruan e parë, nënën tonë Havën. Gabimin e prindërve të parë nuk pranon se përcillet mbi fëmijët e tyre dhe gjeneratat që pasojnë. Në Kur’an rreth kësaj thuhet:

“Ishin ata një popull besimtar. Erdhën e shkuan. Tërë atë që fituan është e tyre, ndërsa e juaja është ajo që është e juaja. Ju nuk do të përgjigjeni për veprat e tyre.”¹³

(9)

II. Barazia femër - mashkull, revolucion i Islam

Deri në lindjen e Islamit, respektivisht deri në shekullin e VII gruaja askund në botë s'kishte kurrëfarë të drejtash. Pyetja, se është gruaja qenie njerëzore ose nuk është ishte temë diskutimi që i nxiti ligjdhënësit dhe mendimtarët.

Ndërsa, në anën tjetër, feja Islame i erdhi në ndihmë gruas së shkelur. Të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh gjininë e racën, në momentin e lindjes janë të njëjtë:

“O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.¹⁴ “O ju njerëz! Kini frikë Zotin që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë All-llahun që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisën (akraballëkun), se All-llahu është mbikqyrës mbi ju”.¹⁵

Në Islam gruaja zë vend të jashtëzakonshëm. Pejgamberi a.s. kur solli besimin e vërtetë dhe kur e shpalli atë, së pari i besoi një grua.

“All-llahu me Hatixhen nuk më dha grua më të vyeshme. Kur askush prej njerëzve nuk më besonte, ajo më besoi. Kur njerëzit iknin prej meje, ajo më ndihmoi me pasuri. Dhe Zoti mua më fali fëmijë, jo me gratë tjera por me të.”¹⁶

Gruaja, në të njëjtën kohë është edhe shehidja e parë e Islamit. Nëna e Amarit, Sumejja, qe martirja e parë e Islamit, u bë sakrificë e maltretimeve më të mëdha. Vetë kurejshët ate, të shoqin e saj Jasirin dhe të birin, Amarin, i veshën me rroba të hekurta dhe në rërë përvëluese i lëshuan të përcëllohen në diell. Kur i pa i Dërguari i All-llahut u tha: **“Keni durim, familja e Jasirit! Vendi i juaj në ardhmëri është Xhenneti.”** Dhe në fund, Sumejja plakë lëshoi shpirtin nën shtizat e Ebu Xhehlit. Ishte kjo shehidja (dëshmorja) e parë e Islamit.¹⁷

Sa shembuj të mirë tregon dhe Pejgamberi a.s. kur flet për dashurinë, mëshirën dhe respektin ndaj gruas. Ai thotë:

“Mua më është falë të më pëlqejë çdo gjë e pastër dhe e bukur në botë siç janë edhe gratë. Ndërsa momenti më i lumtur i imi është kur lidhem në namaz.”¹⁸

Në kohën paraislamike arabët ndaj grave silleshin në mënyrë të vrazhdë. Shembull mjaft të mirë na jep një ngjarje e ‘Umerit r.a. që ishte i njohur me seriozitetin dhe rreptësinë e tij. Sa’d b. Ebi Vekkas thotë:

“Umeri një ditë kërkoi leje të hyjë tek i Dërguari i All-llahut. Tek ai ishin gratë kurejshite. Me të flitnin me zë të lartë dhe pyesnin për shumë gjëra. Kur e dëgjuan zërin e ‘Umerit, u ngritën dhe të shqetësuara filluan të fshihen. I Dërguari i All-llahut i dha leje ‘Umerit të hyjë brenda dhe u qesh ndërsa ‘Umeri iu drejtua: “O i Dërguar i Zotit, si të bëri All-llahu të qeshesh?”. Pejgamberi a.s. u përgjegj: “U habita me këto gra. Rrinin para meje. Kur e dëgjuan zërin tënd, shpejtuan të fshihen.” E ‘Umeri r.a. vazhdoi: O i Dërguar i Zotit, ti meriton më tepër që para teje të jenë më të rezervuara, tha, dhe duke u kthyer nga ato, shtoi me nervozitet: “O ju armiq të vetvetes, prej meje po frikësoheni ndërsa nga i Dërguari a.s. nuk kini fare frikë. E ato thanë: Ti, në krahasim me të Dërguarin e Zotit je shumë i rreptë. Lidhur me këtë Pejgamberi a.s. tha: “Betohem në Zotin që mban në dorë shpirtin tim. Shejtani duke shkuar rrugës së vet, lakon rrugën (kur e takon ‘Umerin) dhe shkon në rrugë tjetër.”¹⁹

Derisa bota krishtere shekuj me radhë e llogariste gruan si një ndytësi dhe nuk e lejonte të hyjë nëpër tempuj, një grua ia tregoi rrugën e drejtë ‘Umerit r.a., rrëfimën e të cilit e treguam pak më lartë. Halifi i dytë ‘Umeri r.a. një ditë, në Medinë, në minberin e të Dërguarit të Zotit hipi dhe mbajti hutbe para të pranishmëve. Në hutbe ‘Umeri r.a. të pranishmëve u tha se kur të martohen, mos t’u japin shumë meher (një shumë të hollash ose të mira materiale që bashkëshorti i jep gruas në vetë aktin e kurorëzimit) grave të tyre. Një zonjë shtatëgjatë u veçua nga xhemati dhe iu drejtua ‘Umerit r.a.:

“O ‘Umer, nuk ke të drejtë kur thua ashtu”. Kështu i tha dhe si argumente ia tregoi ajetet e Kur’anit Famëlartë (en-Nisa 20, 21). Halifi u çudit duke shqiptuar “All-llah, All-llah, një grua diskuton me ‘Umerin dhe atij ia mbyll gojën...”²⁰

Zakonet e gabueshme dhe bestytnitë eliminohen

All-llahu rreptësisht ndalon vrasjen e fëmijëve të gjinisë femërore:

“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj duke iu frikësuar varfërisë, se ne ua sigurojmë furnizimin e tyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.”²¹

Ai gjithashtu kritikon rreptë babanë i cili ndjen turp nga robërimi i saj (vajzës) në luftë, ose nga ajo se femra do t’i bëhet dikujt grua:

“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij nxihet dhe bëhet plot mlllef. Fshihet prej njerëzve për shkak të asaj së keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron bela, e jo dhuratë prej Zotit). Mandej, (mendon) a do ta mbajë atë, ashtu i përulur, apo do ta mbulojë atë (të gjallë) në dhe. Sa i keq është ai gjykim i tyre”.²²

Kur përshkruhet frika e Ditës së Gjykimit, në Kur’an thuhet:

“Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, për çfarë mëkati janë mbytur...”²³

Në realitet edhe vajzën edhe djalin njeriut ia falë Zoti. Robi i All-llahut këtu nuk ka kurrëfarë roli. Veprat e Krijuesit nuk mund të jenë të turpshme e të këqia:

“Vetëm i All-llahut është pushteti në qiej e në tokë. Ai krijon çka të dojë; ai i falë femra atij që do, e i falë vetëm meshkuj atij që do. Ose u falë çifte, meshkuj e femra, por atë që do, e lë pa fëmijë (steril); ai është i Dijshimi e i Fuqishmi.”²⁴

Pejgamberi a.s. thotë:

“Ai që ushqen dy vasha deri sa të arrijnë në moshën e pubertetit, në Ditën e Gjykimit do të jemi së bashku kështu (dhe i bashkoi gishtin tregues dhe të mesëm).”²⁵

Idhujtarët e Mekës mendonin se melekët janë bijat e Zotit. Deri sa ata mendonin se vajzat janë krijesa të thjeshta, bijnë në kundërtënie të palogjikshme duke i krahasuar engjëjt me Zotin. Përgjigje u dha Zoti në Kur’an:

“E Ti (Muhammed) pyeti ata (idhujtarët): A të Zotit tënd janë vajzat, kurse të tyre djemtë? Apo ne i krijuam melekët femra, e ata ishin dëshmitarë (kur thonë se melekët janë femra)?! Vini re se si ata janë gënjeshtarë (kur thonë se engjëjt janë bijat e Zotit)”. A thua vajzat ai i ka bërë më të zgjedhura se djemtë?”²⁶

Idhujtarët me një shikim të sëmurë meshkujt i konsiderojnë të vetët ndërsa femrat të Zotit. Një krahasim i këtillë në Kur’an quhet “ndarje e padrejtë”²⁷

Barazia shpirtërore

Sipas Islamit besimi në Zotin (imani), fitimi i shpërblimit dhe i dënimit, (konform respektimit) të urdhërave dhe ndalesave të Zotit xh.sh. lidhur me botën dhe ahiretin (bota e amshimit), hyrja në Xhennet ose Xhehennem, në të gjitha këto midis gruas dhe burrit nuk ka asnjë dallim. All-llahu i është drejtuar edhe Ademit a.s. edhe Havës në të njëjtën mënyrë. Ashtu si hëngrën bashkarisht fruta nga pema e ndaluar, ashtu edhe u penduan bashkarisht.²⁸

Gruaja dhe burri, i varfëri dhe i pasuri, i ziu ose i bardhi, pa kurrfarë përjashtimi në qiej e në tokë, Ditën e Gjykimit do të dalin para Allahut xh.sh. veç e veç, si një rob dhe nuk do të ketë asnjë dallim.²⁹

Zoti premton se kush beson dhe bën vepra të mira qoftë mashkull ose femër, do të kalojnë jetë shumë të mirë. E, duke hyrë në Xhennet, do të jetojnë në lumturi të amshueshme.³⁰

Gruaja e kurorëzuar, po s'pati filluar të besojë, burri i saj edhe po të jetë i mirë, edhe po të jetë peygamber i Zotit, s'do të ketë kurrëfarë dobie. Shembull për këtë janë Nuhu dhe Luti a.s. të cilët ishin dy besimtarë të mirë të Zotit e në të njëjtën kohë ishin edhe peygamberë, ndërsa gratë e tyre i tradhëtuan ata.³¹ Nëse gruaja beson e burri nuk beson, atëherë vepra e keqe e burrit nuk do ta dëmtojë gruan; ai do të shkojë në Xhehennem ndërsa ajo në Xhennet. Shembulli është gruaja e faraonit në kohën e Musait a.s., e cila si përgjigje të sjelljes zemrake të faraonit kur u tha egjiptasve: ***“Unë jam zoti më i madh”***³² ajo i besoi Musait a.s. dhe luti Zotin: ***“Zoti im, më bën një vend pranë mëshirës sate në Xhennet dhe më shpëto nga faraoni dhe brutaliteti i tij nga populli mizor!”***³³

Kur'ani dhe gruaja

Nga aspekti i krijimit, besimit, lirisë së ndërgjegjës dhe jetës në botën e amshueshme, kur ia caktojmë vendin gruas në Islam, duhet përmendur se përveç sures “en-Nisa” (gratë) ekziston edhe një sure me emrin “Merjem” kushtuar nënës së Isait a.s. Në Kur'an, në mënyrë shumë të përshtatshme përmend emrat e nënës së Isait dhe Musait a.s.

Në Egjipt, faraoni, bijtë e izraelitëve i mbyste ndërsa vajzat e tyre i linte të jetojnë. Kur Musa a.s. erdhi në këtë botë e ëma e tij u shqetësua:

“Ne, nënën e Musait e inspiroam t'i japë atij gji, e kur të kesh frikë për të atë hidhe në lum, e mos u frikëso dhe mos u pikëllo, se Ne do ta kthejmë të ty dhe do ta bëjmë atë nga të dërguarit”.³⁴

Pas këtij urdhëri nëna, e cila e hodhi atë në Nil, derisa nuk mori vesh për të, kaloi çaste të dhimbshme e shqetësuese! Kur'ani e përshkruan ndjenjën fisnike të nënës kështu:

“E zemra e nënës së Musait agoi e zbrazët...”³⁵

Ndërsa në lidhje me Merjemen, sureja që mori emrin e saj shpjegon në mënyrë të jashtzakonshme sjelljen e prindërve. E liron Merjemen nga të gjitha shpifjet dhe akuzat. Kur'ani shfrytëzon shprehjen ***“Buhtanun adhim”*** (shpifje e madhe) për akuzat e hebrenjve lidhur me siç shprehen ata prostitucionin e Merjemes.³⁶ Përsëri në Kur'an shfrytëzohet në mënyrë më gjentile, në mënyrë letrare dhe në mënyrë më të lartë shprehja për Merjemen. Shembulli më i mirë për këtë është edhe sureja Merjem. Engjëjt bisedojnë me Merjemen:

“Përkujto kur engjëjt i thanë: Oj Merjeme, All-llahu të dalloj ty (me besim e karakter), të pastroi (nga shpifjet hebreje) dhe të lartësoi mbi gratë e botës.”³⁷

Gjykimi lidhur me botën

Nuk ka ndryshim as me barabarsinë as me dënimet që u bëhen burrit dhe gruas. Fajet e bëra kundër gruas, edhe sikur të jenë personalisht kundër saj ose kundër pasurisë së saj, edhe kundër nderit të saj, duhet të dënohen njëlloj sikur kundër burrit. Madje janë edhe disa raste që flasin në interes të gruas. Nëse burri e akuzon gruan për prostitucion dhe nëse nuk ka argumente për të, do të dënohet për shpifje dhe deri në fund të jetës nuk mund të dëshmojë para gjyqit.³⁸ Në fenë Islame, njeriu pas pranimit të Islamit, po iu kthye ndonjë besimit tjetër dhe po nuk u pendua për këtë, dënohet me vdekje. Sipas Ebu Hanifes gruaja murtede (që prej Islamit kalon në ndonjë besim tjetër) nuk ekzekutohet me vdekje.³⁹ Po qe e nevojshme të zbatohet *kisasi* (vdekje për vdekje, sy për sy), për një sulm ndaj trupit të gruas, (edhe nëse agresori është burrë), ky dënim do të aplikohet. Nëse është i nevojshëm dëmshpërblimi, këtu ekzistojnë raste specifike për gruan.⁴⁰

Në rast se gruaja është fajtore, dënohet njëlloj sikurse edhe mashkulli.

Udhëheqja me familjen, trashëgimia, institucioni i dëshmisë dhe tematika të ngjashme me këto, të drejtat e ndryshme midis burrit e gruas do të shqyrtohen në faqet e këtij libri që do të pasojnë.

III.

Mendimet e disa dijetarëve të Perëndimit lidhur me të drejtat e gruas në Islam

Stanley Lane-Poole thotë se:

“Atë që ka bërë Muhammedi për çështjen e ndryshimeve relevante në favor të gruas, nuk e ka bërë asnjë ligjdhënës.”⁴¹

Ndërsa Will Durant, sa i përket gruas, shkruan:

“Muhammedi i dha fund vrasjes së fëmijëve të gjinisë femërore tek arabët. Në punët ekonomike dhe juridike, gruan e solli në pozitë të barabartë me mashkullin. Gruaja mund të mirret me çdo profesion ligjor. Mund të disponojë me fitimin e vet, mund të trashëgojë pasuri dhe me pronësinë e vet mund të udhëheqë si të dojë ajo personalisht. Muhammedi a.s. gjithashtu e ndërpreu edhe zakonet tek arabët që siguronte trashëgiminë e grave prej të jatit në të birin. Grave u pranohet gjysma e të drejtës trashëgimore të burrit.”⁴²

Për barabarësinë midis gruas dhe burrit, profesori nga instituti islamik, Jascques C. Risler thotë:

“Në proçeset juridike gruaja është ngritur në status të barabartë me burrin. Prej atëherë gruaja filloi t’i gëzojë të drejtat për trashëgimi, të lë trashëgimi, dhe të punojë ndonjë punë ligjore.”⁴³

Gaudefroy-Demombynes mendimin e vet e paraqet duke konstatuar se të drejtat e gruas në jurisprudencën islame janë në nivelin më të lartë se sa në ligjet evropiane:

“Ligjet e Kur’anit janë në shkallën më të lartë në favor të gruas dhe sigurojnë, së paku teoretikisht, pozitë më të mirë nga ajo që gruas i sigurojnë ligjet evropiane. Gruaja islame ka të drejta për kapital të veçantë në transaksionet financiare. Ajo deri në fund të jetës disponon me pasurinë që e ka fituar si dhuratë ose me trashëgimi, apo me mallin e fituar me djersën e vet personale. Edhe pse në realitet realizimi i këtyre të drejtave është i vështirë, asaj i janë siguruar varësisht nga pozita e saj, ushqimi, strehimi dhe kujdesi për të.”

Filozofi frëng, Voltaire, thotë:

“Vëllait tim turk, do t’ia thoja këtë: Feja jote më duket se meriton respekt. I falesh vetëm një Zoti. Je i obliguar që një herë në vjet pjesën e 40 të fitimit ta japësh si zeqat dhe, në ditën e Bajramit të pajtohesh me armiqtë e tu. Priftërinjtë tanë ndoshta më mijëra herë ju akuzojnë para botës se ndoshta e keni aprovuar atë besim, vetëm për shkak se ajo i ka pranuar kënaqësitë. Këta të mjerë e kanë gënjyer tërë botën. Feja e jote është fe mjaft bujare.”⁴⁴

I njëjti filozof për martesën me më shumë se një grua thotë:

“Problem i vërtetë i priftërve tanë ishte me turqët muslimanë. Duke mos mundur që me ndonjë mënyrë tjetër t’u kundërvihen pushtuesve të Stambollit, ata filluan të shkruajnë me qindra letra kundër tyre. Shkrimtarët tanë që në numër ishin më shumë se jeniçerët, u munduan që t’i përvetësojnë gratë. Gjoja Muhammedi nuk e llogaritte gruan si qenie intelektuale. Gjoja në ligjet e Kur’anit të gjitha gratë janë robëresha. Se nuk paskan kurrfarë të drejta ndaj s’kanë vend as në Xhennet.

Të gjitha këtyre gënjeshtreve, në fillim u besohej. Por, mjafton të lexohet sureja e III dhe e IV e Kur’anit dhe të zhveshen këto gënjeshttra.

Duket se pozita e gruas nuk është e keqe siç tregohej. Gjithsesi se si të krishterë nuk do ta argumentojnë se secila fjalë e Kur’anit është e vërtetë. Por, s’do të themi asnjë fjalë kundër doktrinës që e shtroi Islami për Zotin e vetëm, All-llahun. Që të pushtojë tërë Lindjen, më tepër se shpata, shërbyen këto fjalë të 122⁴⁵ sureve:

“Thuaj: Ai, All-llahu është Një. All-llahut i mbështetet gjithçka. Nuk ka lindur e as është lindur. Atij asgjë nuk i gjason.”⁴⁶

Libri i parë

GRUAJA DHE FAMILJA

PJESA E PARË

MARRËDHËNIET MES FEMRËS DHE MASHKULLIT

- I. Prirja për seks
- II. Martesa
- III. Liria në martesë
- IV. Çështjet tjera lidhur me martesën
- V. Pengesat në martesë

I. Prirja për seks

“Kush dashurohet, ruan pastërtinë e shpirtit dhe vdes duke e fshehur dashurinë e vet, ai është martir.”

Muhammedi a.s.

Feja Islame pranon dhe predikon se secila grua e secili mashkull, njëri ndaj tjetrit ndejnë simpati të madhe. Kjo simpati ka mjaft rëndësi për vazhdimësinë e gjeneratave dhe ekzistencën njerëzore në botë. Njerëzit që llogariten si normal s'mund të paramendojnë t'i shmangen kësaj simpatie. Njëri ndër as'habët, Sa'd b. Ebi Vekkas thotë: **“Uthman b. Maz'un kërkoi leje nga Pejgamberi a.s. që të tërhiqet nga bota dhe t'u shmanget grave, por i Dërguari i All-llahut nuk e lejoi. Po t'i jepte leje, ne do të sterilizoheshim”**.⁴⁷

Në ajetin e 14 të sures Ali Imran flitet për gratë si faktorin e parë, për të cilin njerëzit janë të lidhur me epsh.

“Dhe ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër) që ju të përkujtoni...”⁴⁸

Në tregimin për Jusufin a.s. thuhet si vijon: Zelihaja kur i mbylli dyert dhe kur u siguria, iu afrua Jusufit, dhe kishte qëllimet e veta. Ndërsa Jusufi a.s. sikur të mos mbrohej me një fuqi hyjnore, për pak do t'i dorëzohej Zelihasë.⁴⁹ Simpatia e fortë dhe e ndërsjellë midis burrit dhe gruas, nuk është turp, madje nuk është asgjë e keqe. Islami e pranon njeriun, bashkë me të gjitha elementet e krijimit. Islami nuk premtion se duke e tejkualuar krijimin, njeriun ta bëjë engjëll, as edhe duke ia rritur nevojat trupore që ta sjellë atë në nivelin e kafshës. Islami nevojat e organizmit të njeriut i kënaq duke i ngritur në nivelin e një qëllimi të drejtuar kah Zoti. Hadithet e Pejgamberit a.s. për këtë çështje janë mjaftë interesante.

“Bota është kënaqësi, ndërsa kënaqësia më e mirë është gruaja e mirë.”⁵⁰

“Kush dashurohet e ruan pastërtinë e shpirtit dhe vdes duke e fshehur dashurinë e vet, ai është martir.”⁵¹

Feja Islame i dënon nerëzit që i kërkojnë kënaqësitë e veta seksuale jashtë rrugës legale, e në anën tjetër, ajo ua tregon rrugën e drejtë. Gruaja që veten e ka lëshuar në stuhitë e seksit, si një epsh i fortë, i ka të tmerrshme, hilet, pispëllimet, dhelperitë. Në suren Jusuf, hilet dhe dhelperitë e grave, përmenden një herë nga goja e Azizit nga Egjipti dhe dy herë nga goja e Jusufit a.s.⁵² Për këtë arsye Pejgamberi a.s. thotë:

“Pas meje nuk u lash asgjë burrave, asgjë më të madhe se sa intrigën e rrezikshme siç është gruaja.”^{53, 54}

(9)

II. Martesa

“Martohuni me gruan e cila lindë dhe e cila e don familjen. Ditën e Gjykimit do të mburrem me ju para ummeteve tjera me numrin tuaj.”

Muhammedi a.s.

Nevoja për martesë

Rruga legale e kënaqësisë seksuale është martesë. Të ikurit nga martesë është rrugaçësi dhe shkas, që energjia me të cilën posedon njeriu të bëhet shumë e rrezikshme. Secili njeri ndjen nevojë për kënaqësi seksuale. Kjo, po nuk u realizua në mënyrë legale do të kalojë në punë jo legale: onanizëm, homoseksualitet, marrëdhënie me fëmijë e me kafshë... Dhe shkak për të gjitha këto anomali të çoroditura është mos martesë. Kjo dhe mosplotësimi i nevojave seksuale për organizmin dhe shpirtin e njeriut janë jo vetëm të dëmshme, por edhe të rrezikshme. Ikja nga martesë bazohet në shtimin e pronësisë, largimi nga obligimet dhe frika nga krijimi i familjes e cila shoqërisë do t'i sillte dobi. Po ua ktheu kurrrizin virtyteve shpirtërore duke e trajtuar materjen si një gjë të shenjtë, do të teprohej, e shoqërisë do t'i merrej liria e pavarësia dhe do të bëhej rob i epsheve dhe shfrenimeve të tepërta.

Duke e kërkuar ekzistencën, vazhdimësinë, njerëzit gjetën rrugëdalje me detyrimin e të rinjëve që të martohen. Në perandorinë Romake, institucioni familje që luhatur për shkak të rritjes së numrit të beqarëve dhe të bredhjeve të tyre poshtë e lartë. Për këtë shkak, me ligjet që solli perandori Augusti, secili ishte i detyruar të martohet me një person sipas klasës që i takon, madje secili ishte i obliguar të ketë fëmijë. Kush nuk i respektonte këto dispozita ligjore, ballafaqohej me konsekuenca të rënda.⁵⁵ Njeriu që martohet dhe e don familjen e vet, din t'i dojë edhe njerëzit tjerë. Me siguri njohim shumë pleq të pamartuar të cilët janë nervozë, të pacipë, zemërngushtë, të padobishëm dhe të dëmshëm. Turqët, kur duan të theksojnë mëshirën thonë: “Ty a nuk të lindi nëna, a nuk ke ti fëmijë...”

Kur Musa a.s. ia la fisin vëllait të vet, Harunit dhe shkoi të marrë levhat (pllakat e shenjta), fëmijët izraelitë lëshuan rrugën e drejtë. Dhe, kur u kthye Musa a.s., shikoi gjendjen e mjerë dhe me zemrim e rrëmbeu të vëllanë. E Haruni iu drejtua vëllait të zemruar kështu:

“O djali i nënës sime...”⁵⁶

Kështu, duke e përkujtuar nënën si burim urtësie, dashurie e mëshire, ai e qetësoi të vëllanë. Janë të njohura fjalët e mareshalit Peten që ua drejtoi francezëve të cilët pësuan në luftë:

“O miqtë e mi, neve na shkatërroi ahengu”. Dhe pati shtuar: “Kur t’i peshoni gabimet, do të gjeni gabime edhe më të mëdha. Nuk dëshironit fëmijë dhe braktisët jetën familjare. I lëshuat vyrtytet dhe vlerat shpirtërore... Nga të gjitha anët kërkuat epshmëri...”

Gjykimet për martesën

Në Kur’anin Famëllartë ekziston urdhëri për martesë.⁵⁷ Ky urdhër shkallëzohet nga farzi (urdhër që patjetër duhet kryer) e shkon duke u zbutur, varësisht nga rangu shoqëror dhe nevoja seksuale. Në ajet gjithashtu përmendet shkaku i mosmartesës si rrjedhë e gjendjes financiare, edhe pse Kur’ani na njofton se kur martohen dy të varfër, Zoti, do t’i ndihmojë: robi me marrëveshje se do të lirohet, personit të posamartuar që don të jetë i pamëkatë dhe atij që lufton në luftë të shenjtë, në rrugë të Zotit.⁵⁸ Në hadithet tjera thuhet:

“Njeriu me martesë plotëson gjysmën e fesë. Për gjysmën tjetër le të frikësohet nga Zoti”⁵⁹

“Po erdhi dikush te ju e jeni të kënaqur me karakterin dhe besimin e tij, të kërkojë vajzë, martojeni. Po nuk e bëtë atë, do të lind përçarja dhe intriga.

O i Dërguar i Zotit, thanë: nëse ai është i varfër dhe nuk i takon familjes bujare?

Nëse vjen dikush tek ju të kërkojë vajzë, martojeni! -dhe këtë e përsëriti tri herë.⁶⁰

Në Kur’an për martesën legale përdoret termi ***“ihsan”***, “ngritja e murit rreth e përçark, ruajtja e tij”. Kjo ngase secili çift me aktin e martesës do të mbrohet nga mëkati, nga sulmet epshore dhe nga rreziqet e jetës⁶¹ Po kështu edhe marrëdhëniet jo legale dhe prostitucioni janë quajtur ***“sifah”***, që don të thotë rrjedhje - të dy palët, njëri tjetrit ia dëmtojnë lëngun jetësor. Spermën e shpenzojnë kot nasikoti.⁶²

Duke e përfunduar temën lidhur me nevojën për martesë, të shtojmë edhe këtë se martesë dhe të disponuarit me fëmijë është rruga jetësore edhe e Pejgamberit a.s..⁶³

Ç'është martesë?

Martesën, për të cilën është fjala, do ta definojmë sipas ajeteve të Kur'anit. Ky s'është të jetë definicion juridik. Më tepër do të jetë përcaktim i qëllimit dhe e rezultateve të kurorës si dhe marrëdhënieve dhe sekreteve të lartësuara midis palëve në kurorë.

Në suren er-Rum, ajeti 21, lidhur me specifikën e kurorës ceket: Mashkulli (burri) të gruaja të gjejë qetësinë. Kjo qetësi sa është shpirtërore aq është edhe trupore si mbrojtje nga tronditja jetësore. E njëjta gjë vlen edhe për gruan. Elementi i dytë është krijimi i dashurisë. Dhe në fund, simpatia midis dy gjinive. Specifika e tretë është virtyt që përmban çdo gjë. Në një ajet tjetër, duke iu drejtuar meshkujve, thuhet:

“...ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për to.”⁶⁴

Duke u bërë veshje për shokun e jetës, mbulesa mund të thotë pengim në rrugë të liga me zbulimin e epsheve të veta, si dhe plotësim të njëri tjetrit, natyrisht duke e ndjerë nevojën e ndërsjellë.

Si shembull, nëse marrim një mollë dhe e përgjysmojmë, atëherë kemi dy copa të njëjta molle, gjysma është gruaja e gjysma tjetër burri. Kur të bashkohen dy gjysmat, atëherë na japin njeriun. Në këtë mënyrë ata e plotësojnë njëri tjetrin. Pra, njeriu i pamartuar është “gjysmak” e jo i plotë.

Për regjenerimin, si rezultati i kurorës, flet një ajet, duke thënë se gratë janë një arë nga e cila burrave u sjellin fëmijë.⁶⁵ Mendoj se këto tri ajete, shpjegojnë kurorën (martesën), si mënyrë e vetme legale në Islam për kënaqësitë seksuale.

(9)

III. Liria në martesë

“Pa shprehjen e qartë të vejushës dhe pa lejen e virgjëreshës, nuk mund të lidhet kurorë. Leja e virgjëreshës është heshtja e saj.”

Muhammedi a.s.

A janë të lirë gruaja dhe burri të zgjedhin bashkëshort para martesës? Sipas imam Malikut dhe Shafiut, meqë gruaja mund të mashtrohet nga ndjenjat, nuk mund të zgjedhë bashkëshortin e ardhshëm, pasi që mund të gënjëhet. Edhe nga ky aspekt, pa lejen e prindit ajo nuk mund të martohet. Ndërsa për hanefijtë gruaja edhe të jetë virgjëreshë, edhe të jetë e vejë është e lirë të zgjedhë bashkëshortin. Nuk mund ta japin pa lejen e saj.⁶⁶ Nëse e japin, ka të drejtë të zgjedhë vet, e po deshi mund ta prishë kurorën. Kështu ndodhi edhe me zonjën Hansa e cila iu drejtua Pejgamberit a.s., e ai ia dha të drejtën që ta anulojë kurorën.⁶⁷ në të njëjtën mënyrë një virgjëreshë u lajmërua tek Ai, e Pejgamberi a.s. i dha leje ta pranojë ose ta refuzojë kurorën.

Martesa e një muslimaneje me një jomusliman

Në Islam ekziston një përjashtim lidhur me lirinë e kurorës. Një grua muslimane nuk mund të martohet me një jomusliman.⁶⁸ Këtu i rrezikohet edhe feja edhe tradita. Arsimimi i fëmijëve që do të lindin do të jetë larg Islamit. E një dukuri e këtillë është kundër qëllimit të Islamit për zgjerim.

Edhe në të drejtën romake që ishte burim i të drejtave themelore, ishte e ndaluar të martohen palët me religjione të ndryshme.⁶⁹

Kur shohim se një katolik nuk martohet me një të krishterë të sektës tjetër, atëherë kuptojmë se Islami është shumë tolerant. Dhe, e dijmë se edhe hebrejtë, si njerëz të huaj për ta, nuk ua japin vajzat.

Duhet theksuar edhe këtë se në Islam, çdo akt i një besimtarit është i lidhur me fenë dhe ai duhet lartësuar, madhëruar Zotin. Në Kur'anin Famëllartë kurora quhet **“hududull-llah”**: “kufi që e ka caktuar All-llahu”.⁷⁰

Muslimani është njeri që me çdo akt i shërben Islamit, gjë kjo që don të thotë se nëpërmjet Islamit, njerëzit thirren në shpëtim.

Gruaja muslimane s'mund të martohet për një jomusliman, madje as për dikë besimi i të cilit është i prishur deri në atë shkallë kur largohet nga besimi, ani pse shtiret se është musliman.⁷¹ Nëse lidhet një kurorë e këtillë, kjo do të priset. Palët që e kanë bërë këtë akt dhe ata që kanë ndërmjetësuar, do të marrin dënim përkatës.⁷²

T'ua tregojmë një ngjarje historike që bën fjalë lidhur me një rast kur njerëzit nëpërmjet të kurorës u thirrën në Islam:

Në kohën e Pejgamberit a.s. Ebu Talha para se të bëhet musliman i propozoi martesë Ummi Sulejmes (Rumejsës). Ummi Sulejme tha:

-Të ta them të vërtetën, edhe unë dëshiroj të martohem me ty. Njeriun si je ti s'duhet kapërcyer. Por, ti je njeri i pafe, ndërsa unë jam muslimane. Nuk është e rrugës të martohemi.

Dialogu vazhdoi më tutje. Ebu Talha i tha:

-Ç'po ngjet me ty Rumejsa?

-E ç'po ngjet?

-E ç'do të thojë për të verdhin e të kuqin (arin dhe argjendin)?

-Unë s'po kërkoj as ari as argjend. Ti je njeri që përkulesh para një gjësendi që as dëgjon, as shikon dhe as që ka ndonjë vlerë. A s'turprohesh të falesh para një copë druri që e solli nga mali duke e zhagitur një rob i zi. Nëse ti bëhesh musliman le të jetë kjo prika (mehri) për martesë. Asgjë tjetër nuk kërkoj.

-E kush mundet t'ma sjellë Islamin, Rumejsa?

-i Dërguari a.s., shko tek ai.

Ebu Talha u drejtua tek i Dërguari i All-llahut, i cili ishte duke qëndruar me as'habët e vet. Kur e shikoi, tha:

“Po vjen Ebu Talha dhe po i shkëlqen nuri Islam...”

Ky e pranoi Islamin para Pejgamberit a.s. dhe ia përcolli fjalët Rumejsës. Kështu Pejgamberi a.s. i kurorëzoi sipas kushteve të Rumejsës.⁷³ Pejgamberi a.s. rrëfen:

“Shikoj, kam hyrë në Xhennet. Para meje rrapëllimë hapash. E ç'të shikoj - Rumejsa!”⁷⁴

Martesa me femër jomuslimane

Përkundër asaj se femra muslimane nuk mund të martohet me një jo musliman, sipas të drejtës islame, një mashkull musliman mund të martohet me një femër jo muslimane. I vetmi kusht është që ajo të besojë në njërin nga librat hyjnorë. S'mund të martohet me një femër që i beson zjarrit, diellit, yjeve dhe idhujve. Nuk mund të martohet as me femrat që, edhe pse duken se janë muslimane, nuk respektojnë urdhërat dhe ndalesat e fesë, të cilat nuk përfillin njërin nga gjyqet që janë konstituar me argumente të forta dhe me ato që haramin e kanë kuptuar si diçka që është hallall.⁷⁵

Ekzistojnë mendime të kundërta midis shkencëtarëve të Islamit, në temën, martesë me femra që u besojnë librave të shenjtë. Një shumicë e madhe janë të mendimit, se u lejohet kjo martesë. Abdullah Ibën ‘Umeri, llogarit se ky mendim është i gabuar.⁷⁶

Në kohën e halifit ‘Umer, ushtria islame, çliron disa vende duke bashkuar shumë toka të reja me shtetin islamik. Në ndërkohë, muxhahidët islamikë dhe disa nga as’habët, u martuan me femra që u besojnë librave të shenjtë. Halifit ‘Umer, që mendonte se kjo mund të jetë gjë e rrezikshme për familjet muslimane, nuk i pëlqente martesë me femrat jo muslimane. Hudhejfe, njëri ndër as’habët, u martua me një hebreje, ndërsa halifi ‘Umer i tha atij **“Lëshoje”**. Kur Hudhejfe e pyeti: **“Është haram kjo?”** ‘Umeri iu përgjegj kështu: **“Jo, por po frikësohem se do të kesh punë me dikë që moralisht është i dobët.”**⁷⁷

Kuptohet se ‘Umeri nuk e llogariste haram martesën me një femër jomuslimane, por këtë e llogariste si një akt të rrezikshëm nga aspekti i ardhmërisë së gjeneratave muslimane. Kur e pyetën Abdullah Ibën ‘Umerin për gjykimin e tij lidhur me martesën me një hebreje ose të krishtere, u përgjegj kështu:

“Zoti ua ka bërë haram meshkujve femrat që Zotit i mveshin rival. Unë nuk njoh tradhëti më të madhe se ajo grua që thotë: Zoti im është Isa ose filan fallani tjetër (ndonjë rob i All-llahut)”

Sipas të drejtës islame, ndryshimi midis besimeve është një pengesë për trashëgiminë, ndaj një femër jomuslimane nuk mund të fitojë trashëgimi nga një mashkull musliman. Edhe nga ky aspekt martesë me një femër jomuslimane është akt i papëlqyeshëm.⁷⁸

Takimi i bashkëshortëve të ardhshëm

Para së gjithash kërkohet bashkëshort që e duam. Siç mund të kuptohet nga thelbi i hadithit, femra dhe mashkulli, paraqesin gjysmërrethe të një rrethi të përbashkët. Ata vazhdimisht notojnë në gjithësinë ekzistuese. Kur e gjejnë gjysmërrethin adekuat, bashkohen dhe formojnë rrethin e plotë. E ky rreth e paraqet themelin e jetës.

Për t’u dashuruar duhet takim dhe simpati. Islami i lejon bashkëshortët e ardhshëm të takohen më parë. Madje edhe e urdhëron këtë. I Dërguari a.s. një as’hab që dëshironte të martohej me një muslimane nga Medina, e pyeti: **“A e ke parë?”** dhe kur ai tha: **“Jo”**, Muhammedi a.s. tha: **“Shko dhe shikoje atë, pasi në sytë e femrave të Medines mund të gjendet diçka (ndonjë e metë e syve).”**⁷⁹

Një njeriut tjetër që donte të martohej, Pejgamberi a.s. i tha kështu:

“Ta shikosh njëherë sepse kjo do të ndihmojë që kurora yte të jetë më e qëndrueshme.”⁸⁰

Siç dihet, bukuria është relative. Nga njeriu te njeriu tjetër ajo ndryshon. Ndaj personalisht duhet të shihen bashkëshortët e ardhshëm. Përshkrimet e huaja nuk duhet përfillur.

Por edhe takimet kanë masën dhe kufirin e vet. Pasi midis të simpatizuarve nuk ka kurrfarë lidhjesh, të dy palët fshehen nga njëri tjetri. Në këso lloj takimesh njëri tjetrit mund t'ia shohin fytyrën, duart dhe thembrat. Trupi dhe pamja e përgjithshme janë gjëra të qarta. Ky takim, me këtë masë, mund të realizohet madje edhe në praninë e ndonjë personi që bën pjesë në kategorinë “mahrem”.⁸¹

Nëse dy palët dëshirojnë të mësojnë për moralin dhe mendimin e njëri tjetrit (edhe kjo është me rëndësi), këtë e mundëson pyetja që mund t'ua bëjnë fqinjëve dhe të njohurve ose ndonjë mënyrë tjetër e ngjajshme. Munden edhe të zhvillojnë bisedë të hapët në kushte të lartpërmendura. Bashkëjetesa pa kurorë është e ndaluar. Por, në rrethana të këtilla, kur secili paraqitet jogjentil dhe fsheh karakterin e vet të vërtetë, gjasat që të njihen janë të vogla. Në raste të këtilla mbretëron epshmëria, emocionet mbizotërojnë trurin. Pejgamberi a.s. thotë:

“Dashuria e yte ndaj diçkaje të verbëron dhe të shurdhon”.⁸²

Shkrimtari i madh freng, Molieri, në veprën e tij “*Mizantropi*” me gojën e heronjëve të vet shpjegon, si ligj i dashurisë është ta gënjesht partnerin dhe si të gënjejë ai, dhe se palëve të dashuruara epshet u janë të larta deri në atë shkallë sa që nuk mund të vërehen gabimet e njëri tjetrit. Molieri këtë e shpjegon me fjalët:

“Të dashuruarve çdo gjë u duket simpatike në trupin e atij që e duan. Duke menduar se gabimet e tyre janë pjekuri, ato i emërtojnë me emra përkëledhës. Një pamje të mangët e shikojnë si jasemin i bardhë, të zezën e si zeshkane aq të ëmbël sa që duhet të përkulesh para kësaj ngjyre, gënjeshtari u duket si i mençur ndërsa i marri si një shpirtmirë”.⁸³

Sot me emrin i ose e fejuar, shumë të rinjë takohen, argëtohen, kënaqen, e më pastaj bëjnë përpjekje që të ikin nga njëri tjetri, dhe kuptohet, më shpesh pala më e dëmtuar është femra. Por, me ligj s'mund të detyrohen të fejuarit të vënë kurorë.⁸⁴

Nga bashkëjetesa pa kurorë rrjedh edhe dëmi tjetër, atëherë kur në mënyrë hidhërake ndahen njëri nga tjetri, fillojnë t'i numërojnë e t'i shqiptojnë gabimet e njëritjetrit dhe në këtë mënyrë ardhmëria e tyre sillet në një gjendje jo të pëlqyeshme.

e E

IV. Çështjet tjera lidhur me kurorën

Vetitë që kërkohen tek gruaja

1. I Dërguari a.s. gjithnjë ka preferuar bukurinë shpirtërore përkundër bukurisë materiale. E para është konstante, nuk ndrydhet, ndërsa e dyta është relative, e zbehtë, fiket. Sa bukuroshe ekzistojnë e nuk mund ta bëjnë të lumtur njeriun, pasi që shpirti i tyre është i thjeshtë. Ja disa këshilla të Pejgamberit a.s.:

“Mos i martoni gratë bukuria e të cilave mund t’ju zhvleftësojë nga ana morale, mos u martoni as për pasurinë e tyre sepse ato mund t’i llastoni. Martohuni me ato për shkak të besimit të tyre. Me siguri ndonjë grua zeshkane e me veshje të leckosur por besimtare, është shumë e vlefshme”.⁸⁵

“Kush disponon me këto katër gjëra, disponon edhe me të mirat e kësaj bote edhe me ahiretin: zemërmirësinë, gjuhën që vazhdimisht e përmend emrin e All-llahut, trupin që i duron mundimet dhe që nuk e tradhëton as nderin as pasurinë e bashkëshortit.”⁸⁶

“Me gruan lidhet kurorë për shkak të këtyre katër gjërave: pasuria, fisnikëria, bukuria, dhe besimi. Kërkoje atë që është besimtare dhe do të jesh fatlum!”⁸⁷

2. Virgjëria. I Dërguari i All-llahut as’habët e vet i porosiste të martohen me virgjëresha sepse me një të tillë është më lehtë të adaptohesh në dashuri. Përveç kësaj, për shkak të shumë punëve shtëpiake si dhe për shkak të numrit të fëmijëve u lut për mirëqenien e atyre të cilët u martuan me të veja.⁸⁸

3. Siç u theksua më lartë lidhur me definicionin e kurorës, njëri ndër qëllimet e martesës është edhe ai-të kesh fëmijë. Kjo në njëfarë shkalle mund të kuptohet, duke i krahasuar nënat tona dhe gratë e afërta. I Dërguari a.s. thotë:

“Martohuni me gra që mund të lindin dhe që e duan familjen. Unë në Ditën e Gjykimit do të mburrem me numrin tuaj para ummeteve tjera.”⁸⁹

4. Gruaja duhet t'i dojë fëmijët. Ajo duhet ta ruajë pasurinë e burrit si edhe krenarinë dhe nderin e tij. Nëse burri është lumi që rrjedh vazhdimisht, gruaja është penda e tij. Vërtetë, nëse nuk është ekonomike në buxhetin familjar, fitimi i burrit i gjason asaj sikur të hedhësh ujë në shoshë. I Dërguari i All-llahut thotë:

“Nga gratë më të mira janë gratë kurejshite dhe nga ato, më e vlefshmja është ajo që ndjen dashuri më të madhe ndaj fëmijës së vet dhe e cila kujdeset më së shumti për pasurinë e burrit.”⁹⁰

Kur e pyetën:

O i Dërguar i All-llahut, cila prej grave është e mirë? - ai u përgjigj kështu: -Është ajo grua të cilën kur e shikon burri i saj, ndjen kënaqësi, kur t'i thuhet diçka, e kryen, ndërsa lidhur me nderin e pasurinë nuk bën diç që nuk i pëlqen burrit.”⁹¹

Vetitë që duhet t'i ketë burri

Si tek gratë ashtu edhe tek burrat virtyti i parë është besimi i tij. Një hadith që e cituam në nëntitullin “Nevoja për martesë” po e përsërisim edhe këtu:

“Kur të vijë tek ju dikush me karakterin dhe besimin e së cilit jeni të kënaqur, jepjani vajzën tuaj. Nëse nuk veproni kështu, do të lindin intrigat dhe përçarjet.” “Nëse, o i Dërguar i All-llahut, tek ai mbretëron skamje dhe rrjedh nga familja jo bujare?” i Dërguari i All-llahut duke përsëritur tri herë tha: “Kur të vijë një njeri me fenë dhe karakterin e të cilit jeni të kënaqur, martojeni”.⁹²

Kufuv (ngjashmëria)

Në sistemin e vjetër juridik kihej kujdes që të mos ketë diferenca klasore midis bashkëshortëve të ardhshëm. Në të drejtat e vjetra brahmane, më parë, një burrë mund të martohej me një femër të klasës më të ulët, më pastaj, një martesë e këtillë midis njerëzve të shtresave të ndryshme, sipas zakonit, nuk pranohej.⁹³ Në të drejtën romake, kurorë legale, mund të bëhej vetëm midis një burri, qytetar i Romës, dhe një gruaje, gjithashtu qytetare e Romës. Nëse njëra nga palët s'kishte të drejtën e qytetarit (ose e humbte atë) kurora prishej.⁹⁴

Në të drejtën islame ekzistojnë disa norma në dobi të gruas. Gruaja ose prindi i saj, mund të kërkojë disa kushte prej atij me të cilin do të lidhë kurorë. Juristët e ndryshëm japin mendime të ndryshme lidhur me atë se si duhej të dukeshin këto normativa. Një rregullim i këtillë quhet “*kufuv*”, që do të thotë ngjashmëri, barazi etj,

Drejtimit e ndryshme ndajnë të njëjtin mendim, se në pikëpamje të fesë midis bashkëshortëve duhet të ketë barazi. Veç kësaj hanefijtë, sollën edhe një kusht se burri nuk duhet të jetë në shkallë më të ulët se gruaja nga aspekti i prejardhjes, kështu janë kurejshët midis tyre, arabët tjerë midis veti. Njerëzit tjerë jashtë radhëve të arabëve, janë të barabartë dhe mund të martohen. Gjithashtu, burri duhet të ketë fuqi financiare deri në atë shkallë sa t’ia paguajë gruas mehrin dhe të ketë aq sa mund të paguajë alimentacion 6 muaj ose një vjet. Edhe nga aspekti i marrëdhënieve ndaj shoqërisë ku jeton, nuk duhet t’i sjellë gruas turp.

Sipas shafiijeve, në pikëpamje të fesë, profesionit, origjinës dhe lirisë, burri nuk duhet të jetë në një shkallë më të ulët nga gruaja.

Gjithashtu edhe tek hanbelijtë mendohet përafërsisht njëllë. Ndërsa, malikijtë, mendonin më lirisht dhe për nga argumentet fetare, sillen në mënyrë më solide. Sipas tyre kufuvi ose barazia kërkohet vetëm në besim, në shëndetin trupor dhe të organeve trupore.⁹⁵

Kritika dhe preferime

Është e qartë se juristët islamikë në temën e kufuvit dhe vetitë që duhen kërkuar tek burri, nuk kanë arritur një mendim të përbashkët. Imami Malik Thevri, nga hanefijtë Imam Kerhi, sipas një transmetimi Imam Shafiu, Amr b. Mes’ud, nga tabiinët Muhammed b. Sirin dhe ‘Umer b. Abdulaziz mendojnë se barazia kërkohet vetëm në fe dhe moral.⁹⁶ Pikërisht kështu flet edhe hadithi të cilin e theksuam në fillim të kësaj teme. Ato hadithe që janë në lidhje me kërkesën e barazisë së origjinës midis palëve nuk mund të jenë të fortë.⁹⁷ E nga ato hadithe që janë autentike nuk mund të nxirret një gjykim i këtillë.

Barazia profesionale jasht barazisë së origjinës kohë paskohe ndryshon si edhe nga vendi në një vend tjetër.⁹⁸ Disa profesione të cilat në ndonjë vend ose në ndonjë interval kohe, llogariten të ulëta dhe të prapambetura, në ndonjë vend tjetër trajtohen ndryshe.⁹⁹

Ekzistojnë disa hadithe autentike të Pejgamberit a.s., të cilat në rrënjë e mohojnë diferencën midis njerëzve në baza të origjinës. Para së gjithash, në ajetin 13 të sures el-Huxhurat All-llahu xh.sh. na shpall se të gjithë njerëzit kanë prejardhje nga një mashkull dhe një femër, ndaj janë të barabartë dhe të ndarë në fise të ndryshme që të munden të njihen dhe të identifikohen. Superioriteti mund të kërkohet vetëm në devotshmëri që mund të ekzistojë tek secili:

“...s’ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur...”

Edhe Pejgamberi a.s. urdhëron kështu:

“Njerëzit janë të njëjtë si janë të njëjtë dhëmbët e krehërit. Asnjë arab nuk gëzon më tepër përparësi nga joarabi. Përparësia është vetëm në devotshmëri ndaj All-llahut.”¹⁰⁰

Në hutben e njohur lamtumirëse të Pejgamberit a.s., një citat thotë kështu:

“Njerëz! Zoti është Një. Edhe babai juaj është një. Të gjithë ju jeni bij të Ademit. E Ademi është krijuar nga dheu. Para Zotit është më i çmuari, ai që Zotin e respekton më shumë. Arabi nuk ka asnjë përparësi nga joarabi, përveç masës së respektit ndaj Zotit.”

Dhe të theksojnë edhe këtë se Muhammedi a.s. e martoi Fatimen të bijën e Kajsit që ishte e mençur, e bukur dhe prej fisit Kurejsh, si fis që llogaritet ndër fiset më të njohur dhe më të ngritur, për Usamen, i biri i një robi të çliruar.¹⁰¹ Gjithashtu, në kohën e tij, e motra e Abdurrahman b. Avf nga kurejshët, u martua me ish robin, Bilalin nga Etiopia, ndërsa Ebu Hudhejfe e dha të bijën e vëllait për robin e vet, Salim. I Dërguari a.s. disa nga veprat e këtilla i kreu vet e disa nga ato, pasi u informua, i lejoi të kryhen.¹⁰²

Edhe familja është një nga ato elemente ku ne muslimanët jemi duke pësuar disfatë në frontin tonë të luftës midis së vërtetës dhe gënjeshtres që ka arritur në shkallën më të lartë e që vazhdon prej kohës së njeriut të parë dhe Pejgamberit të parë, Ademit a.s. Numri i familjeve tona që janë të lidhura me imanin e Islamit dhe zakonet lidhur me to, gjithnjë po zvogëlohet. Arsye për këtë është korrupcioni rreth masave dhe vlerave në kurorë. Vajzat që janë rritur në familje muslimane shkojnë në qarqe ateiste për t’u martuar për doktorë, avokatë, inxhinierë, fabrikantë, ndërsa burrat besimtarë, nga ana tjetër, që s’janë të kujdesshëm ndaj fesë, martohen me vajza të cilat, gjithashtu nuk kanë kujdes të duhur ndaj fesë. Në këtë mënyrë familja islame, është e sulmuar nga dy anë dhe fatkeqësisht, prindërit që duken se janë besimtarë, më tepër janë të preokupuar me këtë dukuri. Ata, duke vërtetuar se po kërkojnë njeri besimtar, në realitet kërkojnë dhëndër të pasur (madje edhe sikur të jetë mëkatar). Këta njerëz, që me trupin e vet janë të kthyer nga Kibla e me zemra nga materia, hyjnë në atë kategori, për të cilën i Dërguari a.s. në hadithin që vijon thotë:

“Secili ummet (popull) ka nga një intrigë, e intriga e ummetit tim është pasuria.”¹⁰³

Njëri nga as’habët Sehl b. Sa’d es-Saidi, thotë: Një ditë pranë të pranishmëve të Pejgamberit a.s. kaloi një njeri. I Dërguari a.s. e pyeti njërin ndër të pranishmit:

“-Ç’do të thojë për këtë që po kalon?

-Është vendas i vjetër. Beto hem se sikur të kërkojë vajzë, meriton t’i jipet. Nëse flet për ndonjë temë, meriton t’i dëgjohe fjalat. - tha as’habi.

I Dërguari a.s. heshti. Pas pak kohësh kaloi një tjetër. Edhe kësaj radhe pyeti:

-E për këtë, ç’do të thuash? Ky u përgjigj:

-O i Dërguar i Zotit, ky është njëri ndër muslimanët më të varfër. Sikur të kërkojë vajzë, meriton të refuzohet. Që të jetë ndërmjetës, meriton të mospranohet, e, nëse flet diçka, nuk meriton të dëgjohe.

Pas këtyre fjalëve i Dërguari i All-llahut tha:

-Ky nga ai i pari vlen shumë më tepër se një botë e tërë.¹⁰⁴

Nuk e njoh ndonjë të vërtetë më të madhe se sa atë që e shpalli i Dërguari i All-llahut.”

Të kërkuarit e vajzës

Në kohën e Pejgamberit a.s. Aliu personalisht e kërkoi Nënë të tonë, Fatimën r.a. nga i Dërguari a.s.¹⁰⁵ As'habët u ofronin vajzat dhe motrat e tyre njerëzve përkatës në moshë të martesës, e ata, ose pranonin ose refuzonin, e grave që u pëlqente martesë me dikë ofroheshin personalisht vetë.¹⁰⁶ Kjo rrodhi nga dëshira fetare, sinjeriteti dhe modestia.

I Dërguari a.s. thotë:

“Askush të mos kërkojë të njëjtën vajzë pasi e kërkoi vëllau besimtar, vetëm pasi ky të ketë hequr dorë, ose, po t'i jipte leje atij të dytit. Kjo bën përjashtim”¹⁰⁷

Nuk rekomandohet oferta e kurorës në mënyrë të hapët, gruas që është në fazën e pritjes (sipas shariatit-iddeti), pas shkëputjes së kurorës ose pas vdekjes së bashkëshortit.¹⁰⁸

Mehri dhe dhurata

Në të drejtën islame, mehr, quhet pasuria që e meriton gruaja që t'i jipet nga ana e burrit, për lidhjen e kurorës. Mehri nuk është e drejtë as e nënës, as e babait, as e prindit, por e drejtë personalisht e gruas. Është ky një lloj dëmshpërblimi që e pagon burri në kurorë. Me të, mbulohen nevojat e gruas dhe asaj ia sjell njëfarë vlere. Mehri mund të paguhet menjëherë (muaxh-xhel) ose si muexh-xhel (në rast shkurorëzimi ose vdekjeje). Mehri është i obligueshëm për lidhjen e kurorës. Edhe nëse nuk përmendet gjatë këtij akti, madje edhe të bëhet kurorë me kusht që të mos pagohet mehri, megjithatë burri është i obligueshëm që gruas t'ia paguajë atë, si e drejtë e saj e paevitueshme.

Nuk ekziston kufiri i mehrit edhe pse është i caktuar kufiri më i ulët, por, edhe për këtë nuk ka kufi të caktuar.

Nuk mund të rëndohet kurora në Islam. Përkundrazi, që të mund të shtohen gjeneratat e prostitucioni të evitohet, kurora lehtësohet. Do të ishte mirë që mehri mos ta ngarkojë shumë burrin. Pejgamberi a.s. thotë:

“Mehri më i mirë është ai që është pak”¹⁰⁹

Mehri është e drejtë personale. Me të gruaja nuk është e detyruar të përgatisë pajën (çezin).¹¹⁰

Prindi i vajzës ose farefisi i saj nuk guxojnë të kërkojnë nga ajo ndonjë shumë të hollash.¹¹¹ Të hollat që i paguhën familjes së vajzës në disa vende, s'kanë lidhje me Islamin. Është ky zakon që është praktikuar para Islamit. Në Islam asnjë njeri i lirë, në asnjë mënyrë, nuk mund të shitet. Kërkimi i shpenzimeve të panevojshme nga ana e vajzës që do të bëhet nuse dhe praktika e mosmbulimit të vajzave e rëndon martesën. Kjo e lind tragjedinë e prostitucionit dhe grabitjen e vajzave. E rezultat i këtyre është armiqësia, zënkat, vrasjet...

Dasma

Dasma është sunnet. I Dërguari a.s. thotë:

“Bëni dasmë madje edhe po të jetë ajo vetëm me një dele, jepni zifafet.”¹¹²

Dasma është akt edhe përkujtim, shpallje e një pune fatlume njerëzve, shprehje e disponimit dhe ushqim i të varfërve. Kur të ftohet njeriu në dasmë, ftesën duhet pranuar. Pejgamberi a.s. thotë kështu:

“Ngrënia më e keqe është ajo ngrënie dasmore kur ftohen të pasurit e harrohen të vobektit. Kush nuk pranon ftesën ai është kundër All-llahut dhe të Dërguarit të Tij.”¹¹³

Pasi dasma është një shkas për gëzim, aheng dhe fat, nuk ekziston asnjë pengesë që në një farë mënyre të ndalohet nga feja. Madje kjo është edhe imperativ. Ajo që është e ndaluar, është pirja e alkoolit dhe të tubuarit e grave dhe meshkujve bashkarisht. I Dërguari i All-llahut thotë:

“Shpallni kurorën dhe bëni atë nëpër xhami. Në dasmë ftoni edhe dajre. Hallalli ndryshon nga harami (me haram nënkuptohet prostitucioni) me vënien e kurorës, organizimin e argëtimit dhe muzikimit me dajre.”¹¹⁴

Shoqëria islame nuk i pengon argëtimet legale në ditët e kremteve, festave, etj. Përkundrazi, ato i pranon duke llogaritur se janë të rëndësishme. Është i nevojshëm për një shoqëri formimi dhe ekzistimi i vetëdijes kombëtare. Shoqëria, nevojat e së cilës Islami i përmbush plotësisht, është një shoqëri vullneti i së cilës është vullneti i përhershëm dhe i vazhdueshëm. Derisa ka kaq shumë hadithe verbale dhe praktike të Pejgamberit a.s. ndalimi i dasmave dhe argëtimit në to para së gjithash është kundër sunnetit. Të përsërisim se dasmat dhe argëtimet përputhen me etikën dhe rregullat islame...

Në një ditë të Kurban Bajramit Ebu Bekri, shkoi tek bija e vet, Aisheja, dhe ç'të shikojë-dy vajza muziktojnë me dajre dhe këndojnë. Dhe, Pejgamberi a.s. u mbështet në një kënd dhe u mbështoll me çarçafin e vet. Ebu Bekri iu drejtua vajzave në mënyrë të ashpër. Për këtë Pejgamberi a.s. thotë:

“Lëshoji, Ebu Bekër, secili e gëzon festën e vet. Kjo është festa jonë!”¹¹⁵

Rubejda, e bija e Muadhit, thotë:

“Kur u bë dasma ime Pejgamberi a.s. erdhi dhe u ul. Disa vajza luanin në dajre dhe përmendën babanë tim si dhe xhaxhallarët e mij, që ishin martirë në Bedër. Kur, njëra prej tyre tha: “Leri këto fjalë, vazhdoje atë që e the pak më parë”¹¹⁶ Aisheja kishte martuar një vajzë nga farefisi i vet me njërin nga muslimanët e parë të Medines. Pejgamberi a.s. i tha Aishes: **“Aishe, duket se në dasmën tuaj nuk pati valle e argëtim, e ensarit i pëlqen loja.”¹¹⁷**

Sipas një rrëfimi tjetër Pejgamberi a.s. Aishes i tha kështu: **“A e keni dërguar një vajzë me nusen që të luaj në dajre dhe të këndojë?”** Aisheja e pyeti atë: **“Sikur ta kishim dërguar, ç’do të thoshte?”** E Muhammedi a.s. duke cituar tri vargje poezie, tha: **“Ja kështu do të thoshte”**.¹¹⁸

Një njeri që u ftua në kurorëzim ose në diç të ngjashme, po hetoi diçka jo të pëlqyeshme, së pari duhet ta pengojë atë. Nëse nuk mundet, assesi nuk duhet të merr pjesë në atë akt. S’guxon të rrijë pranë tryezës e të shërbehet me ushqim e pije (në dasmë që bie ndesh me normat islame). Pejgamberi a.s. thotë kështu:

“Po të shikoni ndonjë dukuri të keqe, atë duhet ta përmirësoni me duart tuaja. Nëse nuk keni fuqi me duar, atëherë tentoni me gjuhë (me fjalë). Nëse nuk mund ta evitoni as me fjalë, atëherë ta përbuzni me zemër-që është shkalla më e dobët e imanit.”¹¹⁹

“Ai që i beson All-llahut dhe Ditës së Kijametit, mos të rrijë në tryezë ku ka pije (alkool).”¹²⁰

e E

V. Pengesat në martesë

Pengesat në martesë

Në të drejtën e vjetër iraniane, nuk respektoheshin pengesat, bile edhe preferohej martesë midis vëllaut dhe motrës. Sipas të drejtës iraniane, në vend se të ndalohej prostitucioni midis njerëzve që nuk duhej të martohen mes veti, vëllezërve me motra, prindërve dhe fëmijëve si dhe kushërinjëve dhe farefisit, kjo përkrahej.¹²¹ E njëjtë është gjendja edhe në të drejtën e Egjiptit të Vjetër.¹²² Sipas të drejtës kineze, edhe pse nuk mund të kurorëzoheshin kushërirët nga ana e babait, ata nga ana e nënës kishin të drejtë të kurorëzohen.¹²³

Ajetet 22-24 nga sureja en-Nisa si dhe disa hadithe, e lajmërojnë muharrematin në Islam (njerëz midis të cilëve është i ndaluar kurorëzimi).¹²⁴

Kështu mund t'i radhisim:

1. Ata të cilëve u është ndaluar kurorëzimi për shkak të farefisnisë dhe afërsisë të gjakut nëna, bija, motra, halla, tezja dhe mbesa.
2. Për shkak të lidhjes miqësore midis familjeve, vjehrrat, vajza nga kurora tjetër, nusja, njerka.
3. Për shkak të qumështit. Ndalesat e lartpërmendura për shkak të lidhjes miqësore dhe afërsisë së gjakut njëkohësisht përfshijnë edhe ndalesat edhe për shkak të qumështit: tajat, motrat nga taja, bija nga taja dhe tajën e bashkëshortes...
4. Siç do të theksojmë në vazhdim, nëse ekzistojnë kushte, Islami e lejon martesën me katër gra. Mirëpo martesë me më tepër se katër gra është e ndaluar.
5. Nuk është e lejuar që burri të martohet me gra që mes vete janë të afërta njëra me tjetrën. Për shembull, të merr dy motra ose tezen dhe mbesën.
6. Nuk guxon të martohet me një grua që është e martuar me dikë tjetër, ose me ndonjë që pret iddet pas ndarjes ose vdekjes së burrit.

7. Nuk mund të martohet me gra që s'janë muslimane dhe që nuk besojnë në njërin nga librat hyjnorë.
8. Gratë që janë absolutisht të ndara nuk mund të rimartohen me ata nga të cilët janë ndarë, me përjashtim të atyre të cilat pas ndarjes përsëri janë martuar e më pas janë ndarë, ose nëse bashkëshorti i dytë ka vdekur.

Afërsia e qumështit

Kur në Kur'anin Famëlartë theksohen gratë me të cilat nuk duhet kurorëzuar, atëherë thuhet:

“...nënat tuaja që ju kanë dhënë gjë, motrat nga gjiri...”¹²⁵

Edhe Pejgamberi a.s. thotë:

“Ato që janë të ndaluara (për kurorëzim) sipas farefnisës së gjakut, ato janë të ndaluara edhe sipas qumështit”.¹²⁶

Imamët e katër medhhebeve janë pajtuar se ato që janë të ndaluara sipas farefnisës së gjakut, janë të ndaluara edhe sipas qumështit. Kësaj i kundërshtohet vetëm Ibën Tejmijje.¹²⁷

Për qëllimin dhe arsyen e afërsisë sipas qumështit, në Kur'an nuk janë theksuar të dhëna të veçanta, ndërsa në hadithe theksohen urtësitë në disa pika. Shtrohen dy arsye të rëndësishme për ndalimin e kurorëzimit të atyre që janë në farefnisni të gjakut dhe të atyre që janë miqësuar sipas qumështit. Arsyeja e parë është ajo materiale: ato veti që ka trashiguar mashkulli dhe femra të cilat janë kushëri, pasi që janë të ngjshme (vetitë), me martesën e tyre, fëmijët do t'u lindin jo të talentuar, jo normal, madje edhe të çmendur. Arsyeja e dytë është ajo shpirtërore dhe morale: ata respektohen mes vete, por pasi kurorëzohen, nuk do ta nderojnë njëri tjetrin, e kjo është kundër botëkuptimeve njerëzore, natyrës së njeriut dhe moralit.

E tani këto t'i shqyrtojmë nga aspekti i afërsisë së qumështit.

Gjatë thithjes fëmija ushqen organizmin dhe i formohen mishi dhe eshtrat. Në këtë substancë të çuditshme ushqyese e cila i përmban elementet kryesore ushqyese, vallë, a i përcillen fëmijës edhe elemente shpirtërore? Nëse nëna ka aftësi të imunitetit ndaj disa sëmundjeve ose nëna gjatë taitjes lëngon nga ndonjë sëmundje ngjitëse, mjekësia ka vërtetuar se këto përcillen edhe tek foshnja.

Në hadith thuhet:

“Një dhe dy thithje nuk shkaktojnë pengesë për kurorë.”¹²⁸

Sipas njërit nga dy rrëfimet e Imam Ahmedit dhe Imam Shafiut, që të formohet respekti nëpërmjet qumështit, fëmija duhet të ushqehet me pesë shujta dhe pesë herë të thithë. Sipas disa të tjerëve, mjaftojnë tri thithje. Mirëpo hanefijtë që ishin më të rezervuar dhe më të kujdesshëm për

thithjen, kontrollimi i së cilit është shumë i rëndë, kanë thënë se ndalesa për kurorë do të jetë formuar madje edhe vetëm me një thithje.¹²⁹ Në një hadith tjetër thuhet:

“Kushëriri e tajës formohet vetëm gjatë kohës së urisë (nevojë për qumësht)¹³⁰;

Kushëriri të tajës nuk formohet pas periudhës së thithjes (pas moshës dyvjeçare e mëtej).

Këto hadithe tregojnë se vetitë që i ka marrë fëmija, materiale dhe shpirtërore, nëpërmjet të qumështit, e formojnë bazën e kushëririsë së tajës.

Arsyeja morale që e pengon martesën midis atyre të farefisnisë, qëndron edhe në qumësht. Gruaja që e merr një fëmijë në prehër dhe e tajit, duke e ushqyer gjakun, mishin dhe eshtrat e tij, ajo meriton respektin e nënës.

Shah Velijjullah ed-Dihlevi thotë:

“Femra që është tajë i gjason nënës së vërtetë, nga pikëpamja se ajo është shkaktare e rritës dhe zhvillimit të fëmijës dhe të ngritjes së tij në këmbët e veta. Derisa nëna e vërtetë e ka bartur fëmijën në stomak, taja ia plotëson nevojën për ushqim (me qumësht) pas lindjes së fëmijës. Kështu nënë është edhe taja. Edhe fëmijët e tajës kësaj foshnjeje i janë vëllezër e motra. Kur ajo ia fali gjinin një fëmijës, ia fali edhe të drejtën prindore. Kështu, fëmija në të e gjeti rehatinë. Ndaj, nuk mund të pranohet që fëmija atë ta përvetësojë si grua dhe të bëjë marrëdhënie me të. Si do ta bënin njerëzit këtë, kur as kafsha nuk bën marrëdhënie me kafshën që e ushqen.”¹³¹

Martesa me gruan e pamoralshme

“Laviri nuk do të duhej të martohet me tjetërkë, pos me ndonjë lavire ose idhujtare, e lavirja, me të nuk do të duhej të martohet kush, pos ndonjë lavir o idhujtarë. Ajo (kurvëria ose martesa me të) është e ndaluar për besimtarët.”¹³²

Juristët japin shpjegime të ndryshme lidhur me këtë ajet të sures en-Nur.

A mund një musliman të martohet me një lavire? Shumica mendojnë se një grua lavire, mund të lidh kurorë me një burrë. E, sipas një të thënë të Aliut, Aishes, Bera's dhe Ibën Mes'udit martesa me një lavire nuk guxon të bëhet.¹³³ Ibën Kajjim e pëkrahet mendimin e dytë. Ai thotë: Në Kur'an besimtarit i urdhërohet të martohet me një grua të ndershme.¹³⁴ Kurora është valide me këtë kusht. Kur nuk plotësohet ky kusht, nuk mund të bëhet kurorë. Njeriu që do të martohet ose e pranon ligjin e Zotit ose jo. Nëse nuk e pranon, ai do të jetë pabesimtar, ose do të jetë njeri që i mvësh shok Zotit. Nëse e pranon por nuk e aplikon ose martohet me një lavire, kësaj rradhe nuk i vlen kurora dhe, edhe vetë do të llogaritet si lavir. Ja, kjo është rëndësia e ajetit që u citua. Ibën Kajjim jep edhe shpjegime tjera lidhur me këtë temë.¹³⁵

Çdo grua që hynë në laviri, nuk është e njëjtë. Disa prej tyre kërkojnë falje. Të këtyllave s'ka ç'tu thuhet. Disa të tjera deri në këtë tragjedi kanë ardhur pa dashje. Nëse do të gjendeshte dikush ta shpëtojë, ajo do të ishte mjaft e lumtur. Do të ishte shumë mirë që të shpëtonte kështu. E disa e kënaqin shpirtin e epshin e tyre vetëm me laviri. Edhe sikur të martohej një e këtyllë, syri do t'i ngelte tek tjetri. Ja, pra, martesa me një grua të këtyllë, don të thotë pranim të lavirisë, don të thotë të jetosh me një krijesë që në Kur'an quhet “*habith*: e fëlliqur”. E kjo nuk i gjason një besimtari.

Sipas të drejtës romake, ishte e ndaluar martesa me një grua që ishte lavire, artiste dhe e gjykuar. Njerëzve të dalluar dhe familjeve të tyre u ishte ndaluar martesa me skllëvët e liruar ose më fëmijët e aktorëve teatral.¹³⁶

Martesa e përkohëshme

Kurora është një akt që mbështetet në qetësi e paqë si dhe në dashuri e në mëshirë, e që ka për qëllim që, duke formuar familje, të lindin fëmijë. S'quhet akt kurorë, madje edhe atëherë kur ka dëshmitarë dhe bëhet marrëveshje me një grua për kurorë të përkohshme. Edhe sikur të jetë për dhjetë a njëzet vjet. I Dërguari a.s. këtë e ndaloi në mënyrë absolute. Fjalët e Abdull-llah b. Abbasit, që mendon se kurora e përkohshme është e pranueshme, nuk janë të drejta. Nga as'habët, muxhtehidët e njohur të Islamit që nxjerrin gjykime nga ajetet dhe hadithet dhe nga tabiinët (ata që janë takuar me njerëz të cilët e kanë parë Muhammedin ose kanë dëgjuar hadithet e tij) askush nuk e pranon një kurorë të këtyllë.¹³⁷

e E

PJESA E DYTË

GRUAJA NË FAMILJE

- I. Pozita e gruas në familjen islame
- II. Të drejtat e ndërsjella të gruas dhe të burrit
- III. Poligamia
- IV. Prishja e kurorës (shkurorëzimi)
- V. Hul-le (kthimi i gruas në kurorën e parë)
- VI. Gruaja dhe trashëgimia

Hyrje

Para lindjes së Islamit, kudo në botë gruaja, edhe para kurorës edhe pas saj, kishte të drejta shumë të kufizuara, ose nuk kishte fare të drejta. Në kohën e lulëzimit të civilizimit të Greqisë së Vjetër, deri në shekullin III të erës së re, në Kinë, në të drejtën hinduse, në të drejtën hebreje, gruaja gjendej nën presion. Nuk mund të bënte asgjë krye në vete. Gjendej nën dominimin e babait para kurorës, e në kurorë nën dominimin e burrit, e pas vdekjes së tij - nën dominimin e djalit më të madh ose nën dominimin e ndonjë mashkulli tjetër nga familja.¹³⁸

Edhe në siujdhesën e Arabisë pozita e gruas nuk ndryshonte.

I. Pozita e gruas në familjen islame

“Xhenneti gjendet nën këmbët e nënave.”

Muhammedi a.s.

Aftësitë fiziologjike dhe psikologjike të burrit dhe gruas

E vërtetë e pamohueshme është se gruaja dhe burri, nga pikëpamja e formimit, nuk janë të njëjtë. Shkencëtarët që bëjnë fjalë për të drejtat e gruas, tentojnë të shpjegojnë arsyet e ndryshme të këtij dallimi. Disa prej tyre vërtetojnë se ky ndryshim fiziologjik me kohë do të evitohet, kështu që gruaja dhe burri, edhe psikikisht një ditë do të barazohen. Nëse e lëmë në një anë këtë debat dhe nëse e shqyrtojmë pozitën e sotme, do të shohim se gruaja dhe burri, njeri prej tjetrit, ndryshojnë vetëm nga pikëpamja e formimit të trupit të tyre, organizmit të tyre dhe aktiviteteve. Fiziologjikisht mashkulli dhe femra veprojnë ashtu siç iu mundëson struktura trupore. Ashtu siç një mashkull nuk mund të lind fëmijë, ashtu edhe një femër nuk mund të mbarsë. Pasi që “instikti seksual nuk është vetëm vlerë e mëvetëshme psiko-fizike, por është element i personit me të cilin është i lidhur në mënyrë të pandashme... Duhet të dijmë edhe atë se analiza e instiktit seksual mund të na dërgojë kah veçantitë (specifikat) e karakterit të një njeriu.”¹³⁹

Me siguri do të ketë dallime të mëdha edhe në sferën psikike, varësisht nga struktura fiziologjike. Tek mashkulli nuk mund të gjenden emocione gjithnjë të ndryshme siç janë të hajthme ato te gruaja. Mashkulli është një qenie e tillë që mund t’u kundërvehet dukurive të ashpra të vazhdueshme të natyrës, si dhe sulmeve të numërta të jetës. Fiziologët i shpjegojnë dallimet shpirtërore midis mashkullit dhe gruas. Në familje për burrin gjë elementare është t’i dalë në krye gruas, ndërsa për gruan është kryesore t’i dhurohet mashkullit, ruajtja e personalitetit deri në

shkallën e mundur dhe përpjekja që të jetë e simpatizuar dhe e pranuar nga ana e mashkullit, si dhe ruajtja e mashkullit në “pishinën e saj shpirtërore dhe trupore”. Për mashkullin, familja është një pasuri, ndërsa për gruan është fortifikatë. Gruaja disponon me veti varësisht nga fiziologjia dhe organizmi. Te gruaja janë më të shprehura: temperatura, pulsia dhe frymëmarrja. Forca muskulare ngadhënjën te mashkulli. Një gjendje e këtillë gruan e vendos ndërmjet mashkullit dhe fëmijës.¹⁴⁰

Gina Lambroso e cila e ka studiuar psikologjinë e femrës me një mençuri dhe urtësi në veprat “*L’ame de la femme*”, “*La femme dans la societe actuelle*”, shqyrton shumë çështje interesante:

“Gruaja, për shkak të dashurisë që e ndjen ndaj të tjerëve, është e varur prej tyre. Egoizmi i burrit është një fanar i ndritshëm që tregon rrugët nëpër të cilat duhet kaluar. Ndaj, mashkulli nuk kërkon udhërrëfyes dhe nuk mbështetet në askë. Ndërsa flijimi i gruas, atë e shtyen të mbështetet në të tjerët dhe pengohet të përparojë pa udhërrëfyes. Diç e këtillë nuk i përket vetëm asaj të duash dhe të jesh e dashur, por, ndoshta edhe vetëkontrollimit. Gruaja është si një kacavjerrës, madje edhe sikur t’i thaheshin rrënjët, sikur të gjente ndonjë degë të thatë ose ndonjë mur, do ta vazhdonte jetën. Tragjedia më e madhe për të është kur ngel pa mbështetje. Ka njerëz, të cilët, një dobësi të këtillë - (e kjo për gruan është forcë e të kërkuarit të mbështetjes dhe të varësisë nga të tjerët) e shpjegojnë me mungesë të edukatës. Por, edhe gruaja që ka edukatë më të madhe, përsëri ka nevojë për të (mbështetje).”¹⁴¹

Akademiku Maz’har Osman Uzman, pas studimit të dallimeve organike dhe psikike midis mashkullit dhe femrës, konstaton:

“Në kohëra të vjetra nuk ka ekzistuar mendim për barazi juridike, siç është sot mendimi i feministëve të rinj. Barazia juridike nuk mund të kënaq dy gjenerata që s’janë krijuar në të njëjtën mënyrë dhe që nuk kanë dëshira dhe ideale të njëjta. Edhe kafshët e gjinisë mashkullore janë të vrazhda ndaj atyre të gjinisë femrore. Dikur gruaja këmbehej, blehej, vidhej, grabitej e shitej. Pra, ajo nuk ishte pronare e vërtetë e vetëvetes, por ishte vetëm një lëndë për vazhdimësinë e racës... Madje edhe në ato vende ku gruaja nderohej si kurorë, martesë akoma i sjellte mishërim, bënte që plotësisht të humbë personalitetin e vjetër. Kjo prej zonjushës do të bëhet zonjë, do të mbajë mbiemrin e bashkëshortit dhe do të njihet si pronë e filan fallanit. Por, nuk ndryshon te burri, asgjë. Martesë sado që të jetë zburuese, gruan përsëri e vë në shërbim të burrit. Detyra e gruas në Angli, është të dashurojë, të shërbejë dhe të jetë e dëgjueshme, e thënë kjo që përcillet prej gojës në gojë. Poeti Schiler thotë: “Në rruzullin tokësor, dëgjueshmëria është obligimi i gruas”. Kundër dominimit të dukshëm të burrit, gruaja ka rezistencën e fshehur. Që të mundë burrin, gruaja shërbehet me natyrën e vet të butë dhe në mënyrë të pahetuar, burrin mund ta sjellë deri në atë gjendje që e dëshiron. Në një martesë fatlume, hidhërimi ose zemërimi i njërit palë zëvendësohet me gjentilitetin e palës tjetër. Njëra palë dëshiron të dominojë deri në shkallën e dhunës, ndërsa pala tjetër fiton me modesti, me dorëzim të pazezervë, me varshmëri e dëgjueshmëri. Ja, këto janë mëlmesat e bashkëshortësisë. Vetë krijimi i dy gjinive aq të ndryshme, lind respekt dhe dashuri të ndërsjellë.”¹⁴²

Ndarja e obligimeve

Në institucionin familje, feja Islame ka bërë ndarjen e obligimeve midis gruas dhe burrit sipas mundësive materiale dhe shpirtërore të tyre. Secilës palë ia ka dhënë detyrën që mund ta kryej dhe e ka respektuar aftësinë e tyre. Gruas i ka dhënë detyra që mund t'i kryej, e nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi që nuk mund t'i bartë. Në Kur'an Zoti xh.sh. më shpesh njerëzve u drejtohet vetëm në gjininë mashkullore. Kjo rrjedh nga specifika e gjuhës arabe. Në arabisht përdoret gjinia mashkullore, kur i drejtohem një grupi grash e burrash, për shembull edhe paraqitja **“ja ejjuhel ledhine amenu: o ju besimtarë”** është në gjininë mashkullore. Nga aspekti i përbërjes dhe kuptimit, i përfshin të gjithë besimtarët, pa marrë parasysh gjininë.

Para Islamit, ashtu si edhe në vendet tjera të botës, në Arabi, gruaja nuk kishte të drejta. Feja Islame gruas i solli të drejtat e merituar dhe e vendosi në pozitën e saj të lartë. Në një liri të këtillë që erdhi nga kjo reformë e papritur dhe e jashtëzakonshme, gratë mundeshin në mënyrë të haptë t'i shprehnin mendimet e tyre. Siç u theksua më lartë, edhe pse në Kur'anin Famëlartë shprehjet përgjithësisht janë në gjininë mashkullore për shkak, siç u theksua, të specifikës gjuhësore, gratë kërkonin të zbresin edhe ajete të atilla në të cilat do të përmenden edhe ato. Një ditë, zonja Ummi Umare nga muslimanët ensarë erdhi te i Dërguari a.s. dhe i tha:

“O Pejgamber i Zotit, shikoj se çdo gjë është për meshkujt, pse vallë nuk përmenden gratë?”

Më pas zbriti ky ajet:

“Nuk ka dyshim as për muslimanët dhe muslimanet, besimtarët dhe besimtare, adhuruesit dhe adhurueset, të sinqertit dhe të sinqertat, durimtarët dhe durimtare, të përvuajturit dhe të përvuajturat, sadakadhënësit dhe sadakadhënëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, shumëpërmendësit e All-llahut e shumëpërmendëset e All-llahut, All-llahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblimi të madh.”¹⁴³

Edhe një muslimane që dëshiron barazi totale me burrin nga aspekti i vlerës para Zotit, shpërblimin shpirtëror dhe sevapin... Nëna e jonë, gruaja e Pejgamberit a.s. Ummi Seleme shprehet: **“Ç’do të bëhej sikur të ishim meshkuj, do të luftonim si ata, do të fitonim shpërblime si ata!”** më pas zbrit ky ajet:

“Mos lakmoni në atë, që All-llahu gradoi disa nga ju mbi disa të tjerë. Burrave ju takon hise nga ajo që fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato. All-llahu kërkonte të mirat e Tij. All-llahu është i dijshtëm për çdo send.”¹⁴⁴

Mashkulli nuk mund të bëhet si femra

Nëna e Merjemes, Hanne, kur ishte me barrë (me Merjemen) duke e paramenduar si djalë, ia përkushtoj fëmijën Shtëpisë së Shenjtë (Bejt-ul Mukaddes). Por, kur i lindi vajzë, e brengosur shprehu brengën duke thënë: **“Zoti im, unë e linda femër!?”**. All-llahu që shumë mirë e dinte ç’kishte lindur Hanne, urdhëroi: **“Mashkulli nuk është si femra”**.¹⁴⁵ Pra, djali që e deshe ti nuk mund të jetë si vajza që ta dhash Unë, djali nuk mund të jetë i suksesshëm në shërbim të Shtëpisë së Shenjtë.

Dominimi i burrit

Pas këtyre sqarimeve mund të thuhet se në institucionin familje:

“Edhe atyre (grave) u takon e drejta, sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi, e burrave u takon një përparësi ndaj tyre. All-llahu është i Plotëfuqishëm, i Urtë.”¹⁴⁶

Ajeti i cili e shpall këtë prioritet është si vijon:

“Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase All-llahu ka graduar disa mbi disa të tjera dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre.”¹⁴⁷

Këtë ajet shpeshherë e kanë marrë në gojë shumë kritikë jomuslimanë duke pohuar se gruaja i nënshtrohet urdhërit të burrit dhe është dhënë nën shërbimin e tij.

Që të mund të kuptojmë më mirë këtë, duhet të ndalemi në fjalën *“kavvamun: përgjegjës”* që ka dy kuptime:

1. Interesim për fatin dhe nevojat (e saj) dhe,
2. Mbikqyrje ndaj saj. Kuptimi i parë nuk flet asgjë kundër gruas, përkundrazi, flet në dobi të saj. Kur gjendemi tek kuptimi i dytë, tek e drejta e burrit për mbikqyrjen, mbrojtjen e gruas, kjo ka norma të caktuara në Islam.

Gruaja nëse është jo muslimane por hebreje ose e krishterë, atëherë burri nuk mund të intervenojë në besimin e saj.¹⁴⁸ Burri nuk mund të përzihet as në pasurinë e saj personale. Gjatë vënies së kurorës, gruaja merr mehrin prej burrit. Kjo është pasuri personale e saj. Bashkëshorti nuk gëzon asnjë të drejtë në të. Gruaja nuk është e obliguar që nga mehri të përgatisë pajë. Faktikisht, gruaja as gjatë martesës as më pas nuk ka obligime financiare.¹⁴⁹

Gruaja nëse disponon me ndonjë pasuri tjetër përveç mehrit, madje edhe po pati nevojë burri, ajo gëzon të drejtën absolute ndaj asaj pasurie. Ka autorizim që nëpërmjet tregëtisë ta shtojë pasurinë, ta huazojë ose t’ua dhurojë personave të tretë... Për këtë gjë s’ka nevojë të kërkojë leje nga burri. Edhe pse bashkëshorti nuk ka autorizim të japë sadaka nga prona e bashkëshortes, gruaja ka të drejtë të japë sadaka prej pasurisë së vet pa marrë leje nga bashkëshorti.¹⁵⁰ Në vendin ku përmendet bashkëshorti dhe bashkëshortja, për gratë përdoret shprehja *“maruf: legale, diç që është*

e njohur, diç që u përgjigjet zakoneve (adeteve)”. Nëse burri nuk i kënaq nevojat e fëmijëve dhe të bashkëshortes për shkak të koprracisë, gruaja ka të drejtë pa dijen e burrit të shpenzojë për vete dhe për fëmijët, nëse kjo bëhet në mënyrë hallall dhe nëse është e lejuar me zakone.¹⁵¹

Gruaja, nga aspekti juridik, nuk është e obliguar të punojë në shtëpinë bashkëshortit dhe të kryejë punë amvisërie.¹⁵² Mirëpo, duke patur parasysh dashurinë, ndihmën dhe mirëkuptimin e ndërsjellë nuk do të duhej të mbetet indiferente ndaj këtyre punëve.

Bashkëshortet e as’habëve, përveç që i kryenin punët shtëpiake, u ndihmonin edhe bashkëshortëve në punët e tyre. E dimë se duart e nënës sonë Fatimes, janë shtypur në mullirin e dorës. Motra e gruas Muhammedit a.s., e bija e Ebu Bekrit-nëna e jonë Esmâ, ka punuar punët e bashkëshortit të saj Zubejrit, ka kryer edhe punët rreth ushqimit, përgatitjes së kalit, ka bartur fara dhe bërthama të hurmës në kokë në një largësi prej një kilometri. Ndihma e këtillë e ndërsjellë, midis dy bashkëshortëve, që gjendet në shkallën më të lartë të dashurisë dhe lidhshmërisë, nuk është barrë, por kënaqësi. Kur Esved b. Jezid e pyeti Aishen se me çka merret i Dërguari a.s. kur gjendet në shtëpi, mori këtë përgjigje:

“U ndihmon njerëzve të shtëpisë në punët e tyre, e kur e dëgjon ezanin shkon në namaz.”¹⁵³

Pas një sqarimi të këtillë, mund të themi se burri nuk mund të intervenojë në lirinë dhe autoritetin e gruas nga aspekti fetar, financiar dhe juridik. Atëherë, ku mbeti dominimi i burrit? Ta caktojmë regjionin e këtij dominimi.

Në ajet jipen dy aspekte të dominimit të burrit:¹⁵⁴

1. Nga aspekti i krijimit-burri është më i fuqishëm dhe më i qëndrueshëm se gruaja.¹⁵⁵ Ka qëndresë dhe durim më të madh. Për këtë arsye, rreth termave *nubuvvet* (pejgamberi), prezidencë (kryetar shteti), dëshmitar, luftëtar, dhe pranimit të pjesës më të madhe të trashëgimisë mashkulli ka përparësi.

2. Burri, duke dhënë mehr gjatë kurorëzimit dhe duke siguruar ekzistencën në institucionin - familje, ka përgjegjësinë financiare. Pra, ky dominim i burrit rrjedh nga përgjegjësia e tij. Kjo mbështetet nga parimi që është i pranuar nga të gjithë “Pushteti dhe autoriteti janë proporcionale me përgjegjësinë”.

Burri është personi përgjegjës dhe koka e familjes. Fëmijët janë të lidhur për të. Detyra e tij është të gjejë dhe të ruaj akomodimin. Ai e ka autorizimin për banim. Ai është pronar i shtëpisë. Për këtë arsye, kur burri nuk është në shtëpi, gruaja nuk guxon të lejojë dikush i huaj të hyjë në shtëpi. Thamë se burri është koka e familjes. Gruaja dëgjon urdhërin e burrit. Ajo nuk guxon të mos e dëgjojë burrin, i cili mban përgjegjësinë dhe është i obliguar që me mundin e vet të luftojë gjatë tërë jetës. Të mëdha janë punët e burrit. Pejgamberi a.s. thotë:

“Poqese ndonjërit i kisha urdhëruar t’i falet dikujt, pos All-llahut, atëherë grave do t’u kisha urdhëruar të falen para burrave të tyre”.

Arsyeja për këtë është të drejtat që All-llahu u ka dhënë burrave mbi gratë.¹⁵⁶ Një hadith tjetër thotë:

“Më është treguar Xhehennemi. Ç’të shihet, shumicën e pjesëtarëve të Xhehennemit e përbëjnë gratë. Ato janë në rrugët e pafesë (fyejnë, mallkojnë). - kur u pyet nga ana e një as’habi: -O i Dërguar i All-llahut, a janë ato në rrugë të pafesë kundër All-llahut? ai tha: Ato

nuk iu falënderohen bashkëshortëve dhe mirësisë. Nëse njërës prej tyre me shekuj i bën të mirë, e tek ti heton diçka (që nuk i pëlqen), do të shprehet se kurrfarë të mire s'ka pasur prej teje.”¹⁵⁷

Shtëpia është si një pushtet i vogël. Natyrisht, se do të ketë dikush që do të jetë kryesori. Ky, sipas qenies, obligimeve dhe përgjegjësisë është burri. Ky është prioritet dhe dominimi i burrit ndaj gruas që e pranon Islami.

Edhe sipas botëkuptimeve të sotme juridike, në institucionin e familjes ekzistojnë të drejta prioritare që i posedon burri, për dallim nga gruaja. Burri është koka e familjes. Ai e zgjedh vendbanimin. Gruaja e mban emrin familjar të burrit (mbiemrin e burrit). Gruaja është këshilltare dhe ndihmëse e burrit. Burri e përfaqëson bashkësinë familjare.¹⁵⁸ Pa lejen e burrit gruaja nuk mund të mirret me ndonjë punë ose me ndonjë zeje.¹⁵⁹ Në të drejtën islamike, gruaja, prej momentit të martesës e deri në fund të iddetit, pas ndarjes, kujdeset nga burri. Të gjitha shpenzimet e gruas dhe fëmijëve i mbulon burri. Gruaja nuk përzihet në këtë gjë.¹⁶⁰ Mirëpo, në të drejtën bashkëkohore, edhe gruaja merr pjesë në mbulimin e shpenzimeve lidhur me furnizimin dhe edukimin e fëmijëve.¹⁶¹

e E

II.

Të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të bashkëshortes dhe bashkëshortit

“...ashtu siç ju keni të drejta ndaj grave, edhe ato kanë të drejta ndaj jush.”

Muhammedi a.s.

Në Kur'anin Famëlartë bashkësia bashkëshortore quhet *“hududullah: kufinjë që i ka caktuar All-llahu”*. Martesa s'është vetëm një ngjarje që ndodh midis dy personave. Ajo e përbën themelin e familjes. E familja është shtylla kryesore e shoqërisë. Martesa përveç anës së rëndësishme humane e juridike, ka edhe anën hyjnore fetare. Kushtet e nevojshme për zgjatjen e lumturisë dhe paqës janë *“kufinjt që i ka caktuar All-llahu”*. Vazhdimësia e martesës është e mundur me ruajtjen e këtyre kufijve. Shkelja e tyre, në realitet, është shkatërrimi i martesës.

“Kush i tejkalon kufijtë (e përcaktuar nga ana) e All-llahut, pikërisht të tillët janë zullumqarë.”¹⁶²

I Dërguari i All-llahut përgjegjësitë e bashkëshortes dhe të bashkëshortit në bashkësinë bashkëshortore i thekson kështu:

“Keni kujdes, sepse çdokush nga ju është një bari dhe përgjigjet për ata që janë nën pushtetin e tij. Gjithashtu edhe burri është bari i anëtarëve të familjes dhe përgjigjet për ta. Gruaja, në shtëpinë e bashkëshortit si dhe për fëmijët, është një bari. Është përgjegjëse për ta. Shërbëtori është rojtar i mallit të pronarit të shtëpisë dhe është përgjegjës për të. Në fund, secili nga ju është bari dhe secili është përgjegjës për atë që ruan.”¹⁶³

Të drejtat e gruas ndaj burrit

Një sqarim i obligueshëm:

“T’i njohish njerëzit me masën e së vërtetës, e jo të vërtetën me njerëzit”. Kjo e thënë ka rëndësi të madhe për temën në shqyrtim. Feja Islame është një besim i atillë që e ka zbritur Zoti duke krijuar një tërësi me themelet e imanit, me përcaktime, me faljen me etikën dhe sistemin juridik. Urdhërat dhe udhërrëfimet e Zotit për Islamin janë të shtruara në Kur’an. Muhammedi a.s. është ai që me frymëzim e pranoi Kur’anin nga All-llahu dhe ua shpalli njerëzve. Muhammedi që ishte *“Ummijj: analfabet”* nëpërmjet frymëzimit mbizotëroi çdolloj njohurie, ndaj fjalët e tij janë burim për kuptimin e fesë.

“Ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet.”¹⁶⁴

Veprat që i ka bërë i Dërguari i All-llahut, respektivisht aksionet dhe sjelljet e tij janë vetë e vërteta. Ai të vërtetën e shpalli me fjalë, ndërsa e zbatoi me vepra. Në Kur’anin Famëlartë urdhërohet:

“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut”¹⁶⁵

Nga kjo del se Islamin duhet ta kuptojmë nga Kur’ani dhe nga sunneti i të Dërguarit a.s. që është interpretim, sqarim dhe plotësim i gjykimeve islame. Kur gjykojmë për Islamin para së gjithash, duhet t’i lexojmë burimet e tij. Sipas kësaj dispozite vlerësohet edhe mënyra e sjelljes së muslimanit.

Gjatë historisë së Islamit, gruaja muslimane, në vende të ndryshme është trajtuar në mënyra të ndryshme. Kjo mund të thuhet edhe për të gjitha gratë e botës. S’është mirë të thuhet se muslimania gjatë historisë islame ka jetuar një jetë të prapambetur në krahasim me femrat tjera. Në kohën e Osmanlinjëve kanë jetuar ndryshe, varësisht me atë se ku kanë jetuar, në fshat o qytet, e në vende të ndryshme të mbretërisë së gjerë, e prej kohe në kohë janë ballafaquar me interpretime të ndryshme. Por, kjo nuk është tema jonë. Po përsërisim se nuk duhet dhënë gjykime në lidhje me kuptimin e pozitës së gruas islame, duke shikuar në trajtimin e saj në disa kohëra dhe vende të botës islame.

Të drejtat e bashkëshortes

Kur e kanë pyetur se çfarë të drejta ka gruaja ndaj burrit, i Dërguari a.s. është përgjegjur kështu:

“Kur të hash vetë, do ta ushqesh edhe atë, kur të vishesh vetë, do ta veshish edhe atë. Mos ia përkujto qëllimisht të mirat që ia ke bërë. Mos e quaj atë dhe punët e saja të shëmtuara, kur t’i hidhërohesh, të mos e lësh në vetmi, por brenda në shtëpi (një kohë të caktuar mund t’i rrish larg).”¹⁶⁶

Në një hadith tjetër thuhet kështu:

“U jepni atyre nga ajo që hani, veshni ato sikur që visheni vetë, mos i rrahni, mos i quani të shëmtuara, mos përdorni fjalë të këqia.”¹⁶⁷

1) Nevojat materiale dhe shpenzimet kryesore të gruas janë në përgjegjësi të burrit. Kjo ndryshon varësisht nga gjendja materiale e burrit. Ç'është me rëndësi, kjo duhet të realizohet sipas nivelit të burrit. Siç u theksua më sipër, nga aspekti juridik gruaja nuk është e obliguar të punojë as në shtëpi. Por, s'ka kurrëfarë dyshimi se puna në shtëpi është e vlefshme nga aspekti i dashurisë, intimitetit dhe ndieshmërisë (senzibilitetit), nëse mund të kryhet. Por, sipas mendimit të Imam Malikut dhe disa të tjerëve nga as'habët dhe tabiînët, nëse burri është i varfër gruaja duhet të punojë.¹⁶⁸ Nëse burri është koprrac dhe nuk e shpenzon atë që është faktike dhe e zakonshme, gruaja ka të drejtë që për vete dhe për fëmijën e saj, të shpenzojë atë pa e lajmëruar (informuar) burrin. Pejgamberi a.s. e ka lejuar këtë gjë.¹⁶⁹

2) Të mos degradohet (nënçmohet) gruaja. Kjo don të thotë se as ajo dhe as punët e saja të mos quhet të shëmtuara. Të mos shprehet (nga ana e burrit) mospëlqimi. Siç dihet, ofendimi më i madh ndaj gruas është kur atë do ta quash e shëmtuar. Gruaja është e dhënë vazhdimisht me shpirt që burrit t'ia tregojë bukurinë dhe prezencën e saj. Është sjellje gjentile që asaj t'i thuhet se është e bukur.

Veç kësaj që u tha më sipër, në hadithe ekzistojnë këshilla që burri të mos i hidhërohet gruas, të mos braktiset ajo. Mirësjellja me gruan është shpallur edhe në Kur'an:

***“Çoni jetë të mirë me to. Nëse i urreni ato, bëni durim, se ndodh që All-llahu të falë shumë të mira në një send që ju e urreni.”*¹⁷⁰**

Për këtë çështje flasin shumë hadithe të Pejgamberit a.s.:

***“Në lidhje me gratë, njëri tjetrin ta këshilloni me mirësi...”*¹⁷¹**

***“Një besimtar një besimtares të mos i hidhërohet kur është i nevikosur. Nëse nuk i pëlqen ndonjë veti e saj, ndoshta do të jetë i kënaqur me vetitë tjera.”*¹⁷²**

Me të vërtetë nuk është e thënë të na pëlqejë çdo veti dhe çdo punë e ndonjë njeriu. Por, një njeri i sinqertë, me siguri do të gjejë shumë veti që do t'i pëlqejnë tek të tjerët, e sidomos tek gruaja. Me ato ai duhet të kënaqet dhe të jetë i lumtur. Një hadith tjetër i të Dërguarit a.s. thotë:

***“Besimtarë, më të pjekur në iman janë ata që kanë moral më të lartë. Nga ju, më i vlefshmi është ai, që ndaj grave sillet më mirë dhe është më gjentil.”*¹⁷³**

Të përsërisim se është e ndaluar të hidhërohesh me gruan, të mos i flasish asaj dhe ajo të bojkotohet. (lidhur me këtë ekziston një përjashtim i cili do të ceket në vijim të librit). Gruaja dëshiron që burri të interesohet për të... Ndjen nevojë shpirtërore që vazhdimisht të pranohet prezenca dhe vlera e saj nga ana e burrit. Nëse nuk mund të gjejë një interesim të këtillë nga ana e bashkëshortit, ajo do të jetë e brengosur. Është vërtetuar me anketa se njëri ndër shkaqet më të rëndësishme për kërkesën e kënaqësisë shpirtërore e seksuale, është pikërisht një gjendje, siç u theksua më lartë.¹⁷⁴

3) Argëtimi në shtëpi me bashkëshorten ose vëzhgimi i përbashkët i ndonjë ngjarjeje argëtuese, është njëra nga të drejtat e gruas ndaj burrit. Nëna jonë, Aisheja bënte gara në vrapim me të Dërguarin a.s.; ndonjëherë ajo e tejkalonte të Dërguarin e Zotit, ndonjëherë e tejkalonte ai. Në Mesxhidin e Medines (një xhami e vogël) ushtarë nga Abisinia ushtronin lojra ushtarake me shtizat e tyre. Pejgamberi a.s. dhe Aisheja i

vëzhgonin nga porta e tyre. I Dërguari a.s. e mbuloi me shaminë e tij Aishen dhe kështu, deri sa nuk u mërzi ajo, vazhduan t'i përcjellin ushtarët.¹⁷⁵ Rrëfihen fjalët e Ibën 'Abbasit:

“Si unë që dëshiroj që bashkëshortja ime të rregullohet për mua, ashtu më pëlqen edhe rregullimi im për të. Meqë All-llahu ka urdhëruar:

“Si kanë të drejtë burrat ndaj grave, ashtu edhe ato kanë të drejtë ndaj burrave.”¹⁷⁶

I Dërguari a.s. në një hadith thotë:

“Të gjitha lojrat që i bëjnë njerëzit janë të kota. Përjashtim bën hedhja e shigjetës me hark, ushtrimi me kalë dhe të luajturit me gruan. Janë këto reale dhe të drejta.”¹⁷⁷

4) Të mos rrihet gruaja, duke i pasur parasysht gratë, Pejgamberi a.s. thotë:

“Mos i rrihni robëreshat e Zotit.”

Erdhi 'Umeri r.a. dhe u ankua se gratë kanë filluar të rebelojnë kundër burrave të tyre. Pas kësaj, i Dërguari i All-llahut lejoi që gratë të rrihen. Kësaj radhe u shtua numri i grave që erdhën tek gratë e Pejgamberit a.s. të cilat u ankuan nga burrat e tyre. Në fund Pejgamberi a.s. tha:

“Shumë gra po vijnë tek familja ime e po ankohen nga burrat. Ata që i rrahin gratë e veta, s'ka dyshim se nuk janë të hajrit.”¹⁷⁸

Në Islam, kreu i familjes është burri. A mundet që kreu i familjes ta rrahë gruan për t'a kthyer disiplinën, me kusht që ajo rrahje të mos jetë shumë e dhembshme? Nëse gruaja është rebele ose, nëse ka rebeluar kundër burrit dhe, nëse ka filluar që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ta shkatërrojë bashkësinë familjare, burri mund ta rrahë atë. Për një rrahje të këtillë, ka edhe arsye tjera. Lidhur me këtë do të bëhet fjalë më vonë. Jashtë këtyre arsyeve, burri nuk ka të drejtë ta rrahë të shoqen. Pejgamberi a.s. thotë:

“Asnjë nga ju s'duhet ta rrahë gruan si rrihet robëresha. Ndoshta në fund të jetës do të kthehet dhe do të bëjë marrëdhënie me të.”¹⁷⁹

5) Nuk duhet bërë gruan lëndë shpirtëkeqësie duke e kontrolluar atë befasisht. S'duhet bërë kontrollime sekrete.¹⁸⁰

Vetëm nëse disponon me argumente të forta dyshimi, mund ta bëjë atë. Në një hadith thuhet: Nëse dikush është larg familjes, mos të kthehet pa u lajmëruar më parë.¹⁸¹

Burri nuk duhet aty për aty t'u besojë thashethënave lidhur me gruan e tij dhe s'duhet të japë gjykime të ngutshme. Njëri ndër mëkatet më të mëdha është, të ndërmjetësuarit në keqësimin e marrëdhënieve mes gruas dhe burrit. Pejgamberi a.s. thotë:

“Ai që spiunon gruan tek burri i saj dhe atë e prezenton si femër të keqe, nuk është me ne.”¹⁸²

Njëra ndër arsyet përse nuk është e preferuar që burri befas të hyjë në shtëpi ose në ndonjë rast tjetër, është pamundësia e përgatitjes së gruas të dalë para burrit të vet, e jo diç tjetër e papëlqyer.

6) Nuk është e lejuar që bashkëshortët t'i zbulojnë sekretet lidhur me marrëdhëniet seksuale dhe me çështjet tjera. Një sjellje e këtillë, mund ta prishë ndjenjën e turpit të gruas dhe t'ia dobësojë emocionet, ndaj është jomorale. Këtë gjë i Dërguari i All-llahut e shpjegon kështu:

“Ditën e Gjykimit, para All-llahut, në vendin më të keq do të gjenden edhe ata që zbulojnë sekretin e gruas së vet pas mardhënieve me të.”¹⁸³

Normalisht, edhe gruas duhet të respektojë këtë parim në të njëjtën mënyrë.

E drejta e burrit ndaj gruas

1) Siç është theksuar më parë, burri është njeri i cili: është i obliguar t'i sigurojë gruas dhe fëmijëve ushqim, veshmbathje dhe strehim si dhe nevojat tjera. Mban edhe obligimet e përgjithshme të tërë familjes. Për shkak të këtyre obligimeve dhe aftësive të tij, ai është kreu i familjes është pronar i shtëpisë. Gruaja është e detyruar ta dëgjojë në punët legale. Po nuk u pajtuan rreth diskutimit lidhur me kurorën, do të dëgjohet zëri i burrit. Ta përkujtojmë ajetin në të cilin thuhet:

“Burrat janë përgjegjës për gratë.”¹⁸⁴

Gruaja për burrin është shok jete. Është faktore qetësie e paqe, lëndë e dashurisë dhe mëshirës si dhe këshilltare e denjë. Bashkëshortët e plotësojnë njëri tjetrin. Por, kjo nuk don të thotë se burri ia plotëson çdo dëshirë gruas së vet; se ç'ti bie në mend asaj, do ta ketë. Shoqëria islame bazohet në përgjegjësinë e burrit, që rrjedh nga ajo se burri është i dëgjues, ndërsa gruas ajo që duhet të dëgjojë.

2) Gruaja është rojtare e shtëpisë së burrit. Ajo, siç është e obliguar t'i ruajë fëmijët dhe pasurinë, është e detyruar ta ruaj edhe nderin nga mëkatet. Pejgamberi a.s. në një hadith të drejtat e burrave ndaj grave kështu i thekson:

“Të tjerët mos të shkelin krevatin tuaj. Të mos hyjnë në shtëpinë tuaj ata njerëz që nuk ju pëlqejnë. Gratë të mos i lejojnë këto sjellje.”¹⁸⁵

Në Kur'an theksohet:

“...gratë e mira janë respektuese, janë besnike ndaj fshehtësisë...”¹⁸⁶

Në këtë ajet fjala *“gajb: fshehtësi, sekret”* përmban begatinë e burrit, sekretet e familjes, nderin, madje edhe foshnjen në stomakun e gruas. Gruaja duhet t'i ruajë këto dhe të ketë kujdes të mos dështojë fëmija. Duke i respektuar këto, gruas faktikisht i plotëson në masë të madhe obligimet fetare. Në një hadith thuhet kështu:

“Nëse gruaja falet pesë herë në ditë dhe nëse agjëron një muaj, poashtu nëse e ruan nderin dhe e dëgjon burrin e vet, nga cila portë të dojë le të hyjë në Xhennet.”¹⁸⁷

3) Gruaja nuk duhet ta shkatërrojë sistemin e themeluar familjar. Përveç situatave kur nuk është e mundur të mbahet kurora, gruaja nuk duhet të kërkojë shkurorëzim nga burri i saj. Në këto raste ndodh që shkaqet e shkurorëzimit të rrjedhin nga marrëdhëniet e reja me burrat tjerë ose nga ndonjë vendim i pamenduar mirë. Shkaku i parë është imoraliteti dhe tradhëtia ndaj burrit. Më pastaj do të lind pendimi. I Dërguari a.s. thotë:

“Cila grua kërkon shkurorëzim nga burri pa pasur arsye, era e Xhennetit për të do të jetë haram.”¹⁸⁸

4) Në bashkëshortësi s’duhet të harrohen gjërat e nevojshme për vazhdimësinë e dashurisë dhe simpatisë. Martesa, para së gjithash mbështetet në rehatinë e dyanshme (relaksimi, arritja e kënaqësisë). Ashtu si nuk guxon gruaja t’u largohet obligimeve të bashkëshortësisë, edhe burri nuk guxon t’u shmanget obligimeve të veta. Simptomët e sëmundjes, si prepotenca ose impotenca, janë më të shprehura tek gratë se sa tek burrat. Në epshet seksuale ndikon edhe bota emocionale e njeriut, planet dhe imagjinata. Në këtë ndikojnë edhe gjërat që i dëgjojmë nga të tjerët dhe jeta private e njerëzve lidhur me seksin. Ndaj është i ndaluar rrëfimi dhe transmetimi i marrëdhënieve sekrete të bashkëshortëve.

Bashkëshortët duhet të njihen mirë lidhur me potencën, që të sillen në mënyrë harmonike. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Nëse një grua nuk përgjigjet kur burri i saj e thërret në krevat, engjëjt do ta mallkojnë deri në mëngjes ose deri atëherë kur bjen në krevat.”¹⁸⁹

Një ditë, para Muhammedit a.s. erdhi një grua dhe u ankua nga burri i saj, Safhani:

-Kur lidhem në namaz, ai më rreh, kur agjëroj, ai ma prish agjërimin... - aty pranë gjendej edhe Safhani. Kur e pyeti i Dërguari a.s. ai u përgjigj:

-O ndërmjetës i Zotit, e vërteta është ndryshe. Ajo në namazin e vet lexon dy sure e unë ia ndaloj këtë. -pastaj i Dërguari a.s. tha:

-Të ishte vetëm një sure, do të mjaftonte për njerëzit. - Safhani vazhdoi:

-Unë ia prish agjërimin ngase ajo don të agjërojë vazhdimisht. E unë jam burrë i ri, nuk mund të qëndroj. - e i Dërguari a.s. tha:

-Gruaja të mos agjërojë (vullnetarisht) pa lejen e burrit.¹⁹⁰

Nuk duhet penguar gruan në obligimet bashkëshortore. Në plotësimin e detyrave fetare që janë farze gjithashtu gruaja duhet të ketë kujdes që ibadeti i paobligueshëm të mos bëhet pengesë në funksionin e saj grua, bashkëshorte.

I njëjti parim vlen edhe për burrin. Edhe ky duhet t’i plotësojë obligimet e veta. Ibën Hazëm thotë se detyrat e këtilla të ndërsjella bashkëshortore, për ta janë farz (të detyrueshme).¹⁹¹ Nuk është besim nëse apstenon në këtë temë. Përkundrazi është zullum dhe padrejtësi kundër vetive të egos që ekzistojnë prej lindjes, është torturë kundër gruas. Kjo do të mund të jetë shkas për prostitucion dhe marrëdhënie jolegale. Një ditë, tre as’habë u takuan dhe u morën vesh kështu: I pari tha:

-Unë do të agjëroj përherë. -i dyti ia priti:

-Deri sa të jam gjallë, natën do të fal namaz. -ndërsa i treti tha:

-Unë do të qëndroj larg grave. Kurrë nuk do të martohem. -kur Pejgamberi a.s. kuptoi për këto vendime, shkoi tek ata dhe u tha:

-Jini ju ata që kështu flitni? Keni kujdes! Betohem në emër të All-llahut se në mesin tuaj, unë jam ai që më së shumti i frikësohem Atij dhe më së shumti kam kujdes të mos i kundërvihem. Ndaj, unë ndonjëherë agjëroj e ndonjëherë nuk agjëroj. Edhe falem edhe bëj gjumë dhe martohem me gra. Kush ia kthen kurrizin sunnetit tim, ai nuk i takon anës sime.¹⁹²

Abdullah Ibën Amr Ibën As, ishte i njohur me lutjen e tij në izolim dhe respektin e tij ndaj All-llahut. Kur e pyeti i Dërguari a.s.:

-Dëgjova se ditën agjëron e natën falesh, është ashtu? -ai u përgjegj:

-Po, o i Dërguar i All-llahut. - Pejgamberi a.s. i tha:

-Mos bën ashtu! Ndonjëherë agjëro e ndonjëherë mos agjëro. Natën edhe të falesh edhe të flesh, sepse trupi yt kërkon të drejtën e vet, syri yt kërkon të drejtën e vet, gruaja e jote kërkon të drejtën e vet.¹⁹³

S'ka dyshim se këto falje dhe agjërimet që u theksuan në këto hadithe, janë jashtë farzit. Është normale se farzet duhet plotësuar.

Disa çështje lidhur me jetën seksuale

Gjendjet specifike të gruas

Ekzistojnë disa tema rreth gjendjes të lehonisë dhe menstruacionit të gruas. Menstruacioni është proces organik që paraqitet një herë në muaj tek gratë që nuk janë me barrë. Nuk mund të jetë më pak se tri ditë dhe më shumë se dhjetë ditë. Lehonja, është gjakderdhja pas lindjes dhe mund të zgjasë më së shumti dyzet ditë.

Gratë që kanë menstruacionin ose gjatë lehonisë, deri sa vazhdojnë këto procese, nuk mund të falin namazin, nuk mund të agjërojnë, s'mund ta lexojnë madje as ta prekin Kur'anin, nuk mund të kenë as marrëdhënie seksuale.¹⁹⁴

Hebrenjtë reth Medines, në kohën e Pejgamberit a.s. nuk shoqëroheshin, nuk hanin dhe nuk hynin në të njëjtin krevat me gratë që kishin menstruacionin. Ndërsa Muhammedi a.s. lidhur me këtë gjë thotë:

“Bëni çdo gjë por mos hyni në marrëdhënie seksuale me to.”¹⁹⁵

Me gratë që kanë menstruacionin ose janë lehona mund të shoqërohesh, të flesh e të hash edhe ushqimet që ato i përgatisin. Por, është e ndaluar të bësh marrëdhënie seksuale. Në Kur'an theksohet:

“Të pyesin ty për menstruacionin (hajdin). Thuaj: Ajo është gjendje e neveritur, andaj largohuni prej grave gjatë menstruacionit dhe mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) deri sa të pastrohen. E kur të pastrohen, atëherë afrohuni atyre ashtu siç u ka lejuar All-llahu...”¹⁹⁶

Siç shihet nga ajeti kjo është gjendje neverie, papastërtie. Shpjegimin shkencor lidhur me këtë e jep eksperti:

“Gjatë menstruacionit nuk duhet kontaktuar me burrin. Gruaja që vazhdimisht humb gjak dhe ka një brengë të madhe, duhet pranuar dhe kuptuar si grua e sëmurë dhe duhet të jetë larg çfarëdo shqetësimi, sidomos atij seksual. Në gjendje të menstruacionit, organet gjenitale të gruas janë plotë gjak. Hyrja në damarët e mitrës është e hapur sikur të jetë e dëmtuar. Bile edhe tek pedantet e më të pastrat, në këto kanale ka mikrobe të panumërta që presin me mjeshtri. Gjatë menstruacionit këto shumëzohen në mënyrë të përshpejtuar, forcohen dhe presin momentin e nëse u jipet një shkas i vogël shpejtojnë kah organet e dëmtuara gjenitale dhe vezët. Po ndodhi të ketë marrëdhënie seksuale, mikrobet do të shtrihen edhe më shumë e kështu edhe më tepër do ta dobësojnë femrën. Nëse vazhdohet me këtë, do të shkaktohet gjakderdhje e vrullshme, do të paraqiten dhëmbje në boshtin kurrizor dhe në nyje dhe do të shkaktohet sëmundje shumë serioze. Në këtë periudhë gruaja ka një erë të rëndë e specifike. Kjo erë do të shtrihet në tërë trupin dhe djersën, madje edhe të femrës së pastër. Edhe vetë gruaja do të gërditet nga kjo erë. Është normale se edhe burri do të gërditet nga kjo erë e rëndë gjatë marrëdhënieve seksuale në këtë periudhë. Gruaja, duke qenë e vetëdijshme, duhet të ketë shumë kujdes për higjienën dhe, në këtë periudhë, të qëndrojë sa më larg bashkëshortit.

*Edhe lehona duhet të ketë kujdes gjatë atyre dyzet ditëve, sa zgjat lehonia, të jetë larg bashkëshortit. Meqë në momentin e lindjes, organet gjenitale, veçanërisht brendia dëmtohet shumë, shpesh ndodhin edhe shkëputje. Marrëdhëniet seksuale, në këtë periudhë, e dëmtojnë shumë femrën. Aktivimi i vrullshëm i mikrobeve kontribuon në shkaktimin e shumë sëmundjeve të grave. Ndaj, assesi s’duhet afruarr gruas para se të shërohet dhe para se organet gjenitale të marrin përsëri formën e natyrshme. Tolstoi e turpëron mashkullin që e shqetëson gruan: “Një burrë, kur bën dashuri me një grua, si me të dashurën e tij, nuk duhet harruar se ajo është një nënë. Një grua nuk mund të qëndrojë që, në të njëjtin moment të jetë edhe dashnore, edhe një nënë e lodhur, një njeri i sëmurë.” “Burri nëse është në gjendje të flaktë, mund t’i kënaq epshet e veta pa qenë në afërsi finale, vetëm me përkëledhje, dhe do t’i mjaftojë një bashkëshorti të ndershëm, një kënaqësi e këtillë.”*¹⁹⁷

Në periudhën e menstruacionit dhe të lehonisë, sipas fesë, është i ndaluar vetëm kontakti i drejtpërdrejtë seksual. Sjelljet tjera nuk janë haram, me kusht që njeriu të jetë i sigurt në vete dhe gjërat të mos i çojë deri në haram.

S’është e rrezikshme, sipas fesë, të kontaktohet me gruan shtatëzane. Por mjekët vërtetojnë se gjatë tre muajve të parë dhe të fundit kontaktimi është i rrezikshëm. Gjatë tre muajve të parë është e mundur të dështojë fëmija, ndërsa në tre muajt e fundit, ekziston rreziku i lindjes së parakohshme dhe gjakderdhja. Duhet patur kujdes i posaçëm për gjendejn shëndetësore të gruas.

Marëdhëniet seksuale

Në Kur’an theksohet:

“Gratë tuaja janë vendmbjellje e juaj...”¹⁹⁸

Një qëllim i martesës është edhe ai që të formohet gjenerata e re. E kjo është e mundur vetëm me marrëdhënie sipas rregullave. Në ajetin që e theksuam më parë urdhërohet të bëhet kontakt me gratë e pastruara.

“...E kur të pastrohen atëherë afrohuni atyre ashtu siç u ka lejuar All-llahu ...”

E kjo është një rrugë e natyrshme. Sipas kësaj, një burrë bashkëshortes së tij nuk guxon t'i afrohet afër vendit të ndytë në vend të rrugës së natyrshme gjenitale. Kjo është një sjellje e keqe. Është jo morale.¹⁹⁹ Pejgamberi a.s. thotë:

“Është i mallkuar ai njeri që bashkëshortes i afrohet nga prapa (zgavra anale - anusi).”

Një hadith tjetër thotë kështu:

“All-llahu nuk shikon me mëshirë atë njeri që, gruas i afrohet nga prapa (zgavra anale), ose bën marrëdhënie mashkull-mashkull.”²⁰⁰

Të penguarit e formimit të fëmijës

Në marrëdhënie seksuale, që të mos arrijë sperma deri tek ama, kryhet jasht vaginës. Të kryerit jasht vaginës quhet “azl”. Ka shumë dilema lidhur me atë, është azli i ndaluar ose jo. Pejgamberi a.s. kur e pyetën për këtë, zgjodhi shprehje të buta. Në një hadith të tij thuhet:

“Në kryerjen e azlit nuk ka dëm për ju. Meqë deri në Ditën e Gjykimit sigurisht do të formohen qenie të gjalla që All-llahu ka urdhëruar të krijohen.”

Xhabir b. Abdullahu thotë:

“Erdhi një njeri tek i Dërguari a.s. dhe e pyeti:

-E kam një robëreshë dhe kur jam në marrëdhënie me të, bëj azl. Ç’do të thuash për këtë? - Pejgamberi a.s. u përgjegj:

-S’mund ta pengoj atë që All-llahu e ka dëshiruar. -pas pak kohësh i njëjti njeri e pyeti përsëri:

-O, i dërguar i All-llahut, robëreshën që e përmenda, tani është shtatzane. - Pejgamberi a.s. i tha:

-Unë jam rob i All-llahut dhe i Dërguar i Tij. Atë që të them është e vërtetë”²⁰¹

Vërtetë, ndonjëherë arritja e spermës deri tek mitra mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Është bërë takimi me vajza që nuk e kanë humbur virgjinitetin dhe që kanë ngelur shtatzane. Nga spermata e shumta që gjenden në farën e mashkullit, shumë sish do të arrijnë deri në mitër dhe kështu s’është aq lehtë të ruhesh, duke kryer jashtë, në momentin më të ndieshëm në marrëdhëniet seksuale.

Disa prej juristëve islamikë edhe pse azlin e shohin të papëlqyer, megjithatë kanë thënë se është i lejuar. Është e vërtetë thënia e përcjellur nga një as'hab:

“Ne kemi bërë azl gjatë kohës së Pejgamberit a.s. dhe kjo nuk pengojë.”²⁰²

E disa mendojnë se ky është i ligjshëm vetëm nëse lejon gruaja. Vërtetë është e mundur kënaqësia e gruas në marrëdhëniet seksuale, vetëm atëherë kur spermat udhëtojnë kah mitra. Po nuk u kënaq gruaja, janë të mundura ngatërresat shpirtërore e komplikime trupore.

E azli, në të njëjtën kohë është njëra ndër mënyrat e pengimit të shtimit të gjeneratave. Dhe, kjo është kundër politikës së zgjerimit të Islamit.²⁰³

Sipas fesë, mund të thuhet se azli nuk është haram. Por nuk është as ndonjë hallall. Është mekruh (diç e urrejtur) me kusht që të merret leje nga gruaja. Institucionet fetare të Egjiptit kanë dhënë leje për ruajtjen nga shtatëzania për shkaqe shëndetësore ose financiare.²⁰⁴

Asgjësimi i embrionit të fëmijës (aborti)

Në Kur'an dhe në hadithe shpallet se fara njerëzore nëse qëndron në mitrën e nënës do të kalojë nëpër periudhat që pasojnë: dyzet ditët e para “*nufte: lëng njerëzor*”, dyzet ditët e dyta, një copë gjaku i koagulluar, e dyzet ditët e treta, një copëz mish. Pas dyzet ditëve të treta, ose pas katër muajve të parë, formohen organet e fëmijës dhe fryhet shpirti.²⁰⁵ Shkencëtarët e vjetër llogarisin se legalisht mund të hidhet (mund të bëhet abort) para se t'i mufatet shpirti. Por fëmija është i gjallë, ai është në jetë edhe para se t'i formohen organet. Spermat në farën e mashkullit janë të gjalla. Edhe një gjë është e rëndësishme: shëndeti i nënës. Dështimi i fëmijës është diç e rrezikshme dhe e dëmshme për shëndetin e nënës. Lidhur me këtë temë, të japim një këshillë të shkurtër të një mjeku:

“Është shumë e rrezikshme që nëna shtatzane duke e tronditur ta mbysë dhe ta dështon fëmijën, ngase shpesh edhe veten e dërgon në varr para fëmijës. Enët e mëdha të gjakut pranë mitrës do të dëmtohen, kështu gruaja mund të vdesë nga gjakderdhja e madhe ose do të infektohet në “membranën e peritfanit” rreth mitrës. Dalëngadalë do të vdesë nga sëmundja e Peritonit. Mund të vdesë edhe nga septisemia ose piamia, për shkak të toksinimit të gjakut. Duhet patur kujdes të madh për këtë gjë, që kurrsesi të mos dëmtohet mitra. Kjo do të sillte shumë peripeti. Rreziku i këtillë nuk varet vetëm nga duart e specialistëve të akusherisë. Gruaja mund të vdesë gjatë abortimit ose të ketë dhembje të mëdha pas abortimit.”²⁰⁶

Pejgamberi a.s. u fliste grave që sapo kishin pranuar Islamit rreth mosdështimit të fëmijës. Ibën Kethiri në komentimin e tij të ajetit për mosvrasjen e fëmijëve, ajet ky që flet për marrëveshjen e të Dërguarit a.s. me gratë e reja muslimane, vërteton se abortimi hyn në kategorinë e mbytyjeve të fëmijëve.²⁰⁷ Kështu flet Azzeja, e bija e Habilit:

“-Në marrëveshjen që bëra me të Dërguarin a.s. Ai më vuri kusht që: të mos mbys fëmijën as haptazi, as në mënyrë sekrete. Unë e di se ç’është mbytja e fëmijës haptazi. E për mbytjen e fëmijëve në mënyrë sekrete nuk e pyeta të Dërguarin e Zotit (se ç’është ajo). As ai nuk më tha asgjë. Beto hem në emër të All-llahut se deri sa jam gjallë nuk do të abortoj.”²⁰⁸

Në Kur’an shpallet:

“...gratë e mira janë respektuese dhe besnike ndaj të fshehtës.”²⁰⁹

Këtu në shprehjen “*besnike ndaj të fshehtës*” hyn edhe abortimi i fëmijës, ruajtja e saj në stomak.

Para se ta përfundojmë temën “Gruaja në familje”, të theksojmë një fjalë të rëndësishme për shkak të përparësisë që Islami i jep gruas dhe të sqarimit të reformës së madhe rreth të drejtave të gruas: Abdullah Ibën ‘Umeri r.a. thotë kështu:

“Në kohën e Pejgamberit a.s. u frikësuam nga bisedat e ashpra me gratë, nga sjelljet e vrazhdëta me to, ngase frigoheshim se do të shpallet ndonjë ajet për ne, por, pas vdekjes së tij, filluam të flasim ashpër dhe të sillemi në mënyrë të vrazhdë.”²¹⁰

III. Poligamia

“Njeriu që ka dy gra në kurorë dhe ka simpati në njëren më shumë se në tjetrën, në Ditën e Gjykimit do të vijë me njëren anë të paralizuar.”

Muhammedi a.s.

Martesa me shumë gra në sistemin e vjetër juridik religjioz

Në të drejtën e vjetër egjiptase e cila iu jepte më shumë të drejta grave, në krahasim me atë greko-romake, gruaja, nëse nuk i ka takuar klasës klerikale, në kushte të caktuara burri mund të merrte më shumë se një grua.²¹¹

Në të drejtën e Babilonit, sipas ligjeve të Hamurabit, nëse gruaja nuk mund të lindë ose nëse lëngon nga ndonjë sëmundje e rëndë, burri mund të merr robëreshë.²¹²

Ndërsa në të drejtën kineze, burri mund të martohet me gra nga rendi i dytë, nëse e lejojnë kushtet financiare. Por, me kusht që fëmijët që do të lindin nga këto gra, të numrohen si fëmijë të vërtetë të gruas së parë.²¹³

Tek brahmanët e vjetër, sipas librit të Vishnus, burrat sipas klasave që u takojnë, mund të marrin një, dy, tri ose katër gra. Ndërsa në librin Apastamba, vërehet një kufizim: nëse një grua i plotëson obligimet e veta dhe, nëse mund të lind djalë, burri i saj nuk mund të martohet me një grua tjetër. E në të kundërtën, mund të martohet. Sipas Manu rregullave, një burrë duhet ta zgjedhë gruan e parë nga kasta e vet. Si grua të dytë mund të marrë një grua nga kasta më e ulët. Dhe në fund sipas institucioneve të Naradës, burri sipas kastave mund të martohet me një, dy ose tri gra. E sipas disa institucioneve edhe gruaja ka pasë të drejtë që ndonjëherë të ketë më shumë burra.²¹⁴

Edhe në Persinë e lashtë qe aprovuar poligamia.²¹⁵ Në të drejtën romake ekziston *istifrahi* që don të thotë-bashkëjetesa me një grua pa kurorëzim ligjor.²¹⁶

Në Dhiatën e Vjetër theksohet se Davudi a.s. qe martuar me disa gra.²¹⁷ Kur shpjegohen dispozitat që bëjnë fjalë për ndarjen e pasurisë së babait midis fëmijëve nga dy gra, flitet në mënyrë normale, pa fare turpi.²¹⁸ Prandaj, nga kjo kuptohet se edhe tek hebretë kishte poligami.²¹⁹

Në Dhiatën e Re nuk ekziston asnjë pasus me të cilin ndalohet martesë me më shumë se një grua. Por, këshillohet se *“Një grua është e mjaftueshme për një njeri”*. Martesa me më shumë gra në botën krishtere, deri në shekullin XVI ishte gjë normale. Westermarck në veprën e tij historike këtë e thekson duke dhënë edhe shembuj. E dijmë edhe atë se në botën krishtere bashkë me robërimin ekzistonte edhe istifrahi.

Në siujdhesën arabike ku lindi dhe u zgjërua Islami, nuk kishte kurrëfarë kufizimi lidhur me këtë. Si ka mundur burri të marrë sa gra të dojë, ashtu ka qenë e mundur edhe të këmbehen gratë midis burrave. Kanë ekzistuar edhe gra “të lehta” që llogariteshin si pronësi e përgjithshme.

Poligamia në Islam

Islami me ajetin 3 të sures en-Nisa lejon të merret më shumë se një grua. Ajeti është si vijon:

“Në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri a me katër. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni.”

Në këtë ajet theksohet ***“nëse nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve.”*** Lidhur me të ja se ç’shpjegim jep Aisheja r.a.:

“Bonjakja ndodhet nën kujdesin e zotëriut dhe ai dëshiron ta merr atë me ndonjë mehr të thjeshtë duke vënë merak në bukurinë dhe pasurinë e saj. Të këtillëve u ndalohet martesë me bonjaket, edhe nëse japin mehr të caktuar dhe nëse sillen në mënyrë të drejtë- u është urdhëruar të marrin gra tjera përveç bonjakeve.”²²⁰

Ndërsa Ibën Xherir et-Taberi shënon edhe këtë: Disa kanë thënë se domethënia e këtij ajeti është:

“Sikur që frikësoheni nga pamundësia e plotësimeve të të drejtave ndaj bonjakeve, në të njëjtën mënyrë duhet të frigoheni nga prostitucioni me gratë. Mos bëni prostitucion, por nga gratë që u janë të lejuara merrni nga dy, tri ose katër.”

Edhe Shevkani përmend domethënien e njëjtë në tefsirin e vet “Fethu’l-kadir”.

Duket se martesë me më tepër se një grua, dy, tri e në fund katër nuk është ndonjë obligim farz ose urdhër vaxhib, por është një leje në mënyrë që t’i iket prostitucionit. Por edhe kjo leje është kushtëzuar me mundësitë dhe drejtësinë. Ajeti na shpjegon se në bashkëshortësi është kryesore të kënaqesh me një grua, duke theksuar se martesë me një grua është më afër plotësimit të së drejtave.

Kështu, mund të japim një rezymë lidhur me poligaminë në Islam, para lindjes të së cilit, nuk pati ndonjë përkufizim:

1. Përkufizimi i numrit. Është e lejuar martesë me katër gra më së shumti. Ajeti që e cekëm më lartë e shpreh këtë sipas specifikës së gjuhës arabe. Vërtetimi se martesë me më shumë se katër gra është e lejuar, duke u mbështetur në këtë ajet, është gabim, mos njohje e gjuhës arabe. Pejgamberi a.s. i urdhëroi ata që u bënë musliman të rinjë dhe kishin më shumë se katër gra, të shkurorëzohen me ato mbi katër sish.²²¹

2. Drejtësia si kusht.

3. Urdhëroi të kënaqet vetëm me një, nëse nuk ka mundësi për drejtësi.

Duhet patur llogari për drejtësinë midis grave si në ushqim, veshmbathje, strehim, në respektim, në dashuri e kështu me radhë. Ta veçojmë vetëm dashurinë. Është e mundur që barabarsisht të duhen gratë e bukura dhe ato më pak të bukura, ato të rejtat dhe ato më të vjetrat? Po s'që e mundur, atëherë nuk ka drejtësi. E kur nuk ka drejtësi atëherë njeriu duhet të kënaqet vetëm me një grua. E në këto kushte nuk krijohet poligamia.

Disa vërtetojnë se, në Islam është asgjësuar kjo leje, me qëllim që të pengohet poligamia. Por, ky është mendim i gabuar, me që nyja është zgjidhur me ajetin ku flitet për poligaminë. Tani e tutje, njeriu që don të ketë më tepër se një e më së shumti katër gra, do ta kryej obligimin ndaj shpirtit të vet që s'varet nga ai, pas plotësimit të kushteve materiale siç është ushqimi, veshmbathja, strehimi e të tjera, bile edhe fjetjen pranë tyre:

“Ju kurrësi nuk do të mund ta mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpiqeni, pra mos anoni krejtësisht nga njëra e ta leni tjetrën të varur. E nëse përmirësoheni dhe ruheni (padrejtësisë), All-llahu ju falë dhe ju mëshiron.”²²²

Pejgamberi a.s. bënte drejtësi midis grave të tij, dhe thoshte kështu:

“O Zot, kjo është drejtësia që kam në duart e mia. Mos më merr si përgjegjës nga drejtësia që ke Ti e unë nuk disponoj me të.”²²³

Burri respekton barabarësinë në të gjitha sjelljet e veta përveç në dashuri, që nuk varet prej tij. Pejgamberi a.s. thotë:

“Njeriu që ka dy gra në kurorë dhe ka më tepër simpati në njërën se në tjetrën, në Ditën e Gjykimit do të vijë me njërën anë të paralizuar.”²²⁴

Nëse njëra nga gratë nuk është muslimane ajo gëzon të njëjtat të drejta si gratë tjera.²²⁵

A ka nevojë për poligami?

Siç dihet, kurora në Islam mbështetet në qetësinë dhe paqën, dashurinë, simpatinë, ndershmërinë shpirtërore dhe në vazhdimësinë e gjeneratave, e jo vetëm në kënaqësinë seksuale. Pejgamberi a.s. duke bërë fjalë për këtë, thekson:

“Martohuni, por mos shkurorëzoni, meqë All-llahu i Lartësuar nuk i don burrat dhe gratë që varen në kënaqësitë (pasionet).”²²⁶

Duke folur kështu ai e ndaloi eksploatimin e martesës në favor të kënaqësive të ulëta. Atëherë nuk është i drejtë pohimi se gratë janë të robëruara për kënaqësitë e burrave, duke e vërejtur lejimin e poligamisë në Islam. *Të përsërisim se poligamia nuk është ndonjë gjë e urdhëruar, kryerja e së cilës është e domosdoshme si farz ose vaxhib, por është një mënyrë e ruajtjes nga prostitucioni dhe nga imoraliteti.* Siç do të shpjegojmë më tutje, Islami mundohet t'i mbyllë rrugët për të hyrë në prostitucion kështuqë parasheh dënime madje edhe me vdekje.

Shkencëtarët e Islamit kështu i radhisnin disa nga arsyet pse poligamia do të ishte e nevojshme;

- 1) Kur gruaja të jetë e sëmurë prej lindjes nga impotenca dhe të mos ketë ndjenja për seks;
- 2) Të jetë e sëmurë, kështuqë nuk mund t'i kryej detyrat e bashkëshortësisë;
- 3) Të mos mund të lind fëmijë.

Shkurorëzimi do të sillte dëme dhe halle më të mëdha nga rimartesa. Gruaja që do të përjetonte këtë, nuk do të mundte të martohet me të tjerë dhe do të shkaillmohej.

4) Gruaja kalon nëpër periudha të menstruacionit mesatarisht një javë në muaj ndërsa pas secilës lindje, dyzet ditë lehoni. Në këto periudha sipas Islamit, është haram të bëjë marrëdhënie seksuale. Veç kësaj, veçanërisht gjatë kohëve të fundit të shtatzënisë, s'mund të kryhet obligimi ndaj bashkëshortit. E disa burra nuk qëndrojnë ndaj anojnë kah prostitucioni.

5) Potenca seksuale e gruas, dobësohet dhjetë deri njëzet vjet më parë në krahasim me atë të burrit. Ndërsa, sipas gjendjes familjare, mund të dëshirohet madje edhe fëmijë gjatë kësaj kohe.

6) Mungesa e meshkujve për shkak të tragjeditë, kryesisht nga luftërat. Shembull më i mirë është Gjermania pas luftës së Dytë Botërore. Të gjithë e dijmë gjendjen e mjerueshme të grave gjermane madje edhe kërkesat e tyre për "importimin e burrave". Faraoni në kohën e Musës a.s. i vriste bijt e izraelitëve ndërsa bijat e tyre i linte të jetojnë. Një jobaraspeshë të këtillë, Kur'ani e quan "torturë, dhembje të madhe dhe shkatërrim."²²⁷

Evropa që rreptësisht e sulmon poligaminë në Islam, të gjitha këto domosdoshmëri dëshiron t'i mbulojë me një gjë: "mosvërejtjen e prostitucionit". Prostitucioni, prostituteja dhe fëmija jolegjitim, preferohen në vend të kurorës legale, gruas dhe fëmijës legal. Mirëpo, mendimtarët evropianë filluan në mënyrë pozitive të shikojnë në poligami, të cilën, e pranuan për shkak të disekuilibrit në numër mes gruas dhe burrit, për ta ruajtur nga shkatërimi jetën e burrave dhe të pronësive të tyre për shkak të dashnorëve të grave dhe shtimit të vrasjeve e abortimeve, me qëllim të pengimit të fëmijëve jolegjitim.

Westermarck, në veprën e tij historike, thotë:

"Poligamia, pas ndalimit në Perëndim, s'është shmangur nga praktika. Më pastaj, a është sistemi më i përkryer dhe i fundit, ai në të cilin do të kënaqet njerëzimi vetëm me një grua?"

Përgjigjet janë të ndryshme. Sipas Herbert Spenserit, sistemi i fundit është monogamia. Ndërsa sipas Lebonit:

"...ligjet evropiane për një kohë të shkurtër do ta lejojnë poligaminë."

Prof. Ehrenfeli mendon se poligamia është e domosdoshme për shkak të ruajtjes së racës ariane. Shpjegim më të mirë lidhur me këtë çështje nxjerrim nga vepra e prof. Muhammed Hamidullahut:

“Monogamia faktikisht, është dukuri më e rrallë në krahasim me bigaminë, që llogaritet si gabim i rrezikshëm dhe mosrespektim i ndalimeve dhe gjërave të shenjta. Përveç kohëve të fundit, kur në mënyrë të shpejtë u zhvillua kultura e Perëndimit, s’mund të gjendet një nocion ideal dhe parimor, kuptim që s’mund të shtrembërohet. Madje edhe në doktrinën krishtere, asgjë s’është thënë që të japë argumente të një pasqyre të këtille.”²²⁸

“Askush nuk ka të drejtë të thotë se krishterizmi është ai që e detyron botën e civilizuar të Perëndimit në monogami, Krishterizmi nuk ka ndaluar në mënyrë të haptë poligaminë veç kryepeshkopëve dhe gjakonëve (Timotheu 3/2, 12)... Asnjë nga koncilët krishterë nuk e kundërshtuan poligaminë; nuk u pengua që kjo të vazhdojë as nga mbretërit, aty ku ekzistonte poligamia në kohën e idhujtarisë. Në mes të shekullit të VI mbreti i Irlandës Diarmait, kishte dy mbretëresha dhe dy robëresha. (D’Arbois de Jubainville, VI, 292). Poligamia është vënë në praksë pa kurrfarë pengesash gjatë kohës së mbretërisë së Merovingienit. Karli i Madh kishte dy mbretëresha dhe shumë robëresha, e njëri ndër ligjet e tij theksonte se poligamia nuk është e panjohur për murgjit ²²⁹. Më pastaj Filipe de Hesse dhe Frederic - Guillaume de Prusse nga sekta luterian marrin nga dy gra me lejen e murgëve.²³⁰ Lutheri personalisht ia lejoi bigaminë të përmendurit më lartë. Të njëjtën gjë e bëri edhe Melanchetoni.²³¹ Shumë herë Lutheri vet personalisht, fliste për poligaminë me një tolerancë të madhe: “Kjo (poligamia) s’është e ndaluar nga Zoti... Nuk ka dyshim se poligamia preferohet në vend të shkurorëzimit.”²³² Më 1650 pas marrëveshjes së Westfalisë, Parlamenti Ushtarak i Frankonit (Kriegstag) lëshoi vendim, që prej atëherë, çdo burrë mund të marrë nga dy gra, si preventivë kundër zvogëlimit të popullatës, pas luftimeve tridhjetvjeçare.²³³ Disa sekte krishtere luftuan shumë për poligaminë. Më 1531, në Munster anabaptistët bënë përpjekje duke dashur që, në mënyrë të hapët ta zgjerojnë poligaminë dhe thanë se i krishteri i vërtetë duhet të ketë shumë gra.²³⁴ Dhe, siç e dimë, Mormonët e shikonin poligaminë si një institucion hyjnor.²³⁵

Në njoftimin e princit gjerman Philippe de Hesse, që ia dërgoi teologut Marthin Bucer, lidhur me ca pyetje që i kërkoi t’u parashtrohen shkenctarëve tjerë fetar (Martin Lutherit dhe Filipe Melancheton), shënohet si vijon “(Paragrafi i X): “E di se Luteri dhe Melancheton e kanë këshilluar mbretin anglez që të martohet me një grua tjetër para se të ndahet prej të parës.”^{236, 237}

Gruas së parë në poligami, do t’i lëndohet krenaria. Do të ndjejë xhelozë dhe brenga për shkak të martesës së burrit të saj me një grua tjetër. Por, nga ana tjetër, në martesën jo legale që i takon jetës së prostitucionit me dashnore, ekzistojnë edhe rreziqe tjera: humbja e nderit të burrit që hyn në prostitucion dhe të gruas së tij, dëmin që do ta pësojë gruaja e një burri të atillë, për shkak të jetës së përbashkët me një njeri të pandershëm, dhe mundësia për kapjen e rrugëve të këqija që t’i revanshohet burrit, si dhe dëmi, që do ta pësojë burri për këtë gjë. Nga ana tjetër, nëse ajo grua është martuar e që ishte në marrëdhënie me një burrë të këtille, tradhëtinë që do ta pësojë burri i saj, madje edhe dëmin që do ta pësojë gruaja e atij burri që hyn në marrëdhënie me gruan që deshti t’i revanshohet burrit... Nga të gjitha këto marrëdhënie jolegale paraqiten mbytja e fëmijëve, zgjerimi i sëmundjeve venerike, edhe armiqësia midis palëve... Duket se kur të ndalohet poligamia edhe pse ekziston nevoja dhe domosdoshmëria për të, njëra pas tjetrës vijnë tragjeditë deri atëherë kur të çthuret çorapi.

Të përkujtojmë se në të drejtën islame, gruaja ka të drejtë të kërkojë që të mos i martohet burri me një grua tjetër derisa është e lidhur kurora me të. Pas aktit që do të kryhet në mënyrë legale marrëveshja që do të bëhet, do të vazhdojë, nëse ajo bën fjalë për atë se burri nuk guxon të martohet rishtas, e nëse martohet, gruaja e parë ta mbajë të drejtën e shkurorëzimit. Në një hadith thuhet:

“Kushti që më së shumti meriton ta plotësoni është ai që e keni pranuar gjatë kurorëzimit.”²³⁸

Në këtë rast, gruaja, në poligami do të ketë të drejtë vote. Do të eliminohen dëmet shpirtërore që i takojnë. Në shumë vende të botës zyrtarisht nuk ekziston poligamia. Por, faktikisht ajo vazhdon të përhapet. Për këtë arsye, kohë pas kohe sillen ligje të ndryshme që të përcaktohet origjina e fëmijëve sipas sistemit juridik.

Në fund, mund të thuhet se feja Islame e ka aprovuar poligaminë për shkak të disa domosdoshmërive. Nëse njerëzia ende nuk e din dobinë e saj dhe nuk e aprovon poligaminë, s’ mund të thuhet se një ditë, pas përvojave të ndryshme nuk do ta aprovojë.

f F

IV. Shkurorëzimi

“Martohuni por mos u shkurorëzoni meqë All-llahu nuk i don ata burra e ato gra të cilët janë të varur nga kënaqësitë e tepërta (pasionet).”

Muhammedi a.s.

Shkurorëzimi gjatë historisë

Në të drejtën e vjetër egjiptiane, që dihej se i respektonte të drejtat e grave, shkurorëzimi ishte nën autoritetin e burrit. Duhej që burri vetëm t’i paguajë një shumë të hollash gruas së tij. Pas invazionit maqedonas në Egjipt, sistemi juridik iu afrua atij grek, ndaj të drejtë shkurorëzimi iu dha edhe grave.²³⁹

Sipas ligjeve të Hamurabit, shkurorëzimi, është e drejtë e burrit. Gruaja fiton vetëm një lloj dëmshpërblimi, në para ose në diç tjetër, e kjo varet nga posedimi ose mosposedimi i fëmijëve. Nëse gruaja është shkaktare e shkurorëzimit, duke bërë ndonjë gabim, burri nuk është i obliguar të paguajë diçka dhe ta lëshojë ate ose pa e shkurorëzuar do ta shfrytëzojë si robëreshë, e mund të martohet me ndonjë grua tjetër.²⁴⁰

Në të drejtën kineze, shkurorëzimi mund të bëhet vetëm me marrëveshje të dyanshme dhe me aprovimin e dy palëve. Burri mund ta shkurorëzojë gruan në krye të vet në shtatë raste të caktuara. Në rastin e prostitucionit, shkurorëzimi është i domosdoshëm. Burri, bashkëshortja e të cilit e ka tradhëtuar, gruan do ta shesë dhe paratë do t’i marrë vet.²⁴¹

Në të drejtën e vjetër brahmane, kishte forma të ndryshme të kurorës. Është i mundshëm shkurorëzimi edhe për gruan edhe për burrin për shkaqe të caktuara.²⁴² Burri ka mundur të shkurorëzohet nga gruaja nëse ajo ishte e keqe, bënte hile dhe ishte zemërkeqe.²⁴³

Në të drejtën familjare romake, bashkësia familjare ka mundur të priset në dy mënyra:

1) Prishja e familjes për shkak të asaj që nuk varet as nga burri as nga gruaja. Kjo ndodhte nga vdekja e njërit nga bashkëshortët, më pastaj për shkak të rënurit rob, ose, për shkak të humbjes të së drejtës qytetare;

2) Prishja e kurorës për shkak të kërkesës së gruas ose të burrit. Ky shkurorëzim nuk varej nga vendimi gjyqësor, si në të drejtën bashkëkohore. Ky mbështetëj në aktin paraprak juridik, me të cilin është lidhur kurora dhe quhej “*contrarius actus*” që don të thotë kontra akt.

a) Kurora që janë mbështetur në dominimin e burrit (*me manus*) ndodhte që gruaja të “shitet” si një vajzë familjare nëse kurora paraprake bazohej në blerjen e vajzës, në kurorën ku dominonte burri, e kjo quhet *manus* ose kurora paraprake ishte e lidhur për jetën e përbashkët midis vajzës dhe djalit për një afat njëvjeçar. Normalisht, një shkurorëzim i këtillë kryhej nga ana e burrit. Në këtë gruaja nuk kishte asnjë rol. Në realitet ky ishte refuzim i gruas nga ana e burrit, në vend të shkurorëzimit të rëndomtë. Nëse martesë ishte bërë me ceremoni fetare, ndarja bëhej para klerit. Nëse nuk ishin të pranishëm elementet fetare dhe juridike, atëherë kleri e pengonte prishjen e kurorës.

b) Kurorat që nuk janë mbështetur në dominimin e mashkullit (*pa manus*) ajo mund të prishej me arsye dhe pa të, sipas dëshirave të dyanshme, ose vetëm me kërkesën e njëres nga palët.

Me kohë në Romë, më shumë preferohej kurora pa manus se sa ajo me manus. Proçeset e shkurorëzimit zgjeroheshin deri në pakufi. Nuk ekzistonin gjyqe të ligjshme për pengimin e shkurorëzimit pa arsye. Edhe pse më vonë u sollën disa norma financiare, që obligonin palët, por edhe kjo nuk pati efekt të madh.²⁴⁴

Shkurorëzimi në Bibël

Sipas Dhiatës së Vjetër, burri i martuar me një grua, po pa diç që nuk i pëlqen tek gruaja e tij, duhet të shkruaj lutje për shkurorëzim dhe do ta lëshojë atë të largohet nga shtëpia e tij.²⁴⁵ Gruaja pas largimit nga shtëpia e burrit të parë, mund të martohet me një burrë tjetër. Nëse burri i dytë neveritet nga kjo grua dhe shkruan lutje për shkurorëzim dhe, nëse e largon nga shtëpia e tij, ose nëse vdes, burri i parë nuk mund ta marrë përsëri si grua të veten (meqë ajo nuk është e pastër).²⁴⁶

Që ta provojnë Isain a.s., sipas shënimeve të Dhiatës së Re, (Mateu), farisajtë e pyetën: “*A është e lejuar që njeriu me çfarëdo arsye të shkurorëzohet nga gruaja?*” E ai u përgjeggj kështu: “*A s’keni lexuar se në fillim Krijuesi krijoi një grua dhe burrë, dhe ata duhet të bëhen një trup? Dhe tani, ata nuk janë dy por vetëm një trup. Të mos i ndajë njeriu ata njerëz të cilët Zoti i ka bashkuar.*” Farisajt kësaj radhe shtuan: *Po qe ashtu, atëherë përse Musa urdhëroi të jipet shkurorëzimi dhe gruaja të shkurorëzohet?* Isa tha: *Musa, për shkak të zemërngushtësisë suaj, lejoi të ndaheni nga gratë. Por, në fillim nuk ndodhi ashtu, dhe unë po ju them: kush do të shkurorëzohet nga gruaja për shkak të prostitucionit, nëse martohet me tjetër, do të hyjë në kurorëthyerje, dhe kush martohet me atë të shkurorëzuarën, edhe ai do të jetë në kurorëthyerje.”²⁴⁷ Sipas kësaj në krishterizëm shkurorëzimi është i ndaluar. Por, shumica e shkencëtarëve protestantë, duke u mbështetur në fjalët që vijojnë, vërtetojnë se është i mundur shkurorëzimi, nëse bashkëshorti e lë bashkëshorten për një kohë të gjatë: Gruaja të mos ndahet nga bashkëshorti - e nëse ndahet, të mos ngelë pa bashkëshort, ose le të pajtohet me bashkëshortin - dhe bashkëshorti të mos e braktis bashkëshorten.”²⁴⁸*

Shkurorëzimi në Islam

Në Kur'an shpallet se duhet kaluar mirë me gratë, edhe nëse ato nuk na pëlqejnë. Nëse i durojmë asaj që nuk na pëlqen, ndoshta All-llahu në diç të këstillë ka caktuar ndonjë hajr të madh për ne.²⁴⁹ Kur njerëzve nuk u janë të njëjta gjymtyrët dhe organet, të ndryshme u janë edhe bota shpirtërore dhe dëshirat. As gruaja nga burri e as ky nga gruaja s' duhet të kërkojnë që të mendojë pala tjetër siç mendon vet. Marrëveshja dhe kënaqësia lindin bashkë me flijimin, dhe vetëm me flijime mund të vazhdohet. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Të mos kërkojë arsye një burrë besimtar për të mos e dashur një besimtare. Nëse nuk i pëlqen një veti e saj, do t'i pëlqejnë vetitë tjera.”²⁵⁰

Bashkëshortët duhet të flijohen dhe të respektohen, po deshtën të kalojnë mirë. Përkundër kësaj do të përfundojnë me një pikë, e ajo është rebelimi kundër All-llahut. Flijimi dhe respektimi i ndërsjellë, nuk duhet të jetë kundër urdhërave të All-llahut. Fjalët e Pejgamberit a.s. që vijojnë janë parime të forta të Islamit:

“S'ka bindje për ata që janë rebelë kundër Krijuesit.”²⁵¹

“Nuk ka bindje për të pabindurit ndaj All-llahut, bindja mund të jetë në punë legale (të lejuar sipas normave Islame).”²⁵²

E kjo ka përjashtim. Edhe pse gënjeshtër është gjë e keqe në Islam, , Pejgamberi a.s. e lejon këtë në tri raste:

“Është e lejuar gënjeshtër në luftë, në pajtimin e të hidhëruarve, armiqësuarve dhe gënjimi i gruas që i bën burrit dhe i burrit që i bën gruas (për të mbretëruar qetësia në familje).”²⁵³

Gënjeshtër është lejuar jo për ta tradhëtuar njëri tjetrin në pikëpamje nderi, por, të gënjejnë për gjëra më të vogla me qëllim që të ruhet rendi familjar.²⁵⁴

Zënkat bashkëshortore dhe ndërmjetësimi për zënka më të mëdha, është gjë shumë e keqe. Detyra e një muslimani është, që të pajtojë besimtarët, veçanërisht bashkëshortët dhe t'i përmirësojë marrëdhëniet midis tyre. Pejgamberi a.s. thotë:

“Një njeri që e ven në gjendje të keqe gruan duke i bartë gabimet e saj tek bashkëshorti i saj, nuk i takon rradhës sonë.”²⁵⁵

Moskuptimi midis bashkëshortëve

Pa marrë parasysh sa mendojmë në mënyrë optimiste, ekziston një realitet që s'mund të mohohet, se në jetën bashkëshortore midis bashkëshortëve ka mosmarrëveshje. Evitimit të një sëmundjeje të këtillë, në Kur'an, i kushtohet kujdes. Shkohet nga ajo që kjo sëmundje të evitohet nga ana e vetë bashkëshortëve. Nëse nuk ka sukses, atëherë problemi hidhet që të gjykojnë dy familjet. Kur as kjo nuk ndihmon, zgjidhja e fundit është shkurorëzimi.

Nëse mosmarrëveshja del nga ana e gruas; ajo u shmanget obligimeve të gruas, s'e dëgjon burrin e vet në të drejtat (kërkesat) e tij të pamohueshme dhe legale, i takon një procedurë në tri kategori.²⁵⁶

a) *Këshillimi*- do t'i jipen këshilla që ndikojnë në të dhe do të thirret ajo të jetë e dëgjueshme. Do t'i flitet për punët e mira të burrit dhe dashurinë e tij ndaj saj. Sipas situatës mund të përdoret ndonjë mënyrë më e ashpër e mund t'i thuhet fjalë me të cilat i tërhiqet vërejtja. Mënyra e këshillimit varet nga botëkuptimi i saj. Por, me siguri ky do të jetë një instrument i mirë.

b) Nëse nga këshillimi nuk ka sukses, etapa e dytë është *izolimi* - të ngelë vetë në krevat. Begatia më e madhe e gruas është feminizmi. Është dënim i madh për të bojkotimi nga ana e burrit. Ajo nuk mund të qëndrojë kësaj mase disiplinore. Por, zgjatja e kësaj mase është e rrezikshme.

c) Nëse edhe kjo masë nuk jep asnjë rezultat, burri mund ta aplikojë edhe *rrahjen* e gruas nga pak. E kjo masë është qortim i gruas nga ana e burrit, meqë ai është kreu i familjes. Por, me këtë nuk duhet tepruar, respektivisht nuk duhet shkuar deri në sakatimin dhe shkaktimin e dhembjeve të mëdha, pasi ai as që ka qark të drejtë. Po i tejkaloi kufinj të, do të ketë kundërmasa.²⁵⁷ Erdhi një as'hab tek i Dërguari a.s. dhe u ankua nga gjuha e ndytë e gruas: E Pejgamberi a.s. tha:

-Shkurorëzohu. - as'habi tha:

-Atë e kam shoqe të jetës dhe me të kam edhe fëmijë. -atëherë Pejgamberi a.s. i tha:

-Urdhëroje atë të sillet mirë, këshilloje. Nëse ka mirëkuptim, do ta realizojë urdhërin tënd. Atëherë mos e rrah (siç rrihet robëresha)”²⁵⁸

Në një hadith tjetër thuhet:

“Askush nga ju të mos e rreh gruan siç rrihen robëreshat, ndoshta në fund të ditës do të keni edhe marrëdhënie.”²⁵⁹

Si rezultat i aplikimit të këtyre masave, gruaja, nëse e dëgjon burrin, ai do t'i ndërpresë këto masa dhe do të vazhdojë jetë të mirë me të. Nëse vazhdon ta maltretojë gruan dhe nëse këtë e bën me qëllim shkurorëzimi, gjyqtari duhet ta dënojë këtë. Dhe, gjithsesi do të përgjigjet edhe para All-llahut xh.sh.

Në një atmosferë të tendosur, nëse burri tregon durim në marrëdhëniet me gruan, do të pajtohen.²⁶⁰ Që ta qetësojë burrin gruaja disponon me aftësi të ndryshme. Këtë më së miri e din vetë ajo. Dhe kështu do t'u konvenojë. Në krahasim me natyrën më të vrazhdë të burrit, gruaja ka natyrë të butë dhe të qetë. Gruaja në karakterin e vet disponon me fuqi që ta zbusë e ta qetësojë burrin, që me të të jetojë në lumturi e paqë.

Caktimi i gjykatësve

Nëse mosmarrëveshja ose disharmonia midis bashkëshortëve nuk mund të evitohet nga vetë ata, atëherë sipas urdhërit të Kur'anit emërohen dy arbitër nga dy familjet e palëve në konflikt.²⁶¹ Sipas shumë shkencëtarëve, gjykatësi ka autorizim të emërojë nga një arbitër të merituar nga të dy familjet. Arbitrat i marrin në pyetje dy palët veç e veç, e bëjnë përpjekje që t'i pajtojnë. Në një ajet thuhet kështu:

“Nëse ata dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, All-llahu e mundëson afrimin midis tyre (burrit e gruas)”²⁶²

Zgjedhja e arbitërve është gjë shumë e qëlluar nga familjet e palëve në konflikt, nga aspekti i asaj që të mos dalin në shesh sekretet familjare, njohja e veçorive specifike të bashkëshortëve dhe mundësia që bashkëshortët të shprehen më lirë lidhur me ankesat e tyre.

Nëse arbitrat nuk kanë sukses që t'i pajtojnë pas të gjitha përpjekjeve të tyre dhe nëse dakordohen t'i shkurorëzojnë, një gjykim i këtillë do të jetë i plotfuqishëm. Shumë juristë islamikë kanë mendim të këtillë.

Shkurorëzimi si zgjidhje e fundit

Konflikti ndonjëherë s'mund të mënjanohet edhe pse bëhen përpjekje me qëllime të mira. Në këtë rast shtëpia dhe familja shndërrohen në ferr të vërtetë. Një brengë e këtillë t'i shkaktohet qenies njerëzore nuk përkon me mëshirën. Në Kur'an, pas theksimit të masave dhe metodave për pajtimin e bashkëshortëve, emrimit të arbitërve, më pastaj, dhe punës së tyre, thuhet:

“Por, nëse ndahen prej njëri tjetrit, All-llahu begaton me mirësinë e Tij secilin prej tyre. All-llahu është Bujar i Madh, i Plotëdijshëm”²⁶³

Siç u theksua në titullin *“Shkurorëzimi në histori”*, në sistemet juridike të civilizimeve të vjetra ka ekzistuar shkurorëzimi dhe kjo e drejtë më së shpeshti i takonte vetëm burrit. Në krishterizëm, kisha katolike duke e pranuar parimin se *“bashkëshortët janë një trup e jo dy dhe se, atë që e ka bashkuar Zoti nuk duhet ta ndajë njeriu”²⁶⁴*, me shekuj e kanë ndaluar shkurorëzimin. Por, siç thekson juristi i madh gjerman, Kohler në veprën e tij *“Filozofia juridike”*, *“me të vërtetë kurora që s'ka shans të ruhet nuk do të ngelë vetëm si një burim i mundimit dhe torturës, por do ta pengojë zhvillimin shpirtëror të njeriut dhe aftësitë e tij të mëdha do t'i zbrësë në zero.”*

Në një gjendje të këtillë, siç e përshkruam, nuk mund të ketë asnjë mirëkuptim moral e social që do ta bind ose ta detyrojë njërin për vazhdimin e kurorës. Që kjo të përfundojë sa më shpejtë, është domsdoshmëri sociale e kulturore. Por, një pikëpamje e këtillë e kishës katolike, nga çdo aspekt, është problematike.²⁶⁵

Kështu dalëngadalë populli u mundua të shpëtojë nga një rend i këtillë i kishës katolike që nuk i përgjigjet nevojës së popullit dhe realitetit social. Kisha katolike që e detyruar të bëjë lëshime në gjykimet e veta, varësisht me dëshirat që mbretëronin asaj kohe. Këto rregulla që kisha i quante “*gjendje ku kurora nuk ka vlerë - validitet*” nuk ndryshonin shumë nga gjyqet për shkurorëzim.²⁶⁶ Në realitet, lidhur me këto çështje më parë e solli reformën kisha protestante dhe, me arsye të caktuar e aprovoi shkurorëzimin.

Ndalimi i shkurorëzimit është edhe një rezik që shkakton pasoja të zvogëlohen kurorëzimet. Kur njeriu e din se nuk do të ketë mundësi të shkurorëzohet, do t’i mbyllet dyert kah ka hyrë, si do të dëshirojë të hyjë nëpër to. Zvogëlimi i kurorëzimeve do të shpie kah zgjerimi i prostitucionit, kah shkatërrimi i familjeve dhe vrasjet. Në fund, të gjitha këto, përsëri e demotjnë gruan.

Gjykimi rreth shkurorëzimit

Në të drejtën islame, shkurorëzimi është zgjidhja e fundit, kur më nuk ekzistojnë mundësi për vazhdimin e jetës familjare. Në Kur'an ndalohet shkurorëzimi i pashkas me këto fjalë:

“...e nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre. All-llahu është më i Larti, më i Madhi.”²⁶⁷

Pejgamberi a.s. thotë:

“Martohuni por mos u shkurorëzoni, meqë All-llahu nuk i don ata të cilat varen nga kënaqësia e tyre (pasioni).”²⁶⁸

E një hadith tjetër thekson:

“Për All-llahun gjëja më e urretur, por e lejuar është shkurorëzimi.”²⁶⁹

Juristët u dakorduan se shkurorëzimi pa asnjë shkas nuk mund të jetë i drejtë.

Sipas hanefijve, esenca e shkurorëzimit është haram. Meqë për shkurorëzimin u thanë shumë hadithe, ky në të njëjtën kohë është edhe shkatërrimi i bashkësisë familjare që është gurthemeli i shoqërisë, është edhe shqelminim i nimetit të kurorës. Ndaj, shkurorëzimi i panevojshëm është haram.

Lidhur me shpjegimin e shkurorëzimit, në hadith thuhet:

“Gjëja e lejuar, por më e urretur tek All-llahu është shkurorëzimi.”

Disa shkencëtarë gjetën argumente se shkurorëzimi është mekruhi më i afërt haramit.²⁷⁰ Por, në situata të ndryshme shkurorëzimi trajtohet ndryshe.

Arsyet e shkurorëzimit

Shkurorëzimi është për atë që nuk është i aftë t'i kryejë obligimet e veta ndaj gruas ose të të sigurojë ekzistencën e saj materiale, meqë me këtë rast, mosshkurorëzimi me gruan do ta shkatërrojë moralin e saj. Nga ana tjetër, për njeriun i cili nuk ka arsye për shkurorëzim, por don formojë kushte për prostitucion, shkurorëzimi është haram.²⁷¹

Për burrin, situatat në të cilat do t'i jetë e lejuar legalisht të shkurorëzohet janë: pozita në kurorë, për të cilën thuhet: “kufijti që i ka përcaktuar All-llahu” si për shembull; urretjtja deri në atë shkallë sa që s'mund të ekzistojë bashkësia familjare, disharmonia totale, mosmundësia e kryerjes

së obligimit të bashkëshortit për shkak të impotencës seksuale, mosvullneti për të që rrjedh nga urrejtja e tepruar (në rast kur është i aftë për marrëdhënie), prostitucioni dhe mospërfillja e urdhërave të qartë të All-llahut nga ana e gruas (namazit, agjërimit etj.)²⁷²

Sipas ligjit të së drejtës familjare të shpallur në kohën e Hajri Efendiut, më 10 mars të vitit 1333 nga ana e Institutit për Fetva të Këshillit Pajtimor, që zyrtarisht është aprovuar në atë ditë, gruaja në rastet që vijojnë mund të kërkojë shkurorëzim:

1. Gruaja që nuk ka sëmundje të atillë që mund ta pengojë aftësinë seksuale, kur të kuptojë se burri i saj ka sëmundje të këtillë, me anë të gjyqit mund të kërkojë shkurorëzim. (Neni 19). Nëse sëmundja e burrit nuk është e shërueshme, gjykatësi menjëherë duhet të sjellë vendim për shkurorëzim. Nëse është e mundur terapia, këtë gjë duhet ta afatizojë për një vjet. Po s'u shërua, në fund të këtij afati, nëse gruaja akoma insiston për shkurorëzim, gjyqi do të sjellë vendim për shkurorëzim, madje edhe sikur burri të kundërshtojë. (Neni 127).

2. Gruaja mund të kërkojë shkurorëzim edhe për shkak të sëmundjeve venerike, leprës tek burri i saj, që nuk mundësojnë jetë bashkëshortore. Po shpresoi se këto sëmundje do të shërohen, jipet një vjet afat, e nëse s'ka shpresa atëherë shkurorëzimi kryhet përnjëherë. (Neni 122).

3. Pas aktit të kurorës, nëse burri çmendet dhe gruaja këtë e paraqet tek gjykatësi, kjo përsëri afatizohet në një vjet. Po nuk u evitua sëmundja, atëherë sillet vendim për ndarje.

4. Veç këtyre, nëse burrit i zhduken të gjitha gjurmët, dhe nëse nuk mund të realizohet alimentacioni, gjykatësi pas hetimeve të nevojshme, sipas kërkesës së gruas, duhet të vendos për shkurorëzim. (Neni 126).

5. Gruaja e njeriut që ka humbur, edhe pse ka lënë një farë pasurie që mund të shfrytëzohet si alimentacion, paraqitet te gjykatësi të kërkojë shkurorëzimin, por më parë ai, duhet t'i bëjë hetimet e nevojshme për atë njeri. Pritet katër vjet prej humbjes së shpresës, se ku gjendet ai dhe është i gjallë ose i vdekur. Poqese nuk mund të lajmërohet dhe nëse gruaja insiston në kërkesën e saj edhe më tutje, gjykatësi do të sjellë vendim për shkurorëzim. (Neni 127).

Këto shkurorëzime janë si shkurorëzimet absolute - të prera.

6. Po u shkaktua mosdurim dhe disharmoni midis bashkëshortëve, dhe njëra palë kërkon shkurorëzim, gjykatësi duhet të caktojë dy arbitër nga familjet e tyre. Nëse ata nuk mund të gjenden nga të dy familjet, ose nuk kanë veti përkatëse për ta kryer këtë obligim, atëherë gjykatësi do të emërojë njerëz tjerë nga rrethi jashtëfamiljar. Kuvendi familjar i krijuar në këtë mënyrë, me analizën e deklaratave dhe mbrojtjen e të dy palëve, bën përpjekje t'i pajtojë ata. Nëse nuk është e mundur kjo, dhe nëse faji është te burri, ata i shkurorëzojnë. Nëse faji qëndron te gruaja, një pjesë ose tërë mehri do të ngelë te burri, dhe sillet vendim për shkurorëzim.

Nëse gjykimet e arbitërve nuk janë të njëjtë, atëherë gjykatësi emëron një komision tjetër arbitërsh, që posedojnë veti të mjaftueshme, ose një tim të tretë arbitrash që s'janë në lidhje farefisnore me palët. Gjykimi që do ta japin arbitrit është definitiv, dhe kundër tij nuk mund të bëhet ankesë. (Neni 130).

Shkurorëzimi për shkak të
renegimit (daljes nga feja)

Meqë në Islam të gjitha gjykimet për kurorë dhe aktet tjera juridike mbështeten në iman, nëse njëri nga bashkëshortët lëshon fenë e vet, atëherë kurora automatikisht bëhet e pavlerë, boshe. Bashkëshortët shkurorëzohen. Nëse ndodh vdekja e pafreskuar me iman dhe pa pendim dhe kurora nëse nuk ripërtrihet, atëherë midis tyre s' do të ketë trashëgimi.²⁷³

Nëse çështjet të cilat janë esenciale për fenë Islame, siç është Dita e Gjyimit, namazi ose agjërimi dhe farzet e këtilla, mohohen ose përqeshen, atëherë bëhet kufër (mosbesim), ndaj është e nevojshme përsëritja e imanit dhe kurorës. Gjithashtu, edhe ofendimi ose nënçmimi i gjërave që meritojnë respekt, siç është Kur'ani, Qabja, Sheriati dhe xhamia, pastaj sharja e fesë dhe imanit është kufër. Sharja e Muhammedit a.s. dhe talljet në llogari të tij, gjithashtu janë kufër, që e anulojnë imanin dhe kurorën.²⁷⁴

Shkaqet e shkurorëzimit dhe kisha

Siç u shpjegua më lartë, kisha katolike nuk e aprovon shkurorëzimin. Një mendim i këtillë i katolicizmit e ruan dominimin e vet, madje edhe sot në shumë vende.

“Kisha dhe e drejta katolike e privoi institucionin e shkurorëzimit, për disa arsye të caktuara: Nëse i numërojmë arsyet kalimtare dhe ato konstante për shkurorëzim në të drejtën katolike dhe ato në të drejtën protestante, atëherë del në pah se këto kanë ndikuar në gjendjen e ‘vendeve të civilizuarra’.”²⁷⁵

Autorizimi për shkurorëzim

Në të drejtën islame, akti i martesës është konstant. Ndaj nuk vlen martesa e përkohshme. E për të qenë valide kurora, duhet të ekzistojë dashuria dhe mirëkuptimi midis bashkëshortëve. Baza e jetës bashkëshortore është dashuria dhe mirëkuptimi. Ç'ndodhë kur nuk ka dashuri e mirëkuptim midis bashkëshortëve dhe kur s'mund të përmirësohet kjo gjendje? Me siguri nuk do të ketë rrugëdalje tjetër pos shkurorëzimit. E ku do të jetë autorizimi për shkurorëzim? Këtu do t'i përkujtojmë katër mënyra që do t'i shqyrtojmë një nga një:

1) *Shkurorëzimi me pajtim të dy palëve*: në të drejtën romake pranohej se është e mundur të bëhet shkurorëzimi me pajtimin midis palëve. Mund të bëhej shkurorëzimi me ujdj dypalëshe edhe në të drejtën gjermane dhe kineze. Për një kohë të caktuar, të njëjtën mënyrë të shkurorëzimit e aprovoi edhe Franca.²⁷⁶ Më pastaj shkurorëzimin midis dy palëve, përveç arsyeve tjera, me pajtim nga dy palët, e pranuan edhe disa vende evropiane siç janë: Belgjika, Luksemburgu, Rumania, Estonia, Letonia, vendet e Skandinavisë, Rusia dhe disa vende latino amerikane.

Edhe pse në të drejtën islame, marrëveshja midis dy palëve, nuk është forma kryesore e shkurorëzimit, kjo gjë mund të realizohet në kushte specifike (burri që ka autorizimin për shkurorëzim, këtë të drejtë t'ia pranojë edhe gruas. Kjo është mënyrë e marrëveshjes dypalëshe).

Kritikë: Marrëveshja dypalëshe nuk është mënyra më e mirë e shkurorëzimit. Të lejuarit, që vetë dy palët të bëjnë marrëveshje, në praksë do të jep rezultat që shkon kah minimizimi i shkurorëzimit, edhe pse ai ndoshta është i domosdoshëm, e ndonjëherë tjetër, pajtohen aq lehtë sikur ajo të ishte ndonjë zënkë e rëndomtë, dhe ndodh që shumë shpejt pajtohen për t'u shkurorëzuar.

2) *Shkurorëzimi nëpërmjet të gjyqit:* Sot mbretëron një mendim i përhapur se shkurorëzimi është i mundur vetëm me anë të gjyqit, madje në kushte të caktuara.

“Ky mendim në mënyrë të veçantë ishte i pranueshëm nga kisha protestante dhe nga ajo kaloi nëpër gjyqe të shteteve të ndryshme. Në disa vende që e pranuan këtë mënyrë, përveç shkurorëzimit ekziston edhe institucioni i ndarjes.”²⁷⁷

Kritikë: Për gjyqin është shumë vështirë ta peshojë shkallën e dashurisë, këtë misterioz që i lidh bashkëshortët njërin me tjetrin, të depërtojë në fshehtësitë e kurorës e shkurorëzimit nëpërmjet të gjyqit, pala që kërkon shkurorëzim, duhet t'i tregojë ngjarjet dhe të jep shkase dhe argumente për të. Ndërsa gjykatësi nuk mund të sjell vendim derisa nuk bindet në ndërgjegjen e vet për ekzistimin e ngjarjeve që janë theksuar si arsye e shkurorëzimit. Për këtë nuk vlejné as betimet e as gjërat tjera, në vend të argumenteve.²⁷⁸ Në këtë rast, gjykatësi duhet ta hulumtojë jetën personale të bashkëshortëve dhe të interesohet për fshehtësitë e tyre. E kjo nuk është e drejtë.

Gjatë shkurorëzimit me anë të gjyqit, zbulimi i fshehtësive para komisionit të gjykatësve, do të dëmtojë sidomos gruan, për të cilën do të ketë thash e theme, do të preket krenaria e saj dhe për të do të jetë shumë e vështirë të rimartohet pas shkurorëzimit. Thash e thënat e këtilla, madje mund të përcillen edhe nëpërmjet të shtypit.

Është e mundur që një bashkëshort që dëshiron ta prishë bashkësinë familjare si gurthemel të shoqërisë, të pengohet nga ana e gjyqit, duke ia tërhequr vëmendjen për një sjellje tjetër më të mirë. Maz'har Osman për këtë thotë:

“Ata që kanë sjellje si të kafshëve, duke dashur të shkurorëzohen pa arsye ose me pak arsye, edhe po nuk kryhet shkurorëzimi, bashkëshortet dhe familjet e tyre do t'i lëshojnë në mënyra tjera.”²⁷⁹

Jemi të vetëdijshëm, për falsifikimet dhe vendimet e ndryshme që shfrytëzohen për sigurimin e shkurorëzimit duke e dëmtuar palën tjetër në kësi lloj gjyqesh. Shumë herë bashkëshorti (ose njëri ndër bashkëshortët), që të shpëtojë nga një gjendje e vështirë, shfrytëzon trillime, kombinime të ndryshme, dëshmitarë të rrejshëm, që të pranohet kërkesa e tij ose e saj, derisa nuk disponon me argumente të shëndosha ose dëshmitarë të bindshëm. Gjyqet shpesh gjykojnë për alimentacione, të shumtën në favor të gruas, gjë kjo që nuk është e drejtë. Rritet numri i grave të cilat kërkojnë shkurorëzim, e prolongojnë gjykimin, japin dëshmitarë adresat e të cilëve nuk dihen fare ose jetojnë shumë larg, më pastaj sjellin vërtetime të ndryshme që s'kanë kurrëfarë lidhje dhe duke i harruar obligimet e veta familjare, bëjnë jetë të lirë dhe kërkojnë që për këtë jetë shpenzimet t'i paguajë bashkëshorti.

“Nga ana praktike, nuk mund të bëhet asgjë tjetër përveç t’u besohet fjalëve të palës e cila vërteton se nuk mund të jetojë në bashkëshortësi. Nëse mirret parasysh se të gjitha përpjekjet që të ndalin çiftët fatlum, që gjejnë dobi materiale e shpirtërore në dashuri dhe jetë bashkëshortore, ngelën pa sukses, do të ngelë një numër i vogël i bashkëshortëve që do të kërkojnë shkurorëzim pa ndonjë arsye të madhe.”²⁸⁰

Me siguri do të jetë i dobishëm qëndrimi me personin që dëshiron të shkurorëzohet. Të ftohet të mendojë mirë dhe me durim. Të bëhet përpjekje që bashkësia familjare të vazhdojë, kuptohet me fjalë të buta e pajtuese. Këtu, më së miri do të ketë sukses kuvendi familjar që e përbëjnë njerëzit me më tepër përvojë dhe seriozë, nga ata anëtarë të familjeve që gëzojnë respekt.

3) *Shkurorëzimi me kërkesë vetëm të gruas*: Njëra nga mënyrat e shkurorëzimit është ajo me kërkesën e njërit nga bashkëshortët. Është kjo, forma më e lehtë që praktikohet në Rusinë e sotme por që shkakton komplikime të mëdha, pasi që krijon tollovi në nder dhe nga rrënjët i trondit familjet. Ta analizojmë këtë formë të shkurorëzimit nëpërmjet të shqyrtimit të dëshirës së grave e të burrave.

Te francezët e vjetër e drejta e shkurorëzimit i pranohej edhe gruas, në kushte të caktuara. Te romakët, deri sa në fillim shkurorëzimi ishte e drejtë vetëm e burrit, me kalimin e kohës dhe zgjerimin e kurorëzimit pa manus, atë të drejtë e fitojnë edhe gratë.²⁸¹

Kritikë: Edhe pse në shikim të parë na del se gruaja ka atë autorizim që ta prish aktin e kurorës, është e qartë se kjo është gjë e rrezikshme nga aspekti i të drejtës familjare, por nga pikëpamja e gjendjes shpirtërore, ajo, respektivisht personaliteti i saj, shumë shpejt ndryshon. Gruaja që nervozohet nga një imtësi, ndaj edhe mendon se jeta në bashkëshortësi nuk është e mundur, shumë shpejt do të kërkojë të shkurorëzohet.

Sipas së drejtës islame, burri jep mehr për kurorë. Ai bën edhe harxhime të tjera. Ashtu siç ekziston mehr *muaxh-xhel* (pagesë e menjëherëshme), ashtu ka edhe *muexh-xhel* (që pagohet në rast të shkurorëzimit ose vdekjes). Nëse gruaja që don të shkurorëzohet është shtatëzane, burri paguan alimentacion derisa të lind foshnja. Nëse fëmijës i duhet taja, burri duhet të paguajë për të. Pra, burri ka obligime financiare për mirëmbajtjen e familjes sikur të ishte në kurorë. Siç s’është e drejtë që gruaja ta lidhë me obligime financiare burrin sipas tekeve të veta, ashtu, nuk është e drejtë e saj të veprojë në kokë të vet dhe të sillet pa përgjegjësi.

4) *Shkurorëzimi me kërkesë vetëm të burrit*:

Në të drejtën e vjetër turke dhe gjermane, si dhe në fazat e para të së drejtës romake (kurorëzimi me manus) e drejta e shkurorëzimit i takonte vetëm burrit. E njëjta situatë ishte edhe në të drejtën egjiptase dhe babilonase. Në të drejtën islame forma themelore e shkurorëzimit është kjo. Në Kur’an thuhet se lidhja e kurorës është në duar të burrit.²⁸² Në Kur’an, në ajetet që flasin për shkurorëzimin, folja *shkurorëzohem* gjithmonë ka të bëjë me gjininë mashkullore.²⁸³

Kritikë: Burri, sipas natyrës, është më i kujdesshëm se gruaja, më gjakëftohtë. Konsekuencat e sjelljeve të veta i paramendon më mirë. Edhe në kurorëzim edhe në shkurorëzim, sipas të drejtës islame, burri ka obligime financiare. Burri që kërkon shkurorëzim, edhe gjatë shkurorëzimit edhe në kurorën e ardhshme ka shpenzime të ndryshme. Me shkurorëzim, do ta shkatërrojë shtëpinë e vet, e fëmijët dhe punët shtëpiake do t’i lejë pasdore.

Burri mund të gabojë. Mund të shkurorëzohet befaz, pa pasur nevojë, me një vendim të papritur. Kur mendon se vazhdimi i një jete në kurorë është i rrezikshëm dhe kur vëren se dashuria dhe lidhjet me bashkëshorten janë dobësuar, atëherë do të shfrytëzojë autorizimin e vet për

shkurorëzim. E përse gruaja të mos i ketë të drejtat e veta që, kur të vërejë të njëjtën gjë, të veprojë si burri? Është kjo pyetje, gjithsesi me vend. Do të mundohemi t'u japim përgjigje në titujt që vijojnë: *“Llojet e shkurorëzimit”* dhe *“Shkurorëzimi i gruas në këmbim me mehrin”*.

Të përkujtojmë se individi në Islam është i rrethuar me obligime juridike dhe materiale. Obligimi më i madh është ai se një ditë do të përgjigjet para All-llahut për të gjitha ato që ka bërë. Individi është i bindur se ajo ditë do të vijë patjetër. Faktikisht, kjo rrjedh nga bazat e imanit dhe pa të, nuk mund të jesh mu'min (besimtar). Kurora, është një e drejtë hyjnore midis njerëzve. Në Kur'anin Famëlartë kurorëzimi quhet *“hududullah: kufinj që i cakton All-llahu”*. Kjo shprehje theksohet shpeshherë në ajetet që bëjnë fjalë për shkurorëzimin dhe urdhërohet që këta kufinj të mos tejkalohen, e ata që i tejkalojnë trajtohen si zullumqarë.²⁸⁴

Disa shprehje që disa herë përsëriten janë si vijon:

“...dhe keni frikë All-llahun, e dini se All-llahu është i Gjithëdijshëm për çdo send.”

“...e kush i frikësohet All-llahut, Ai atij ia lehtëson punën”²⁸⁵

Në Kur'an shpallet gjithashtu se sa janë këshilluar ata njerëz që i besojnë All-llahut dhe Ditës së Gjykimit, të sillen mirë me gratë me të cilat do të shkurorëzohen dhe të dëgjojnë porosinë e All-llahut lidhur me këtë çështje.²⁸⁶

All-llahu i Lartësuar pa dyshim di më së miri për çdo punë të njeriut, për çështjen e shkurorëzimit thotë:

“E kur t'i keni lëshuar gratë, dhe ato i afrohen afatit të tyre, a atëherë ose i mbani si duhet, ose i leni si duhet, e mos i mbani sa për t'i dëmtuar, e të bëheni të padrejtë. E kush bën atë, ai e ka dëmtuar vetveten. Dispozitat e All-llahut mos i merrni për shaka.”²⁸⁷

Akademiku M. Reshid Belgesay, pas fjalës lidhur me autoritetin që i është dhënë burrit në shkurorëzim, në të drejtën islame, thotë:

“Por në gjykimin që e solli e drejta islame, nuk i jepet shumë hapësirë keqpërdorimit në praksë, meqë parimet sociale, etike dhe fetare që ishin më të fuqishme se ligjet për organizimin e marrëdhënieve familjare, llogarisnin se është mëkat dhe turp që burri ta lëshojë gruan pa arsye, e në anën tjetër, nëse ekzistonin arsye të rëndësishme, do ta detyronin që të aprovojë kërkesën e gruas për shkurorëzim.”²⁸⁸

Që të pengohet shfrytëzimi i autoritetit për shkurorëzim nga ana e burrit kundër gruas, janë marrë disa masa, në të drejtën islame. P.sh. nëse burri që gjendet para vdekjes e lëshon gruan dhe nëse vdes para se të përfundojë iddeti (koha që gruaja duhet të presë për rimartim pas shkurorëzimit iddeti varet nga situata, mund të zgjasë edhe tetë ose nëntë muaj) në këtë rast do të llogaritet se ai (burri) bën dredhi që gruan ta lë pa miras, dhe gruaja bëhet trashëgimtare. Në kesi lloj rastesh merret parasysh iddeti më i gjatë se ai që u theksua (është ky në dobi të gruas për ta fituar trashëgiminë). Por, për të njëjtën kohë, nëse vdes gruaja e burri është ai që dëshiron të shkurorëzohet, atëherë burri nuk mund të jetë trashëgues i saj, pasi ai, duke e shfrytëzuar autoritetin e vet për shkurorëzim, e ka humbur të drejtën për trashëgim.²⁸⁹

Nga ky shpjegim i shkurtër, kuptohet se njeriu i cili i drejtohet Islamit dhe edukohet nga ai, është njeri i pjekur, i ndijshëm, i drejtë, i sinqertë dhe i ndërgjegjshëm në tërësinë e vet. Në kohën kur Islami praktikohet totalisht, njerëzit e këtillë ishin njerëz të rëndomtë nga rradhët e

qytetarëve. Prandaj, nuk kemi të drejtë ta ngarkojmë e ta fajësojmë Islamin, për shkak të keqpërdorimeve dhe akteve të këqia që i bëjnë individët në shoqëritë që kanë ngelur prapa dhe janë ligështuar nga të gjitha palët e korruptuara si nga aspekti fetar ashtu edhe në fusha tjera.

Autorizimi i gruas për shkurorëzim

Juristët e Islamit kanë argumentuar se e drejta e shkurorëzimit mund t'i jipet edhe gruas. Por, midis tyre, ka edhe mendime të ndryshme. Në kryerjen e aktit të kurorës, burri që ka autorizim për shkurorëzim, mund që gruas t'i jep të drejtë shkurorëzimi kur të dëshirojë vetë ajo. Kjo quhet “*tefviz*”. Burri mund ta japë këtë të drejtë edhe pas aktit të kurorëzimit. Ai do të përcaktojë dhe do të vërtetojë formën e shkurorëzimit dhe numrin e shprehjeve për shkurorëzim. Gruaja mund ta shfrytëzojë këtë të drejtë vetëm në kushte të caktuara. Burri nuk mund ta tërheq autorizimin që ia ka dhënë gruas.²⁹⁰

Por, as gruaja nuk duhet ta keqpërdor autorizimin për shkurorëzim. Pejgamberi a.s. thotë:

“Cilado grua që dëshiron të shkurorëzohet pa nevojë, asaj do t'i jetë haram era e Xhennetit.”²⁹¹

A mund t'i jepet autorizim shkurorëzimi personit të tretë

Burri që bartë të drejtën e shkurorëzimit, mund të autorizojë për këtë të drejtë edhe ndonjë tjetër përveç gruas së vet. I autorizuari sillet sipas udhëzimeve të autorizimdhënësit. Burri edhe pse nuk mund ta tërheq autorizimin për shkurorëzimin e gruas, mund ta largojë personin e tretë të autorizuar.²⁹²

A mundet personi i tretë, që burri nuk e ka autorizuar, të ketë autorizim për shkurorëzim? Më drejtë gjykatësi dhe arbitrat, a kanë të drejtë ta bëjnë shkurorëzimin? Kur definohet dhe shpjegohet talaku (ndarja) në librat e së drejtës islame, anulimi i kurorës përdoret në vend të shkurorëzimit.²⁹³ Por kjo ndodh në raste të veçanta e të domosdoshme, si paraqitja e gruas tek gjykatësi për shkak të gabimeve dhe fajeve të burrit, ose aprovimi i Islamit nga gruaja e mos aprovimi nga burri.²⁹⁴

A janë të autorizuar arbitrat t'i shkurorëzojnë bashkëshortët midis të cilëve mbretëron disharmoni? Në realitet, ata janë të njohur me pozitën e të dy palëve meqë janë nga familjet e tyre. Në këtë këshill familjar nuk ekziston frika e daljes së sekretit në shesh, si sekretet e kurorës, si ato të cilat duhet të shfaqen në gjyq. Por, shumica e drejtëve juridike islame mendojnë se arbitrat kanë për detyrë vetëm të venë paqen, e nuk kanë autorizime për shkurorëzim, meqë ky autorizim i është dhënë në mënyrë të qartë burrit në ajetet dhe hadithet. Por, malikijtë ua pranojnë të drejtën e shkurorëzimit edhe arbitërve. Në ajetin e sures en-Nisa, bëhet fjalë për caktimin e arbitërve nga ana e gjykatësit. Nëse arbitrat mendojnë se pajtimi është i pamundshëm, do të sjellin vendim për shkurorëzim, dhe ky vendim do të jetë valid. Taberiu, Ibën Kethiri dhe Shevkani, në tefsiret e tyre japin argumente të qarta të cilët do t'i aprovojnë mendimet e malikijve. Madje, Ibën Kethiri, vërteton se shumica e dijetarëve islam (xhumhuri) ka pranuar që vendimet e arbitërve për shkurorëzim të jenë valid edhe pse bashkëshortët nuk i kanë autorizuar ata.²⁹⁵

Këtu qëndron edhe një çështje që duhet kushtuar vëmendje. Kryetari i shtetit Islam mund të lejojë që të bëhen disa punë e disa tjera t'i ndalojë që t'i mundësojë ca të mira për opinionin ose t'i evitojë ca të këqia. Duke u mbështetur në këtë parim, a mund të mirret e drejta për shkurorëzim nga burri ose a mund t'i japë një formë tjetër shkurorëzimit? Shikuar nga këndi i së drejtës islame përgjigjen duhet dhënë - jo. Meqë, kryetari i shtetit islam ka një autorizim të këtillë vetëm për çështjet për të cilat nuk ekziston gjykimi. Në Kur'an, marrja e një të drejte nga pronari i saj, e që është konstatuar nga argumente definitive, do të thoshte anulim i atyre argumenteve. E këtë të drejtë nuk e gëzon asnjë qenie e gjallë. "Ku do të ketë rrebelime kundër Krijuesit, aty nuk dëgjohen robërit e tij", Është shpallur haptazi në Kur'an, se shkurorëzimi i takon burrit. Por, mund të intervenohet në këtë autorizim të burrit në kushte të caktuara, si ato të lartpërmendura.²⁹⁶

Llojet e shkurorëzimit

Në të drejtën islame, shkurorëzimi ndahet në disa forma. Këtu do të ndalemi në ndarjen e shkurorëzimit sipas kategorive. Kjo ndarje është ose “*sunni*” ose “*bid’i*”. Ndarja sunni është ajo që i përgjigjet sunnetit. Këtu sunneti don të thotë “*rrugë*” që duhet ndjekur në shkurorëzim e që është urdhëruar nga ana e Zotit e nuk don të thotë sunnet, kryerja e së cilës ka shpërblim (sevap). Meqë shkurorëzimi është një akt që s’i sjell të mirë askujt, është i lejuar vetëm nga nevoja ose domosdoshmëria. Shkurorëzimi bid’i, është ai që kryhet kundër rregullave të urdhëruara fetare dhe nuk i përgjigjet sunnetit.²⁹⁷

Ndarja sipas sunnetit

Shkurorëzimi është ndarje me gruan, me të cilën është hyrë në gjerdek, në periudhën e pastërtisë (periudhën e kaluar midis menstruacioneve), periudhë në të cilën nuk hulet në marrëdhënie seksuale me një talak. Nga marrëdhëniet që ekzistojnë midis bashkëshortëve, talaku i dytë është në periudhën e dytë të pastrimit, ndërsa talaku i tretë dhe i fundit bëhet në periudhën e tretë të pastrimit. Gjithashtu me nga një “*rixh’i talak*” në tri periudhat e pastrimit, që zgjasin gati tre muaj, forma e shkurorëzimit quhet “*sunni hasen* - shkurorëzim i mirë sunni. *Rixhi - talak*, don të thotë talak ose ndarje nga e cila mund të hiqet dorë po u dëshirua kjo. Ekziston edhe një formë që quhet “*sunni ahsen*: shkurorëzimi më i mirë sunni”. Pas dhënies se një talaku në një periudhë të pastrimit, duhet pritur që gruaja të pastrohet pas tri menstruacioneve, e mëpastaj të jipet talaku i dytë. Përsëri priten tre menstruacione dhe jipet talaku i tretë. Normalisht, nuk hyhet në marrëdhënie seksuale derisa zgjat ky proces. Mënyra e këtillë e shkurorëzimit zgjat rreth nëntë muaj.

Talaku që nuk i përgjigjet sunnetit (bid’i)

Ky shkurorëzim është në kundërshtim me talakun sunni. Me një grua që është në gjerdek ose gjatë menstruacionit ose në një periudhë të pastrimit, nëse jepet talak, kjo është kundër sunnetit. Veç kësaj talaku bid’i, është ai talak që jipet më shumë herë në të njëjtën periudhë të menstruacionit ose atë të pastrimit.²⁹⁸ Tani të flasim për rëndësinë e një ndarjeje të këtillë.

All-llahu xh.sh. autorizimin për shkurorëzim ia dha burrit dhe shpalli mënyrën si duhet të shfrytëzohet ky autorizim. Urdhërat e All-llahut për këtë çështje detyrojnë që talaku të jetë sipas sunnetit.²⁹⁹ I biri i ‘Umerit e shkurorëzoi gruan në periudhën e menstruacionit, dhe kur ‘Umeri ia

përshkroi situatën Pejgamberit a.s., ai udhëroi që të kthehet te gruaja sepse nuk e ka bërë shkurorëzimin sipas sunnetit, dhe nëse dëshiron që rishtas ta shkurorëzojë, ta bëjë ashtu siç i përgjigjet sunnetit.³⁰⁰

Arsyeja që të mos mund të bëhet shkurorëzimi gjatë menstruacionit që, sipas talakut sunni është forma normale e shkurorëzimit në Islam, është era jo e këndshme që kundërmon nga trupi i saj, derisa ndodhin ca ndryshime në metabolizmin e gruas, dhe, për këtë shkak gjendja e gruas është jo e kënaqshme nga aspekti seksual. Ndaj, burri nuk është aq i kënaqur me gruan gjatë menstruacionit dhe lehtë mund të shkurorëzohet.

Shkaku për moslejimin e shkurorëzimit në një periudhë të pastrimit, kur është hyrë në marrëdhënie seksuale, është se burri, nuk do të jetë aq i disponuar ndaj gruas. Pas marrëdhënieve, tek ai do të paraqitet njëfarë ftohje ndaj gruas dhe atëherë shumë shpejt mund të kërkohet shkurorëzimi. Duket se psikikisht është zgjedhur koha kur burri është më së shumti i disponuar për gruan, ndaj është shkuar në pengimin e shkurorëzimit deri në një shkallë të mundshme.

Mënyra më e mirë e shkurorëzimit, që i përgjigjet sunnetit, mund të bëhet gjatë rreth nëntë muajve. Derisa zgjat ky proces, burri, nëse dëshiron, mund të heq dorë nga shkurorëzimi dhe të kthehet tek gruaja që të vazhdojë jetën bashkëshortore. Burri nuk mundet të japë asnjë talak më tepër në një periudhë të pastrimit. Ja këtu takohemi me “rastin për t’u menduar, që është dobia e vetme e shkurorëzimit me anë të gjyqit. Kështu i japim përgjigje pyetjes “mundësia që burri të shkurorëzohet me një vendim të paparamenduar mirë” që theksuam më lart në titullin “*Llojet e shkurorëzimit*”.

Imamët e medhhebeve u pajtuan se bid’i talaku është haram dhe rrebelim kundër vullnetit të All-llahut.³⁰¹ Ndaj, kthimi i burrit tek gruaja që e shkurorëzoi me bid’i talak është farz sipas hanefijve dhe malikijve. Sipas këtyre të fundit, nëse nuk dëshiron të kthehet, do ta detyrojë gjyqi.³⁰² Nëse përsëri nuk dëshiron të kthehet gjykatësi do të vendosë për kthimin në emër të tij edhe pse ai mund të presë gjobë me qëllim që burri të kthehet. Por, nëse talaku bid’i, edhe pse është haram, bëhet nga ana e burrit, edhe pse përfundon tri herë talaku, a do të jetë kjo valide? A do të realizohet kjo nga pikpamjet e së drejtës? Ta zbërthejmë këtë çështje në një mënyrë më të qartë: A është realizuar shkurorëzimi i bërë në një periudhë të pastrimit, në të cilën është bërë dashuri ose në një periudhë të menstruacionit, edhe pse kjo është haram? Pastaj, a do të numërohet talaku i një njeriut një ose më tepër, sa e ka përsëritur, madje ky të ketë ndodhur në një periudhë të pastrimit, kur nuk është bërë marrëdhënie seksuale?

Prej kohës së as’habëve dhe tabiinëve deri në ditët tona, thuaja të gjithë juristët islamikë mendojnë se, edhe pse është haram talaku bid’i, ai përsëri bëhet. Këtu vërejmë edhe një herë se në të drejtën islame, obligimet materiale kompletohen me detyrime shpirtërore dhe se bashkohen të drejtat që i takojnë All-llahut dhe ato që u takojnë njerëzve. Autorizimi për shkurorëzim është tek burri, edhe pse është bid’i, burri e shfrytëzon autorizimin e vet. Vetëm një cilësi që i shtohet mënyrës së shfrytëzimit të këtij autorizimi (që ai shkurorëzim është bid’i) këtë e ka vënë në haram. Por, kjo cilësi nuk e anulon të drejtën e tij dhe as vlefshmërinë. I gjason kjo, faljes në një copë toke që është grabitur në mënyrë të padrejtë nga të tjerët, ose tregëtisë së njeriut pas ezanit të namazit të xhumasë edhe pse atij i është farz namazi i xhumasë. Edhe pse është haram edhe plaçkitja e tokës së huaj edhe tregëtia gjatë faljes së xhumasë, këto juridikisht janë të lejuara.

Në realitet Ibën Tejmije, Ibën Kajjim, Ibën Hazm, Shevkani dhe disa shkencëtarë tjerë, dhe, ca shkencëtarë egjiptas të kohës së fundit si Amed Shakir, vërtetojnë se juridikisht nuk është realizuar shkurorëzimi bid’i. Me siguri, me ndikimin e këtij drejtimi shkencor në ligjin për të

drejtat personale (ahvali shahsije) që u soll nga shteti egjiptas në vitin 1929 nr. 25, parashikohet se do të numërohet vetëm një talak nëse në të njëjtën kohë janë dhënë dy ose tre talakë. (Neni 3)

Por, kjo gjë që rrjedh nga kohërat e vjetra, me argumente të fuqishme është hedhur, dhe nga pikëpajmet shkencore ngeli vetëm, si mendim i disa personave. Një vepër e rëndësishme është “*El-ishfak ala ahkami't-talak*” e Zahid el-Kevtheriut, i cili nuk e pranon veprën “*Nizamu't-talak*” të egjiptasit Kadi Ahmed Shakir dhe të përkrahësve të tij. I ndjeri, profesori Kamil Miras, thotë se ky, mendimi i dytë, në pikëpamje shkencore është shumë i dobët.³⁰³ Veç këtyre, tema jonë e ruan cilësinë, të jetë një çështje për të cilën duhet menduar, çështje kjo që ka të bëjë me fatin dhe unitetin e familjes.

Disa çështje të rëndësishme

Njeriu duhet të jetë mendjehollë edhe në moshën e paspubertetit që të mund të jetë i pjekur për ndalesat dhe urdhërat e fesë Islame. Një gjë relevante që kërkohet në tubimet dhe në sjelljet e përgjegjësive është nijjeti (qëllimi), për të cilin flet edhe hadithi që është njëri ndër parimet më të forta të fesë Islame e që përmendet në hadithet që përcillen nga i Dërguari a.s.:

“Veprat maten nga nijeti. Secilit do t’i jepet ajo që e meriton sipas nijetit.”³⁰⁴

Pas theksimit të këtyre bazave, të ndalemi në disa çështje më të rëndësishme:

1. Nuk është valid shkurorëzimi i të çmendurit si dhe i njeriut që vuan nga skleroza. Shkurorëzimin që e kanë kryer ata, me ligj llogaritet sikur të mos jetë bërë, meqë nijjeti (qëllimi dhe dëshira) ka munguar tek ata.

2. Shkurorëzimi me dhunë dhe me detyrim. Hanefijtë mendojnë se shkurorëzimi në këtë mënyrë është valid. Ndërsa sipas shafiijve, ky shkurorëzim nuk është valid. Kështu mendojnë edhe malikijtë dhe hanbelijtë, meqë sipas të drejtës nuk mund të ketë vlerë, pasi që është bërë nga frika, pa qëllim e dëshirë (nijjet) të njeriut.

Në fazën e parë të Islamit, idhujtarët i torturonin muslimanët që i zinin. U kanoseshin me vdekje dhe i detyronin të shprehen kundër fesë Islame. Ammari r.a., e ëma dhe i ati i të cilit ishin vrarë para syve të tij, nën ndikimin e këtyre torturave, që ta shpëtojë jetën e vet, ua plotësoi dëshirën mushrikëve. Por, në rastin e parë, pas shpëtimit nga duart e tyre, shkoi tek i Dërguari a.s. dhe ia shpjegoi tërë ngjarjen. Kështu, më pastaj zbriti ajeti 106 i sures en-Nahl. Në këtë ajet theksohet se nuk do ta dëmtojë askë që do të jetë i detyruar që me dhunë të flasë kundër All-Illahut xh.sh., nëse e ka zemrën të mbushur me iman dhe me të është i qetësuar. Kur imani nuk është i dëmtuar nën dhunën dhe detyrimin, në analogji me këtë nuk është valid as shkurorëzimi. Në Turqi, në kohën e Sultan Reshatit, ligji për të drejtën familjare theksonte se “talaku i bërë me anë të dhunës nuk është valid.” (Neni 105)

3. Talaku i pijanecit: Nuk është valid shkurorëzimi që është bërë nën ndikimin e mjeteve për dehje që nuk janë të ndaluara me fenë, siç është mjalti. Me përdorimin e mjeteve për të cilat nuk e din se do të bëjnë të dehur ose me detyrimin e përdorimit të tyre, shkurorëzimi s' do të vlejë, meqë njeriu i dehur, përkohësisht është si i çmendur. Atyre, që mendja dhe drejtpeshimi nuk u janë në rregull, as aktet nuk u janë juridikisht të drejta. A do të vlejë shkurorëzimi për një njeri që me dëshirë të vetë është dehur, gjë kjo që në pikëpamje fetare është e ndaluar? Një grup tabiinësh, Imam Ebu Hanife, Imam Maliku, Imam Shafiu, një shkurorëzim të këtillë e llogarisin si të drejtë, ose thënë ndryshe, legal. Përkundër kësaj Osmani, Kerhi nga hanefijtë sipas rivajetit nga Ibën Abbasi, Tahaviu, Imam Zuferi, Muhammed b. Seleme si dhe sipas një transmetimi të Imam Ahmedit, nuk e llogarisin shkurorëzimin e njeriut të dehur si shkurorëzim valid. Në nenin 104 të ligjit për të drejtën familjare theksohet e njëjta gjë. Ibën Tejmijje, Ibën Kajjim, Ibën Hazm dhe Shevkani janë të njëjtit mendim.

4. Shkurorëzimi në gjendje të zemëruar: Është valid shkurorëzimi që njeriu e bën në gjendje të zemëruar me ose pa të drejtë, por nëse nuk e ka humbur vetëdijen nga ky zemërim i butë. Por, nëse zemërimi është i madh, nëse ai flet pa lidhje si i dehur, njeriut të këtillë nuk i pranohet shkurorëzimi, meqë në atë moment as mendja dhe as sjelljet e tij nuk bëhen me dëshirën e vërtetë të tij.

Profesori Kamil Miras, pas shqyrtimit të çështjes, shkurorëzimi me dhunë, në gjendje të dehur, dhe shkurorëzimi me zemërim, thotë kështu:

“Do të jetë akt në kufinjë shkencor, që të shërohet një plagë sociale në botën islame, duke thënë: Asnjë shkurorëzim nuk vlen dhe duhet të vazhdojë jeta familjare.”

Duke e aprovuar situatën e një njeriu i cili para shoqërisë do t'i shprehë me një fjalë të tre talakët në një krizë nervore, nëse ai pranon se kjo fjalë e nxjerrur nga goja e tij është si fjalë e një të çmenduri, e thënë pa dëshirën e tij, pa vetëdijen e tij, i shqetësuar, në kushte që këtë ta përsërisë para opinionit, kjo gjë don të thotë se ato fjalë nuk merren parasysh dhe jeta familjare vazhdon.³⁰⁵

5. Shkurorëzimi për shkak të gabimeve: Njëri ndër kushtet e shkurorëzimit është ekzistimi i qëllimit që shprehet talaku (dëshira për t'u ndarë) nga ana e bashkëshortit. Shkurorëzimi nuk do të bëhet me një shprehje të gabuar, duke dashur të thuhet diçka tjetër. Në ajete dhe hadithe është shpallur se robi nuk është përgjegjës për punët e bëra gabimisht ose në harresë.³⁰⁶

Shkurorëzimi i shprehur me tallje është valid, sipas hanefijve dhe shafijve. Pasi nuk ekziston arsye që të vërtetohet një shkurorëzim i këtillë, nuk mund të ketë tallje dhe argëtime në çështje të këtilla serioze, siç është talaku. Ndërsa Imam Maliku dhe Ahmedit thanë se nuk është valid, sepse s'ka pasë për këtë një nijet serioz.³⁰⁷

Shkurorëzimi i gruas në këmbim me mehrin e vet

Nëse burri mendon se s'është i mundur vazhdimi i kurorës, mund ta përfundojë atë, që don të thotë do ta shfrytëzojë të drejtën për shkurorëzim. Por, a ka gruaja, vallë të njëjtën të drejtë, kur të bindet se nuk është e mundur jeta bashkëshortore? Këtu takohemi me “muhalaa” në të drejtën islame. Hul ose muhalaa është shkurorëzimi i gruas në këmbim me mall... Mehri që gruaja e fitoi gjatë aktit të kurorëzimit prej bashkëshortit të saj, mësuam se i takon vetëm asaj. Burri asgjë nuk mund të marrë nga ai. Gruaja mund të kërkojë shkurorëzim, kur të bindet se nuk ka fare mundësi për vazhdimin e jetës bashkëshortore, duke i dhënë një pjesë të mehrit ose krejt atë burrit të vet. Nëse mirret vesh me burrin, shkurorëzimi është valid. Sipas malikijve, nëse gruaja nuk mund të jetojë më me burrin dhe, nëse paraqitet te gjykatësi për shkurorëzim, ky do të vendosë për shkurorëzim, me kusht që ajo t'i japë burrit një pjesë ose tërë mehrin.³⁰⁸

Sipas shpalljes në Kur'an nuk është hallall që burrat t'a marrin mehrin nga gratë. Atëherë kur u ka humbur shpresa që t'i plotësojnë dispozitat e kurorës, shkurorëzimi nuk është mëkat as për njërën nga palët.³⁰⁹ Gruaja e Thabit b. Kajsit, nga as'habët, erdhi te Pejgamberi a.s. dhe tha:

-O i Dërguar i All-llahut, s'kam asgjë kundër besimit dhe natyrës së burrit tim, por nuk po mundem ta duroj (ta dashuroj). Si një muslimane, nuk dëshiroj të jem shpirtligë (frikësohem nga mosplotësimi i obligimeve të mia ndaj tij, meqë assesi nuk mund ta dashuroj). Muhamedi a.s. i tha:

-A dëshiron t'ia kthesh kopshtin e tij (që ta kishte dhënë si mehr)- dhe kur u përgjegj ajo:

-Po, - Pejgamberi a.s. i urdhëroi burrit të saj:

-Pranoje kopshtin dhe shkurorëzohu”.³¹⁰

Po që shkak i shkurorëzimit muhalaa, ose nëse mosmarrëveshja ka filluar nga ana e burrit, ai duhet të ndahet pa e marrur mehrin. Po nëse e ka gruaja, burri do ta shkurorëzojë pa marrë më shumë nga mehri, sa e ka caktuar ai vetë gjatë kurorëzimit.

Është haram që burri ta detyrojë gruan të kërkojë shkurorëzim me qëllim të këmbimit me mall e as ta keqtrajtojë. Sipas hanbelijve, një muhalaa e këtillë nuk është valide.³¹¹

f F

V. Ç'është hul-le (tahlil)

Shkurorëzimi absolut do të bëhet kur të shkëputen tri lidhjet (tre shprehjet e talakut), që llogariten se ishin midis bashkëshortëve. Pas kësaj, për njëri tjetrin, gruaja dhe burri janë të huaj. Sipas të drejtës islame, këta nuk mirren rishtas.

Të përmendim edhe një herë se në Islam kurora themelohet në bazë të dashurisë dy palëshe, të paqës dhe mirëkuptimit. Kurora e përkohshme nuk është valide. Qëllimi i kurorës është bashkësia familjare, kujdesi ndaj fëmijëve, çështje këto që i respekton Islami. Çiftet që bëjnë shkurorëzim, na realitet e braktisin begatinë e kurorës, duke mos i marrë parasysh qëllimet e larta të saj. Si dënim për këtë, ata nuk mund të kurorëzohen përsëri. Martesa e sërishme midis palëve të njëjta, pas shkurorëzimit, pa kurrfarë pengese, do të smadhonte numrin e shkurorëzimeve. Palët mund të shkurorëzohen për ndonjë arsye të vogël, duke menduar se mund të merren përsëri pasi të pendohen. Me kohë ata kanë krijuar familje, kanë provuar njëri tjetrin e në fund janë shkurorëzuar, duke menduar se nuk mund ta vazhdojnë jetën bashkëshortore. Tani nuk është me vend martesa e sërishme e palëve të njëjta, para se të fitojnë edhe një përvojë, dhe para se të “piqen” edhe pak.

Në të drejtën bashkëkohore, gjykatësi do t'ia pengojë martesën për një kohë të caktuar, palës fajtoje për shkurorëzim një ose dy vjet.³¹²

Por, burri që është shkurorëzuar nga gruaja, duke e shfrytëzuar autorizimin e vet, nuk mund të marrë të njëjtën grua përsëri.

Por, nëse gruaja martohet me një burrë tjetër qoftë edhe një ditë, pasi të ndahet prej tij, ose ai vdes, pas pritjes së iddetit të duhur, mundet ta marrë bashkëshortin e parë. Në Kur'an thuhet:

“E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë (për herë të tretë), pas atij (lëshimi) nuk i lejohet më që ta kurorëzojë, derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e lëshon atë, atëherë për ata të dy, poqese mendojnë se do t'i zbatojnë dispozitat e All-llahut, nuk ka pengesa të rikthehen (në bashkëshortësi). Këto janë dispozitat të All-llahut që ia sqarojnë një popullit që kupton.”³¹³

Sipas këtij ajeti, gruaja e shkurorëzuar tri herë nga ana e burrit (me tre talakë), do t'i jetë hallall të njëjtit njeri vetëm pas kurorës me një njeri tjetër. Pra martesa e gruas së ndarë me burrë tjetër do ta bëjë martesën me burrin e parë hallall.

Mendimet e juristëve Islam lidhur me hul-len

Ajeti që e cekem më lartë, flet qartë se në të drejtën islame gruaja që është është ndarë nga burri, do të jetë hul-le nëse ndahet nga burri i dytë dhe përsëri mund të mirret me burrin e parë. Së pari të përmendim disa hadithe lidhur me këtë çështje. Abdullah b. Mes'udi thotë:

“I Dërguari i All-llahut e mallkon atë që bën hul-le dhe për të cilin bëhet hul-le.”³¹⁴

E i Dërguari a.s. thotë:

“Dëshironi t’ju lajmëroj kush është çjap i huazuar?” kur i thanë - po, o i Dërguar i All-llahut, ai shtoi: -Është njeriu që bën hul-le. Atij që bën hul-le dhe për atë për të cilin bëhet hul-le, All-llahu le t’i mallkojë.”³¹⁵

Hazreti ‘Umeri ka thënë:

“Nëse më sjellin dikë që bën hul-le, dhe atë njeri të cilit i bëhet hul-le, do t’i dënoj me vdekje duke i qëlluar me gurë.”

E pyetën Abdullah b. ‘Umerin:

Nëse një tjetër e merr gruan e njëjtë përkohësisht, që t’i bëhet hallall atij që e ka lëshuar por që është pënduar, ç’duhet të bëjë? E ai u përgjigj kështu: Që të dy janë prostitutë bile edhe nëse jetojnë njëzet vjet bashkë.³¹⁶

Iu drejtua edhe një pyetje së cilës i dha këtë përgjigje:

Një kurorëzim i këtitllë, artificial, nuk do të jetë i pranueshëm, për gruan dhe nuk do t’ia bëjë hallall burrit të parë. Këto punë ne i llogarisim si zina në kohën e Pejgamberit a.s.³¹⁷

Nga shpjegimet e deritanishme, kuptohet se kurorëzimi në mënyrë artificiale, dhe me tahlil është haram, i ndaluar. Ç’mund të jetë punë më e keqe se ajo që e ka mallkuar i Dërguari a.s.?

Në vazhdim t’i shqyrtojmë mendimet e medhhebeve:

Të gjithë juristët ndajnë mendimin se gruaja që nuk ka hyrë në gjerdek me burrin e dytë ose nëse vdes ai para se të shkurorëzohen, nuk do të mundet të rimartohet me burrin e parë.³¹⁸ Medhhebet janë bashkuar rreth mendimit se një grua e martuar nuk do t’i bëhet hallall burrit të parë edhe pse është dhënë kusht për hul-le gjatë kurorëzimit të saj të dytë, edhe sikur të ishte thënë kjo gjë s’është valide për drejtësinë, meqë kjo është një dredhi. Nuk ndryshon nga kurora e përkohshme. E kurora e përkohshme sipas mendimit të përgjithshëm është kurorë e rrejshme, jo e drejtë.³¹⁹ Sipas juristëve malikij dhe hanbelij, kurora është valide, nëse nijet për hul-le pati nga dy palët, edhe pse kjo nuk u theksua gjatë

kurorëzimit.³²⁰ Sipas Imami Shafi, si dhe një rivajeti nga Ebu Hanife, akti i bërë me kusht që mos të theksohet tahlili, është valid pa marrë parasysh ç'nijet do të ketë. Pas gjerdekut, burri, po të dëshirojë mund të vazhdojë të jetojë me gruan, e po deshti, mund ta lëshojë atë. Në mendime të këtilla dominon parimi që të jipet gjykim vetëm për situatën që duket edhe nuk mirret parasysh nijeti. Kjo don të thotë se kur një proces i tillë do të shtrohet para gjykatësit, ai do t'i shikojë argumentet materiale dhe do të vendos se kurorëzimi është i shëndoshë, nëse në aktin e kurorëzimit nuk është vënë kusht për tahlil. Gjykatësi nuk është përgjegjës për zbulimin e qëllimeve që dy palët i fshehin në zemër. Por, Imami Muhammed dhe Ebu Jusufi nga hanefijtë, mendojnë se nuk është valide kurora me qëllime të hul-les madje edhe nëse ekziston vetëm nijeti. Në realitet, një e thënë që vjen nga Ebu Hanife, e thotë gati të njëjtën gjë - se një kurorë e këtillë nuk do të ishte e shëndoshë. Sipas një të thënë të tretë, Imami Azam, thotë se kurora është e shëndoshë, por kushti për hul-le është i padrejtë.³²¹

Rezyme

Në të drejtën islame, e drejta e ndarjes normale është pranuar për burrin. Por, janë marrë masa të ndryshme që të mos shfrytëzohet kjo e drejtë pa nevojë ose të bëhet me trillime të ndryshme. Njëra ndër këto masa, është ndalimi i martesës së sërishme me gruan e shkukurëzuar. Por, mund të martohen përsëri nëse gruaja martohet me një burrë të dytë dhe nëse ndahet nga ai, ose ai vdes. Pas kalimit nëpër një fazë të këtillë të përvojës, pas të menduarit të gjatë dhe “vendimit për mbrojtjen e bashkësisë bashkëshortore martesë ndërmjet tyre bëhet e lejuar.”³²² Por, nëse ndodh që kurora e dytë e gruas të shkukurëzuar të jetë me një ujdj (muvazaa), dredhi dhe kurorëzim artificial, kjo do të jetë “tahlil” (hul-le). I Dërguari a.s. i ka mallkuar ata njerëz që bëjnë hul-le. Atë që bën hul-le e ka quajtur “cjap i huazuar, njeri i mallkuar.” ‘Umeri dhe i biri i tij Abdullahu, e kanë pranuar hul-len si zina dhe thanë se dënim të njëjtë do të aplikojnë për të. Edhe drejtimet juridike, me shumë argumente, kanë prurë vendim se hul-le është haram, dhe kanë dhënë mendime të ndryshme nga pikëpamja e argumenteve materiale me të cilat do të merret gjykatësi, e këto nuk e ndryshojnë faktin se hul-le është haram.³²³

Veç kësaj, sipas të drejtës islame, një grua e ndarë nga burri duhet të presë iddet para se të ketë të drejtë të martohet me një burrë tjetër. Një pritje e këtillë zgjat mesatarisht tre muaj (tri periudha pastrimi). Nëse gruaja është shtatëzane, duhet të pres deri në lindje të fëmijës.³²⁴ Ndaj nëse dëshirohet të shkatërrohet kjo formë e mallkuar e shkukurëzimit, duhet pritur pas ndarjes me burrin e parë tre muaj, dhe ndarjes nga burri i dytë, përsëri tre e më shumë muaj, e më pastaj mund të bëhet martesë me burrin e parë. S'është puna për një natë, siç mendojnë disa. Veç kësaj nuk numërohet kurorëzim vetëm një akt, ose ngelja vetë në dhomë për disa orë. Kushti kryesor është që burri i dytë të mos jetë impotent, fëmijë, plak ose i sëmurë. Në kohën e Pejgamberit a.s., një grua që dëshironte t'i kthehet burrit të parë, për shkak të moskënaqjes me burrin e dytë, nga i Dërguari i All-llahut nuk e fitoi lejen. E këtu nuk është fjala për ndonjë dredhi të saj, por e tërë kjo mbështetet në mos kënaqjen seksuale nga burri i dytë.³²⁵

8 8 8

VI. Gruaja në trashëgimi

“Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që e lënë prindrit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit, le të jetë pak ose më shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti).

Kur’ani (4): 7

Trashëgimia dhe gruaja para Islamit

Tek egjiptasit e vjetër edhe vajzat edhe djemtë barabartë i trashëgonin etërit e tyre. E djalit më të madh i takonte pak më shumë.³²⁶ Sipas ligjeve të Hamurabit, pasuria e babait ndahej midis djemve ndërsa vajzat nuk mund të trashëgonin gjë.³²⁷ Në të drejtën kineze, nga fillimi, vajzat nuk mund të trashëgonin. Më pastaj u bë një ndryshim me të cilin vajzave u pranohej kjo e drejtë, po s’kishte trashëgimtarë nga meshkujt. Trashëgimia nuk bartej në prindët e të ndjerit.³²⁸ Tek japonezët, djemt e trashëgonin nga një e vajzat nga gjysmë pjese.³²⁹ Në të drejtën e vjetër brahmane, djemtë merrnin pjesë të barabarta të trashëgimisë, por djali i madh merrte diç më tepër. Vajzat nuk kishin të drejtë trashëgimie.³³⁰ Në të drejtën e vjetër iraniane, djemtë dhe vajzat e pamartuara pa testament trashëgonin pjesë të barabarta.

Për vajzat e martuara, paja që e merrnin nga babai, llogaritej një pjesë e trashëgimisë.³³¹

Në të drejtën romake, nëpërmjet të testamentit pasuria ndahej midis trashëgimtarëve legal. Vajzat dhe djemtë merrnin pjesë të barabarta.³³² E drejta e trashëgimisë hebreje, vajzat totalisht i shmangte nga trashëgimia.³³³ Por, sipas gjykimeve të Dhiatës së Vjetër:

“Nëse dikush vdes dhe pas vetes lë një djalë, vajzat nuk mund të jenë trashëgimtare. Por, nëse nuk lë djalë pas, atëherë trashëgimia hidhet në vajzat.”³³⁴

Por, vajza që merr trashëgim nga i ati, s'mund të martohet me njerëz të tjerë veç atyre nga farefisi, meqë nuk lejohet që trashëgimia nga një fis të kalojë në tjetër. Çdo fis duhet të mbajë trashëgiminë e paraardhësve të tyre (gjyshërve, stërgjyshërve etj.) ”³³⁵

Para Islamit, tek arabët, ata që nuk ishin të aftë të bartin armën, fëmijët e vegjël dhe gratë që s'ishin në gjendje ta mbrojnë vendin, nuk mund të ishin trashëgimtarë. Pronësia e të ndjerit duhej të trashëgohej nga mashkulli (burri) më i afërt, që mundej të luftojë.³³⁶

Gruaja në të drejtën trashëgimtare islame

Islami, me ajetin e 7 të sures en-Nisa i shpëtoi fëmijët e vegjël si dhe gratë nga një padrejtësi e madhe - ngelja pa të drejtën e trashëgimisë. Si mund të jenë trashëgimtarë burrat ashtu mund të jenë edhe gratë. Në kohën e Pejgamberit a.s. gratë dhe dy vajzat e Sa'd b. Rebias që ra martir në Uhud, erdhën para të Dërguarit a.s. dhe i thanë:

-O i Dërguar i All-llahut, këto janë të bijat e Sa'dit. Babai i tyre ra martir në luftën e Uhudit, e xhaxhai i tyre ua ka grabitur pasurinë dhe nuk u ka lënë asgjë. Këto vajza nuk mund të martohen pa kurrfarë prone. Pejgamberi a.s. u përgjegji:

-All-llahu për këtë gjë do të na shpallë gjykimin e vet. Më pastaj zbriti ajeti mbi trashëgiminë.³³⁷

Kur zbriti ajeti për trashëgiminë dhe i caktoi fëmijët dhe prindërit për trashëgimtarë, muslimanët duke i parë tendencat e përgjithshme në shoqërinë e vet deri në atë kohë edhe tek vendet fqinje, u çuditën shumë, bile edhe u brengosën. Si mund t'i jepet gruas një e katërta ose një e teta pjesë, vajzës një e dyta pjesë, madje edhe djali i vogël të gëzojë trashëgiminë. Askush nga ata nuk dilte që të luftojë kundër armikut dhe të fitojë pre lufte.³³⁸ Kjo tregon madhësinë dhe rëndësinë e revolucionit që e bëri Islami lidhur me trashëgiminë.

Sistemi i ndarjes dy me një

Sipas ajeteve që bëjnë fjalë për trashëgiminë, rrugët themelore të trashëgimisë (trashëgimia nga prindërit, nga bashkëshorti ose bashkëshortja), një burrë merr sa dy gra. Një ndarje e këtillë dy me një i zmadhoi kritikantët e atyre që thonë se Islami gratë i pranon si “gjysmë krijesa” të parëndësishme. Para se të shpjegojmë arsyen e kësaj çështjeje të rëndësishme, duhet të theksojmë një gjë që do t'i ndriçojë të gjitha vështirësitë që do të dalin para nesh.

Shkencëtarët Islam, thonë se do të na çuditte ajo sikur t'i analizonim gjykimet e fesë Islame nga lëmenjë të ndryshëm duke zgjeruar disa prej tyre dhe t'i shqyrtojmë të nxjerrura jashtë sistemit të përgjithshëm. Si s'mundemi ta montojmë një pjesë të orës së murit në orën e dorës, ashtu nuk mundemi ta shqyrtojmë vetëm të drejtën islame, në krahasim me sistemet tjera juridike dhe problematikën e gjykimeve islame vetëm brenda në sistem, por duhet bërë krakasime me ndonjë sistem tjetër. Ky është një parim i përgjithshëm. Pa qenë të njohtuar sa duhet për institucionin - familje, në të drejtën islame, nuk do të mund të kuptonim as parimin

“Pjesa e një burri është sa pjesa e dy grave”.

Më pastaj, çështjet tjera siç janë: Shkurorëzimi, poligamia, mbulesa, prostitucioni janë të ngjajshme. Të nënvizojmë se problemet sociale që paraqiten në shoqërinë, ku nuk është aplikuar Islami (si një tërësi e bazave të besimit, gjykimet e ibadetit dhe moralit), nëse nuk mund të evitohen me vendime e formulime të veçanta, për një gjendje të këtillë nuk mund të fajësohet dhe përgjigjet feja Islame. Në veprën e vet të titulluar *“Huxh-xhetu’llahu’l baliga”* Shahu Velijullah ed-Dihlevi (fq. 671 dhe vazhdimi) ku i numëron bazat e të drejtës së trashëgimit në Islam, shënon edhe këtë: tërë puna dhe munda i njeriut në botë, është që të kujdeset dhe të rritë një zëvendës (pasardhës) që do ta mbaj vendin pas tij dhe do t’ia trashëgojë emrin dhe gjininë (fisin).

Kjo për të, është një dëshirë e përhershme. Siç dihet, as gruaja, as vajza, as motra nuk mund ta ruajnë fisin dhe emrin familjar. Këtë mund ta bëjë djali, e ndoshta edhe vëllau. Gruaja, mundet që, pas vdekjes së burrit të martohet me ndonjë burrë tjetër. Edhe vajzat edhe motrat do të martohen dhe do ta vazhdojnë fisin tjetër. Vetëm djali është ai që do ta vazhdojë rendin dhe punën e bërë me nder e djersë të të ndjerit dhe do ta bartë emrin e babait. Për këtë arsye i jipet pjesa më e madhe që të mos dëmtohet rendi i formuar juridikisht dhe dëshirat e pronarit, respektivisht të të ndjerit, Në Islam, trashëgimia është caktuar sipas nevojave dhe përgjegjësisë së individëve. Kështu, trashëgimia prej bashkëshortit në bashkëshortin ose nga prindërit në fëmijë, faktor kryesor i ndarjes së saj është parimi - një burrit sa dy pjesë të grave.

a) Nëse vajza s’është e martuar, është vetëm një njeri. Përveç personalitetit të vet, s’ka kë të mbikëqyrë tjetër. Po që e martuar, detyra e burrit të saj është që t’ia plotësojë të gjitha nevojat, jo vetëm asaj por edhe fëmijëve të vet. Por, për këtë gjë kemi folur më parë. Më pastaj, kur të martohet, do të merr mehrin dhe shumë dhurata tjera. Po u bë fjalë për vëllain që do të merr dy fish më tepër, ai është ose i martuar ose do të martohet. Në të dyja rastet është përgjegjës t’i shikojë shumë anëtarë dhe të kujdeset për ta, ose, së paku duhet të kujdeset për veten dhe bashkëshorten. Kur të martohet, ai do të japë mehrin dhe do të ketë shpenzime tjera. Malli, gruas së martuar nuk do t’i zvogëlohet fare, madje, me autorizimin që i është dhënë nga e drejta islame, duke qarkulluar kapitali i saj, ai edhe do të smadhohet. Nga ana tjetër alimentcioni, po pati nevojë për të, është në kurriz të burrit. Ndërsa vëllau do të shpenzojë trashëgiminë e ngelur nga babai, që të kujdeset për fëmijët e vet. Veç kësaj, motra e pamartuar, po s’mundi të kalojë me trashëgiminë që ia ka lënë babai, do të ketë ndihmë nga i vëllai.

b) E njëjta gjë vlen edhe për gruan që ka trashëguar bashkëshortin. Nëse ajo ngel vejtshë, do të jetë vetëm një individ dhe mund të jetojë me trashëgiminë që e ka marrë nga burri, madje ndodh që të trashëgojë edhe nga prindërit. Nëse martohet rishtazi kësaj radhe për nevojat e saja do të kujdeset burri i ardhshëm.

Duket qartë se në një sistem të këtillë, u është dhënë kujdes i duhur obligimeve.

Barabarësia midis gruas dhe burrit, që qartë duket në disa situata, përveç këtyre dy rrugëve themelore të trashëgimisë, vërteton se gruaja në trashëgimi nuk llogaritet si “e parëndësishme, gjysma e burrit.”

“Në qoftë se ai (i vdekuri) ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta.”³⁹

“Në qoftë se (i vdekuri) është mashkull ose femër, e trashëgohet nga ndonjë i largët, pasi nuk ka as prindër as fëmijë por ka një vëlla ose një motër (nga nëna), atëherë secilit prej tyre u takon një e gjashta”³⁴⁰

Në këto dy raste, marrin pjesë të barabarta edhe babai edhe nëna që janë grua e burrë, madje edhe vëllau edhe motra nga e njëjta nënë. Nuk ka ndryshim midis tyre. Por, kjo s’është rruga kryesore e trashëgimisë. Gruaja nëse llogaritej absolutisht si gjysma e burrit, në këtë rast duhej të merrte gjysmën e pjesës në krahasim me burrin.

Ajetet që flasin për trashëgimi, në Kur’anin Famëlartë, përfundojnë kështu;

“Këto janë (dispozita) të caktuara prej All-llahut. Kush i bindet All-llahut (urdhërave të tij) dhe të dërguarit të Tij, atë e dërgon në Xhennete, nën të cilët burojnë lumenj. Aty do të jenë përgjithmonë. E ky është shpëtim i madh.”³⁴¹

Libri i dytë

GRUAJA DHE SHOQËRIA

PJESA E PARË

MBULESA - PROSTITUCIONI

- I. Mbulimi
- II. Prostitucioni
- III. Masat e Islamit për ta penguar prostitucionin
- IV. Dënimi për prostitucion.

I. Mbulesa

“Turpi vjen nga besimi.”

Muhammedi a.s.

Nevoja për mbulim

Në Dhiatën e Vjetër janë disa pjesë ku flitet për lakuriqësinë si gjë e turpshme, dhe pjesë ku urdhërohet mbulimi.³⁴²

Në Dhiatën e Re thuhet kështu:

“Secilit burrë që lutet dhe secili burrë që kryen punë të shenjta, do ta zhvleftësojë kokën e vet, por secila grua që lutet me kokë të zbuluar, ose secila grua që kryen punë jo të shenjta... do ta zhvleftësojë kokën e vet... Nëse gruaja nuk mbulohet le ta nënqethë flokun; e nëse turpërohet të rruhet, le të mbulohet. Gruaja për burrin paraqet krenarinë, ngase burri nuk është krijuar për gruan por gruaja është krijuar për burrin...”³⁴³

Sipas botëkuptimit Islam, gruaja nuk është krijesë satanike e krijuar për keqbërje. Përkundrazi, gruaja është krijesa e parë që i ka besuar Islamit, dhe, krijesë e respektuar që u bë martire për Islam.

“Xhenneti është nën këmbët e nënave”.

Vetëm ajo mund ta humbë lehtë vlerën e vet dhe bujarinë e vet, duke u mashtruar lehtë dhe duke u eksploatuar për shkak të bukurisë së trupit të saj, gjentilitetit, ndjenjave, pastërtisë së shpirtit dhe sinqeritetit të saj.

Në Kur'an, ajetet, me fjalë të buta dhe respekt flasin për gratë e burrat që janë haram për martesë njëri tjetrit, të mos e shikojnë njëri tjetrin dhe t'i ruajnë vendet e turpshme prej njëri tjetrit. Kurrë nuk është pranuar njeriu si burim i imoralitetit dhe nuk është shquar si një qenie e tmerrshme ose si një armik kundër nderit. Kuptohet në urdhërat e ndalesat për mbulim, është sjellur me kujdes dhe vazhdimisht ka qenë në rend

të parë parimi, që t'u frenohen epshet atyre personave që në zemër bartin "sëmundjen e prostitucionit". Në ajetin ku u urdhërohet besimtarëve t'i mbyllin sytë para namahremit (namahrem: njerëzit që nuk kanë afërsi që pengon kurorëzimin, gruaja e burri që s'kanë lidhje familjare që të pengohet kurora):

"...e ajo është më e pastër për ta..."³⁴⁴

Ekziston edhe një porosi e drejtuar besimtarëve, ku thuhet:

"...kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyre..."³⁴⁵

Në ajetin ku urdhërohen gratë besimtare të vejnë shami, kur të dalin në rrugë, thuhet:

"...pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen..."³⁴⁶

Nuk mund të jetë e vërtetë ajo që thuhet: Islami, me urdhërin që të mbulohet gruaja, atë e ka bërë krijesë të pavlerë, ia ka marrë të drejtën dhe lirinë e saj. Përkundrazi, feja Islame me urdhërin për mbulim, dëshiron ta ruajë gruan, ta rritë vlerën e saj, dhe të tregojë se ajo është personalitet që meriton respekt.

Disa pohojnë se mbulimi nxit për seks. Është ky mendim i gabueshëm. Kur qëllimi i mbulimit nuk është shfaqje e pjesëve të bukura duke i mbuluar ato më pak të bukura, por është mbulim i vërtetë, atëherë ai nuk do të jetë tërheqës për seks. Ai (mbulimi) mund të zgjojë kërshëri të përgjithshme për trupin e gruas tek meshkujt. E kjo do ta sjellë njeriun në kurorëzim të dëshirueshëm. Por, mosmbulimi do ta sjellë njeriun, respektivisht kërshërinë e tij, në marrëdhënie të drejtëpërdrejta e papërgjegjësi, e kjo me një fjalë tjera, quhet prostitucion.

"Nëse tek një grua nuk ka vlerë ruajtja e nderit, me detyrimin e saj të mos përzihet me meshkuj dhe të mbulohet, kjo nuk do të thotë virtyt. Gruaja duhet ta ketë në shpirt nderin, përndryshe ai nuk do të realizohet vetëm me mbulimin e saj..."

Një rezistencë lidhur me këtë nuk është e logjikshme, sepse virtyti, realizohet pak edhe me ndihmën e fuqisë. Nuk mund të fitohet shprehi pa përdorimin e forcës dhe pa përgatitur kushte. Një detyrim i këtitillë do të bëhet i arsye-shëm, do të na mbrojë dhe kështu do të krijohet shprehia dhe do të realizohet virtyti. Mbulimi dhe mospërziera me burra do t'i evitojë pasojat e këqia. Si janë të mundura mendime të kundërta nga ato që i përmendëm, nëse merret parasysh natyra e njeriut dhe vetitë e tij? Edhe t'a tërheqësh vëmendjen e meshkujve, të jesh bashkarisht me ta e të mos i nxisish epshet e tyre - a duhet besuar kësaj?

Burri duhet ta përvetësojë shpirtin e gruas. E nëse nuk e përvetëson, atëherë ç'dobi do të ketë mbulimi?

Përgjigje: *e para - secila grua nuk ka burrë. Më pastaj s'është lehtë të përvetësohet shpirti. "Gruaja jeton me emocione". Zemrat ndryshojnë. Ato nuk qëndrojnë në pika të njëjta. Shpirti i gruas është si lum pa pendë, që të mund të pushtohet, atij lumi duhet t'i ndërtohet një pendë. Ja, ky është qëllimi i mbulimit.*

"Sa gra janë të mbuluara me ferexhe, dhe janë imorale. Më shumë se ato të zbuluarat?!"

Këto fjalë janë të tepruara. Për shembull, të parafytyrojmë se janë të vërteta. Nëse një grua e mbuluar është imorale dhe do të bëjë kontakt me dikë. Por, kjo nuk do të ndikojë seksualisht tek të rinjtë e virgjër, të painformuar e të cilët përbëjnë shumicën. Ndërsa një grua e zbuluar, çfarëdo që të ketë si nijet dhe ide, me konstruktin dhe veshjen e saj, do të ndikojë tek njerëzit potent, e ata do t'i nxisë në shqetësime seksuale. Secili njeri është i mirë dhe i drejtë derisa nuk vërtetohet e kundërta. Por, duhet të respektohen ndenjat e tjerëve si me sjellje, ashtu edhe me veshmbathje. Nuk duhet të ketë agresivitet.

Njeriu vjen në botë duke patur me veti dhe dëshira të ndryshme. Midis njerëzve ka shumë sish të respektuar dhe të dashur si edhe të atillë që janë të poshtër dhe të këqinj deri në shkallën e fundit. Nëse e kuptojnë se çka dëshirojnë ndonjëherë shpirtërat tonë, shokët tonë më të ngushtë, nuk do të na shikojnë me sy të njeriut. Cipa e hollë që i mbulon dëshirat e këqia dhe të ulta të njeriut, është turpi. Kur të hiqet ajo perde, njeriu duket si një shtazë e egër. Turpi është stolia e njeriut, njerëzia e njeriut. E për gruan turpi është begatia më e çmuar... Një grua mund të humbë çdo gjë, por s'guxon ta humbë turpin. Një ditë, një grua me emrin Ummi Halid me fytyrë të mbuluar erdhi tek Pejgamberi a.s. dhe e pyeti për të birin e vet, i cili kishte rënë martir në një luftë ku kishte marrë pjesë edhe Muhammedi a.s. Dikush nga as'habët i tha asaj:

“-Ke ardhur ta pyesish për djalin, e fytyra e jote është e mbuluar. - ajo u përgjegj:

-Nëse e kam humbur djalin, nuk e kam humbur edhe turpin.”³⁴⁷

Mbulimi është pranimi i Urdhërave të All-llahut, të All-llahut, Krijuesit tonë e të gjithësisë. E në lidhje me zbulimin, me shfrytëzimin e një lirie të thjeshtë, ne, në realitet bëhemi fli të robërimeve të ndryshme. Para së gjithash, kjo është kundër traditës kombëtare të veshmbathjes. Është imitim i Perëndimit. Kjo, në fund, don të thotë, të na robërojnë ata që ishin në strehimin tonë për një kohë të gjatë. Më pastaj, vallë nuk fshihet diç tjetër pas shëtitjeve të hapta? Unë s'besoj se zbulimi është vetëm shfrytëzim i të drejtës për liri. Gruaja, e cila ka një liri të madhe, ka shkuar shumë më larg se burri dhe ka hapur shtigje që burri nuk shikon se ka nevojë t'i hapë ato. Ndaj, këtu është në pyetje vetëm dominimi i egos, dëshirës, modës, pasioneve... Nuk mund të pranohet se trupi i gruas, pjesët që e tregojnë feminizmin e saj nuk ndikojnë në palën e kundërt. Atëherë edhe burrat janë të dënuar nga pala tjetër. Duket se një liri e thjeshtë shkakton robërimi të ndryshme dhe dënime të shumta. Dhe konsekuencat nga këto, janë shumë tragjike.

Vendet që duhet mbuluar

Para Islamit gratë arabe nuk e respektonin mbulimin. Gjendja në atë kohë ishte e njëjtë me gjendjen e sotme nëpër qytetet e mëdha. Gruaja shëtitte në mesin e burrave me krahëror të hapur. Shpesh bënte ekzibicione, e tregonte qafën, bistekun dhe vathët.³⁴⁸

Tek meshkujt

Në Kur'an, edhe meshkujve edhe femrave u janë dhënë urdhëra të veçantë, që të mos i shikojnë namahremët dhe t'i mbulojnë vendet e turpshme:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimin (prej haramit) të ruajnë ojesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.”³⁴⁹

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Avreti (pjesa që duhet mbuluar) i burrit është pjesa midis barkut dhe gjunjëve.”³⁵⁰

Për barkun dhe gjunjët është zhvilluar diskutim i madh. Sipas hanefijve kapaku i gjurit është auret ndërsa barku jo.³⁵¹

Tek femrat

Për mbulimin e gruas, në Kur'an, flasin disa ajete. Edhe ajetet që u drejtohen grave të Pejgamberit a.s. vlejné për të gjitha gratë muslimane.³⁵²

“...e kur kërkoni prej tyre (grave të Pejgamberit a.s.) ndonjë send, atë kërkoni pas derës, kjo është më e pastër për zemrat e tuaja dhe të tyre...”

“O Pejgamber, thuaju grave tuaja, bijave tua dhe grave të besimtarëve, le të vejnë shamitë (mbulesat) e veta mbi trupin e tyre, se kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara. Ai është Mëshirues.”³⁵³

Ajeti i dytë, shpall se gratë duhet të mbulohen kur të dalin në rrugë. Në ajet, veshja është “xhilibab”. Kjo është veshja e jashtme, respektivisht të mbuluarit e tërë trupit me mbulesë.

Ajeti i tretë që bën fjalë lidhur me mbulimin është ajeti i 31-të i sures en-Nur. Në ajetin në fjalë, pas dhënies së urdhërit të duhur besimtarëve të gjinisë mashkullore, thuhet:

“Thuaju edhe besimtareve t'i ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos i zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shamitë mbi krahërorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, etërve të vet, vëllezërve të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, ose grave të tyre ose robërshave që i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femra ose fëmijëve që nuk kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”

Në këtë ajet u urdhërohet grave që të mos shikojnë në namahremin, ta ruajnë nderin e tyre. U tërhiqet vërejtja që shamitë e tyre t'i vejnë mbi jaka e të mbulohen. Fjala “*humur*” në ajet është shumësi i fjalës *hamr* (h me pikë e arabishtes). *Hamr* është send me të cilin mbulohet koka. Me shprehjen “*le t'i vejnë shamitë mbi krahërorin e tyre*”, don të thotë - të jetë e mbuluar koka, veshët, gjoksi dhe qafa. “***Të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme...***” Lidhur me këtë shprehje, shpjegimet e as’habëve të ndershëm, në përgjithësi janë të harmonizuara në pikën se vetëm fytyra dhe duart mund të jenë të zbuluara. Qëllimi i stolive dhe stolisjes natyrore është edhe zbulurimi i fytyrës, ose vendeve për stolisje. Edhe këtu mund të zbulohen vetëm duart dhe fytyra. Është diskutuar edhe për shputat, se a mund të zbulohen ose jo, shumica mendojnë se nuk duhet të zbulohen. Pjesa e duarve dhe fytyrës që mund të zbulohet është pjesa e krahut deri te zokthi i dorës dhe pjesa e fytyrës që pastrohet në rast abdesi (veç flokut, veshëve dhe nënmjeksës). Edhe pse ka leje që kjo pjesë e fytyrës të zbulohet, nuk është e drejtë që meshkujt të shikojnë fytyrën e gruas me epshe seksuale. Kjo, siç theksohet në hadith, do të jetë prostitucion me sy (me shikim). Bëhet përjashtim, vetëm atëherë kur ky shikim bëhet me qëllim martesë. (Për këtë temë, është bërë fjalë në temat e mëparëshme të këtij libri)³⁵⁴

Pejgamberi a.s. thotë:

“All-llahu nuk do ta pranojë namazin e gruas pas pubertetit pa shami.”³⁵⁵

Motra e gruas së Pejgamberit a.s. dhe e bija e Ebu Bekrit, Esma, një ditë hyri te i Dërguari i All-llahut me një veshje të hollë, e Pejgamberi a.s. duke e larguar shikimin, i tha:

“Esma! Gruas pas pubertetit nuk i është lejuar t’i zbulojë pjesët e trupit, përveç kësaj (ia tregoi duart e fytyrën).”³⁵⁶

Qëllimi i mbulimit është, që vendet e turpshme të mos duken fare. Ndaj rroba e tejdukshme që i tregon gjymtyrët s’mund të llogaritet si mbulesë. Në këtë mënyrë, pjesët e trupit dalin edhe më tërheqëse. Të njëjtën gjë e thekson Pejgamberi a.s. kur bën fjalë për gratë të cilat kurrë nuk do ta nuhasin erën e Xhennetit, ato janë gratë që janë:

“Të veshura, por të cullakuara”³⁵⁷

Veç kësaj, në hadithin e lartpërmendur në lidhje me Esmën, kjo çështje ishte shumë e qartë.³⁵⁸

Në ajetin e sures en-Nur, 31, që e cituam më lartë, numërohen mahremët të cilët guxojnë t’i shikojnë stolitë, duart që duhet të zbulohen derisa gruaja punon në shtëpi, flokun dhe veshët, qafën, prej gjunjëve e deri më poshtë.³⁵⁹ Edhe ata që nuk janë përmendur në ajet nga farefisi, dajallarët, xhaxhallarët dhe disa mahremë tjerë, janë përfshirë në të, s’është mëkat të shikohet me ta.³⁶⁰

Ajeti shpall se nuk ka asnjë dëm nga shikimi i njerëzve më në moshë, që janë larguar nga burrëria, as nga shikimi me njerëz impotentë nga lindja si dhe me fëmijët që ende nuk dijnë se ç’është femra.

Mundësia e hyrjes së njerëzve impotentë dhe fëmijëve tek gratë, flet se në Islam është urdhëruar mbulimi për shkak të nderit dhe shpëtimit të tij, dhe jo për atë që gruan ta shndërrojë në një krijesë të ulët ose krijesë të mbyllur në kafaz.

Enesi, (i cili i shërbeu Pejgamberit a.s. njëzet vjet me rradhë), pa u turpëruar hynte dhe dilte në shtëpinë e lumtur të Pejgamberit a.s. si një anëtar i shtëpisë pas zbritjes së ajetit për hixhab (mbulim), thotë:

“Pas zbritjes së ajetit për hixhab shkova në shtëpinë e të Dërguarit të Zotit si edhe më parë. E i Dërguari a.s. më tha: -Kthehu Enes! - dhe më pas lëshoi perdet.”³⁶¹

Thënë shkurt, gruaja muslimane është e obliguar t’i mbulojë të gjitha pjesët e trupit, përveç fytyrës dhe duarve deri në zokth të dorës. Kjo s’është e thënë të bëhet me çarçaf. Përkundrazi, kjo duhet të jetë si shembull për gratë tjera - pastër e thjeshtë dhe bukur e mirë. Një grua e këtillë përhap respekt e jo epsh seksual. Këtë grua e lartëson Islami, e për të shpalli se Xhenneti është nën këmbët e saj.

Aisheja rrëfen për besimtarët e kohës së saj, se si i kanë respektuar urdhërat e All-llahut, duke i braktisur shprehitë e vjetra dhe modën:

“Për Zotin, unë nuk kam parë gra më të virtytshme se gratë ensare, në pikëpamje të besimit në librin e Zotit dhe bindjes se Ai e ka zbritur Kur’anin. Kur zbriti ajeti për mbulim, erdhën burrat e tyre tek ato dhe filluan të lexojnë ajetet që i zbriti All-llahu. Të gjithë i lexuan këto urdhëra për gratë, vajzat, motrat dhe personat tjerë. Të gjitha, pa përjashtim, u mbuluan me mbulesat e veta të leshta ose nga pambuku, duke i respektuar urdhërat e All-llahut - dhe për namazin e mëngjesit të mbuluara qëndruan prapa të Dërguarit a.s. dhe dukeshin sikur në kokat e tyre të qëndronin laraska”. Rrëfimi i dytë i saj është ky:

“All-llahu t’u falë shpëtim atyre grave të mëdha - atyre muhaxhireve. Ato, kur zbriti ajeti për mbulim i prenë mbulesat më të trasha dhe u strukën brenda në to.”³⁶²

(9)

II. Prostitucioni

“Dhe mos iu afroni amoralitetit (zinasë) sepse vërtet ajo është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.”

Kur’ani Famëllartë, (17): 32.

Hyrje

Prostitucioni është i ndaluar prej shoqërive më të vjetra e deri në ditët e tona. Atyre që kanë bërë prostitucion u është shqiptuar dënimi më i rreptë, meqë ai shkatërron bashkëshortësinë, madje shkatërron familjet dhe gjeneratat.³⁶³ Para Islamit, tek arabët, prostitucioni ishte shumë i zgjëruar. Disa gra, në vende të caktuara merreshin me prostitucion. Në shtëpitë e veta varnin flamuj të shënuar posaçërisht, në vend të firmave.³⁶⁴ Është normale se feja Islame këto i ka ndaluar rreptësisht.

Sot në Evropë dhe në vendet e Lindjes, që mundohen t’i gjasojnë Evropës nëpërmjet imitimit, prostitucioni është zgjëruar shumë. Realisht, krishterizmi e ka ndaluar prostitucionin dhe sjelljet amorale (zinanë). Por, evropianët që nuk e njohin asnjë vlerë tjetër përveç interesave dhe epshëve të tyre, nuk e respektojnë urdhërin e fesë së tyre. Në veprën e Max Kemerichit *“Ngjarjet e çuditshme në histori”*, i është kushtuar shumë vemendje ngjarjeve të këqia e rënqethëse lidhur me jetën prostitucionale në Evropë. Madje në disa qytete, vendet e shtëpitë publike janë hapur pa pagesë dhe, në këtë mënyrë, gjoja, është treguar mikpritja (!) vizitorëve, mbretërve dhe suitës së tyre nga ana e prefektëve të atyre qyteteve.

Siç theksohet në Kur’an,³⁶⁵ të krishterët e shpikën klerikalizmin, i cili nuk u është urdhëruar nga All-llahu, por edhe atë nuk e respektuan sa e si duhet. Murgët dhe murgeshat, gjoja, ishin braktisës të kësaj bote. Nuk martohen, nuk lindin fëmijë. Por, ky parim që nuk i përgjigjet psikologjisë njerëzore, në realitet është shkelur nga murgët e murgeshat, me intriga të ndryshme bëjnë gjithfarë prostitucionesh.

“Në shekullin e XIII në manastire, marrëdhëniet jo natyrale midis femrave ishin të zgjëruara shumë. Në shekullin e XI, në Angli, homoseksualizmi ishte problem i madh, veçanërisht nëpër manastire, kjo kënaqësi jonormale kish marrë përmasa të mëdha. Kuptohet pasonin dënime që shkonin deri në djegjen e personit. Por këtë sjellje abnormale nuk mundi ta ndalojë edhe dënimi më i rreptë.

Edhe amoraliteti i priftërinjëve të mesjetës nuk kishte fund. Po japim vetëm një shembull: Në qytetin Nordingen, në vitin 1472, Kuvendi i këtij qyteti, duke mos pasur guxim të duhur që priftërve t’ua ndalojë vizitën e shtëpive publike, u kënaq vetëm me ndalimin që ata të mos buajnë në ato shtëpi.

Në shekullin e XVI çdo prift kishte nga një shërbëtore të dhomës. Në këtë shekull priftërit ishin të detyruar me ligj që gratë e ndershme t’i lënë të paprekshme. Baroni Zimmern në veprën e tij “*Chronik*”, shkruan se manastiret e murgeshave u gjasonin shtëpive publike. Në shekullin XVII gjendja ishte e njëjtë. Ky prostitucion i fshehur ndonjëherë dukej haptazi. Kur një mbrëmje, në Strasburg një manastir femrash e goditi rrufeja dhe u shkaktua zjarr, populli, duke i thyer portet, me dhunë hyri brenda dhe u ballafaqua me shumë turpësi. Takuan shumë murgesha me meshkuj të rinjë në të njëjtin krevat. Në atë kohë fëmijë të lindur jo legjitim, liheshin nëpër dritaret e manastireve dhe për këta fëmijë kujdeseshin murgeshat. Në këtë ngjarje, të rinjët që ishin mjete të murgeshave, u zbuluan si kopila të rritur. Kur arrinë në moshën burrërore u bënë dashnorë të murgeshave në moshë e të shëmtuara. Në kësilloj manastiresh kishte edhe pishina gjithnjë të mbushura me ujë ku murgeshat i ngulfatnin foshnjat nga prostitucioni në këta manastire.”³⁶⁶

Arsyeja tjetër, për zgjërimitin e prostitucionit në Evropë është detyrimi i monogamisë në krishterizëm e posaçërisht ndalimi i shkurorëzimit në katolicizëm. Krishterizmi njëkohësisht e ndaloi zinanë, e fëmijët e jashtëkurorës i dëboi, i shpalli si fëmijë të mallkuar të mëkatit dhe skandalit. Profesori ordinar, doktor Andreas B. Schwarz i cili, në mënyrë të ashpër e kritikoi këtë sjellje shton:

*“Në fund të shekullit XVIII që ishte shekulli i iluminizmit, një lëvizje e madhe i lartësoi përnjëherë fëmijët e lindur jashtë kurorës” dhe jep një histori të shkurtër në këtë temë, si dhe mbron atë se fëmijët jashtë kurorës, duhet të llogariten si fëmijë legal.*³⁶⁷

Pikërisht ashtu kisha, nga njëra anë, duke ndaluar shkurorëzimin, i detyronte meshkujt për monogami dhe për këtë shkak e hapte rrugën për prostitucion, e nga ana tjetër i dënonte fëmijët jashtë kurorës. E njëri ndër këto dy probleme duhej zgjidhur. Profesori pranoi mënyrën e llogaritjes së fryteve nga zinjaja, si legale. Dhe, pasi ky ishte mendim i tij, këtë edhe e mbrojti... Dhe, kjo në Evropë zhvillohej në drejtimin që e dëshironte ai. Sipas perëndimorëve është gjë shumë e turpshme dhe e prapambetur për një burrë, që nuk mund t’i kënaqë nevojat seksuale nga një grua, ose që ka një grua impotente, të martohet edhe me një grua, dhe me të ta jetojë një jetë legale. Por, s’ka asnjë dëm që, i njëjti të jetojë me më shumë dashnore. Gjatë kësaj kohe, do të vijnë në jetë fëmijë, nëse mund të lindin, nëse i shpëtojnë abortimit ose ngulfatjes, dhe, ata do të llogariten si fëmijë legal. Të mos harrojmë se për shkurorëzimin, në të drejtën katolike, zinjaja është shkak për ndarje të vazhdueshme. Por, ata që ndahen për këtë arsye, sipas të drejtës së njëjtë, nuk mund të kurorëzohen deri në fund të jetës.”³⁶⁸

Sëmundja e imitimit

Edhe pse kemi trashëgimi të madhe e të ndershme nga paraardhësit, në Turqi ka njerëz që, duke u mbështetur në Evropën, mendojnë se prostitucioni është mjeshtri. Sipas tyre është ajo një nevojë e jetës bashkëkohore. Për këtë temë doktor Xhemal Zeki, thotë kështu:

“Tradhëtia midis gruas dhe burrit ndodh shpesh në vende sekrete, në hotelet privatë, në garsoniera, në shtëpi publike dhe kësilloj çerdhesh. Por, kjo në jetën bashkëkohore është gjë legale. Familjet e degjeneruara që kanë humbur kuptimin e familjes, janë dhënë pas kënaqësive të kota, pas argëtimit, pas takimeve në orë të vona dhe pas lojërave të ndryshme. Këtë, respektivisht prostitucionin e praktikojnë publikisht. Dje shkëlqenin ndryshe kandilat ndërsa sot shkëlqejnë ndryshe, e kjo paturpësi quhet argëtim.”

Në Amerikë, për çdo katër minuta lind një fëmijë jo legjitim. Këtë dukuri dr. Schauffer e shpjegon kështu:

“Dita ditës rritet numri i grave të cilat mashtrohen (gënjehen). Vajzat që akoma nuk e njohin botën, shkatërrohen. Më parë “gjuheshin” ato të pakulturuarat. E sot, për fat të keq, vajzat nga familjet më të mira e shumica studente të universitetit, bëhen pre gjuetarësh”.

Psikologu amerikan Greonwold thotë:

“Arsyeja për inkuadrimin e vajzave në prostitucion është disharmonia midis bashkëshortëve dhe moskujdesi ndaj fëmijëve.”

Në vende dhe kohëra të ndryshme ka pasur tradhëti midis meshkujve dhe grave, dhe mashtrime midis tyre. Studimet rreth kësaj çështje tregojnë se 7 % të anglezëve tradhetojnë gratë e tyre, ndërsa në Amerikë 85 % të burrave i gënjajnë gratë e tyre, e 65 % nga këta kanë mundur që këtë ta fshehin krejtësisht. Sa u përket grave, 37 % i kanë gënjyer burrat e tyre e 11 % nga to kanë pasur sukses ta fshehin këtë gjë.³⁶⁹

Presioni social

Sot, si shoqëri islame, pësojmë dëme të mëdha nga humbja e një gjëje. Një kohë, në secilin qytet, qytezë, në secilin fshat, madje edhe në secilën lagje, ekzistonte një lloj “presioni social” që i ndriçonte sjelljet e shoqërisë islame. Diku, kur bëhej një punë amorale dhe kundër traditës islame, muslimanët e atij vendi nuk i mbyllnin sytë, e protestonin shkaktarin, ose e përmirësonin ose ia përgatitnin dënimin më të ashpër. Kjo ndjenjë hyjnore dhe kjo bindje e thellë, ishin nyjet më të rëndësishme të moralit. Vrasësi, do të ndjehej vazhdimisht i padrejtë dhe i vetmuar. Ky presion social, ishte edukatori më i madh. Kjo ndjenjë hyjnore, për fat të keq, në kohën tonë është e verbuar ose është zhdukur totalisht. Është zvogluar shumë numri i njerëzve që e respektojnë porosinë e Pejgamberit a.s. kur thotë:

“Kush, nga ju, do të shikojë ndonjë punë të keqe, le ta pengojë me duart e veta. Nëse nuk mund ta pengojnë me duar, atëherë me gjuhë (fjalë), nëse nuk mundet as me gjuhë, së paku mos ta miratojë me zemër. Ja, kjo është shkalla më e dobët e imanit.”³⁷⁰

Cilat janë shkaqet për mosrespektimin e porosisë së lartpërmendur?

E para, tek ne është dobësuar shumë madje edhe është lënë prapa, jeta fetare dhe ndjenja shoqërore. Kur bëhet diç kundër fesë dhe moralit para syve tanë, nëse nuk mund të gjejmë guxim të intervenojmë kundër, siç ka thënë Pejgamberi a.s. atëherë jemi në nivelin më të ulët të imanit; e kjo don të thotë se imani ynë nuk ka fuqi të mjaftueshme të na aktivizojë. Shkaku i dytë i rëndësishëm, është: Tek ne u bënë ndryshime në krahasim me të kaluarën, nga këndvështrimi - kuptimi i jetës, në gjykimet mbi vlerat, duke filluar nga qytetet e mëdha kah ato më të vogla - Të parët tanë, kur shikonin si disa bënin hoka madje edhe me gratë e tyre, në vendet publike, atë e llogarisnin si diçka të ulët, të shëmtuar, dhe bënin çmos ta pengojnë atë. Thënë më drejtë, njerëzit e këtillë me sjellje të këqia dhe kulturë të ulët, e dinin se shoqërisë nuk i pëlqenin këto dhe se s’duhej të sillëshin kështu. E tani, në qytetet tona më të mëdha, panorama është ndryshe. Sot në rrugët tona e në parqe, mund të vësh prostitucion treanësh: prostitucioni i të pa martuarve, prostitucioni të fejuarve, dhe pafytyrësia e të martuarve. Këto japin panoramën e një gjenerate e cila ka humbur turpin. Pejgamberi a.s. thotë kështu:

“Njerëzit, prej profetit të parë e deri tani, gjithnjë i dëgjojnë fjalët: Po s’u turpërove, mund të bësh gjithçka.”³⁷¹

Është fakt se egoja jonë dhe anët e këqia të fshehura në strukturën tonë fizike e shpirtërore, shpesh na detyrojnë të bëjmë punë të këqia duke i stolisur ato. Neve na pëlqen një farmak vdekjeprues. Nëse në një vend egoja, epshi dhe shejtani dominojnë mbi mençurinë, logjikën dhe ndjenjën fetare, atje nga forcat e këqia dhe shtazarake të njeriut do të del në sipërfaqe perverzioni seksual. Ky perverzion është forca më e madhe nxitëse e fshehur në qenien njerëzore. Ata që do të përfshihen nën komandën e kësaj fuqie, mund të bëjnë çfarëdo punë të këqia. Po e shikuar rrethin tonë me një sy analitik, me siguri do të gjejmë shumë gjëra të mjerueshme, gjoja të bëra me zemër të hapur dhe se janë nevojë e civilizimit. Thënia se këto marrëdhënie janë me zemër të pastër ose është një interpretim të cilit nuk i beson as vetë thënësi, ose është mosfrenim i ndjenjave seksuale. Shkencëtarët që merren me seksologji, vërtetojnë se gjërat e këtilla bëhen vetëm me qëllim të kënaqësisë seksuale. E për fjalët “nevojë për gjentilitet dhe civilizim” duhet të përkujtojmë se, për ne, nderi më i madh është Islami. “Krenari më të të madhe se Islami nuk ekziston.” Të gjitha rregullat për gjentilitet dhe edukim si dhe shkaqet për krenari janë në Islam. Punët që do të na i ofrojnë pasioni dhe shejtani, janë punë që ne s’duhet t’i pranojmë. Këto zakone që janë hedhurinë e civilizimit perëndimor, në jetën sociale nuk kanë lidhje me civilizimin dhe gjentilitetin si dhe krenarinë. Të mos harrojmë se All-llahu në Kur’an shpall se kujt i takon krenaria dhe dinjiteti:

“...Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë.”³⁷²

Si e shikon Islami prostitucionin

Me të gjitha llojet e veta prostitucioni është punë shumë e keqe, të cilën, Islami e ndalon.³⁷³ Në Kur'an zinaja quhet “paturpëshmëri e madhe, rrugë shumë e keqe. Prostitucioni është mosrespektim i njeriut”³⁷⁴ që është krijuar si i respektuar dhe meritues i sexhdeve të engjëjve dhe i cili është “halif i All-llahut në sipërfaqen e Tokës”. Prostitucioni është rebelim kundër Zotit dhe Pejgamberit a.s. të tij. Prostitucioni është tradhëti e emanetit të All-llahut.³⁷⁵ Hazreti Pejgamberi a.s. në haxhin lamtumirës para 120 mijë muslimanëve, në hutben e vet tha kështu:

“Njerëz! Sa është e shenjtë kjo ditë, sa është i shenjtë ky muaj, sa është fatlum ky qytet (Meka), aq janë të shenjtë edhe shpirtërat tuaj, pasuria dhe nderi juaj që, gjithsesi janë të ruajtur nga të gjitha agresionet.”³⁷⁶

Në Kur'an, kur u caktuan cilësitë e atyre që gjetën shpëtim theksohet:

“Dhe ata që ruajnë organet e turpshme”³⁷⁷

Pejgamberi a.s. thotë:

“Ai që bën zina, nuk e bën atë derisa është mu'min (besimtar). Ndërsa vjedhësi nuk vjedh derisa është mu'min dhe, njeriu nuk pin (alkool) derisa është mu'min.”

Rëndësia që del nga ky hadith, është se njerëzit që bëjnë zina, që vjedhin e pijnë, kanë dalur nga imani në momentin e kryerjes së këtyre punëve. Por, zinaja e punët e tjera edhe pse janë mëkate të mëdha, dhe nuk pranohen si hallall, nuk e largojnë njeriun besimtar nga imani, që, është pranuar nga ana e ulemave duke u mbështetur në argumentet fetare, ndaj imani në këtë hadith është marrë si iman i pjekur.³⁷⁸ Në këtë mënyrë hadithi do të thotë: ai që ka iman të plotë, nuk bën zina, nuk vjedh dhe nuk pin. Çfarëdo kuptimi që t'i jepet këtij hadithi, përsëri kuptohet qartë sa e keqe dhe e tmerrshme është në Islam zinaja.

Prostitucioni edhe individëve edhe shoqërisë i sjell dëme dhe tragjedi të papara. Nga këto do t'i cekim dy: gonorenë dhe sifilisin.

“Si edhe dje, sot rënqethet njeriu nga tmerrri i statistikave për gërmadhat, e tragjeditë që s'mund të rrëfihen as me fjalë as me shkrim. Vdekja e 500 mijë fëmijëve vetëm në një kënd të Evropës nga sifilisi, të verbëruarit e gjysmës së atyre që janë të verbër për shkak të gonoresë në Evropë dhe Amerikë, janë një numër i vogël i fatkeqësive që vazhdojnë.”³⁷⁹

Sot kësaj tragjedie i është shtuar edhe sëmundja AIDS, që paraqet një tragjedi të cilës i ekspozohet njerëzimi, më shpesh nëpërmjet prostitucionit.

Prostitucioni njëkohësisht shkakton edhe çmendinë. E eliminon “mjetin” e njeriut që të njeh Krijuesin dhe të krijuarit. Çdo gjë që është e dëmshme për shëndetin dhe trurin e njeriut, në Islam është e ndaluar, dhe nga ky aspekt, prostitucioni është një vepër që e ndalon në mënyrë të rreptë Islami.

Secili din ndonjë rast çmendie tek prostitutet. Këtu njeriut do t'i bijnë në sy dy gjëra: Krijon vallë çmendinë prostitucioni, ose të çmendurit janë prostitutë? Një specialist do të përgjigjej pozitivisht, madje në të dyja pyetjet. Jeta prostitucionale sigurisht e shton çmendinë. Mos fjetja gjatë natës, vazhdimësia e domosdoshme e jetës prostitucionale, tronditjet shpirtërore, frika dhe xhelozia, gjendja pirake, shprehitë për përdorimin e morfiumit dhe narkotikëve tjerë, e më në fund sifilisi, histeria dhe neurostenia si pjesë përbërëse e paralizës, madje edhe paraqitja e psikozës dhe neurozës, shkaktar i vetëm i të gjitha këtyre është prostitucioni. Nga ana tjetër, nëse analizohet psikologjia e atyre njerëzve që janë të zhytur në tragjedinë, ku njeriu njolloset me vulën e prostitucionit, duket qartazi se shumica nga ata ishin të çmendura, para se të merrnin rrugë të prostituteve. Për shembull, shumica e prostituteve janë të marra, ose së paku nuk mund të gjykojnë si duhet. Ndonjë burrë, tregëtar me femra, për shkak të marrëzisë së tyre, shumë shpejt do ta mashtrojë atë. Duke pasë afinitet ndaj prostitucionit, ajo ose do ta kuptojë ose nuk di ta kuptojë fëlliqësinë e gropës në të cilën ka sharruar, ndaj, duke u qelbur në kënetën e prostitucionit, definitivisht do të mbarojë. Një pjesë e tyre që janë zhytur në prostitucion, janë maniakë. Për shkak të stimulimit të çmendisë, epsheet do t'i shtohen, i zvogëlohet ndjenja e turpit, asaj do t'i pëlqejë të bëjë krim të tepruar dhe të shëtisë. Një person i këtillë i marrë që është, është kafshatë e lirë. Nëpër shtëpitë publike këto të gjora u pëlqejnë mushterinjëve me sjelljet e tyre. Rëndom, këto i thërrasin vajza të marra. Dihet mirëfilli se ç'i pret! Ose do të vdesin nën thikën e çartur të dashnorit të zemruar e në krizë të melankolisë, meqë gjatë aktit të argëtimit nuk mund t'u japë kënaqësi të mjaftueshme myshterinjëve të vjetër që kanë formuar shprehi në estravagancën e saj, e në anën tjetër, lajmërohet turpi dhe pendimi. Ose do të vdesë nga arma e feministëve, pas një shkalle të xhelozisë që do të shkaktojë nga mosgjykimi i shëndoshë derisa vazhdon disponimi. Ato që kanë hyrë në prostitucion, janë më tepër hysterike. Janë shumë të dhëna pas stolive, përvëlohen nga dëshira të fitojnë pa marrë parasysh çmimin, entuziazmohen pa masë kur t'u thonë se janë të bukura...

Çmenduria nga epsheet që quhet nimfomani, në fund, ato që janë hysterike i drejton në prostitucion. Gati të gjitha prostitutet gjentile dhe ato "de mondine" që dëshirojnë t'u tërheqin vëmendjen njerëzve me të gjitha gjërat që disponojnë (që kanë në trupin e tyre), prej çorapëve të mëndafshta, këpucëve vizlluese (të lustruara) deri tek grimat në fytyrë, janë hysterike. Thuaja, të gjitha prostitutet janë psikopate, që don të thotë, gjysmë të marra dhe të degjeneruara. Një grua shpirtpastër dhe me gjak fisnik, që ka thithur qumësht të pastër të nënës, nuk do të bjerë kurrë në prostitucion, pa marrë parasysh vështirësitë jetësore. Kurrë nuk do të flijojë virgjinitetin dhe dinjitetin e vet, të një femre, për stoli e xhingla ose për kënaqësi. Kurrë nuk do të sharrojë në baltë. Mund të jetë amvise, arsimtare, nëpunëse, shërbëtoresh, madje edhe të vdesë nga skamja por asnjëherë nuk do të bëhet prostitute.

Ja, për këtë shkak, midis të marrave takojmë paciente që janë prostitute. Një pjesë e tyre, periudhën e manisë e kanë shumë të fuqishme, ndaj edhe i vendosin në çmendë. Ato me lot në sy rrëfejnë se u janë të mbyllura të gjitha portat, madje edhe kur dëshirojnë të bëhen shërbëtoresh, nga shkak i reputacionit të keq që gëzojnë, dhe kështu, dalin nga çmendia të brengosura. Një grua e pastër derisa jeton në mjedisin e të çmendurve, mëson për jetën e ndershme. Një kohë dëshiron të kthehet në atë jetë të pastër. Por, nuk gjen kurrfarë strehimi tjetër veç shtëpisë publike ndaj, kthehet në jetën e njëjtë. Ballafaqohemi me atë se prostitutet që janë të robëruara në një paralizë të përgjithshme, në periudhën e ndershmërisë

janë të pranuar mirë në shtëpitë publike. Një grua familjare do të pranojë para burrit të vetë mëkatin e bërë. Por ai do të ndjejë se ajo i ka nxitur meshkujt e fqinjësisë në krizën e parë të manisë. Është normale se ai do të ndahet nga ajo. Prindi i saj do ta çojë në çmendi. Do të përmirësohet. Disa vjet jeton me mendje të shëndoshë. Në krizën që pason, përsëri me të vjetrën. I fryhet stomaku me një foshnje. Kësaj rradhe babai e shporr nga shtëpia. Përsëri hidhet në çmendi. Më vonë do të turpërohet për të gjitha që ka bërë por babai assesi nuk ia falë gabimin. Kjo grua, e familjes së pastër, kur të përmirësohet s' do të kthehet në shtëpinë e vet por bëhet pastruese rrobash e jo prostitute. Do ta çojë jetën e vet në mënyrë të ndershme. Në krizën e tretë të manisë, ja, në shoqërim me policë shkon të furnizohet me dokument prostituteje. Atëbotë shikon pa fije turpi. Ja edhe një grua e gjorë që regjistrohet në prostitute. Është vallë ajo diç tjetër përveç një e çmendur, një kliente e papërgjegjësi. Ndonjë prostitute që e ka përjetuar krizën e çmendisë, në gjendje normale e urren edhe prostitucionin. Është e nënçmuar në shoqëri... E, kurrë nuk përmenden emrat e atyre të poshtërve që e kanë shfrytëzuar në mënyrë shtazarake shpirtin e saj të sëmurë.

8 8 8

III. Masat që i ka ndërmarrë Islami që ta pengojë prostitucionin

Siç dihet, në të drejtën islame, ka dy lloj obligimesh. Njëri është sikurse edhe në sistemin juridik, e që ka të bëjë me këtë botë, e i dyti është hyjnor, ka të bëjë me ahiretin. Atij që ka bërë gabim, i jipet dënim në planin material ndërsa në planin shpirtëror është mëkati. Nga ky aspekt Islami e ruan individin nga gabimet, ose me fjalë tjera e ruan që të mos bjerë në mëkat. Feja Islame, si një nënë e vërtetë, si një mjek bëmires, e ruan individin nga rreziqet. E drejta islame nuk është ndonjë sistem i cili sillet me pakujdesi ndaj njeriut, dhe s'është sistem që ia lehtëson njeriut mënyrën të gabojë. Por, kur të gabojë, e rrëmben me pamëshirë dhe e dënon. Pikërisht për këtë, Islami, ia ndalon njeriut çdo aksion që çon kah prostitucioni. Është me rëndësi që njeriu të largohet nga punët e liga. Seksi është emocion i fortë që gjendet në pikat më të thella të qenies së njeriut. Është e natyrshme të plotësohet. Nëse kjo nevojë nuk u bë në mënyrë legale, atëherë do të bëhet ilegalisht. Ndaj, Islami e lehtëson mënyrën legale respektivisht kurorëzimin legal. Sipas nevojës, legalizohet edhe poligamia. Në situata kur bashkëshortët nuk mund ta kënaqin njëri tjetrin, ose kur mbretëron moskuptimi midis tyre, është e lejuar edhe ndarja. Në këtë mënyrë të dy palët, në mënyrë legale, mund të gjejnë jetë më të lumtur tek personi tjetër.

Rrugët që çojnë në prostitucion

Shikimi, prekja, zëri...

Feja Islame e ndalon zbulimin, shikimin me njëri tjetrin, prekjen (kontakti fizik) dhe bashkëgjendjen, gjëra këto që nxisin epshet ndërmjet dy gjinive. Meqë këto janë sy, vesh, duar, dritare që kapen kah zemra, po nuk u ruajtën, zemra do të jetë gjithnjë e zaptuar. E kur ajo është e zaptuar, atëherë është vështirë të pengohen organet gjenitale. Hz, Pejgamberi a.s. thotë kështu:

“Zinaja e syve është shikimi, zinaja e veshëve është të dëgjuarit, zinaja e gjuhës është fjala, e duarve kapja. Zinaja e këmbëve është ecja ndërsa egoja (epshi) dëshiron dhe dashuron. Organet gjenitale ose do ta kryejnë aktin ose do të largohen.”³⁸¹

Marrëdhëniet midis gruas dhe burrit shpesh fillojnë me shikime të zjarra. Shkencëtarët që merren me seksologji, gjatë kohë e kanë shpjeguar efektin e shqisës së të pamurit në jetën seksuale.³⁸² Në Kur’anin Famëllartë urdhërohet që burrat besimtarë dhe gratë besimtare t’i ruajnë sytë e tyre nga harami.³⁸³ Pejgamberi a.s. thotë:

-Ali! Pas një shikimi mos shiko edhe një herë. Ngase edhe pse shikimi i parë për ty është i lejuar, i dyti nuk është!”³⁸⁴

Syri i njeriut mund befas të shikojë në haram. E kur u pyet i Dërguari i All-llahut lidhur me këtë gjë, tha: **“Ktheji sytë nga ana tjetër!”³⁸⁵** Ruajtja e syrit nga harami njeriut i jep vlerë të imanit dhe ibadetit. Këtë e shpreh edhe parimi “dënimi dhe shpërblimi janë adekuat me një punë të kryer”. Nëse njeriu heq dorë nga puna që i pëlqen e ajo punë është e ndaluar, All-llahu i Lartësuar do t’i dhurojë një kënaqësi nga lloji i atyre hyjnore. Kjo gjë tek i Dërguari i All-llahut shprehet kështu:

“Cilido qoftë musliman që do të shikojë në bukurinë e një gruaje dhe pastaj do t’i mbyllë sytë, All-llahu i Lartësuar do t’i dhurojë një ibadet në të cilin ai do të gjejë kënaqësi.”³⁸⁶

Ibën Kajjim el-Xhevziije thotë:

“Epshi i njeriut ka predisponim të shikojë forma të bukura. Syri është i deleguari i zemrës. Zemra e shëtit andej e këndeje që të analizojë ç’ka dhe, kur të gjejë diçka të bukur, ai do ta lajmërojë zemrën e ajo kërcen nga shqetësimi shumë herë, dhe, vet ajo dhe i deleguari i saj kot së koti do të mundohen të qetësohen, siç ka thënë poeti: “Syri lajmëron për asi bukuri pasi nuk posedon fuqi as t’i përvetësojë as të ndahet nga ndonjëra prej tyre”, por zemra, nëse të deleguarit ia ndalon hulumtimet dhe zbulimet, edhe vetë do të shpëtojë nga pesha e kërkesave dhe dëshirave. Ai që lëshon shikime, gjithnjë do të ketë mallëngjime. Shikimi e lind dashurinë. Në fillim zemra do të ketë një interesim. Më pastaj ky interesim forcohet dhe shndërrohet në një dashuri të marrë që zemrës i bën invazion. Më pastaj, do të mbledh fuqi të bëhet një fuqi që s’mund të shkëputet nga zemra. Do të rritet edhe më e do të bëhet e tepruar. Duke u forcuar edhe më, bëhet e marrë. Në fund zemra do të robërohet. Dhe si e tillë i dorëzohet atij ose asaj që nuk e meriton. Ja të gjitha këto janë rrjedhë e shikimit. Tani zemra ka rënë në robëri. Tani është vetë, një rob që shitet. Derisa më parë ishte e lirë, tani është si rob i mbyllur. Gjithnjë ankohet nga syri. E syri thotë: Isha nëpunës i yt, isha i deleguari yt. Ti më dërgove mua. Të gjitha këto janë probleme të zemrave që janë larguar nga dashuria e Zotit dhe që janë shkëputur nga lidhshmëria me Zotin. Ajo që quhet zemër duhet të lidhet me një dashuri, nëse nuk është All-llahu i dashuri i tij, zemra e tij sigurisht do të jetë rob i dikujt tjetër. Si, Zeli-haja, e shoqja e Azizit, edhe pse ishte grua e martuar pasi ishte mushrike (që All-llahut i mvesh shok pa pasur kurrfarë argumenti), ra në aventura të njohura, e Jusufi a.s., edhe pse ishte i ri dhe i pamartuar e i varfër, pasi e kishte zemrën e pastër dhe ishte i lidhur me All-llahun, shpëtoi nga ajo, dhe ngeli i pastër.”³⁸⁷

Të shtojmë edhe këtë se një burrë sigurisht ka të drejtë kur ka nijet të sinqertë për martesë, ta shikojë gruan e tij të ardhshme a i përgjigjet dhe a është e bukur sipas shijes së tij. Madje kjo gjë është edhe e urdhëruar. Por, duhet të ngelë vetëm në kufijtë e shikimit. Atij nuk i është hallall të

shëtisë me një vajzë të panjohur, madje edhe të ngelë me të vetë, meqë nuk ekziston kurrnjë lidhje midis tyre para kurorëzimit. Shumë vajza të fejuara, pas një kohe të caktuar shpesh i ndërrojnë meshkujt.

Pejgamberi a.s. shpjegon shumë mirë një rregull të mirësjelljes:

“Asnjë grua nuk duhet t’ia rrëfejë vetitë e burrit të vet ndonjë gruaje tjetër, pasi për atë grua do të jetë sikur ta shikojë atë”³⁸⁸

Meqë ndonjëherë, propagimi dhe të mbushurit të mendjes së dikujt, mund të jetë më efikas se sa shikimi me sy.

Mund të vërtetohet se një lloj fanatizmi i tepruar, është pengimi i dorështërëngimit midis një gruaje dhe një burrit që janë mahrem! Por, që të besohet se s’bëjnë asnjë ndikim dorështërëngimet dhe puthjet në nëndijen ose dije e njeriut, do të jetë gjë shumë naive. Megjithatë ka edhe përjashtime.

“...Mund të shtohet prej dikujt se ekzistojnë edhe puthje të cilat shprehin edhe tjetër gjë veç epshit seksual. Por, numri i puthjeve të këtilla është shumë më i vogël se sa ato që njerëzit naivë shpresojnë se krijojnë afërsi, meqë ndjenjat për seks janë të vendosura thellë brenda jetës shoqërore, me një forcë më të madhe nga ajo hipotezë e pambështetje.”³⁸⁹

Një gjë tjetër që i nxit ndjenjat për seks, është zëri.

“Ngjyra e zërit, arija që merr tingull duke e shqiptuar veç e veç çdo fjalë - ndoshta nuk është dukuri e rëndësishme por, jashtëzakonisht ndikon në tronditje dashurie.”³⁹⁰ Ka fetishizëm rreth tingullit (ndjenjat e tepruara deri në shprehi). Për shembull, disa thonë femrat me zë të trashë. Ka shumë gra të cilat duke u dashuruar në zërin e ndonjë burri, lëshojnë familjet dhe fëmijët dhe ikin për ta.³⁹¹ Zinaja e veshëve është zëri që ngacmon epshet për marrëdhënie seksuale. Në Kur’anin Famëlartë grave të Pejgamberit a.s. u jepet këshillë që të mos llastohen në të folur, sepse kjo mund të bëhet shkas që të lakmojë ai që ka sëmundje në zemër. Ndaj duhet që fjala të shprehet normalisht.³⁹² Kjo gjë vlen edhe për gratë tjera.³⁹³

Rrëfimet e çuditshme të ekspertëve të psikologjisë, flasin se rrapëllima e zëshme e këmbëve nxit shqetësim seksual.³⁹⁴ Në Kur’anin Famëlartë u urdhërohet grave:

“Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre...”³⁹⁵

Kjo don të thotë, të mos i shfrytëzojnë tingujt e këmbëve për të qenë sa më tërheqëse.³⁹⁶

Këngët dhe instrumentet muzikore

Lejon vallë feja këngë dhe muzikim me instrumente muzikore? Rreth kësaj çështje ekzistojnë mendime të ndryshme. E para, siç shënuam më lartë, duke u argëtuar ma dajre ditëve të bajramit dhe dasmave, të këndohet ndonjë këngë, nuk është mëkat.³⁹⁷ Është ky një argëtim, gëzim dhe emocionim i muslimanëve. Kur po kthehej nga një betejë, para Pejgamberit a.s. erdhi një shërbëtoze zezake dhe i tha: O i Dërguar i All-llahut, nëse të kthen All-llahu xh.sh. nga beteja shëndosh e mirë, kam vendosur që t'i bij dajres. Ç' thua për këtë? E i Dërguari i All-llahut i tha: **“Nëse vërtetë ke vendosur, atëherë bjeri darjes, e nëse nuk ke premtuar, s’do të mundesh t’i bijsh.”** Dhe shërbëtorja i ra dajres.³⁹⁸ Nga ky hadith del se është e lejuar të përdoret dajreja (pa xhingla), të këndohen marshe dhe këngët tjera nga ngjarjet e rëndësishme siç janë betejat.

Lidhur me këtë temë flet edhe një hadith tjetër nga i Dërguari i All-llahut:

“Do të ketë njerëz të atillë nga ummeti im, të cilët do t’i bëjnë hallall zinanë, mëndafshin, pijet që shkaktojnë gjendje të dehur dhe çallgitë.”³⁹⁹

Edhe pse ka edhe disa hadithe tjera lidhur me këngët, çallgitë, vërtetohet se ata janë të dobët.⁴⁰⁰

Disa kanë vërtetuar se këndimi kolektiv është haram. Edhe Birgivi në veprën e tij *“Tarikat-i Muhammedijje”* e thekson të njëjtën gjë. Por, ky është mendim i gabuar. Nuk është i vogël numri i as’habëve dhe i tabiinëve dhe i imamëve të medhhebeve, të cilët nuk e quajnë haram. Gjithashtu shejhul Islami i asaj kohe, Ebussuud Efendiu në letrën që ia dërgon Birgivit, thotë se nuk është e vërtetë se për këtë temë ekziston ujdi (ixhma), meqë as’habët, tabiinët dhe imamët e medhhebeve këtë e qanin ose mubah ose mekruh (mubah: kryerja e një akti që s’është as gjynah as sevap. Mekruh: punë që llogaritet e shëmtuar).⁴⁰¹ Shevkani në librin e tij *“Nejlu’l-evtar”* pas një shpjegimi të gjatë të argumenteve dhe mendimeve të dy palëve, shënon se kjo vazhdon të jetë e dyshimtë edhe pse nuk është haram, ndaj njerëzit duhet të ruhen nga dëgjimi i këngëve që veçanërisht flasin për dashurinë dhe gruan. (v. VIII, fq. 109).

Meqë vargjet e këndshme poetike, me valle të bukura dhe gjëra të ngjashme i interesojnë edhe sufizmit, përkatësit e sufizmit insistojnë shumë për këtë temë dhe diskutojnë shumë me ata që mendojnë ndryshe. Në misticizëm kjo quhet *“Sema”*. Imami Suhraverdi në veprën e tij *“Avarifu’l-maarif”* kësaj teme i kushtoi një vend të posaçëm.⁴⁰²

Gazaliu në veprën e tij *“Ihja”* në një pjesë të madhe të librit lidhur me semanë (ritual religjioz i dervishëve) pas theksimit të mendimeve të ulemasë, thotë se nuk ka asnjë argument se semaja është haram. Përkundrazi nassi dhe kijasi (*nass*: argumente nga ajetet në Kur’an dhe hadithet; *kijas*: metodë islamike që nga një çështje për të cilën ka tekst decid, analogjikisht nxirret vendimi për një çështje për të cilën nuk ka “nass”) vërtetojnë se kjo është mubah nga aspekti fetar. Por njofton se si haram janë llogaritur instrumentet muzikore, nëse ato janë shkaktoze për gjërat që me fenë janë të ndaluara e haram, siç është pija alkoolike. Sipas Gazaliut në pesë raste janë haram kënga dhe çallgia:

- a) Të dëgjuarit e individëve që nuk janë mahrem dhe me zërin e të cilëve mund të nxiten ndjenjat seksuale;
- b) Çallgitë, të cilat do të jenë shkaktoze të harxhimeve të kota dhe shkapërderdhjeve, si dhe shkaktoze të një pune që është e ndaluar;

c) Këngët për prostitucionin, këngë që shpifin për All-llahun dhe për të Dërguarin e Tij si dhe për ashabët, ose ato që në mënyrë të hapët e përshkruajnë gruan;

d) Haram është edhe të dëgjuarit e një njeriu që është shumë i ri e nën ndikim të egos dhe të epsheve të tij, e që ato që i thotë (këngëtari), çojnë në sjellje që është haram;

e) Është e ndaluar nëse e harxhon kohën kot së koti, madje edhe nëse dëgjuesi është nga populli i thjeshtë dhe kënga s'ka ndikim as pozitiv as negativ ndaj tij.⁴⁰³

Konkluzion: Sipas mendimit tim, s'është me vend të jipen gjykime se kënga dhe çallgia, (që deri tani thuhej se janë hallall, mubah, mekruh dhe haram), janë hallall absolut ose haram absolut. Problemin duhet shikuar në këtë mënyrë:

a) S'ka kurrfarë dëmi në organizimin e ndonjë argëtimi në momentet e kënaqshme hallall, në rastin e ditëve fetare, kombëtare, dhe festa, siç janë për shembull dasmat, bajramet, luftërat, shkuarja në haxh etj.

b) Janë këngët e çallgitë që do të shkaktojnë shqetësime seksuale, tubimi i burrave dhe grave që krijojnë kushte që janë haram sipas fesë, siç janë pija e bixhozi, që veç tjerash na e marrin kohën dhe pengojnë në kryerjen e obligimeve. Shkurt, janë haram të gjitha ato që shkaktojnë të këqia dhe amoralitet.

Jeta përbashkët
e grave dhe burrave

Në moralin Islam nuk lejohet që njerëzit e dy gjinive të qëndrojnë bashkë nëse nuk janë mahrem. Nuk lejohet që këta të mbyllen vetë në një dhomë. Është theksuar se personi i tretë midis atyre që nuk janë mahrem është shejtani.⁴⁰⁴ Në një hadith thuhet:

“Prej sot asnjë burrë të mos hyjë tek gruaja burri i të cilës nuk gjendet me të. Po qe e domosdoshme të hysh, atëherë le të jetë me ty një ose dy shokë.”⁴⁰⁵

Në një tjetër hadith thuhet:

“Mashkulli të mos hyjë tek gratë, burrat e të cilave nuk janë me to, meqë shejtani, si gjaku hyn nën lëkurën e njeriut.”⁴⁰⁶

Ju ofrojmë një shembull për kujdesin që i jepet këtij parimi në shoqërinë islame: Gruaja e Pejgamberit a.s. Safija shkoi tek i Dërguari i All-llahut që ishte i zënë me ibadet në xhami. Pas një bisede të shkurtër Safija dëshiroi të kthehet në shtëpi. Pasi ishte natë, i Dërguari i All-llahut deshti ta përcjellë. Derisa Pejgamberi a.s. dhe gruaja e tij shkonin rrugës, dy veta nga muslimanët ensarë, kaluan me nguti skaj tyre. Pejgamberi a.s. u tha: **“Mos u ngutni, pranë meje është bija e Hujetit, Safija (gruaja ime).”** E ata thanë: **“Subhanall-llah! (vallë për ty do të mendojmë diç të keqe?)”** Pejgamberi a.s. shtoi: **“Shejtani hyn në njeriun si qarkullimi i gjakut. Edhe unë u frikësova dhe juve t'mos ju ketë hyrë në zemër.”**

Një ditë Pejgamberi a.s. as'habit të tij i tha:

“Asnjë burrë të mos ngelë sy më sy me një grua, mahremi i së cilës s’është me të. Gruaja të mos udhëtojë pa mahremin e vet. Një i pranishëm e pyeti: -O i Dërguar i Zotit, gruaja ime shkoi në haxh e unë u paraqita për luftë. Pejgamberi a.s. e urdhëroi: -Atëherë shko me gruan tënde dhe bashkarisht kryeni haxhin”.⁴⁰⁷

Jeta grua - burrë

“Në jetën shoqërore të sotme kënaqësia, mjerimi, dëshira e flaktë për stoli, veçanërisht jeta qytetare, mbledhjet dhe argëtimet, qejfet me pije, në tryezën e bixhozit: gruas i bëhet truri vërdallë dhe në këtë rrugë ndjen një dobësi...” Këto fjalë dalin nga vepra “*Tradhëtia*” autor i së cilës është një mjek që i është rrekur temës “Seksi dhe kurora”.⁴⁰⁸

Shoqëria islame s’është shoqëri ku nuk takohet asnjë grua në vendet publike, siç është rruga, tregu... Është gjë normale se gruaja do të del në rrugë, do të shkojë në treg që të kryej punët e veta, për nevojat e veta, madje edhe për rekreim. Por nuk është ajo shoqëri islame ku gruaja dhe burri pa kurrfarë kushtesh dhe nevoje gjenden njëri pranë tjetrit intimisht të përzier.

Bile edhe ata shkencëtarë të seksologjisë dhe ata shkrimtarë të cilët nuk i marrin parasysh rregullat morale dhe fetare, si dhe parimet shpirtërore, thonë se në afërsinë e dy gjinive ekzistjnë ca parime dhe rregulla. Psh. flerti. Në leksikone, flerti definohet kështu: “*Dashuri midis dy palëve pa shkuar larg në të*”. Në librat e seksologjisë e njëjta gjë shprehet kështu: “*Një marrëveshje e sinqertë midis femrës dhe maskullit në kufinj të edukatës që do të dashurohen dhe do ta ngazëllejnë njëri tjetrin dhe të provojnë se a do të vazhdojë ky ngazëllim dhe argëtim.*” Nëse këto definicione shprehin sinqeritetin, atëherë na imponohet një pyetje: Cili do t’i kontrollojë këta të rinjë që dashurohen dhe gjejnë kënaqësi dhe ngazëllim ndaj njëri tjetrit, që të mos e teprojnë deri sa janë në lidhje dashurie e të mos i tejkalojnë kufijtë? Vallë vetë ata do ta kontrollojnë derdhjen e ujit të kënaqësive fizike, kur digjen në flakën e dëshirave seksuale? Këtë e demanton (përgënjeshtrojnë) vetë natyra e njeriut, e mbi të gjitha realiteti dhe praksa e sotme. Nëse ekziston sinqeritet në mendimet e përkrahësve të flertit, feja Islame nuk e lejon këtë marrëzi, nuk e lejon as hipokrizinë dhe gënjeshtren.

Mund të ketë dobi nga shoqërimi midis femrës dhe maskullit. Në çfarëdo sistemi qoftë, nuk është e thënë të mos ketë dobi nga ky shoqërim. Vehen në peshojë punët se cilat janë të dobishme e cilat jo. Cila anë të peshojë, për atë anë jepet gjykimi. Po u pyet vjedhësi, ai do të thoshte - s’ka gjë më të dobishme se vjedhja.

Theksohen dy dobi nga shoqërimi i meshkujve dhe femrave:

1. Ky shoqërim gruas i sjell dituri, përvojë dhe sprovë. Dituria për jetën nuk fitohet në shkollë por në vetë jetën. Kjo mund të arrihet në një jetë të përbashkët midis gjinive. E burri do të mësojë për sjelljet e mira dhe gjentile si dhe për bukuritë e këtij shoqërimi.

2. Një shoqëim i këtillë midis dy gjinive do të nxisë kërshërinë e cila e shpreh dhe dëshirat e palëve do t'i zbusë, e kështu do të bëhet edhe edukimi seksual e nga ana tjetër do të zvogëlohet prostitucioni.

Por, një shoqërim i këtillë nuk do t'i japë gruas dituri të mjaftueshme. Detyra e gruas është që ajo të jetë nënë. E kjo gjë nuk mësohet nga mashkulli. Progresi perëndimor në planin material vyshket për shkak të shoqërimit të burrave me gra. Dhe, nëse pajtohemi se shoqërimi i gjinive ka kontribuar në diçka, dëmet janë shumë më të mëdha: degjenerimi në planin moral, rritja e kriminaliteteve të ndryshme.

Nuk mund të pranohet as ajo se jeta e përzier zvogëlon kërshërinë midis gjinive, as ajo se prostitucioni do të zhduket. Përzierja nuk zvoglon entuziazmin. Sikur t'ishte ashtu, burri nuk do të duhej të hynte në marrëdhënie me gruan e vet pas martesës. Gruaja sado që do të shoqërohet me burra, do t'i rritet epshi dhe fillon të harxhojë për veshmbathje dhe për gjëra luksoze. E kjo është një goditje financiare. Vendet e Evropës, ku më së shumti praktikohet jeta e përzier midis femrave dhe meshkujve, janë vende ku më së shumti është i zhvilluar prostitucioni. Nëse përzierja me gra, meshkujve u sjell njëfarë ftohje, njëfarë neverie, edhe kjo nuk është gjë e lavdishme. Mospasje të njëfarë tendence, ndjenje ndaj femrës, don të thotë “feminizim i tij”, rënia ose asgjësimi i burrërisë së tij. Kuptohet, edhe kjo nuk është gjë e dëshirueshme.

Moda

Në besimin islam shëndetit i jepet rëndësi e merituar. Gjërat që janë të dëmshme për shëndetin (pija, bixhozi etj) në Islam ndalohen.

All-llahu i krijoi njerëzit në dy gjini, femra dhe meshkuj. Forma e trupit të tyre ndryshon. Në Islam është i ndaluar mashkullarizimi i femrës dhe feminizimi i mashkullit, ose gjasimi meshkujve femrave dhe anasjelltas si me imitimin në të folurit dhe sjelljet e gjinisë së kundërt, ashtu edhe nëpërmjet të ndryshimeve të organeve trupore, madje edhe veshmbathjes. Është kjo humbje e personalitetit, rënie e moralit dhe sëmundje shpirtërore. Ibën Abbasi thotë kështu: **Pejgamberi a.s. i mallkoi ata njerëz që tentojnë t'u gjasojnë grave, ose ato gra që tentojnë t'u gjasojnë burrave, dhe thotë: “Largoni nga shtëpitë tuaja!” Ai vet e shporri filanin, dhe ‘Umeri e largoi filanen (nga Medina).⁴⁰⁹ Para të Dërguarit a.s. e sollën një njeri që kishte vënë kanë (ngjyrë) në duar e këmbë. Kur ai e pyeti: Ç’është kjo?” ky u përgjegj se dëshiron t'u gjasoj grave. Pejgamberi a.s. lëshoi urdhër ta shporrin në Nakë. E pyeti as’habi: O i Dërguar i All-llahut, a ta vrasim? Pejgamberi a.s. i tha: “Më është ndaluar t'i vras ata që falen.”**

Profesori Maz’har Osman thotë kështu:

“Për mua është leksion histerie i pakohshëm grimi i një vogëlushje të bukur si kukull, të lyerit e buzëve të saj, fytyrës dhe syve të saj, stolisja e gishtave dhe e veshëve me xhingla. Gjithashtu veshja e vashave të vogla me petka meshkujsh dhe përpyekja që tek ajo të mbijë narcizmi dhe safizmi (narcizmi: të dashuruarit në vetëvete - vetëpëlqim, ndërsa safizmi - të ushtruarit e dashurisë midis dy femrave). Bredhjet dhe jeta e fëmijëve duhet të jenë të drejtura me një mençuri.”

Sipas shënimeve të Neveviut, floku i huaj nuk i vehet njeriut, meqë pjesët e trupit duhet të respektohen. Ato s’duhet të shfrytëzohen por, futen nën tokë.⁴¹⁰ Nëse dikush dëshiron të stoliset me qime kafshësh, qimet duhet të pastrohen para se të vehen, po qe e mundur kjo gjë dhe po e dëshiroi këtë gjë burri.⁴¹¹ Me lejen e burrit është e lejuar podra për fytyrë dhe kana për duar.⁴¹² Pasi me këto nuk bëhet asnjë ndryshim në organet e trupit edhe kjo gjë bëhet për burrin e vet e jo për marrëdhënie të palejueshme me dikë tjetër. Nuk është mëkat që gruaja të përdorë kanën dhe parfumin, por vetëm për burrin e vet. Lidhur me këtë bën fjalë një hadith nga Aisheja r.a.⁴¹³ Por, gjithsesi parfumi është i ndaluar për gratë që duan të dalin jashtë. Dihet mirë efekti i parfumit në marrëdhëniet seksuale. Pejgamberi a.s. thotë:

“Secili sy bën zina. Kështu është zina edhe parfumi i gruas që të kalojë pranë burrave.”⁴¹⁴

Midis burimeve të “persioneve seksuale”, për të cilat psikiatrët bëjnë hulumtime të gjata, traditat dhe zakonet, edukata, dhe, me një fjalë, moda, zë vend të rëndësishëm.⁴¹⁵

Ta përfundojmë këtë temë me një hadith të Pejgamberit a.s.:

“Janë dy kategori të banorëve të Xhehennemit: ata që do të kenë në dorë kamxhikun si bisht lope, dhe me të rrahin popullin; dhe gratë me gjymtyrë të zhveshura (ato që duke i mbuluar pjesët jotërheqëse të trupit, i zbulojnë pjesët tërheqëse, ose ato që bartin petk të tejdukshëm, ku duket ngjyra e lëkurës së tyre) e shkojnë duke i thyer gjymtyrët me lazdrim dhe me kokë të rregulluar si deve Horosani. Këto nuk mund të hyjnë në Xhennet dhe as që mund ta nuhasin erën e Xhennetit. E aroma e Xhennetit ndihet aq larg.”⁴¹⁶

t T

IV. Dënimi për zinanë

Në të drejtën e egjiptasve të vjetër, zinjaja është pranuar si sulm kundër të drejtave tjetrit dhe të moralit shoqëror. Burrit që bënte zina i shkurtrohej organi gjenital e gruas për të njëjtën gjë i prehej hunda.⁴¹⁷

Në të drejtën babilonase, gruaja e martuar që kapej në zina dënohej me vdekje dhe së bashku me bashkëfajësin hidhej në ujë. Mund të shpëtonin nëse burrit të kapur në zina ia falte sundimtari ndërsa gruas bashkëshorti. (Ligji i Hamurabit, neni 129). Me këtë ligj njeriu që me dhunë ia merrte virgjinitetin femrës, dënohej me vdekje (Neni 130). Gruaja që nuk kapet në flagrancë, e paditet nga ana e burrit, do të shpëtojë duke u betuar. Nëse kurdiset akuza nga një person tjetër, gruaja dërgohet në testim, në lum. (Neni 131, 132). Prostitucioni midis farefisit të ngushtë dhe mahremëve dënohej me internim, hedhje në zjarr ose në ujë me duar të lidhura. (Neni 153, 155-156)⁴¹⁸

Është përshkruar gjendja e një gruaje që u nda nga burri për shkak të zinasë, në dokumentet e së drejtës babilonase, me anë të ligjit të Hamurabit: Duke ia vënë një nishan në gjoks, burri e shporrte nga shtëpia. Dhe kurrë më nuk do ta pranojë në shtëpi si grua të veten. E vetmuar do të bredhë nëpër rrugë të qytetit dhe do t'i dorëzohet zinasë. Gjykatësi do ta detyrojë të qëndrojë në shi dhe ta kafshojnë gjarpinjtë. Prindët nuk do ta njohin si të veten. Dënimi i shqiptuar kurrë nuk do t'i falet.⁴¹⁹

Në Kinë sjelljet kundër edukatës së përgjithshme dhe moralit dënoheshin me sterilizimin e burrit (tredhje). Dënimi për përdhunim ishte prerja e këmbëve.⁴²⁰

Në të drejtën mongoleze, në fillim, sulmi kundër nderit të gruas së martuar, dënohej me vdekje. Por, më vonë për zina, bëhej dhurimi i një kalit nga burri që ka bërë zina burrit të vërtetë, e më pastaj edhe falja e nëntë krerë kafshë gjykatësit dhe puna qëtësohej.⁴²¹

Edhe tek japonezët dënimi për zina ishte vdekja.⁴²²

Sipas të drejtës brahmane, zinjaja dënohej vetëm me gjobë në të holla.⁴²³ Por, sipas *manu* ligjeve dënimi për prostitucion ishte internimi. Gjithashtu ishte e ndaluar t'i shikosh gratë në vende të fshehura, dërgesa e dhuratave, të prekurit me dorë. Gruaja që kryente zina u hidhej qenve ta coptojnë, ndërsa burri, për zina hidhej në zjarr.⁴²⁴ Sipas institucioneve të Naradës s'ishte haram që mashkulli të ketë marrëdhënie me femrën e pamartuar. Por, zinjaja me një grua të rangut më të lartë dënohej me vdekje.⁴²⁵

Dënimi për zina sipas Biblës

Në Dhiatën e Vjetër: Një djalë beqar po fjeti me dhunë me një vajzë të pamartuar, do të jetë i obliguar të pagojë 50 mithkalë argjend. (1 mithkal: 4, 8 gramë). Vajzën do të jetë i detyruar ta marrë për grua dhe gjatë tërë jetës nuk mund të ndahet nga ajo.⁴²⁶ Por, nëse babai i vajzës nuk dëshiron ta japë për të, bërësi i zinasë do të pagojë sipas mehrit të virgjërve.⁴²⁷ E, po bëri dikush zina me të bijën e një kleriku do të dënohet me vdekje, e vajza hidhet në zjarr, me qëllim që të ruhen traditat fetare.⁴²⁸ Nëse një burrë bën zina me një grua të martuar, do të dënohet në qendër të qytetit duke u goditur me gurë. Nëse mashkulli këtë e ka bërë me dhunë, ai vritet e gruaja nuk preket.⁴²⁹ Edhe hebrenjtë, përsikaj këtyre normave të qarta, hoqën dorë t'i praktikojnë këto dënime, madje këtë e filluan një shekull para erës së re.⁴³⁰

Në krishterizëm: Hebrenjtë sollën një prostitute para Isës a.s. dhe kërkuan të gjykohej. Qëllimi i tyre ishte që Isën a.s. ta vënë në situatë të vështirë: Po të vëndosë ai që atë grua ta mbysin duke e goditur me gurë, të thonë: Po dëshiruat ta pranoni fenë e Isës, të gjithëve do të na vrasin me gurë. E nëse nuk vendos ai ta vrasin me gurë, kësaj radhe do të thonë: Isa jep gjykime kundër punëve të shtruar mirë në librin tonë. Një lloj i këtyllë i intrigave (fitëve) del nga marifetllëqet e tyre. Isa a.s. nuk ishte as gjykatës zyrtar, as i autorizuar të shqipëtojë dënime. Ndaj nuk dha gjykim për dënim me vrasje me gurë dhe, ja, të krishterët nxorrën gjykimin se: Zinaja e të pamartuarve është mëkat por, ata s'mund të dënohen. Nëse njëra ndër dy palët në zina është e martuar, ky bën faj për prishjen e betimit. Ndërsa dënimi është kërkesë, për ndarje prej palës tjetër para gjyqit. Madje bashkëshorti mund të kërkojë dëmshpërbim nga personi që ka bërë zina me gruan e tij. Por një gjykim i këtyllë nuk funksionon, për shkak se sipas ligjeve krishtere asnjëra nga palët nuk mund të kurorëzohet deri në fund të jetës.⁴³¹

Zinaja nga aspekti i Islamit

Për peshën dhe mëkatën e madh të zinasë në Islam, t'i theksojmë fjalët e Pejgamberit a.s.:

“O ummeti im, nuk ekziston askush që hidhërohet më shumë se All-llahu kur Ai shikon robin e vet duke bërë zina, qoftë grua ose burrë. O ummeti im, ta kishit ditur ju atë që e di unë, me siguri do të qeshnit pak e do të qanit shumë.”⁴³²

Sipas të drejtës islame, zinaja, nuk është vetëm çështje personale por edhe problem shoqëror, pasi është në lidhje me ekzistimin dhe shpëtimin e shoqërisë islame në përgjithësi. Lejimi i zinasë do të çojë kah zgjerimi i amoralitetit e ky çon kah shkatërrimi i familjes e me të edhe kah shkatërrimi i shoqërisë. Por, Islami deri në shkallën e fundit e respekton dhe synon ekzistimin dhe vazhdimësinë e shoqërisë islame me marrëdhënie të forta.⁴³³

Të fajësuarit për zina

Sa është kundër dinjitetit dhe krenarisë njerëzore zinaja, kuptojmë edhe nga dënimi në të drejtën islame. Në Islam, është njëri nga mëkatet më të mëdha fajësimi i një gruaje të ndershme për zina. Në Kur'anin Famëlartë thuhet:

“Vërtetë ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim i madh.”⁴³⁴

Pejgamberi a.s. njërin ndër shtatë mëkatet më të mëdha që mund ta shkatërrojnë njeriun e llogariste “shpifjen kundër një gruaje besimtare, që është e ndershme dhe nuk din asgjë për të keqen”⁴³⁵.

Dënimi për atë që shpif për zina, është 80 shkopinjë dhe mospranimi i dëshmisë së tij deri në fund të jetës.⁴³⁶ Nëse bashkëshortët akuzojnë njëri tjetrin për zina dhe nëse nuk mund ta vërtetojnë atë, gjykatësi do të vendosë për ndarjen e tyre dhe do t'i shkurojë.⁴³⁷ Kjo quhet “*lian*”. Nëse nuk kryhet ndarja, ata e meritojnë dënimin e barabartë.⁴³⁸ Të njëjtin dënim e merr edhe ai që akuzon një musliman për homoseksualizëm dhe marrëdhënie me kafshët.⁴³⁹ Nuk ka dënim të këtillë nëse akuzohet ndonjë musliman për ateizëm, pasi është e mundur të përgënjeshtrohet një akuzë e këtillë dhe të argumentohet se njeriu është i pafajshëm. Lehtë do të kuptohet çështja kur të kryhen obligimet që kërkon Islami. Por akuza për zina, nuk është ashtu. Do ta njollojë njeriun, do t'ia prekë dinjitetin. Personi i akuzuar shumë vështirë mund të japë argumente pafajësie.

Dënimi për kryerjen e zinasë

Në të drejtën islame dënimi për kryerjen e zinasë për të pamartuarit është njëqind shkopinjë.

“Laviren dhe lavirin t'i rrihni, secilin prej tyre me njëqind shkopinjë dhe në zbatimin e Urdhërave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj fajtorëve, nëse jeni të atillë që i besoni All-llahut dhe botës amshuese. E gjatë zbatimit të ekzekutimit të dënimit le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh.”⁴⁴⁰

Pos kësaj gjykatësi mundet, nëse e gjen të nevojshme, t'u japë një vjet burg ose internim. Sipas malikijve, shafijve dhe hanbelijve, gjykatësi është i detyruar të ekzekutojë dënimin e këtillë.⁴⁴¹

Dënimi për zina i të martuarve është vrasja me gurë. Kështu ka urdhëruar dhe ka praktikuar Pejgamberi a.s. ‘Umeri thotë se ky dënim është konstituuar me Kur'an dhe sunnet.⁴⁴² Zina është edhe akti i të paguarit të një gruaje që të bëjë kontakt seksual. Nëse ai është i pamartuar dënohet me njëqind shkopinjë, e nëse është i martuar do të dënohet me vrasje me gurë. Të njëjtin dënim e meritojnë mahremët që bëjnë zina me pjesëtare të farefisnisë, afërsisë së gjakut dhe qumështit.⁴⁴³

Por të vërtetuarit e zinasë dhe praktimi i këtyre ndëshkimeve nuk është punë e lehtë. Nëse bëjmë një analizë sadopak të vogël, do t'u jipet përgjigje atyre që mendojnë se ky dënim është i rëndë.

Zinaja është të hyrit në marrëdhënie të dy personave që s'janë të kurorëzuar. Kjo gjë argumentohet në dy mënyra:

a) Me dëshmi të katër burrave dëshmitarë. Ata duhet ta kenë parë vetë personalisht aktin e zinasë. Më pastaj, ata duhet të disponojnë cilësi - duhet të jenë të drejtë dhe të ndershëm. Nëse janë më pak se katër persona, ose nuk i posedojnë cilësitë që u përmendën më lart, atëherë akti i zinasë nuk do të vërtetohet. Atëherë, ata që kanë ardhur të dëshmojnë, trajtohen si shpifës dhe dënohen për gënjeshtëri. Nëse katër personat para se të dëshmojnë për aktin e zinasë tërhiqen, do të pësojnë dënim me nga tetëdhjetë shkopinj, ndërsa i akuzuari do të lirohet.

b) Pranimi i vetë të akuzuarit, mentalisht të shëndoshë, në katër vende të ndryshme, se ka bërë zina, gjykatësi gjithnjë do të mohojë, do ta mbrojë me fjalët: gabon, ndoshta ke qenë në ëndërr, akti i zinasë nuk është real... Këtë (person) do ta analizojë veçanërisht nga aspekti i mendjes dhe memorjes. Por nëse ai ende insiston ta pranojë, gjykatësi do të kumtojë vendimin. Por, nëse ky që vetëpranoi, pendohet, para ose gjatë ekzekutimit të dënimit, ai megjithatë do të lirohet. Kur ndëshkohet dikush për zina me dëshminë e katër dëshmitarëve, me vrasje me gurë, gurët e parë do t'i hedhin vetë dëshmitarët. Nëse dikush nga ata nuk e kryen këtë obligim, ndëshkimi në këtë mënyrë nuk do të ekzekutohet. Nga ky shpjegim kuptohet se në praksë është vështirë dhe shumë rrallë mund të vërtetohet akti i zinasë dhe fajtorët të dënohen me dënimin e merituar në këtë botë. Në të drejtën islame duke i shfrytëzuar të gjitha rastet dhe motivet shkohet kah ajo që t'i iket dënimit. Pejgamberi a.s. thotë:

“Largoni muslimanët nga dënimet dhe kufizimet sa të mundeni. Po pati mundësi për shpëtim, lironi të akuzuarit. Me siguri është shumë më e dobishme që gjykatësi të gabojë duke falur se sa duke dënuar.”⁴⁴⁴

Kjo don të thotë se në të drejtën islame e dhëna për aktin e zinasë, para së gjithash e tregon përgjegjësinë për këtë gjë. Ekzekutimi i dënimit ka karakterin edukues, të ruajtjes së moralit publik etj.⁴⁴⁵ Të theksohet edhe kjo se gjykatësi, gruas dhe burrit, që është vërtetuar se ishin në marrëdhënie imorale, nëse bëhet fjalë për punë imorale që nuk janë zina në plotkuptimin e fjalës, mund të caktojë dënim përkatës, me kusht që ai dënim të jetë proporcional me veprën, më i vogël sesa dënimi për zina (*ta'dhir*). Mirëpo mos ekzekutimi për zina, pasi nuk vërtetohet, nuk e shpëton fajtorin nga përgjegjësia shpirtërore.

Martirët e urdhërave
të All-llahut

Edhe pse ekzistojnë dënime kaq të rrepta për zina, kishte edhe nga edhe burra besimtarë që, duke ardhur tek Pejgamberi a.s., rrëfyan zinanë e vet duke insistuar në të, që i Dërguari ta pranojë dhe të bëjë ekzekutimin për zina. Këta u ndëshkuan me vdekje dhe u bënë martirë të urdhërave të All-llahut.

Ebu Hurejre dhe një as'hab tjetër thonë: Një ditë tek Pejgamberi a.s. erdhi një njeri nga fisi Eslemi me emrin Mais dhe tha:

-O i Dërguar i Zotit, më pastro! Pejgamberi a.s. i tha:

-Medet sa dëm! Kthehu në shtëpi dhe lutju All-llahut për falje dhe pendim. Pas një kohe ky përsëri erdhi. I tha të njëjtat fjalë, e i Dërguari i All-llahut i dha të njëjtën përgjigje. Dhe, kur kjo u përsërit për të katërtën herë, i Dërguari i All-llahut e pyeti:

-Për çka të të pastroj? Ai i tha:

-Për zina. (Ai kishte bërë zina me një robëreshë.) Më pastaj Pejgamberi a.s. i pyeti fqinjët dhe fisin e Maisit:

-Është ai i marrë ose normal? Ata i thanë se është njeri i mirë dhe i mençur. Atëherë Muhammedi a.s. e pyeti Maisin:

-Ndoshta atë që ke bërë s'ka qenë akt zinaje? Mos po gabon? E ky u përgjegj:

-Epsi im i poshtër e bëri këtë akt. Dhe, kur shtoi se ishte në kurorë, i Dërguari i All-llahut urdhëroi ta vrasin me gurë, e urdhëri i tij u realizua. Populli që mori pjesë në këtë ekzekutim u nda në dy pjesë: Njëra pjesë thoshte: mëkati e mbuloi. Maisi u rrëzua. Pjesa tjetër thoshte: Nuk mund të ketë pendim më të madh se sa që ishte pendimi i tij. Erdhi vetë tek Pejgamberi a.s. dhe kërkoi të ndëshkohet me vdekje. Pas dy-tri ditëve i Dërguari a.s. erdhi tek as'habët, i përshëndeti, u ul dhe u tha:

-Lutuni për faljen e Maisit!; e ata thanë,

-All-llahu le ta falë Maisin; i Dërguari i All-llahut shtoi:

-Ai aq shumë u pendua, sa që po të ndahej ai pendim i tij në një popull, të gjithëve do t'u mjaftonte, madje edhe do të tepronte.”⁴⁴⁶

Pas një kohe erdhi një grua nga fisi Xhuhajne dhe të Dërguarit a.s. i tha:

-O i Dërguar i Zotit, më pastro! Pejgamberi a.s. i tha:

-Shko në shtëpi dhe lutju All-llahut për falje dhe pendohu. Të nesërmen ajo erdhi përsëri dhe shtoi:

-O i Dërguar i All-llahut, ndoshta ti po më largon siç e largove Maisin. Për Zotin unë jam shtatëzane (si rezultat i zinasë). Pejgamberi a.s. e urdhëroi:

-Atëherë të shkosh e ta lindësh fëmijën! Pas një kohe e njëjta grua erdhi me një fëmijë në dorë dhe Pejgamberit a.s. i tha:

-Ja, e linda. Kësaj rradhe Pejgamberi a.s. e urdhëroi kështu:

-Shko dhe ushqej derisa të mos e ndërprejë qumështin! Kur erdhi përsëri, Pejgamberit a.s. i tha:

-O Pejgamber i All-llahut! E përfundova të ushqyerit e fëmijës me qumësht. Tani ai ushqehet me lëndë ushqimore (Ia tregon copën e bukës). I Dërguari i All-llahut ia dorëzoi fëmijën një ensarit dhe urdhëroi që gruaja të dënohet me vdekje. Kur përfundoi ekzekutimi i dënimit me vdekje ai personalisht ia fali namazin e xhenazes. ‘Umeri i tha:

-O i Dërguar i Zotit, ajo bëri zina. Si mundet t'ia falish xhenazen? E Pejgamberi a.s. i tha:

-Ajo u pendua aq shumë sa që sikur të ndahej ai pendim në shtatëdhjetë njerëz nga Medina, do të tepronte. O ‘Umer, a mund të gjesh diçka më të vlefshme nga pendimi i një gruaje, e cila e flijoi jetën e vet për All-llahun?”⁴⁴⁷

Prostitucioni midis njerëzve nga e njëjta gjini

Homoseksualizmi

Ata njerëz që kërkojnë kënaqësi seksuale nga e njëjta gjini që është kënaqësi e marrë, bëjnë amoralitet të ndytë. Në Kur'anin Famëllartë shpallet se Luti a.s. i ka thënë fisit të vet që bënte këtë turpësi:

“Bëni një gjë të shëmtuar që, asnjë popull i botës nuk e bëri para jush. Vërtetë, ju të shtyer nga epshet, u afroheni burrave duke i braktisur gratë. Po, ju jeni popull i shfrenuar.”⁴⁴⁸

Në një ajet përmendet populli i Lutit si popull që bën një punë të ndytë e të shfrenuar.⁴⁴⁹

Hazreti Pejgamberi a.s. në një hadith thotë:

“I mallkuar është secili që bën punën e popullit të Lutit.”

Në hadith tjetër thuhet:

“Kur t’i takoni ata të shëmtuar që bëjnë homoseksualizëm, edhe ata që bëjnë, edhe atyre që u bëjnë punë të fëlliqura mbytni.”⁴⁵⁰

*“Bëhet një fëlliqësirë me qëllim përpjekjeje që bota të pranojë diçka se gjoja është natyrale të bëhet një dashuri e këtitllë, që është shumë larg nga shumëzimi natyral njerëzor. Hirschveld, njeri që fitoi reputacion të madh në lëmin e hulumtimit të marrëdhënive amorale, në monografinë me titull “Të poshtrit e Berlinit”, edhe pse vërtetoi se këta janë njerëz të sëmure dhe shumica janë shpirtërisht të krijuar me dy gjini, vërtetoi se secili rast nuk mund të mirret si sëmundje.”*⁴⁵¹

Sipas mendimit të përbashkët të dijetarëve islamikë, homoseksualizmi është haram. Ky është njëri ndër mëkatet e mëdhaja. Sipas Imam Malikut, Shafiut dhe Ahmed Ibën Hanbelit si dhe Imami Muhammed nga hanefijtë dhe Ebu Jusufit, homoseksualizmi dënohet si zina. Sipas disave, akterët e homoseksualizmit pa marrë parasysh se janë të pamartuar ose të martuar, rregullisht dënohen me vdekje. Sipas Imami Azamit, nëse akterët e kanë bërë shprehi këtë punë, dënohen me vdekje. Nëse nuk e kanë bërë shprehi do të dënohen me një dënim që do ta caktojë gjykatësi. Por, mendimi i grupit të parë është më i argumentuar.⁴⁵²

Safizmi

Një ndër perversionet seksuale janë edhe marrëdhëniet e gruas me gruan. Gratë që bëjnë safizëm, dënohen me dënim përkatës. Atyre nuk u jipet dënim zinaje.⁴⁵³ Pejgamberi a.s. ka këshilluar që njeriu normal të ruhet nga homoseksualizmi dhe safizmi, gjëra këto që janë kundër natyrës së njeriut dhe si gjëra të ndyta. Pejgamberi a.s. porositi që **“burri të mos ia shikojë organet seksuale burrit tjetër, por as gruaja të mos ia shikojë organet seksuale gruas tjetër. Që të mos gjenden nën një mbulojë burri me burrin dhe gruaja me gruan.”**⁴⁵⁴

Edhe marrëdhëniet me kafshë janë jonatyrore, haram. Pejgamberi a.s. thotë:

“Vritni njeriun që bën marrëdhënie me kafshët. Eliminoni edhe kafshën.”⁴⁵⁵

Siç ekziston një grup juristësh që marrin parasysh të gjitha argumentet për këtë çështje që e dënojnë këtë akt, ekziston edhe grupi tjetër që thuan se gjykatësi duhet të caktojë dënim më të vogël sesa ai për zina.⁴⁵⁶ Çfarëdo të jetë dënimi në këtë botë, s’ka dyshim se marrëdhëniet me kafshë janë haram sipas fesë, dhe janë gjë shumë e shëmtuar sipas moralit.⁴⁵⁷

t T

PJESA E DYTË

POZITA SOCIALE E GRUAS

- I. DËSHMIA DHE GRUAJA
- II. E DREJTA E ARSIMIMIT
- III. JETA E LIRË - NËPUNËSIA
- IV. USHTRIA, LUFTA DHE GRUAJA
- V. TË DREJTAT POLITIKE TË GRUAS

I. Dëshmia dhe gruaja

“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnjak, pse All-llahu di më mirë për ta...”

Kur’ani Famëlartë, (4): 135

Rëndësia e dëshmisë

Në të drejtën islame, dëshmia është mjete kryesor i argumentimit. Varësisht nga dëshmia e dy ose katër dëshmitarëve, përcaktohen të drejtat më të mëdha të robërve të All-llahut, dhe sillen dënime më të mëdha deri në vdekje. Një ditë, para të Dërguarit a.s. as’habët nxorrën një xhenaze. Të pranishmit nga as’habët e lavdëruan të vdekurin, ndërsa Pejgamberi a.s. tha:

-Atij i është caktuar Xhenneti; - pas një kohe të caktuar kaloi një grup me një xhenaze tjetër, as’habët e kritikuan të vdekurin. Pejgamberi a.s. tha:

-Atij i është caktuar Xhehennemi. -Kur e pyetën as’habët për ç’arsye, morën këtë përgjigje:

-Besimtarët janë dëshmitarë të All-llahut në sipërfaqen e tokës.

Një gjë e ngjashme ndodhi edhe në prani të ‘Umerit r.a.

Në Kur’anin Famëlartë është theksuar largimi i njerëzve nga adhurimi idhujve dhe ruajtja nga dëshmia e rrejshme. Një herë Pejgamberi a.s. rrinte me as’habët dhe i pyeti tri herë:

-A dëshironi t’ju njohtoj me mëkatën më të madh?; ata i thanë: **-Urdhëro.** Ai filloi të numërojë:

-Shirku (të adhuruarit e tjetërkujt pos All-llahut) dhe kundërshtimet që i bëhen babait dhe nënës. Pas kësaj Pejgamberi a.s. duke u drejtuar në vend, përsëriti tri herë: **-Keni kujdes, është edhe një - dëshmia e rrejshme. Keni kujdes, është edhe një - dëshmia e rrejshme. Keni kujdes, është edhe një - dëshmia e rrejshme.** Kështu tha i shqetësuar dhe në mënyrë kërcënuese, as'habët, duke u çuditur, u lutën vetëm të qetësohej ai.

Dëshmia, që zë vend të rëndësishëm në ndarjen e drejtësisë, luan rol të madh edhe në sistemin e vjetër juridik edhe në atë të ri. Në drejtësinë e vjetër egjiptase, për dëshmi të rrejshme, dënimi ishte pas prerjes së duarve, ekzekutimi me vdekje. Ky dënim për dëshmi të rrejshme, bëhet vetëm e vetëm për realizimin e drejtësisë. Për këtë shkak, në drejtësinë islame, që të vazhdojë dëshmia, kërkohen ca kushte nga dëshmitari. Kushti më i rëndësishëm quhet *“el-adlu”*. Në Kur'an urdhërohet që dëshmitarët të kenë drejtësi. Ç'është *“adl”* ose të kesh drejtësi? ‘Umeri thotë kështu:

“Në kohën e të Dërguarit a.s. gjendja e njerëzve vlerësohej me vahj (shpallje). E tani (pas përfundimit të shpalljes) është ndërprerë kjo. Tani i gjykojmë sipas sjelljeve të jashme.”

Në librat e drejtësisë islame, e drejta e dëshmitarit shpjegohet kështu: Njeriu të ketë më tepër anë të mira se sa të këqia, kjo don të thotë se ai duhet të ruhet nga mëkatet e mëdha e të mos bjerë në mëkate të vogla shpesh. Gjykatësi është i thirrur t'i studjojë sjelljet e dëshmitarëve.

Dëshmia e gruas

Në drejtësinë islame dëshmia e grave bëhet rreth çështjeve ku burrat nuk janë kompetentë. Si për shembull, virgjëria e lindja. Sipas hanefijve përveç *“haddit”* dhe *“kisasit”* të gjitha të drejtat dhe kontratat tjera, në proceset gjyqësore në vend të dy burrave dëshmitarë respektohet edhe dëshmia e një burri dhe dy grave. (*Hadi* është dënim me urdhër të All-llahut, siç janë, zinaja, vjedhja dhe të dehurit. *Kisas* është dënim për sulme mbi trupin e njeriut, siç është plagosja dhe vrasja që aplikohet në të njëjtën mënyrë edhe në trupin e dorasit).

Dy gra në vend të një burri

Mund të dëshmojnë dy gra në vend të një burri. Arsyen për këtë Kur'ani Famëlartë e thekson kështu:

“...se nëse njëra prej tyre gabon, t’ia përkujtojë tjetra...”

Këtu përdoret fjala në përkthim “gabon” që rrjedh nga fjala “*dalalef*” që don të thotë: pakujdesi, gabim dhe largim nga rruga e drejtë. Kjo flet se në dëshmi aprovohet se gruaja ka trajtim tjetër nga burri.

Është një e vërtetë se gratë kanë një gjendje specifike shpirtërore. Për këtë çështje psikiatri Maz’har Osman thotë:

“Ndryshimi natyror midis gruas dhe burrit fillon që në vitet e para dhe gjithnjë zmadhohet. Karakteristika e parë e gruas është emocioni. Në të gjitha psikozat e gruas takohen gjurmët emocionale. Më tepër takohen psikoza ku dominon emocioni, p.sh. mania depressive. S’ka dyshim, histeria fushën e vet të ndikimit e gjen tek gratë. Prej fiseve primitive e deri te kombet më të zhvillura, prej një vashe të thjeshtë fshatare deri tek një zonjë e arsimuar qytetare, të gjitha gratë kanë gjeste të ngjashme. Secila grua gjysmën e muajit e kalon duke u përgatitur, më pastaj vjen menstruacioni e më në fund vjen një gjendje jonormale sikur të jetë e sëmurë. Roli i burrit në marrëdhëniet intime zgjat vetëm pesë minuta, e pastaj, ai është indiferent, madje ndodh që edhe urren frutin e dashurisë të bartur nëntë muaj në stomak të nënës dhe dy vjet në gjoks. Ajo pëson shumë ndryshime gjatë shtatëzanisë, në lindje dhe lehoni, duke u bërë nervoze, gjë e cila është normale. E si mund të jenë të barabartë gruaja dhe burri?”

Derisa bëhet përparim në psikiatri, edhe më qartë duket dallimi shpirtëror dhe mendor. Gruaja jeton me shqetësime, ndërsa burri me gjykimin, maturinë e tij.”⁴⁵⁸

Një dijetar tjetër thotë kështu:

“Gjykimet depërtojnë jo në vetëdije por në zemër të gruas. E nga zemra ndikojnë në të. Kënaqësia emocionale, sjellja më tepër nga emocionet se sa nga mendja, të gjitha aktiviteteteve të saja morale dhe praktike u japin një drejtim që bazohet në intimitetin... Në temat që e interesojnë gruan, ajo kërkon ndonjë moment që do ta tërheq vëmendjen e saj madje edhe senzibilitetin e saj. Burri nuk gënjen atje ku nuk ka interes, ose gënjen aty ku ka interes. Ndjeshmëria dhe imagjinata tek gruaja mund ta ndryshojë realitetin dhe e bëjnë gruan të jetë e dyshimtë, më melankolike.”⁴⁵⁹

Pas këtyre vërejtjeve mund të themi se, angazhimi i dy grave si dëshmitare në vend të një burri, në disa raste, në ligjin Islam nuk don të thotë se rrjedh prej konceptcionit se gruaja është më e ulët se burri ose është gjysmë qenie në krahasim me burrin, por kjo rrjedh nga karakteristikat fiziologjike dhe psikologjike të saj. Pejgamberi a.s. flet për këtë karakteristikë të gruas gjatë dëshmisë.⁴⁶⁰ Këtu është edhe një moment që duhet të

mirret parasysh. Cilësia më e madhe dhe më e nderuar e gruas është - detyra e nënës. Nëna, natyrisht, pjesën më të madhe të kohës së saj e kalon në shtëpi duke i rritur dhe edukuar fëmijët e vet. Ajo nuk mundet shumë t'i përcjellë ngjarjet që ndodhin jashtë, në shoqëri. Sipas ligjeve të memories në psikologji, sa më shumë njeriu të jetë në kontakt me një ngjarje, aq më tepër përshtypje i regjistrohen në trurin e tij. Në mënyrë të ndërsjellë ngjarjet që i opservon më rrallë, kanë përshtypje më të dobëta në memorien e tij dhe ato më lehtë harrohen. Sipas kësaj, edhe përshtypjet e gruas lidhur më marrëdhëniet ndërnjerëzore në të cilat natyrisht ajo më rrallë merr pjesë, janë më të dobëta, në krahasim me burrin. Kur'ani Famëllartë duke i dhënë gruas një ndihmesë në këtë pikëpamje, në të njëjtën kohë i ka dhënë edhe një rëndësi drejtësisë.

Mosdëshmimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë çon në fshehjen dhe mosrealizimin e së drejtës. Zoti e ka ndaluar këtë.⁴⁶¹ Dëshmimi jo i drejtë për shkak se njëra nga palët mund të jetë farefis i dëshmitarit ose për ndonjë arsye tjetër, gjithashtu çon në padrejtësi. Kur'ani Famëllartë thotë kështu:

“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetëvetes suaj, kundër prindërve ose të afërmyve tuaj, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnjak, pse All-llahu di më mirë për ta.”⁴⁶²

Dëshmia ka edhe dënimet materiale. Për shembull: Nëse dikush dëshmon rrejshëm për zinanë e nuk e vërteton dëshminë e vet, dënohet me tetëdhjetë shkopinje dhe kurrë më nuk i besohet fjalës së tij.⁴⁶³ Pikërisht duke e marrë parasysh rrezikun dhe përgjegjësinë e madhe të aktit të dëshmisë, ligjet islame, gruas i kanë dhënë një shoqe me të cilën ndajnë përgjegjësinë. Pikërisht për këtë, gruaja nuk mirret si dëshmitare në raste të zinasë, akuzimeve të padrejta, për akte të dehjes ose të vjedhjes si dhe të hakmarrjes.⁴⁶⁴

E vërteta kurrsesi nuk duhet të humb në institucionin e dëshmisë. Në raste kur nuk është e mundur që të dëshmojë mashkulli, dëshmia e grave (madje edhe vetëm një prej tyre) është e vlefshme. ‘Umeri r.a. e aprovoi dëshminë e gruas në raste të shkurorëzimit. Edhe Aliu r.a. e ka pranuar dëshminë e grave që ishin dëshmitare në vrasjen e një fëmije.⁴⁶⁵ Në Kur'anin Famëllartë është shpallur, që me rastin e udhëtimit kur dikush don të lë testament dhe nuk mund të gjejë dëshmitarë nga muslimanët pranohet edhe dëshmia e jomuslimanëve.⁴⁶⁶ As’habët e ndershëm e kanë pranuar edhe dëshminë e fëmijëve në rast të lëndimeve midis fëmijëve. Ibën Kajjimi, thotë se ulemaja duke u mbështetur në këto argumente, mendimet e tyre përputhen në këtë pikë: në rast nevojë dhe domosdoshmërie që të mos humb e vërteta, pranohet dëshmia e atyre që në kushte normale nuk u pranohet dëshmia për disa çështje.⁴⁶⁷ Përjashtimi i gruas nga dëshmia në raste të gjykimeve për hadd dhe kisas, rrjedh nga nevoja që në këto raste të rënda të mos ketë vend dyshimi. Në ligjet islame këto parime janë themelore: “Dënimet të jenë të pastra prej dyshimeve”. “Sa të jetë e mundur dënimet më larg muslimanëve”. E gjithë kjo, tregon një respekt ndaj qenies së njeriut, trupit dhe shëndetit të tij.

t T

II. E drejta për arsimim

“...A janë të barabartë ata që dijnë dhe ata që nuk dijnë?”⁴⁶⁸

Arsimimi është kusht i parë që gruaja ta kuptojë humanizmin e vet. Gjatë historisë, në periudha dhe mjedise të ndryshme, gruaja ishte trajtuar në mënyrë të ndryshme. Gruaja nga Perëndimi, të cilës i ishin marrë të gjitha të drejtat mdaje edhe trajtimi si njeri, luftën e vet e filloi me arsimim. Ajo dinte t’i kërkojë të drejtat e veta dhe vendosmërisht e vazhdoi luftën e vet. Sa i përket gruas nga Lindja islame edhe ajo duke i lakmuar shoqes së saj nga Perëndimi, dëshiroi ta shfrytëzojë armën e njëjtë. Por, pozita e saj si njeri ishte e pranuar me të drejtat e saja të njohura nga Islami. Ajo këtë nuk e dinte dhe kishte nevojë që ta kuptojë.

Urdhëri i parë i Kur’anit Famëlartë që është shpallur para katërmbëdhjetë shekujsh për ta shpëtuar njerëzinë nga errësira, është:

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me penë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”⁴⁶⁹

Edhe gruaja, sikurse burri është rob i All-llahut. Ajo do të dënohet ose do të lavdërohet për veprat e veta:

“...Unë nuk ia humbë mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër.”⁴⁷⁰

“Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtare, të tillë hyjnë në Xhennet dhe nuk u bëhet farë padrejtësie.”⁴⁷¹

Nga kjo rrjedh se edhe gruaja sikurse burri është e obliguar që aktivitetet e veta t’i realizojë sipas urdhërave të All-llahut dhe të mos dalë jashtë këtyre kornizave. Për këtë arsye, ajo duhet t’i mësojë urdhërat e Tij. Sepse:

“All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët.”⁴⁷²

dhe:

“A janë të barabartë ata që dijnë dhe ata që nuk dijnë?”⁴⁷³

“O ju që besuat, ruani veten dhe familjen tuaj prej zjarrit (Xhehennemit)!”

Aliu r.a. ajetin e Kur'anit Famëlartë me këtë kuptim e komentoi si vijon:

“Edukoni fëmijët tuaj e jepuni dituri.”⁴⁷⁴

Rëndësia e arsimimit për gruan

Gruaja është edukatorja më e përsosur e fëmijëve. Që t'i japë fëmijës, në një periudhë të gjatë, gjatë zhvillimit të tij një edukim të përsosur, ajo duhet të jetë e arsimuar, të ketë përvojë dhe edukatë morale. Secilit i është e ditur rëndësia e shprehive që i fiton fëmija në moshën më të re. *“Ajo që hyn në djep, del në varr”*.

Gruaja e arsimuar dhe e edukuar, është më e dashur për burrin, të cilit i ndihmon në punët e tij. Pejgamberi a.s. për Hatixhen r.a. thotë:

“Betohem se All-llahu xh.sh. nuk më ka falë grua më të aftë se atë: Atëherë kur nuk më besonin njerëzit, ajo më besoi. Derisa mua nuk më pranonin, ajo më afirmoi. Derisa më lanë të varfër, ajo më ndihmoi me mallin e saj.”⁴⁷⁵

Thuhet se kinse arsimimi e dërgon gruan në amoralitet!

Kjo nuk është e vërtetë. Por, para së gjithash duhet të thuhet se injoranca nuk mund të jetë më e vlefshme dhe më e dobishme se dituria. Veçanërisht në kohën tonë arsimimi është i nevojshëm edhe për burrin edhe për gruan.

Dituria, arsimimi dhe edukimi në kuptimin absolut të fjalës nuk kanë asnjëfarë lidhje me amoralitetin. Por, në institucionet arsimore që janë larg parimeve morale, disiplinës dhe rregullit, morali i të rinjve që janë në moshën e zhvillimit mund të vijë në rrezik. Arsimimi i gruas në shoqërinë islame, nuk don të thotë se ajo duhet të qëndrojë bashkë me shokët meshkuj, të flertojë me ta ose, nuk don të thotë shëtitje të përbashkët të femrave me meshkuj nëpër mësonjtore, korridore dhe vende të tjera. Dituria nuk e arsyeton stolisjen si një valltare, të bëjë grim si një aktore. Përkundrazi ajo duhet të gërditet nga ato. Të theksojmë këtë se kur flasim për arsimimin dhe edukimin, mendojmë në shoqërinë islame si një mjedis. Në institucionet arsimore të një shoqërie të këtillë, ballafaqoheni jo me epsh por me dituri dhe vlera relevante.

Arsimimi i gruas nga prizmi i sunnetit

Fjalët që vijojnë dhe që pa të drejtë i mvishen Pejgamberit a.s. e që kanë këtë kuptim:

“Gratë mos i ulni nëpër qoshke, ato mos i mësoni të shkruajnë e të lexojnë, por i mësoni të tjerrin dhe të lexojnë suren Nur” janë të trilluara dhe jo të vërteta - nuk kanë të bëjnë fare me hadithin. Fjalë të tilla, prej gojës së të Dërguarit a.s. nuk kanë dalë.⁴⁷⁶ Përkundrazi, i Dërguari a.s., e ka nxitur dhe e ka urdhëruar arsimimin e grave. Kështu Shifahatunit, një gruaje nga as’habët i kishte urdhëruar që gruas së Pejgamberit, Hafsasë, t’ia mësojë shkrimleximin dhe disa gjëra tjera.⁴⁷⁷

Në një hadith të tij thotë:

“Ai që e edukon mirë dhe i jep një sjellje dhe arsimim xharijes së tij, nga ana e All-llahut shpërblehet sevap të dyfishtë.”⁴⁷⁸

Nëse kjo gjë është sevap për gruan jo të lirë, është sevap edhe për femrat tjera.

Në Medinetu’l-Munevvere ishin tubuar gratë dhe kishin shkuar tek i Dërguari a.s.:

“Burrat vazhdimisht po vijnë tek ti dhe mësojnë dituri. Po mësojnë atë që nuk e dijnë, duke mos na dhënë rast që të vijmë tek ti. Na cakto një ditë kur të vijmë të të dëgjojmë dhe t’i mësojmë ato gjëra që nuk i dijmë.”

I Dërguari a.s. u kishte caktuar një ditë. Atë ditë ai u kishte mbajtur va’z dhe i kishte udhëzuar. Në komentin e këtij hadithi, Ajni e arsyeton diskutimin e grave dhe bisedën e tyre me meshkujt lidhur me problemet fetare.⁴⁷⁹

Kështu në Medine, gratë muslimane, për të gjitha problemet e tyre janë këshilluar dhe kanë marrë mësim nga Pejgamberi a.s. Sikur t’ishte mëkat arsimimi dhe edukimi i grave, vallë a do ta bënte këtë Pejgamberi a.s.? Aisheja thotë:

“Sa të mira janë gratë ensare, turpi nuk i ka penguar të mësojnë për fenë e vet.”⁴⁸⁰

Njëra nga gratë të kohës së Pejgamberit a.s. që i kishte dhënë rëndësi diturisë, ishte edhe gruaje e të Dërguarit a.s. Aisheja. Ajo mirrej me dituri, kur dëgjonte diç që deri atëherë nuk e ka ditur, pyeste përsëri derisa nuk do ta mbante në mend atë.⁴⁸¹ As’habi Ebu Musa thotë kështu:

“Nuk ekzistonte problem i rëndë për ne (as’habët) për të cilin Aisheja nuk do të gjente zgjidhje.”

Një as’hab tjetër, Musa b. Talha thotë:

“Nuk kam parë dikë tjetër të flet më qartë dhe haptazi se sa Aisheja. Dihet se i transmeton dy mijë e dyqind e dhjetë hadithe të Pejgamberit a.s.”⁴⁸²

Përveç Aishes edhe Fatimja, vajza e Ebu Bekrit, Esma dhe Ummu’d - Derda janë të njohura si gra që kanë dhënë fetva.⁴⁸³

‘Umeri, në kohë të halifatit të vet, një ditë del në minberin e të Dërguarit të Zotit dhe i këshillon muslimanët që në martesë të mos japin mëhër të madh. Nga xhemaati i femrave një grua e lartë del duke thënë:

-‘Umer, nuk ke të drejtë të flasish kështu!; dhe citoi ajete nga Kur’ani Famëlartë, ‘Umeri tha: **All-llah, All-llah! Një grua diskuton me ‘Umerin dhe atij ia mbyllë gojën;** dhe e tërhoqi fjalën.⁴⁸⁴ Një ditë tjetër duke ecur në rrugë me shokët e vet, takohet me vajzën e Malikut, Havlen dhe e përshëndet. Pasi e pranon përshëndetjen, Havleja e këshillon kështu halifin dhe e mëson si duhet ta kryejë detyrën e burrështetit:

Prit ‘Umer! Të njoh prej kohës kur në panairin e Ukazit të thërrisnin ‘Umer i vogël dhe kur me shkopin tënd i frikësoje fëmijët. Pas kalimit të një kohe filluan të të thërrasin ‘Umer. Prap pasi nuk kaloi shumë kohë e more titullin emirul-mu’minin (udhëheqës i besimtarëve, kryetar shteti). Frikësohu prej Zotit për njerëzit që i udhëheq! Dije mirë se për atë që frikësohet nga dënimi i All-llahut, Dita e Gjykimit që duket larg, i vjen shumë shpejt. Ai që i frikësohet vdekjes shqetësohet prej zhdukjes... Pas këtyre fjalëve njëri nga shoqëria e ‘Umerit, Xharudi, i drejtohet Havles: Zonjë, shumë e zgjate me Emirul-mu’minin! ‘Umeri menjëherë ia tërhoqi vërejtjen Xharudit: Lere, a s’e njohe Xharud? Kjo është gruaja e Ubade b. Samitit, Havleja, ankesën e së cilës All-llahu e ka dëgjuar nga shtatë qiejt. Sa i përket ‘Umerit, i betohem All-llahut se jam i detyruar ta dëgjoj.⁴⁸⁵ Edhe në periudhën pas as’habëve, në botën islame, numri i grave që janë arsimuar dhe kanë bërë va’z e kanë dhënë fetva, ka qenë i madh. Në veprën e rahmetli haxhi Zihni Efendiut “*Meshahiru’n-nisa*” kanë vend biografitë e shumë prej tyre. Midis tyre ajo e Fatime Fakihes dhe Fatimes nga Bagdadi, janë shumë të njohura.⁴⁸⁶

III. Jeta e lirë - nëpunësia

“Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj si shfaqej në injorancën e hershme...”⁴⁸⁷

Një grup mendimtarësh për problemin e gruas, e mbrojnë mendimin që ajo të jetë tërësisht e lirë jashtë kontrollit. Por këta nuk bëjnë fjalë për virtytet e gruas, për ruajtjen e tyre. Ata i mbyllin sytë para bukurive, siç janë: ecjes së hapur (të pambuluar), përdorjes së alkoolit, bixhozit dhe pjesëmarrjes në argëtime si dhe përzierjes së gruas me burrin në këto aktivitete. Dhe, kështu kinse do të arrihet civilizimi i Perëndimit, do të jetohet një liri e tipit perëndimor. “Gruaja në Perëndim, doli në treg, kaloi në sokaqe, shkoi nëpër fabrika, hyri nëpër lokale nate duke fituar për jetën e saj. Me këtë ajo u shfrenua. Gruaja u keqpërdor në tregëti. U bë shitëse dhe manekene. Për të holla femëria dhe personaliteti i saj u nxorr në treg. U zhduk nderi dhe respekti i saj. Tani është një robëreshë e lirë nën kamxhikun e nevojave dhe varfërisë, e sjellur në tregun e robëreshave. Jo si në kohën e lashtë kur shitej si shërbëtoreshë nëpër familje, tash shitet për të punuar në tregëti, afarizëm. Atje, për një copë bukë që ta evitohet urinë e saj, ajo e ofron, si një femër, gjenë më të çmueshme të saj, si mallin.”⁴⁸⁸

Grupi tjetër i mendimtarëve e shikojnë anën e kundërt të problemit, kështuqë nuk e lënë gruan as të merr frymë. Meqë këta nuk kanë një teori të caktuar dhe numri i tyre nuk është i madh, këtë nuk do ta shqyrtojmë më tepër.

Midis këtyre dy ekstremeve qëndron një mendim i tretë, ky është mendimi Islam. Sipas tij, gruaja nuk është qenie satanike, e cila me kënaqësitë fizike e shfrytëzon çdo rast. Ajo paraqet një qenie të pafajshme njerëzore me ndjenja të holla dhe me fizikus delikat. Por, shumë e lehtë është që të nxirret nga rruga e drejtë dhe të keqpërdoret.

Detyrat primare të gruas

Gjatë ndarjes së detyrave nga ana e Krijuesit, duke u nisur nga konstruksioni trupor dhe përmbajtja specifike psikike, gruas, i janë ndarë katër detyra të mëdha: *Shtatzënia, lindja, të dhëniturit gjë dhe edukimi i fëmijës*. Secila prej tri detyrave të para kanë specificitetin e vet, madje edhe

rezikun. Për t'i kryer këto me sukses, ajo duhet të mundohet me punë të rënda dhe të lodhshme. Në aftësinë psikike të fëmijës, roli i jetës së nënës ka ndikim të madh, madje prej momentit të shtatzënisë. Padyshim, edukimi ka ndikim të madh në inteligjencën dhe karakterin e fëmijës. Mjekët e sotëm që i japin rëndësi të madhe trashëgimisë, nuk duhet t'i harrojnë ligjet për zhvillim dhe evolucion të Darvinit, dhe nuk duhet ta mohojnë ndikimin e edukimit dhe të rrethit. Në paraqitjen e një numri të madh të neurozave, edukimi ka rolin e vet. Edhe në psikozë, edhe pse roli i edukimit është më i vogël, ai padyshim u jep një formë reaksioneve.

“Fëmija nuk mund të edukohet posa të lind. Shqisat e tij gradualisht i edukojnë nervat. Mendohet se ushqimi në kohë të duhur, fjetja në kohë të duhur, pushimi në kohë të shtatëzënisë ia përcjellin edukatën fillestare fëmijës që gjendet në stomakun e nënës. Pas lindjes së fëmijës ky ndikim reflektohet me fjetjen dhe zgjimin e fëmijës me kohë. Qysh gjatë taitjes, fëmija mësohet për një rend. Taitja për çdo tri orë, pushimi gjatë orë pa qumësht gjatë natës, është edukimi i parë që i jepet fëmijës.”⁴⁸⁹

Nuk është e mundur që një grua e inkuadruar t'i kryejë të gjitha këto në përpikëri. Bile gruaja në punët e veta jashtë shtëpisë edhe materialisht dhe shpirtërisht lodhet dhe vjen në pozitë të mos i kryejë detyrat më të natyrshme të saja.

“Qysh në kohën më të lashtë, burrat ishin të angazhuar me ndonjë profesion. Kohëve të fundit edhe gratë, si edhe burrat, qenë të detyruara të përfshihen në luftë për jetë. Gjithsesi, edhe ato do t'i pësojnë pasojat nga profesioni i tyre. Tani takojmë histeri, neurosteni, melankoli, më së shumti tek arsimtaret vajza dhe gra. Profesionin më i mirë dhe më i shëndoshë i gruas është ai i bashkëshortes dhe nënës. Kujdesi ndaj fëmijëve dhe të sëmurëve, puna në kopsht dhe në shtëpi janë punët më të shëndosha të një gruaje. Meqë roli i gruas dhe nënës i rrit ndjenjat altruiste, higjiena mentale ia rekomandon si profesione më të preferuara.”⁴⁹⁰

Biologjia komparative vërteton se foshnja, pas lindjes, paraqet krijesën më të pafuqishme dhe periudha e fëmijërisë më së shumti zgjat tek njeriu. Për këtë arsye Claparede pyet: “Për çka shërben fëmijëria?” Kush mundet me kujdes më të madh ta rris fëmijën, gjatë një periudhe më të gjatë të zhvillimit të tij? Kush mundet të përgjigjet në nevojat dhe dëshirat e tij që ndërrohen vazhdimisht? E vërteta është që nuk mund të gjendet mik më i afërm për foshnjen se sa nëna e tij, askush përveç saj nuk mund t'i ofrojë kujdes më të madh. Gruaja e punësuar nuk mund t'i kushtojë këtë kujdes fëmijës së vet. Një pengesë tjetër për punësimin e gruas është pamundësia që fëmijës t'i japë edukatë seksuale. Këta fëmijë ose rriten pa kontroll ose bëhen lëndë argëtimi në duart e edukatorëve.

“Vajza martohet. Në rrethin e familjes gjen hapësirë për zhvillimin e aftësive të veta emocionale. Lind fëmijë”.

“Në periudhën e më pastajme ajo bëhet bosht për fëmijët dhe frymën familjare e jo lëndë për tërheqje dhe koketim. Gruaja, tërheqësinë e vet seksuale e realizon në shtëpi, në një atmosferë të këndshme.”

Në qoftëse psikologjia e femrës nuk adaptohet me këtë situatë, nëse manifestimet e burimet shpirtërore nuk i realizon në një hapësirë normale, në hapësirën familjare, nëse në kohën kur duhet të jetë nënë vazhdon me koketime dhe “aventura seksuale”, ballafaqohemi me një tip të një femre të një moshe mesatare e cila e luan rolin e një vajze gjithnjë të re. Atëherë paraqiten konflikte shpirtërore dhe mungesa të adaptimit tek gruaja. Kjo gjendje mund të çojë edhe deri te diçka që aspak s'është e lavdishme.”

“Gruaja bëhet robëreshë e egoizmit vetiak kalimtar, e jo e rrethit, familjes dhe shoqërisë së saj.”

“Këto situata jo të lakmueshme janë shkase të tragjedive që i shikojmë në salla të kinemave, romane dhe në jetën e përditshme.”⁴⁹¹

Nga punësimi i saj gruaja nuk ka ndonjë dobi të madhe. Të hollat që do t'i fitojë nuk janë më të mëdha se shpenzimet që i bëjnë për punët e shtëpisë dhe në rritjen e fëmijëve, veçanërisht për veshmbathje dhe aspekte të tjera të nevojshme, ngase ajo një pjesë të kohës e kalon jashtë shtëpisë, midis njerëzve. Nga ana tjetër meshkujt që ngelin pa punë, për arsye të çrregullimeve psikike që rrjedhin nga papunësia, bëhen një faktor rreziku për shoqërinë.⁴⁹²

Me largimin e gruas nga rrethi familjar, dobësohen edhe lidhjet familjare. Gruaja si një qenie me konstruksion fizik e shpirtëror delikat, që i kalon orët e ditës duke punuar nën komandën e tjetrit dhe lodhet në valët e luftës së përditshme, dalngadalë bëhet nervoze dhe e zemëruar. Në mbrëmje kur kthehet e lodhur në shtëpi e kundërshton burrin, zihet me fëmijët. Askujt nuk i është mirënjohëse. Bukën e vet e fiton me duart e veta. Kur të dëshirojë vjen në shtëpi. Kur të dëshiron mund të dalë. Shkon në shoqërinë që e dëshiron dhe në argëtime që i zgjedh vetë.

Statistikat flasin se deri tek ndarja arrihet para se të lindin fëmijët. Njëri ndër shkaqet më të mëdha për moslindje është pjesëmarrja e gruas në jetën e lirë.

Në Kur'anin Famëllartë, urdhërohet që gratë e Pejgamberit a.s. sipas kësaj edhe besimtalet tjera të rrijnë në shtëpi, të jetojnë në kushte krenarie, paqe dhe qetësie.⁴⁹³ Kjo flet se shtëpia për gruan është një rreth dhe një detyrë normale dhe e natyrshme. Por, kjo nuk don të thotë se gruaja assesi nuk mund të del nga shtëpia. Pejgamberi a.s. i ka urdhëruar gratë:

“All-llahu u ka lejuar të dilni për nevojat tuaja.”⁴⁹⁴

Dihet se në kohën e të Dërguarit a.s. gratë shkonin nëpër mesxhide që ta falin namazin pas tij. Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Mos ua ndaloni grave, që janë robër të All-llahut, të vijnë në xhamia!”

Në një tjetër rast prap thotë:

“Mos i ndaloni gratë të shkojnë natën në xhamia!”⁴⁹⁵

Shkuarja e gruas në xhami ka funksionin e vet. Shkaku për shkuarje në xhami është të falurit e namazit, dëgjimi i Kur'anit Famëllartë dhe va'zit. Në xhami, meshkujt dhe femrat, kanë vendet e ndara, s'mund të ndodhë të jenë të përzier. Pas namazit, kur Pejgamberi a.s. jepte selam, ky priste një kohë të caktuar që gratë të shkojnë e më pastaj ngrihej. Për këtë shkak i Dërguari a.s. një derë të mesxhidit në Medine, e kishte caktuar për hyrjen dhe daljen e grave. Abdullah b. 'Umeri deri në vdekje nuk kishte hyrë as dalë nga ajo derë.⁴⁹⁶ Për këtë rregull të mesxhidit, i Dërguari a.s. ka thënë:

“(O ju gra), mos u parfumoni kur të shkoni në xhami. Ajo që parfumohet të mos hyjë në xhami.”⁴⁹⁷

Ndërsa Aisheja r.a. thotë kështu:

“Në qoftë se i Dërguari a.s. i sheh intrigat e grave të sotme, edhe ai do t’i largonte nga mesxhidi sikurse bënin izraelitët.”⁴⁹⁸

Sa mund të kuptohet nga gjithë kjo që u tha, në shoqërinë islame, nuk u lejohet femrave të sillen në jetë, të lira pa asnjë rregull. Në të njëjtën kohë, nuk është adet që gruaja të punësohet, për arsye se detyra e saj në shtëpi është në lidhje me edukimin dhe se ajo nuk është e obliguar të kontribuojë në ekonominë familjare. Por, nuk ka asnjë pengesë të punojë punë dhe nën kushte që të mos i lë prapa detyrat e vërteta të saja.

Gruaja dhe nëpunësia

Siç theksuam në nëntitullin “Detyrat e vërteta të gruas”, jeta e lirë dhe nëpunësia janë gjëra që nuk pajtohen me natyrën fizike dhe psikike të saj. Një grua që largohet nga rrethi familjar, i humb karakteristikat e gruas, vendin e punës dhe detyrën e saj të punëtores, i shndërron në atmosferë shtëpiake. S’janë pak ato gra, që në vendin e punës, vazhdimisht flasin për fëmijët e tyre dhe në kohë të punës bëjnë punëdore.

Situata e grave të zbuluara dhe e meshkujve në jetën e lirë ose në vendet e punës është shqyrtuar në pjesën e deritanishme të kësaj vepre. Nuk ka pengesa që gratë të mirren me asiljoj pune ku nën udhëzimet e Islamit do të jenë të sukseshme. Të themi edhe këtë se flasim për “gruan islame” në kuptimin absolut të fjalës. Nuk e marrim parasysh ndonjë shtet konkret islam të kohës sonë. Islamit e paramendojmë si një totalitet. Kur flasim për “Shoqërinë islame” mendojmë për shoqërinë ku zbatohen normat islame. Në një shoqëri të këtillë, nuk ka asnjë arsyetim që gruaja të mos bëhet tregëtare, mjeke... Por, duhet të përsërisim se duke i zbatuar këto detyra, ajo medoemos duhet t’i respektojë rregullat e moralit islam.

Jeta është specializim. Rezultatet më të mira arrihen, kur secili merret me punë në përputhmëri me natyrën e tij.

Shifahatuni, prej kurejshëve, që u përkiste muslimanëve nga Meka, ishte njëra prej muhaxhireve të para dhe njëra nga gratë më të njohura të kohës së Asri-Saadetit. Ajo e kishte mësuar Hafsanë të shkruajë e të lexojë. Halifi ‘Umer r.a. i jep rëndësi mendimit të saj, e pyeste për shëndetin, ia dinte vlerën dhe i jipte për detyrë t’i kontrollojë tregjet.⁴⁹⁹

IV. Ushtria - lufta dhe gruaja

“Në betejën e Uhudit, duke shikuar majtas dhe djathtas, e pashë Ummi Umaren si po luftonte.”

Muhammedi a.s.

Sipas të drejtës islame, gruaja nuk është e obliguar të shkojë në luftë e të luftojë. Për meshkujt vlejné si udhëzim fjalët:

“Xhenneti është nën shkëlqimin e shpatës”.⁵⁰⁰

Ndërsa për gruan:

“Xhenneti është nën këmbët e nënave.”⁵⁰¹

Në realitet, gruaja është krijesë që punon më së shumti dhe më sinqeritet në mbrotjen e atdheut. Ajo e përgatitë “fuqinë njerëzore” të një populli dhe ia dhuron atdheut të vet. Ato janë krijesa të cilat në parzmat e veta ruajnë mundimet që i sjellin mobilizimet dhe humbjet që ato i shkaktojnë.

Në kohën e të Dërguarit a.s. muxhahidët islam derdhnin gjakun e vet në mënyrë të pakursyeshme, duke flijuar edhe jetën, me qëllim që të bëhen “shehidë”, si gjënë më të lartë pas “pejgamberisë” (nubuvvetit).

Ato (gratë) ishin tubuar dhe dërguan njerën te i Dërguari i All-llahut:

“-O i dërguar i Zotit! Unë jam përfaqësuese e grave. Nuk ka grua të njohur e të panjohur që nuk dëshiron të dalë para jush. All-llahu është Rabbi dhe Zoti edhe i burrave edhe i grave. Ndërsa ti je i Dërguar i All-llahut, i Dërguar edhe për meshkujt edhe për femrat. All-llahu i Lartësuar, xhihadin e fali si farz për meshkujt. Nëse ata e luftojné armikun dhe nuk mbyten, bëhen gazi. Do të fitojné dhurata dhe sevape. Nëse bëhen shehid, nuk do të llogariten si të vdekur, por, përkundrazi si të gjallë, do të shpërblehen nga All-llahu xh.sh. Ç’kanë femrat të ngjashme me këtë aktivitet të burrave?”

I Dërguari a.s. u përgjigj kështu:

Duhet t'i respektoni burrat dhe duhet t'i dini detyrat dhe obligimet, e pak kush nga ju e bën këtë!”⁵⁰²

Një grua nga familja Kudaa kërkoi leje nga i Dërguari a.s. që ti bashkohet mobilizimit ushtarak. Ai refuzoi. E gruaja i tha:

-Nuk dua të luftoj. Vetëm dua t'i shëroj të plagosurit dhe të sëmurëve t'u jap ujë. Ja, për këtë dua të marr pjesë. Pejgamberi a.s. iu përgjigj kështu:

-Do të lejoja sikur kjo të mos bëhej traditë dhe sikur të mos flitej se filan gruaja shkoi në luftë. Por, megjithatë, ti duhet të ngelish në shtëpinë tënde.”⁵⁰³

Këto hadithe flasin se në kushte normale gruaja nuk është obliguar të shërbejë në ushtri dhe të shkojë në luftë. Por, kjo s' duhet kuptuar se gruaja në asnjë mënyrë nuk duhet të marrë pjesë në kësi lloj aktivitetesh.

Sipas juristëve islam, nëse armiku ka shkelë në vendin e tyre dhe nëse vjen në pyetje ekzistenca, atëherë edhe gratë, pa marrë parasysh se a ua lejojnë këtë burrat dhe etërit, shkojnë në luftë.⁵⁰⁴

Në kushte tjera nëse gratë shprehin dëshirën dhe këtë ua lejojnë të afërmit mund të marrin pjesë vullnetarisht në luftë.⁵⁰⁵ Gruaja nuk është luftëtare, prandaj gruaja e armikut nuk vritet në luftë. Pejgamberi a.s. gjatë dërgimit të muxhahidëve në luftë, u jipte këto instruksione:

“Shkoni në emër të All-llahut duke u mbështetur në All-llahun dhe në fenë që predikon i Dërguari a.s. Mos i vritni pleqtë e dërmuar, fëmijët dhe gratë. Mos e grabitni pasurinë shtetërore. Bashkojeni prenë. Zbatoni Islamin. Bëhuni të ndershëm. Bëni të mira! All-llahu i don ata që bëjnë vepra të mira.”⁵⁰⁶

Por, nëse gruaja në mënyrë ideore ose aktive merr pjesë në luftë, atëherë (gruaja e armikut) mund të vritet.⁵⁰⁷

Gruaja në ushtrinë islame

Nga koha e Pejgamberit a.s. e deri në ditët tona, gruaja islame, i ka rritur luftëtarët më të guximshëm dhe trimat më të drejtë për ushtrinë, dhe, kohëpaskohe edhe vetë është pjesëmarrëse në luftë. Në kohën e Pejgamberit a.s. gratë dhanë shehidin e parë për Islam. Në periudhën e “vështirë të Mekës”, gruaja bashkë me të shoqin u përballoi të gjitha mundimeve. Emigroi në shtetet e huaja. U pikëllua nga dhembja e madhe e krijuar nga skenat e vdekjes së burrave gjatë rrethimit të muslimanëve dhe nga periudha e urisë. Në bisedat e fshehta politike dhe fetare që në fund të periudhës së Mekës i bënë qytetarët e Medines dhe i Dërguari a.s. morën pjesë edhe gratë.

Ajo mori pjesë në Hixhretin për në Medine dhe mbrojti Islamin gjatë tërë jetës. Gruaja mori pjesë në shumë ekspedita të armatës islame dhe në transportimin dhe shërimin e heronjëve, në bartjen e shehidëve, në hapjen e varrezave, në përgatitjen e ushqimit, në sjelljen e ujit, në ruajtjen e rezervave ushqimore dhe shumë aktivitete tjera.⁵⁰⁸ Veç kësaj, ajo vetë personalisht përdori shpatën dhe shtizën. Vrau armiq dhe vetë u bë heroinë dhe shehide.

Ummi Umare nga ensarët mori pjesë në betejën e Uhudit. Gjatë një luftimi, në radhët e ushtrisë islame, midis dhjetë vetëve që gjendeshin pranë të Dërguarit a.s. ishte edhe kjo, burri i saj dhe të dy bijtë. Kjo, me shpatë në dorë luftoi pranë të Dërguarit a.s. Në këtë rast vrau një kalorës të armikut dhe u plagos edhe vetë, madje në disa vende. Pejgamberi a.s. thotë:

“Ditën e betejës në Uhud, në çdo shikim majtas e djathtas, e shikoja Ummi Umaren si luftonte pranë meje.”

Ummi Umare mori pjesë në disa beteja. Kur kuptoi se Pejgamberi i rrejshëm, Musejleme ia vrau djalin, Halidin, ajo u betua se do të luftojë kundër tij dhe mori pjesë në betejën kundër murtedëve (renegatëve) në Jemame nën komandën e Halid b. el-Velidit. Në këtë luftë ia prenë dorën dhe kishte marrë dymbëdhjetë plagë. Musejleme u vra në këtë luftë dhe kështu fjala e Ummi Umares erdhi në vend.⁵⁰⁹ Në historinë islame ka shumë raste të ngjashëm me këtë të Ummi Umares.

Nuk është lëndë e kësaj vepre të flitet për këtë gjë. Për gratë muxhahide të kohës së Asri-Saadetit, hadithe transmetuan këta muhaddithë: Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi, Ibën Maxhe, Ebu Nuajm, Abdurrezak dhe Taberani.⁵¹⁰

Veprat e grave muxhahide në ushtrinë islame në periudhën e mëvonshme gjinden në faqe të arta të historisë. Ende janë të freskëta kujtimet për heroizmin e muxhahideve në luftërat çlirimtare si p.sh. gratë algjeriane.

V. Të drejtat politike të gruas

Gruaja dhe politika

“Është gruaja qenie që ka shpirt? Nëse ka, është ai shpirt njerëzor apo shpirt i kafshëve? Nëse supozojmë se ai është shpirt njerëzor, në këtë rast është inferiore pozita e saj në krahasim me burrin, si të një robi diç më të lartë?” Në botën perëndimore, ku koncepti për “gruan” kishte një definicion të tillë, ajo ka filluar një luftë të cilën e vazhdoi derisa nuk u pranua si një qenie njerëzore. Duke dashur të hakmirrej për padrejtësitë shekullore dhe vrazhdësitë, ajo dëshiroi t’i realizojë disa qëllime jashtë natyrës dhe aftësive të saja shpirtërore. Në këtë luftë të saj, ajo kërkoi të jetë absolutisht e barabartë me burrin dhe si garancë të kësaj barazie ajo aprovoi edhe të drejtat politike.

Kur është fjala për luftën për të drejtat e gruas në vendet islame ajo, më së shumti rrjedh si rezultat i ndikimit nga Perëndimi.

Gjatë historisë hasen gra të cilat merreshin me politikë, kanë komanduar me ushtri dhe kanë udhëhequr edhe shtete. Kësi shembuj gjejmë edhe në botën islame.⁵¹¹ Por nga aspekti i botëkuptimeve të sotme, për të arritur deri tek disa të drejta politike, gruaja, duhet të luftojë me këmbëngulje. Kjo situatë i përket edhe gruas edhe burrit, i cili në këtë pikëpamje u mundua sa gruaja.

Por, ka edhe diçka që t’i kushtohet vëmendje, e kjo është se vallë, vërtetë ato ndajnë kënaqësi nga një jetë e atillë? Poqese i realizojnë ato të drejta, do të jenë të lumtura? Citojmë zonjën Gina Lambroso e cila me një aftësi shkencore e studioi psikologjinë e gruas:

“Të gjithë ata që e kanë studjuar psikologjinë e gruas, kanë ardhë në konkludim se gruaja nuk gjen satisfaksion në angazhimin politik. Si argument më të madh për këtë gjë, është fakti se gruaja e punësuar në institucione të ndryshme, merret me zgjidhjen e problemeve në lëmin e profesionit, çmimeve, arsimit dhe edukimit, religjionit dhe pedagogjisë, por, nuk mirret ose mirret shumë rrallë me problemet financiare dhe ndërkombëtare, e veçanërisht me problemet politike. Gazetat e femrave në Rusi, sa i kanë nxitur gratë të mirren me politikë, gjithmonë janë ballafaquar me një rezistencë të madhe. Marrë në përgjithësi numri i grave të arsimuara që merren me art, poezi, muzikë, pedagogji, etikë dhe religjion është shumë më i madh se ai i grave që merren me histori, gjeografi dhe ekonomi.”

Zonja Gina Lambroso e cila formoi një shoqatë në Itali (*L'associazione di vulgatrice Donne Italiane*), edhe përkaj shumë aktiviteteve që bëri që tek gruaja italiane t'i nxisë afinitetet politike, nuk arriti sukses. Madje edhe me librat dhe revistat që i botoi kjo shoqatë, nuk u zgjua asnjë interesim tek gruaja italiane, e cila tregoi interesim për psikologji, filozofi dhe çështje tjera shumë më të rënda nga kultura e përgjithshme. Edhe në Gjermani, aktivitetet e një shoqate të këtillë përfunduan në të njëjtën mënyrë. Atje ku gruaja gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të jetë e zgjedhur, një numër shumë i vogël i tyre e shfrytëzoi këtë të drejtë dhe këtë obligim. Për shembull, në qytete të Italisë me një numër banorësh deri më 60 mijë, vetëm tre mijë gra morën pjesë në zgjedhje. E në disa qytete tjera, ky numër ishte krejtësiht i vogël. Këtu nuk do t'i numëroj shkaqet për këtë.⁵¹²

Don të thotë se realizimi i të drejtave politike, që ka rëndësi si një arritje kulminante në realizimin e të drejtave të saj, në praktikë s'është diç që i sjell lumturi gruas.

Gruaja e cila padyshim ka një karakter tjetër nga burri, i jep më shumë rëndësi dhe vëmendje pamjes së saj dhe synon që të jetë e respektuar. Për këtë shkak, sipas shkencëtarëve, gruaja u angazhua në jetën politike e udhëhequr nga dëshira të jetë e vërejtur dhe e respektuar, jo nga dëshira që të jetë vërtetë politikisht e angazhuar.

“Burri që e nënçmon gruan, pa marrë parasysh cilësitë e tij fizike e shpirtërore, për gruan paraqet qenie të gërditshme dhe kurrë nuk do t'ia falë atë. Por burri që e lavdëron gruan dhe e nderon atë sa do që të jetë në një gjendje të keqe, për gruan ai paraqet një qenie hyjnore.”

“Gjykimet depërtojnë jo në vetëdije por në zemër të gruas. E nga kjo ndikon në të. Kënaqësia emocionale, sjellja më tepër nga emocionet se sa nga mendja, të gjitha aktiviteteve të saja morale dhe praktike u japin një drejtim që bazohet në intuitetin. Dhe ky intuitet, për të është i nevojshëm ngase, asaj i mundëson një bindje se atë që e mendon dhe që e bën është me vend. Nga kjo rrjedh kokëfortësia dhe karakteri i saj të mos e dëgjojë bashkëbiseduesin. Ajo dëgjon vetëm atë që i konvenon dhe për të s'egziston gjë më e keqe se sa ta kritikosh. Kurrë nuk i falë ata që e kritikojnë. Egoizmi i shprehur i gruas, atë e bën të mospranueshme nga rrethi. Kjo gjendje emocionale, e shtyen gruan simpatinë ndaj saj dhe kështu krijon një autoritet dhe gjendje despotizmi. Burri për shkak të aftësive mendore nga natyra është skeptik, por skepsa e tij s'është e qëndrueshme si tek gruaja. Ajo gjithmonë ndjen mosbesim dhe një joqëndrueshmëri në marrëdhënie me njerëzit që e rrethojnë.”⁵¹³

Këto analiza të psikologjisë së femrës, tregojnë se ajo me natyrën e saj nuk është e përshtatshme të mirret me politikë që, posaçërisht në kohërat tona është bërë një profesion tërheqës.

Sot, në shumë vende të botës të drejtat politike të gruas janë të barabarta me ato të burrit. Por në realitet këto të drejta gruaja i shfrytëzon vetëm pjesërisht. Njohim shumë pak gra të cilat pasi u zgjedhën për një funksion të kenë arritur rezultate të mëdha. Njohim gra deputete dhe senatore, madje edhe presidente të shteteve, të qeverive, si dhe ministresha. Por ato më shpesh luanë rol simbolik. Punët kryesore i kryejnë meshkujt që gjenden pranë tyre. Sipas kësaj praxa flet se gruaja në lëmin e politikës nuk luan rol relevant dhe të përhershëm.

Të drejtat politike të gruas në ligjet politike

Në Kur'anin Famëlartë nuk ka shpallje të qarta lidhur me të drejtat politike të gruas. Në të janë vetëm ajete që në mënyrë indirekte kanë të bëjnë me këtë çështje. Për shkak të interpretimeve të ndryshme të agrumenteve nga Kur'ani dhe Sunneti, si dhe të praksës nga agimi i Islamit, u sollën gjykime të ndryshme:

1. Gruaja i ka të gjitha të drejtat politike, duke përfshirë këtu edhe të drejtën të jetë kryetare e shtetit;
2. Gruaja nuk ka asnjë të drejtë politike;
3. Ka të drejtë të zgjedhë por jo edhe të jetë e zgjedhur.

Tani disa fjalë për anët pozitive dhe negative të këtyre mendimeve.

Kryesia shtetërore

“Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë e ndalojnë nga e keqja...”⁵¹⁴

Në këtë ajet në Kur'anin Famëlartë përmendet *“emr bil-ma'ruf, nehj anil-munker: urdhërim për të mirë, e ndalim nga e keqja”*. Këtë detyrë mund ta kryejnë si meshkujt besimtarë poashtu edhe gratë besimtare. Politika, duke përfshirë këtu edhe funksionin kryetar të shtetit s'është asgjë tjetër veç akti i kryerjes së porosisë së ajetit të lartcituuar. Sipas kësaj, gruaja mund ta ushtrojë këtë detyrë.

Në Kur'anin Famëlartë flitet për mbretëreshën nga Sebe, Belkisën dhe për marrëdhëniet e saja me Sulejmanin.⁵¹⁵ Kjo grua ishte kryetare e shtetit. Prof. Muhammed Hamidullah në ligjeratat e tij në Institutin për Hulumtime Islame, duke u mbështetur në këtë ajet, thotë se gruaja mund të jetë kryetare e shtetit.

Kritikë: Asnjë prej ajeteve që mirren si argumente se gruaja mund të jetë kryetare e shtetit nuk jep fakte të qarta lidhur me këtë. Detyra *“emr bil ma'ruf, nehj anil-munker”* është detyrë që u përket të gjithë besimtarëve brenda kufinjëve të mundësive të tyre. Siç theksohet në një hadith, kjo detyrë kryhet me dorë (forcë), po s'pati mundësi që të kryhet me dorë, atëherë kryhet me fjalë ose me shkrim. Nëse me këto s'mund të kryhet atëherë kryhet me zemër, duke shprehur urrejtje ndaj të keqes. Kjo vlen edhe për kryetarin e shtetit.

Mbretëresha e Sebes, Belkisa, ishte sunduese para se t'i dorëzohet Sulejmanit. Por në atë kohë ajo s'ishte muslimane, i falej diellit. E prej se iu dorëzua Sulejmanit a.s. ajo pranoi fenë Islame. Më pastaj në Kur'an s'bëhet fjalë se ishte mbretëreshë. Sipas kësaj, situata e një femre që i falet zjarrit nuk mund të jetë argument për një muslimane.

Por, lidhur me këtë çështje, ekzistojnë hadithe të qarta dhe precize të Pejgamberit a.s. Ebu Bekre r.a. thotë: Muhammedi a.s. pasi që mori vesh se vajza e mbretit të Iranit u bë sunduese, tha:

“Një popull i cili problemet e veta ia beson dorës së gruas, assesi nuk mund të jetë fatlum.”⁵¹⁶

Mendimi se gruaja nuk ka asnjë të drejtë politike

Një grup tjetër mendon se gruaja s' duhet të ketë asnjë të drejtë politike. Sipas këtij mendimi gruaja s' ka të drejtë për "*Vilajet-i amme*" që do të thotë se nuk ka të drejtë të jetë deputete në parlament. Gruaja nuk mund as të votojë dhe as të jetë e votuar. Ajo mund të gjendet në ndonjë pozitë burokrate që s' ka karakter politik. Mund të jetë gjykatëse, ndërmjetëse në transaksione tregëtare, mbikqyrëse në punët e trashëgimisë, poashtu edhe në punët e vakëfit, sepse këto i takojnë "*Vilajeti Hasses*".

Gruaja s' ka të drejtë vote. Edhe pse në këtë drejtim s' ka argumente precize të ndonjë ajeti dhe hadithi megjithatë në kohën e Pejgamberit a.s. dhe halifëve, gruaja s' kishte asnjë të drejtë vote gjatë zgjedhjes së këshillave dhe halifëve. Veç tjerash ajo duhet të shkojë bashkë me burrin në mitingje, e kjo në Islam është e ndaluar.⁵¹⁷ Nga kjo rrjedh se, po s' pati të drejtë të votojë, ajo nuk e gëzon as të drejtën të jetë e votuar.

Më, 1952, Komisioni për sjelljen e fetvave pranë Unevirsitetit El-Ez'her, solli fetvanë se gruaja s' ka të drejtë të jetë e zgjedhur si anëtare e as të votojë për anëtarë të parlamentit.⁵¹⁸

Ky qëndrim që është shumë i ashpër do të jetë i kritikuar në tekstin që vijon.

E drejta të jetë e zgjedhur

Hadithi i përmendur më parë i Ebu Bekres, flet se gruaja nuk mund të bëhet kryetare e shtetit ose anëtare e parlamentit, funksione që janë të tipit Vilajeti Amme. Pejgamberi a.s. në një hadith tjetër thotë:

“Nëse udhëheqësit tuaj janë më të mirët më të pasurit, më mëshiruesit, dhe në qoftë se punët tuaja i rregulloni duke u këshilluar, sipërfaqja e tokës do t’u jetë më e mirë nga brendësia e saj. Por nëse udhëheqësit tuaj janë më të këqinjët, më të pasurit janë më koprracët midis jush, dhe nëse punët tuaja zhvillohen sipas urdhërave dhe nën kontrollin e grave tuaja, atëherë brendësia e tokës do t’u jetë më e mirë se sipërfaqja e saj.”⁵¹⁹

Parlamenti është organi më i lartë në aparatin shtetëror. Anëtari i parlamentit është reprezent i popullit që e ka zgjedhur në këtë funksion. Kjo s' është përfaqësi e thjeshtë. Nga kjo pikëpamje, gruaja mund të merr pjesë në aktivitetet tjera juridike, ky funksion sipas një analogjie nuk mund të vazhdojë edhe në funksionin anëtare e parlamentit.⁵²⁰ Ajeti nga Kur'anit Famëlartë "*Burrat janë përgjegjës për gratë*" nënkupton se gruaja nuk mund të jetë anëtare e parlamentit.⁵²¹

Siç theksuam edhe më lartë, gruaja, psikikisht nuk është përshtatshme të jetë anëtare e parlamentit, funksion ky, që kërkon përgjegjësi të madhe, e ajo nuk është e aftë për një aventurë politike të tillë. Vërtet sipas Kur'anit Famëlartë, prejardhja e gruas dhe burrit është nga i njëjti burim.⁵²² Por, kjo nuk dëshmon se duhet të kenë barazi të plotë. Nëse do të ishte ashtu, atëherë, duke u mbështetur në ajetin: "*...Ujin e bëmë bazë të jetës*"⁵²³ do të ishte e drejtë të themi se të gjitha krijesat janë të barabarta. Në realitet, gruaja, për nga obligimet dhe përgjegjësitë dallohet nga mashkulli. Gruaja nuk është e obliguar të shërbejë në ushtri, ajo nuk merr pjesë në luftë. Ajo nuk është e detyruar të punojë për ta siguruar

ekzistencën familjare. Meqë nuk ekziston asnjë e drejtë pa obligime dhe përgjegjësi, atëherë nuk është e drejtë që çdo e drejtë që i takon burrit t'i takojë dhe gruas.

Në Kur'anin Famëlartë grave të Pejgamberit a.s. e sipas kësaj edhe të gjitha grave muslimane⁵²⁴ u urdhërohet të qëndrojnë në shtëpi në një atmosferë të qetë dhe të rehatshme e jo si në periudhën e parazbritjes së Kur'anit (xhahilijetit) kur shëtisnin bashkë me burrat e huaj në një atmosferë të afërt dhe intime. Poashtu, sipas parimit “të ruajtjes së moralit seksual”, nuk janë të obliguara të marrin pjesë në namazin e xhumasë dhe Bajramit si dhe të falin namazin me xhemaat, poashtu edhe anëtarësimi në parlament dhe pjesëmarrja në tubimet e përgjithshme bashkë me meshkujt, për gruan nuk janë situata të dëshirueshme.

Nëse anëtarësimi i gruas në parlament arsyetohet me mbrojtjen e të drejtave të saja, atëherë ajo, ato të drejta mund t'i realizojë nëpërmjet të shoqatave speciale në institucionet publike. S'ka përse meshkujt t'i uzurpojnë të drejtat e grave. A, s'janë ata djem, burra dhe vëllezër të tyre (grave)? Vallë, a nuk e dojnë ata lumturinë e tyre. Në realitet, sipas të drejtës islame, parlamenti nuk paraqet fuqi të madhe ligjdhënëse. Përndryshe ligjdhënës (Shari') është vetëm All-llahu. Parlamenti mund të bëjë intervenime dhe porosi vetëm brenda kufijve që i ka përcaktuar All-llahu.

Disa shkencëtarë mendojnë se është arritur konkluzion i përbashkët se në periudhën e parë të Islamit muslimanët nuk u kanë lejuar grave pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë në punët e shtetit.⁵²⁵

E drejta të votojë

Në argumentet që i ndalojnë gruas të jetë kryetare shteti dhe anëtare e parlamentit nuk ka asgjë që i pengon asaj te ketë të drejtë vote. E drejta e natyrshme e gruas është të votojë. Derisa të mos gjendet ndonjë argument më bindës që do ta rrëzonte këtë argument, kjo e drejtë ngel përgjithmonë. Vendimi i komisionit për fetva nga El-Ez'heri se “*gruaja nuk ka të drejtë të votojë dhe të jetë e votuar*”, është karakteristik për situatën politike në vendin përkatës. Të përsërisim se bëhet fjalë për gruan muslimane në përgjithësi, e jo për ndonjë shtet islam veçanërisht. Në shoqërinë islame s'ka asnjë pengesë që gruaja të ketë të drejtë vote. Gjatë kohës së Pejgamberit a.s. dhe në periudhën pas tij, kryetari i shtetit zgjidhej me besatim (*bej'at*). Është kjo një simbol dhe ceremoni e pranimit të funksionit kryetar shteti. Pejgamberi a.s. shumë herë ka bërë besatim me as'habë, gra e burra. Kjo gjë së pari u bë në Akabë në periudhën e Mekës. Besatimet e Akabës (ku kanë marrë pjesë edhe gratë) janë të njohura në historinë e Islamit.⁵²⁶

Besatimi i të Dërguarit a.s. është përsëritur disa herë në Medinë dhe në ditën e çlirimit të Mekës.⁵²⁷ S'do të ishte e drejtë që këto besatime të trajtoheshin vetëm si manifestime fetare, sepse kanë edhe anën politike. Përndryshe, në ajetin ku i urdhërohet të Dërguarit të Zotit të bëjë besatim me gra, pasi janë numëruar disa specifika fetare, i shpallen edhe këto fjalë: “*...dhe se nuk do të kundërshtojnë në atë që i urdhëron...*”⁵²⁸ Kjo dëshmon për urdhërat e të Dërguarit të Zotit si një kryetar shteti. Në realitet, meqë ai është i Dërguar i All-llahut, besatimi ndaj tij do të thotë besim në pejgamberinë e tij, e kësaj i thuhet iman. Në ajete dhe hadithe termi besatim ekziston. Veç kësaj, nga as'habët ka rivajete sahiha në këtë

kuptim: **“Si me gra, Pejgamberi a.s. ka bërë besatim edhe me ne...”**⁵²⁹ Këto hadithe tregojnë se besatimet që janë bërë me meshkuj e me femra kanë të njëjtën natyrë.

Një specificitet që dëshmon se Pejgamberi a.s. ka bërë besatim me as’habët e tij jo si profet por si burrështeti, është edhe fakti se nuk ka bërë besatim edhe me fëmijë. Por ka ca transmetime autentike që tregojnë se fëmijët e moshës së mitur i kanë kërkuar të bëjnë besatim ose në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet të prindëve të tyre, por i Dërguari a.s. nuk e ka pranuar këtë.⁵³⁰ Nga kjo rrjedh se besatimi i gruas, e dëshmon të drejtën e saj për votim.

Njëra nga gratë e Pejgamberit a.s. Ummi Seleme, në ditën e Hudejbijes, shprehu mendimin dhe këshillën për një situatë të rëndë. Pejgamberi a.s. duke e dëgjuar fjalën e gruas së tij, veproi sipas këshillës së saj, dhe i doli në krye kësaj situatë.⁵³¹

E bija e xhaxhait të Pejgamberit a.s. Ebu Talibit, Ummi Hani në ditën e çlirimit të Mekkes i dha eman (siguri) një idhujtari. Pejgamberi a.s. e pranoi këtë.⁵³² E ky ishte një akt administrativ dhe politik.

Pas Pejgamberit a.s. në periudhën e hulefai rashidinëve, gjendej një shtresë e zgjedhur që e këshillonte halifin. Nuk kishin ditë të caktuar kur mblihdeshin këta. Kur dëshironte halifi i ftonte dhe merrte mendimin e tyre. Veç kësaj, halifi i pyeste për mendimin edhe gratë e të Dërguarit a.s. që qëndronin në shtëpi.

‘Umeri para vdekjes pat thënë që pas tij zgjedhjen e halifit ta bëjnë personat nga ashëre-i mubeshere që ishin në jetë (*ashëre-i mubeshere*: dhjetë persona të cilët Pejgamberi a.s. i kishte përgëzuar me Xhennet). Këta nga rrethi i tyre zgjodhën Abdurrahman b. Avfin për administrator. Sipas shënimeve të Ibën Kethirit, Abdurrahman b, Avfi për ta caktuar halifin, kërkoi mendim edhe nga njerëzit e Medines, dhe në këtë drejtim u ishte drejtuar edhe grave.⁵³³

Pas vrasjes së ‘Uthmanit r.a., Aisheja kërkoi hakmarrje për ‘Uthmanin dhe për këtë gjë ajo e nisi edhe luftën. Kjo është pjesëmarrje e drejtëpërdrejtë në politikë. Një pjesë e parisë e aprovoi këtë sjellje të Aishes ndërsa pjesa e tjetër nuk e aprovoi.

Në librat historike duket se më vonë ajo vetë është penduar. Por, sipas disa të tjerëve ky pendim s’ka qenë nga arsyeja se ishte përzier në politikë por për shkak të disfatës së saj.⁵³⁴

Nëse bëhet një rezymë e kësaj që u tha deri më tani për të drejtat politike të gruas, mund të thuhet se, të drejtat politike edhe pse pranohen si një shkallë më e lartë e realizimit të të drejtave të gruas, prapëseprapë mund të thuhet se ajo, sipas natyrës së saj dhe karakteristikave shpirtërore nuk gjen satisfaksion shpirtëror në aventurën politike. Edhe pse gjatë historisë dhe sot gruaja ka pasë ndonjë funksion, ajo në këtë pikëpamje s’ka arritur rezultate të dukshme. Pjesëmarrja e gruas në politikë paraqet më tepër një pjesëmarrje simbolike.

Sipas të drejtës islame, mendimi për të drejtën e gruas të bëhet kryetare e shtetit dhe anëtare e parlamentit, thuhet se është një mendim i dobët. Juristët, në dritën e argumenteve fetare, të mendjes dhe logjikës, kanë arritur deri në konkluzion se ajo mund të jetë votuese.

Ajete të Kur'anit që flasin për gruan

EL-BEKARE: 35-39, 49, 102, 180, 187, 196-197, 221-223, 225-237, 240-242, 282.
ALI IMRAN: 14, 35-40, 42-47, 61, 195.
EN-NISA: 1, 3-4, 7, 11-25, 32-35, 43, 75, 92, 98-99, 117-118, 124, 127-130, 156, 176.
EL-MAIDE: 5-6, 17, 38, 75, 110, 116.
EL-EN'AM: 9, 87, 98, 100-101, 137, 139-140, 143-144, 151.
EL-A'RAF: 19-25, 27, 83, 126, 141, 150, 189.
ET-TEVBE: 24, 67-68, 71-72.
HUD: 40, 45-46, 71-73, 78-79, 81.
JUSUF: 21, 23-24, 50-51.
ER-RA'D: 8, 23-24, 28.
IBRAHIM: 6.
EL-HIXHR: 59-60, 65, 71, 88.
EN-NAHL: 57-59, 72, 92, 97.
EL-ISRA: 23-24, 31, 40.
MERJEM: 8, 14, 16-36.
TAHA: 38-40, 94, 117, 123.
EL-ENBIJA: 94, 90-91.
EL-HAXHXH: 2, 5.
EL-MU'MINUN: 5-7, 27, 50.
EN-NUR: 2-20, 23-26, 30-33, 60-61.
EL-FURKAN: 74.
ESH-SHUARA': 165-166, 169-171.

EN-NEML: 7, 23-44, 55-57.
EL-KASAS: 9, 9-13, 23-29.
EL-ANKEBUT: 29, 32-33.
ER-RRUM: 21.
LLUKMAN: 14-15, 34.
EL-AHZAB: 4, 6, 28-37, 50-55, 58-59, 73.
JASIN; 36.
ES-SAFFAT: 133-135, 149-153.
SAD: 43-44.
EZ-ZUMER: 6.
EL-MUMIN: 8, 24-26, 40.
ESH-SHURA:49-50.
EZ-ZUHRUF: 12, 16-19, 70-71.
EL-AHKAF: 15.
MUHAMMED: 22.
EL-FET'H: 11-12, 25.
EL-HUXHURAT: 11-13.
EDH-DHARIJAT: 26-30, 49.
ET-TUR: 25-27, 39.
EN-NEXHM: 21-22, 27-28, 32, 45-46.
EL-HADID: 12-13.
EL-MUXHADELE: 1-4.
EL-MUMTEHINE: 10-12.
ET-TEGABUN:14.
ET-TALAK: 1-7.
ET-TAHRIM:1-6, 10-12
EL-ME'ARIXH:11-12, 29-31.
EL-XHINN: 3.
EL-ABESE; 34-37.
ET-TEKVIR: 8-9.
EL-MUTAFFIFIN: 31.

EL-INSHIKAK:9-13.

EL-BURUXH: 10.

EL-LEJL: 1-3.

TEBET: 4-5.

EL-FELEK: 4.

Ajetet lidhur me hyritë e Xhennetit

EL-BEKARE: 5.

ALI IMRAN: 15.

JASIN: 55-56.

ES-SAFFAT: 48-49.

SAD: 52.

ED-DUHAN: 54.

ER-RAHMAN: 56-59, 70-74.

EL-VAKIA: 23, 35-38.

EN-NEBE': 31-34.

LITERATURA E KONSULTUAR

Tefsir

1. Muhammed b. Xherir et-Taberi, "*Xhamiu'l-bejan fi tefsiri'l-Kur'an*", Bulak, 1323.
2. Xhelaluddin es-Sujuti, "*ed-Durru'l-mensur fi t-tefsir bi'l-me'thur*", Egjipt, 1314.
3. Ebu'l-Fida Ismail Ibn-i Kethir, "*Fet'hu'l-Bejan fi makasidi'l-Kur'an*", Kajro, botim i Isa el-Babi el-Halebiut.
4. Fahrudin er-Razi, "*Mefatihul-gajb*", Stamboll. 1294.
5. Muhammed b. Ali esh-Shevkani, "*Fethu'l-Kadir*", "*el-Xhami' bejne fenneji'r-ravije ve'd-diraje min ilmit't-tefsir*", Egjipt 1349-1351.
6. Bejdavi, "*Envaru't-Tenzil ve ensaru't-te'vil*", Stamboll, 1314.
7. Ebussuud Muhammed b. Muhammed el-Imadi, "*Irshadu'l-akli's-selim ila mezaji'l-Kerim*". Egjipt 1952.
8. Sejjid Kutb, "*Fi Dhilali'l-Kur'an*", Kajro (Botimi i parë).
9. Ebu'l-A'la el-Mevdudi, "*Tefsiru Sureti'n-Nur*", përktheu në arabishte: Muhammed Asim el-Haddad, Damask, 1960.
10. Elmalik Muhammed Hamdi Yazir "*Hak Dini Kur'an Dili*", Stamboll 1935-1938.
11. Ebu Bekr er-Razi el-Xhessas, "*Ahkamu'l-Kur'an*", Stamboll, 1935.
12. Muhammed Ali es-Sajis, "*Tefsiru ajati'l-Ahkam*", Kajro.
13. Xhelaluddin es-Sujuti, "*Lubabu'n-nukul fi esbabi'n-nuzul*".

Hadith

1. Muhammed b. Ismail el-Buhari, “*El-Xhamiu’s-sahih*”, Stamboll, 1315.
2. Bedruddin Muhammed el-Ajni, “*Umdetu’l-ka’ri fi sherhi Sahihi’l-Buhari*”, Stamboll 1308. Ahmed Zabidi, Kamil Miras, “*Sahih-i Buhari Muhtasar*” - *Tecrid-i Sarih Tercemesi*”, Stamboll 1948.
3. Muslim b. el-Haxhaxh el-Kushejri, “*Sahihu’l-Muslim*”; (botues: Muhammed Fuad Abdalbaki), Kajro, 1955.
4. Imam en-Nevevi, “*Sahihu Muslim bi sherhi’n-Nevevi*”, Kajro, 1349.
5. Velijjudin Muhammed el-Hatib et-Tabrizi, “*Mishkatu’l-mesabih*” (Muhammed Nasiruddin el-Albani), Damask, 1961-1962.
6. Mansur Ali Nasif, “*Et-Taxh el-Xhami lil-usul fi ahadithi’r Resul*”, Egjipt 1961-1962.
7. Muhammed b. Ali esh-Shevkani, “*Nejlu’l-evtar sherhu Munteka’l-ahbar*”, Egjipt, 1961.
8. Abdurrauf el-Munavi, “*Et-Tejsir bi sherhi’l-Xhamii’s-sagir*”, Egjipt, 1286.
9. Ismail b. Muhammed el-Axhluni, “*Kefshu’l-hafa ve muzilu’l-ilbas amme’shtehere mine’l-ahadis ala elsineti’n-nas*”, Egjipt 1351.
10. Ibën Hamza el-Husejni el-Hanefi, “*El-Bejan ve’t-ta’rif fi ashabi vurudi’l-hadisi’sh-sherif*”, Haleb, 1329.
11. Zejnuddin el-Iraki, “*El-Mugni an hamli’l-esfar fi tahrishi ma fi’l-Ihja mine’l-ahbar*”.

E drejta islame

1. Kemaluddin Ibnu'l-Humam, "*Fet'hu'l-Kadir*". Egjipt, 1356.
2. Ez-Zejla'i, "*Nasbu'r-raje li ahadithi'l-Hidaje*", Egjipt 1938.
3. Ibën Abidin, "*Reddul-muhtar ala-Durri'l-muhtar*", Stamboll 1291.
4. esh-Sha'rani, "*El-Mizanu'l-kubra*", Egjipt, 1940.
5. Ebu Abdillallah Muhammed Ebu'l-Fazl Mexhdudin el-Mevsili, "*El-Ihtijar li ta'lili'l-Muhtar*", Egjipt, 1956.
6. Ebu Abdillallah Muhammed b. Abdirrahman ed-Dimashki, "*Rahmetu'l-umme fi'htilahi'l-eimme*".
7. Ibën Hazm, "*El-Muhal-la*", Kajro, 1351-1352.
8. Ibën Kajjim el-Xhevziije, "*I'lamu'l-muvakkiin an Rabbi'l-alemin*" (botim i M. Muhiddin Abdulhamid) Egjipt, 1955.
9. el-Maverdi, "*El-Ahkamu's-sultanijje ve'l-vilajetu'd-dinijje*", Egjipt. 1960
10. Abdurrahman el-Xheziri, "*Kitabu'l-fikh ale'l-medhahibi'l-erbaa*", Egjipt.
11. Abdulkadir Aude, "*Et-teshri'ul-xhinaiju'l-Islami mukarinen bi'l-kanuni'-vud'i*", Egjipt 1959.
12. Muhammed Zahid el-Kevtheri, "*Makalatu'l-Kevtheri*" (botim i Ahmed Hajrit) Kajro, 1372.
